

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6204
31 dhjetor 2020 dhe
1, 2 e 3 janar 2021



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

Lamtumirë, vit i mbrapshtë!

Në numrin ekskluziv dhe festiv të gazetës “Epoka e re” do të lexoni intervista, opinione, shkrime nga politika, ekonomia, kultura dhe sporti

Po në këtë numër mund të lexoni për ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur në Kosovë gjatë vitit 2020 dhe në botë

Për numrin festiv të gazetës “Epoka e re” gazetari Nuhi Bytyçi sjell kujtime nga festimi i Vitit të Ri 1999 në zonat e luftës

**SHKRUAJNË ENKAS
PËR “EPOKËN E RE”:**

REXHEP QOSJA
AGIM VINCA
BEHXHET SHALA
MILAZIM KRASNIQI
EDITA TAHIRI
ISMAIL SYLA
SHKELZEN MALIQI
VALON MURATI
FERAT SHALA
FATON ABDULLAHU
ARIAN ZEKA
TAHIRI AHMETI etj...

2020

**PRINCESHA**
GROUP SH.P.K.

ND, RTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

RENOVA
PUTZ

Magdoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

**DINO**

Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

**Bunjamini**

FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË

044/256-051
044/367-061
028/532-617

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 870 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIJA VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
SIGMA INTERALBANIJA VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



KOSOVA GJATË VITIT 2020

EPOKA ERE Përgatiti: **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, DHJETOR / JANAR - Republika e Kosovës gjatë vitit 2020 është ballafaquar me sfida të mëdha. Gjatë këtij viti janë rrezuar dy qeveri, ajo e drejtuar nga Albin Kurti dhe qeveria e udhëhequr nga Avdullah Hoti. Po gjatë vitit 2020 Kosova është ballafaquar me Gjykatën Speciale, ku tashmë gjenden në Hagë ish-drejtesit kryesorë të UÇK-së, por edhe me pandeminë Covid-19.

Kurti bëhet kryeministër

3 shkurt - Me 66 vota Kuvendi i Kosovës ka votuar për formimin e qeverisë së re të udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, e cila pati dalë e para në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit të vitit të 2019. Kosova ishte bërë me qeveri të re gati katër muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve dhe votimi i saj erdhi pas negociatave të gjata ndërmjet LV-së dhe LDK-së. Para se të votohej qeveria Kurti, partitë opozitare, PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma Socialdemokrate, e kanë lëshuar sallën. Qeveria e re kishte 15 ministri. Kryeministri i ri kishte edhe dy zëvendëskryeministra, kurse në përbërjen e saj kishte edhe 33 zëvendësmministra.

Vjosa Osmani bëhet kryetare e Kuvendit

3 shkurt - Vjosa Osmani është zgjedhur kryetare e Kuvendit të Kosovës. Ajo ka marrë 65 vota të deputetëve. Më 26 dhjetor të vitit 2019 këtë pozitë e kishte marrë Glauk Konjufca, mirëpo për shkak të arritjes së marrëveshjes politike LV-LDK kishin rënë dakord që këtë pozitë t'ia kalojnë LDK-së. Ndërsa

Glauk Konjufca ishte zgjedhur ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Konjufca propozon tërheqjen e disa ambasadorëve nga misionet diplomatike

3 mars - Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka propozuar tërheqjen nga misionet diplomatike të gjashtë ambasadorëve dhe një konsulli. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se personat e propozuar për tërheqje nga misionet diplomatike janë: Vlorë Çitaku (Uashington), Edon Cana (Sofje), Lirim Grejçevci (Hagë), Shpend Kallaba (Budapest), Mimoza Ahmetaj (Strasburg), Ylber Hysa (Podgoricë) dhe Ramadan Avdiu (konsull në Gjenevë). Po ashtu, Konjufca ka shkarkuar edhe disa konsuj të cilët kanë qenë duke shërbyer në disa vende të botës.

Covid-19 prek edhe Kosovën

13 mars - Në Kosovë janë konfirmuar rastet e para me koronavirus. Numri total i rasteve pozitive është 50 910 raste nga 181 148 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 1 325 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 454 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 40 423 raste, kurse numri i rasteve aktive është 9 162.

Kurti shkarkon Veliun

18 mars - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka shkarkuar nga detyra ministrin e Punëve të Brendshme (MPB), Agim Veliu. Zyra e Kryeministrit të Kosovës përmes

një njoftimi pati njoftuar se shkarkimi i Veliut kishte ndodhur për shkak të deklarimit kundër qëndrimit të kryeministrit Kurti mbi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Shkarkimi i Veliut ishte bërë shkak që të priset koalicioni në mes të Vetëvendosjes dhe LDK-së.

Rrëzohet qeveria e Kurtit

25 mars - Me 82 për, 32 kundër dhe një abstenim, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar pro mocionit të mosbesimit të qeverisë, duke e shkarkuar kështu qeverinë e udhëhequr nga Albin Kurti, e cila nuk pati jetëgjatësi më shumë se 50 ditë pune. Mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë Kurti ishte iniciuar nga LDK-ja dhe ishte mbështetur nga partitë e tjera parlamentare në Kuvendin e Kosovës, përfshirë edhe Listën Serbe. Ndryshe nga grupi i saj parlamentar, LDK-ja, Vjosa Osmani ka votuar kundër këtij mocioni.

Kurti shkarkon Hotin nga pozita e zëvendëskryeministrit

26 mars - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, kishte marrë vendim për lirin nga posti i zëvendëskryeministrit të parë, Avdullah Hoti. Këtë vendim ai e kishte marrë pas mesnate, jo shumë kohë pas miratimit të mocionit të mosbesimit, që i kishte dhënë fund qeverisë Kurti.

Kushtetuesja i jep të drejtë Thaçit për dekretin

28 maj - Gjykata Kushtetuese ka vendosur që t'i japë të drejtë presidentit Hashim Thaçi rreth dekretit për mandatarin e qeverisë.

Kushtetuesja kishte vlerësuar se presidenti ka vepruar në përputhshmëri me Kushtetutën me rastin e mandatimit të Avdullah Hotit për kryeministër nga LDK-ja. Dekretin e presidentit Thaçi në Kushtetuese e kishte dërguar për interpretim Vetëvendosja, pasi ajo si parti fituese e zgjedhjeve këmbëngulte se Kushtetuta ia mundëson vetëm asaj propozimin e mandatarit për formim të qeverisë.

Avdullah Hoti zgjedhet kryeministër

3 qershor - Deputetët e Kuvendit të Kosovës për herë të parë në historinë e Kosovës e kanë votuar një qeveri e cila nuk e përfshinë fituesin e zgjedhjeve. Me 61 vota për, 24 kundër dhe një abstenim, deputetët e Kuvendit e kanë zgjedhur Qeverinë e re të Kosovës, e cila do të drejtohej nga kryeministri Avdullah Hoti. Qeveria e re është kundërshtuar nga Lëvizja Vetëvendosje, PDK-ja dhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, e cila, në shenjë pakënaqësie, nuk e ka drejtuar këtë seancë. ShBA-ja, BE-ja, presidenti Thaçi, kancelari austriak dhe liderët shqiptarë e kanë përshëndetur formimin e qeverisë së re.

Vjosa Osmani shkarkohet nga pozitat udhëheqëse në LDK

21 qershor - Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka shkarkuar Vjosa Osmanin nga posti i nënkryetares së partisë dhe anëtares së kryesisë, kurse Osmani i ka paralajmëruar të gjithë ata që votuan për largimin e saj nga këto pozita, se do të shihen së shpejti në zgjedhje. Kryetari i LDK-së, Isa

Mustafa, ka njoftuar se për shkarkimin e Osmanit nga posti i nënkryetares dhe anëtares së kryesisë kanë votuar për 70 anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm, 16 kanë qenë kundër dhe 28 nuk kanë marrë pjesë në votim, i cili është zhvilluar në mënyrë elektronike.

Anulohet takimi i Uashingtonit

25 qershor - Është anuluar takimi i 27 qershorit në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë pasi kryeministri Avdullah Hoti ka bërë me dije se nuk do të shkojë në këtë takim pasi Gjykata Speciale ka publikuar aktakuzën ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli. I dërguari i posaçëm i ShBA-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, ka mirëkuptuar vendimin e kryeministrit të Kosovës. Thaçi ishte kthyer nga rruga për Uashington pas marrjes së lajmit nga Gjykata Speciale.

Kushtetuesja e shpall të pavlefshëm Ligjin për pagat

30 qershor - Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka shpallur të pavlefshëm Ligjin për pagat në sektorin publik. Sipas vendimit, ligji nuk është në përputhshmëri me 11 nene të Kushtetutës së Kosovës. "Shkeljet kushtetuese të evidentuara në Ligjin e kontestuar janë të një peshe aq serioze saqë të njëjtat ndikojnë në bërthamën e funksionimit të qeverisjes në Republikën e Kosovës, duke shkaktuar çrregullim të ndarjes së pushteteve në disfavor të gjyqësorit dhe institucioneve të pavarura", është thënë në vendimin e Kushtetueses.



Mbahet Samiti i Parisit për Kosovën dhe Serbinë

10 korrik - Nën ndërmjetësimin e Francës, Gjermanisë dhe BE-së është mbajtur samiti virtual ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në këtë samit, që shënon takimin e parë ndërmjet përfaqësuesve politikë të Kosovës dhe Serbisë, palët i kanë prezantuar objektivat e këtij procesi. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se procesi duhet të ketë afate kohore dhe të përfundojë me njohje reciproke. Ndërsa presidenti i Serbisë, kërkesat e Kosovës i ka quajtur të pakuptimta.

Thaçi intervistohet nga Gjykata Speciale

13 korrik - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është intervistuar për tri ditë me radhë në Hagë nga Gjykata Speciale. Para se të hynte në objektin e Gjykatës Speciale, ai është shprehur i gatshëm të përballet me këtë sfidë, duke mohuar të gjitha pretendimet e kësaj gjykate. Ai ka deklaruar se askush nuk mund ta rishkruajë historinë dhe se ky është çmimi për lirinë.

Në Amerikë nënshkruhet marrëveshja ekonomike Kosovë - Serbi

4 shtator - Republika e Kosovës dhe Serbia kanë nënshkruar marrëveshjen për normalizim ekonomik në Shtëpinë e Bardhë. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, marrëveshjen e kanë nënshkruar në prani të presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, në Zyrën Ovale. Pas ceremonisë së nënshkrimit, presidenti Trump këtë marrëveshje e ka vlerësuar historike. "Pas një historie të dhunshme dhe tragjike dhe vitesh negociatash të dështuara, administrata ime propozoi një mënyrë të re për ta kapërcyer ndarjen", ka deklaruar ai, duke shtuar se Kosova dhe Serbia kanë shprehur përkushtimin e tyre që t'i

normalizojnë raportet ekonomike.

Izraeli njeh Kosovën shtet

4 shtator - Menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes Kosovë - Serbi në Uashington, Izraeli e ka njohur Republikën e Kosovës. Kurse kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka folur për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën. "Kosova ka rënë dakord ta hapë ambasadën në Izrael, konkretisht në Jerusalem", ka deklaruar ai. Sipas tij, Kosova është bërë vendi i parë me shumicë myslimane që do ta ketë ambasadën në këtë vend. Duke folur në Shtëpinë e Bardhë, presidenti amerikan Trump ka thënë se Serbia ka shprehur përkushtimin ta zhvendosë ambasadën e vet nga Tel Avivi në Jerusalem. Edhe kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu e ka konfirmuar këtë lajm.

Salih Mustafa, i arrestuari i parë i Gjykatës Speciale

24 shtator - Zyra e Prokurorit të Specializuar, me seli në Hagë, ka njoftuar të enjten se ka bërë arrestimin e parë në Kosovë. I dyshuari i parë që është arrestuar nga Gjykata Speciale është ish-ushtari i UÇK-së, Salih Mustafa, zyrtar i lartë në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes. Arrestimin e tij e ka konfirmuar Zyra e Prokurorit të Specializuar.

EULEX-i arreston Gucatin dhe Haradinajn, i dërgohen në Hagë

25 shtator - Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka bastisur zyrat e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK). Gjatë këtij aksioni, në të cilin kanë marrë pjesë edhe hetuesit e Gjykatës Speciale, është arrestuar kryetari i kësaj organizate, Hysni Gucati, i cili është dërguar për në

Hagë. Ndërkaq vetëm dy orë më vonë është arrestuar edhe nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj. Pas arrestimit të tyre, ata janë dërguar në Hagë, ku më vonë u është konfirmuar aktakuza nga Gjykata Speciale për pengimin e drejtësisë.

Arrestohet Jakup Krasniqi, dërgohet në Hagë

4 nëntor - Pas konfirmimit të aktakuzës nga Gjykata Speciale në Hagë është arrestuar ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi. Arrestimi është bërë pas një aksioni të bastisjes në shtëpinë e Krasniqit nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, e mbështetur nga EULEX-i. Avokati i Krasniqit, Valon Hasani, ka deklaruar se pas arrestimit klienti i tij pritet të dërgohet në Hagë. Ai ka thënë se Krasniqi dyshohet për vepra të cilat nuk janë të specifikuar, por janë në kuadër të veprave që bien nën juridiksionin e Speciales. Aksioni i bastisjes është kritikuar nga OVLUÇK, Nisma Socialdemokrate dhe shumë ish-bashkëluftëtarë të Krasniqit.

Thaçi jep dorëheqje nga detyra e presidentit, shkak konfirmimi i aktakuzës nga Specialja

5 nëntor - Hashim Thaçi ka dhënë dorëheqje nga detyra e presidentit pasi ndaj tij është konfirmuar aktakuza nga Gjykata Speciale. Ai ka deklaruar se nuk dëshiron të shkojë para Dhomave të Specializuara si president i Kosovës. "Ashtu, siç kam premtuar, nuk do të lejoj në asnjë rrethanë që para gjyqit të dal presidenti i Republikës së Kosovës. Prandaj, për ta mbrojtur integritetin e Presidencës së Republikës së Kosovës, integritetin e shtetit të Kosovës, integritetin dhe dinjitetin e qytetarit të Kosovës, popullit të Kosovës, duke respektuar edhe partneritetin edhe me bashkësinë ndërkombëtare, unë sot jap dorëheqje nga pozita e presidentit të Republikës së Kosovës", ka deklaruar Thaçi.

Aktakuza e Speciales, Veseli tërhiqet nga pozitat politike

5 nëntor - Pas konfirmimit të aktakuzës nga Gjykata Speciale, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, kishte bërë me dije se do të tërhiqet nga të gjitha pozitat politike. "E vlerësoj faktin që Dhomat e Specializuara kanë treguar mirësjellje duke më nisur një ftesë për t'u paraqitur në gjykatë në vend se të më arrestonin në mënyrë të padinjitetshme. Unë i jam përgjigjur këtij akti mirësjelljeje, duke u pajtuar që të udhëtoj këtë mëngjes për në Hagë me përfaqësues të Tribunalit, ku formalisht do të paraqitem para trupit gjykues për t'u përgjigjur akuzave të bëra dhe për të nisur një proces të gjatë të mbrojtjes", kishte thënë Veseli.

Rexhep Selimi dërgohet në Hagë

5 nëntor - Bashkë me Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin për në Hagë ka udhëtuar edhe Rexhep Selimi, gjithashtu një nga themeluesit e UÇK-së, shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, të cilit një ditë më parë i është konfirmuar aktakuza nga Specialja. Ai ka thënë se do të shkojë në Hagë kokëllartë. "Unë po shkoj me kokën lart dhe kurdo që kthehem do të kthehem me kokën lart sepse isha, jam dhe do të jem ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të cilën jam i gatshëm të jap gjithçka nga vetja. Ideali i asaj ushtrie të lavdishme është mbi mua, mbi këdo, mbi gjithçka. Mirë u takofshim në fitoren e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!", ka shkruar Selimi në profilin e vet në "Facebook".

Hoti i kërkon Gashit ta lirojë detyrën e shefit të AKI-së

17 dhjetor - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i ka kërkuar

Kreshnik Gashit që të lirojë detyrën e drejtorit të Agjencisë Kosovare për Inteligjencë (AKI). Zyra e Kryeministrit Hoti nuk ka ofruar më shumë hollësi rreth kësaj kërkesë. Më 25 nëntor të vitit të kaluar, Gashi ishte emëruar në këtë pozitë nga Ramush Haradinaj, i cili atëbotë mbante pozitën e kryeministrit të Kosovës. Paraprakisht, Kreshnik Gashi ka mbajtur pozitën e kryetarit të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës (ARKEP).

Bie qeveria Hoti

21 dhjetor - Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim që Kosova të shkojë në zgjedhje. Vota e deputetit Etem Arifi është shpallur e pavlefshme dhe kësajsoj edhe qeveria Hoti nuk është më legjitime. Gjykata Kushtetuese ka nxjerr aktgjykim pro kërkesës së Lëvizjes Vetëvendosje për shpalljen të pavlefshëm votimin në Kuvendin e Kosovës për zgjedhjen e qeverisë Hoti më 3 qershor, pasi për këtë qeveri kishte votuar edhe deputeti Etem Arifi, i cili kishte një aktgjykim përfundimtar nga Gjykata e Apelit.

Enver Hoxhaj, kandidat i PDK-së për kryeministër

23 dhjetor - Kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka marrë besimin e strukturave të kësaj partie për kandidat për kryeministër. Sekretari i përgjithshëm i PDK-së, Uran Ismaili, ka thënë se Hoxhaj është kandidati më i mirë për ta drejtuar qeverinë e ardhshme të Kosovës. Ai ka theksuar se Hoxhaj ka punuar gjatë dhe afër me dy burrështetasit e Kosovës, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin. "PDK-ja me kandidatin e saj për kryeministër, Enver Hoxhaj, do të konfirmohet forca më e madhe politike në vend dhe do të dëshmojë edhe një herë si e vetmja që di të qeverisë dhe në qendër të qeverisjes së saj do të jetë qytetari", ka deklaruar Ismaili.





REXHEP QOSJA

PO NA NDAJNË EDHE ATA QË DUHEJ TË NA BASHKONIN

1. Megjithëse numri i tyre është i madh, po dëgjoen rrallë ata që dëshirojnë e që duhet të na bashkojnë.

Megjithëse numri i tyre sot për sot është ende i vogël, po dëgjoen më shpesh ata që po na ndajnë.

Do të them pak fjalë për ata që po na ndajnë, qoftë pse nuk janë, qoftë pse janë të vetëdijshëm se po na ndajnë.

Do të them pak fjalë për ta sepse e di se pas tyre qëndrojnë disa që vërtet dëshirojnë të na ndajnë.

2. Është fjala për dukuri dhe ngjarje sidomos kohën e fundit në fushën e kulturës, dukuri dhe ngjarje që në të shumtën e herës përjashtojnë shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë shtetërore. Dhe kjo ndodh më

së dukshmi në fushën e letërsisë kur flitet për letërsinë! Për të mos u zgjeruar dhe pa qëllimin që kjo temë të trajtohet në gjithë problematikat e saj do të marr në pikëveshtrim vetëm një çështje nga ato që bien në sy haptas kur shkruhet, flitet, bisedohet për letërsinë shqipe në mediat në Shqipëri: çështjen si trajtohet letërsia shqipe? A trajtohet në tërësinë e saj, ashtu si do të duhej – e bashkuar, e njësuar, e tërësishme, apo e ndarë, e veçuar, për të mos thënë e pjesëzuar? Mjerisht, shpesh po ndodh kjo e dyta! Le të jepen disa shembuj këtu.

3. Flitej për risitë më pak tematike e më shumë formale e stilistike në letërsinë e gjysmës së dytë të shekullit njëzet, të krijuar në Shqipëri, vetëm në Shqipëri, e

jo edhe në letërsinë shqipe të krijuar në Kosovë. Dhe, në letërsinë shqipe të krijuar në Shqipëri në atë kohë, e emërtuar letërsia e realizmit socialist, një prej studiuesve të saj gjen një varg veçorish të letërsisë moderne. Nuk do të dijë ky studiues i letërsisë së asaj kohe se moderniteti me të gjitha veçoritë e tij përmbajtjesore e formale ishte zyrtarisht i ndaluar në realizmin socialist ashtu siç ishte i ndaluar edhe në veprat e shkrimtarëve të asaj kohe, që shkruanin duke iu përmbajtur asaj doktrine.

Përmbajtje, vargje, rrëfime, veçori gjuhësore dhe stilistike, gjedhe moderne letërsisë shqipe të asaj kohe do t'i sjellin vetëm letërsia shqipe e krijuar në Kosovë dhe letërsia e arbëreshëve të Italisë. Cila është arsyeja pse duhet me

patjetër të kërkohen elemente moderniste në letërsinë e realizmit socialist, pse duhet dhe kujt i shërben heshtja për letërsinë e Kosovës gjatë asaj kohe? Nuk e di pse s'i donte shkrimtarët e Kosovës ky, ky orator: a pse s'e donte Kosovën apo pse i kishin hyrë në hak shkrimtarët modernë! Pse, X studiuesi i letërsisë shqipe, dhe jo vetëm ai, sa herë flet në emisionet për kulturën e për letërsinë në televizion, i bie anash së vërtetës? Pse emërtimin Letërsi shqipe e rrëgon në letërsinë shqipe që krijohet ose krijohet në Shqipëri dhe me dashje a pa dashje shpërfill letërsinë shqipe të krijuar në Kosovë?

4. Në televizionet e Tiranës u tregua kujdesshëm manifestimi në të cilin u dhanë

çmimet e përvitshme kombëtare të letërsisë shqipe – për roman, për poezi, për tregime, për letërsinë për fëmijë, për përkthime. As për njërin gjini, as për njërin lloj letrar nuk iu dha çmim asnjë shkrimtari që jeton e krijon në Kosovë. Asnjëri prej tyre as nuk ishte i propozuar! E pabesueshme! E pabesueshme sepse çmimet u dhanë, si u tha, për letërsinë shqipe – për roman, poezi, tregime, për letërsinë për fëmijë dhe për përkthime, ndërsa me emërtimin letërsi shqipe nuk mund të quhet vetëm letërsia e krijuar në Shqipëri, por e gjithë letërsia shqipe e krijuar prej atyre që shkruajnë shqip pavarësisht ku krejt jetojnë sot. Në Kosovë vitin e fundit janë botuar edhe romane, edhe përmbledhje me poezi, edhe përmbledhje me tregime, që e



meritojnë çmimin kombëtar, që u dha në Tiranë për letërsinë shqipe të Shqipërisë, por jo për Letërsinë shqipe mbarëkombëtare të pandarë siç ndahej dikur për arsye ideologjike e politike. E ata që jepnin çmimin do të duhej të theksonin se ai çmim po jepej për letërsinë shqipe të Shqipërisë.

5. Një shkrimtare, njëkohësisht zyrtare e një institucioni të kulturës dhe disa gazetarë në disa televizione të Tiranës flasin për njëqind veprat e letërsisë shqipe të përkthyer në gjuhën italiane. Dhe, me këtë rast përmendën disa autorë që jetojnë në Shqipëri dhe disa vepra të tyre të përkthyer italisht. Mes tyre nuk ishte asnjë autor që jeton e krijon në Kosovë! E, siç dihet, në gjuhën italiane janë përkthyer qoftë në vitet e shtatëdhjeta e të tetëdhjeta të shekullit të kaluar, qoftë në këta

njëzet vjetët e shekullit njëzet e një, përmbledhje me poezi, përmbledhje me tregime, drama, dhe disa romane të shkrimtarëve shqiptarë që jetojnë e krijojnë në Kosovë. Kjo shpërfillje e letërsisë shqipe që është krijuar e po krijohet në Kosovë është pasojë e moskujdesit të atyre që s'e dinë se Letërsi shqipe emërohet vetëm letërsia shqipe (gjithëkombëtare), kurse letërsia shqipe që krijohet vetëm në Shqipëri, vetëm në Kosovë, vetëm në Maqedoni, në Mal të Zi a te arbëreshët e Italisë mund të quhet vetëm letërsia shqipe e Shqipërisë, letërsia shqipe e Kosovës, letërsia shqipe e arbëreshëve të Italisë e kështu me radhë.


6. Një studiues i letërsisë dhe disa bashkëbisedues të tij në një televizion të Tiranës biseduan për venomet e trajtuara në letërsinë shqipe. Ndër veprat në të cilat ishin trajtuar ato

venome që nga fillimet e gjysmës së dytë të shekullit njëzet e deri sot dhe ndër emrat e shkrimtarëve që i kishin shkruar ato vepra e që i përmendën studiuesi dhe bashkëbiseduesit e tij nuk ishte asnjë vepër dhe asnjë shkrimtar shqiptar që kishte jetuar e jeton dhe që kishte krijuar e krijon në Kosovë. Emërtimi Letërsi shqipe edhe prej këtij studiuesi e prej këtyre bashkëbiseduesve të tij, rrëgohej në letërsinë shqipe që ishte krijuar dhe krijohet në Shqipërinë shtetërore. U çudita që nuk dëgjova edhe çka do të duhej të dëgjoja: që nuk dëgjova mbrojtjen e domethënies shkencore të emërimit shkencor Letërsi shqipe (mbarëkombëtare), që s'mund të ndahet në letërsitë e Shqipërisë shtetërore, të Kosovës, të arbëreshëve, por është: Letërsi shqipe.

7. Llexuesit mund të çuditen dhe

të dëshpërohen pse po na ndajnë disa nga ata që nuk duhet kurrë, nën kurrfarë kushtesh, të na ndajnë: krijuesit e letërsisë dhe studiuesit e tyre e të veprave të tyre. Do të çuditen e do të dëshpërohen, por edhe të ngushëllohen: po na ndajnë disa krijues të letërsisë e disa studiues të tyre, e sidomos disa zyrtarë e organizues të manifestimeve letrare, por po na bashkojnë shumë televizione, po na bashkojnë shumë e shumë këngëtarë, muziktarë, artistë e futbollistë. Po na ndajnë disa krijues të letërsisë, disa studiues të tyre, sidomos disa zyrtarë e organizues të manifestimeve letrare që Letërsinë shqipe (mbarëkombëtare) e ndajnë, e copëtojnë, si ç'u pa se e ndajnë, e copëtojnë, por po na bashkojnë: shumë e shumë shkrimtarë, regjisorë, shumë e shumë studiues shkencorë, publicistë, gazetarë. E të tjerë. E të tjerë.

Siç dihet, popujt më parë bashkohen me letërsi dhe me kulturë dhe në letërsinë e në kulturën në përgjithësi e pastaj me politikë e në politikë. Duke na bashkuar me letërsi e me kulturë e me manifestimet letrare, dhe duke e kuptuar e trajtuar emërtimin Letërsi shqipe si një të tërë, si të pandarë, si mbarëkombëtare, shkrimtarët, studiuesit e veprave të tyre letrare artistike dhe zyrtarët e institucioneve letrare e kulturore, që na ndanin në veprimtaritë e manifestimet letrare të përkthyer shkurt më lart, do të mbesin pa duartrokitjet e atyre që duan të na ndajnë edhe me shumë çka tjetër: duan të na ndajnë duke bërë prej shqiptarëve edhe një komb - edhe kombin kosovar, duke bërë edhe gjuhën e tij standarde sepse kjo që kemi prej vitit historik 1972, thonë ata, "nuk është gjuhë standard për të gjithë shqiptarët...!"



Ish-drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ballafaqohen me drejtësinë në Gjykatën Speciale

KRERËT E UÇK-së MBROJNË LUFTËN ÇLIRIMTARE NË HAGË



Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj dhe Salih Mustafa janë drejtuesit dhe luftëtarët e parë të UÇK-së që janë duke u ballafaquar me drejtësinë në Gjykatën Speciale. Gjatë paraqitjes së parë para Speciales ata janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës me të cilat është duke i ngarkuar prokuroria. Po ashtu, ata kanë thënë se ky proces do ta dëshmojë se populli shqiptar i Kosovës ishte i shtypur, i cili luftoi për liri. Sipas tyre, UÇK-ja ka bërë luftë të pastër dhe të drejtë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, DHJETOR/ JANAR - Gjykata Speciale është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2015. Kur kanë kaluar pesë vjet nga themelimi, kjo gjykatë ka nisur punën, duke i akuzuar ish-drejtuesit kryesorë të UÇK-së. Bëhet fjalë për Hashim Thaçin, ish-drejtues i Drejtorisë Politike të UÇK-së, Kadri Veselin, ish-udhëheqës i Shërbimit Informativ të UÇK-së, i njohur si "G2", Rexhep Selimin, ish-udhëheqës i Drejtorisë së Operacioneve në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Jakup Krasniqin, ish-zëdhënës i UÇK-së. Po ashtu, me drejtësinë në Hagë janë duke u ballafaquar edhe kryetari dhe nënkryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, si dhe ish-epropri i UÇK-së, Salih Mustafa. Seancat fillestare gjyqësore ndaj tyre kanë filluar tashmë, por jo

edhe shqyrtimi kryesor gjyqësor. Më 9 nëntor 2020 ish-drejtori politik i UÇK-së, Hashim Thaçi, dhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, kanë hedhur poshtë pretendimet e Dhomave të Specializuara për krime lufte ndaj tyre. Në paraqitjen e parë para këtyre dhomave në Hagë, Thaçi dhe Krasniqi kanë thënë se akuzat ndaj tyre janë të pabaza. "Deklarohem i pafajshëm për të gjitha pikat e akuzës", ka deklaruar Thaçi kur është pyetur nga gjykatësi i procedurës paraprake nëse ndihet i pafajshëm apo fajtor rreth aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ai ka deklaruar se aktakuzat kundër tij janë të paqëndrueshme. Njëjtë është deklaruar edhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, i cili është paraqitur në seancë paraditen e së hënës. "Unë nuk ndihem fajtor e as përgjegjës për asnjë pikë që thuhet në aktakuzë dhe për asnjë

gjë tjetër që thuhet në aktakuzë", ka deklaruar Krasniqi gjatë paraqitjes së parë para Dhomave të Specializuara, kur është pyetur nëse deklarohet i pafajshëm apo fajtor për krimet që rëndojnë ndaj tij. Krasniqi, para se të deklarohet për aktakuzën, mbajti një fjalim para gjykatës, ku ka deklaruar se është bërë një padrejtësi e madhe ndaj tij. "Cilësimi i prokurorit të Dhomave të Specializuara, se ne qenkemi ndërmarrje kriminale e përbashkët, për mua, shokët e mi, familjen time që luftuam gjatë, por edhe për kombin tonë, nuk ka diçka më fyese, pasi ne një kohë të gjatë, në rrethana tepër të vështira jetë a vdekje, u vumë në shërbim të lirisë e të shtetndërtimit të cilat i arritëm në bashkëveprim me Shtetet e Bashkuara, me vendet e Bashkimit Evropian, me NATO-n, me OKB-në dhe të gjithë së bashku ishim dhe jemi ndërmarrje e përbashkët çlirimtare dhe shtetformuese", ka

deklaruar Krasniqi gjatë një fjalimi para Gjykatës në Hagë. Ai ka vlerësuar se ndërmarrje e përbashkët kriminale është koka e Beogradit dhe mbështetësit e politikës së Beogradit. Ai e ka kritikuar Specialet, duke thënë se në aktakuzat e saj po i ndan qytetarët e Kosovës në katolikë e myslimanë. "Ju në aktakuzë po mundoheni t'i ndani njerëzit në katolikë e myslimanë. Unë nuk jam as myslimanë e as katolik. Jam shqiptar", ka thënë ai. Krasniqi është ankuar edhe për trajtimin që po i bëhet nga Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar. "Unë jam arrestuar më 4 nëntor. Në aktakuzë po na quani ndërmarrje kriminale e përbashkët. Unë dua të deklaroj sot se kurrë në jetën time në asnjë rast nuk i kam trajtuar njerëzit as kaq sa e si më trajtuat mua nga ndërtesa e burgut e deri në këtë ndërtesë", ka deklaruar Krasniqi, duke shtuar se ndaj tij po bëhet padrejtësi. "Mua më është bërë padrejtësi e madhe dhe do ta mbaj këtë padrejtësi. Unë dhe populli im kemi mbajtur shumë padrejtësi dhe nuk kemi pasur nevojë për këtë padrejtësi", është shprehur Krasniqi. Pala mbrojtëse e Krasniqit ka paralajmëruar se shumë shpejt do të bëjë kërkesë për lirim me kusht të Krasniqit. "Kemi synim

të bëjmë një depozitim për lirim paraprak ose me kusht të tij sa më shpejt që të jetë e mundur", është shprehur avokatja Venkateswari Alagendra. Veprat që rëndojnë ndaj Thaçit dhe Krasniqit kanë të bëjnë me krime lufte, ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme dhe krime kundër njerëzimit, të burgosjes, të akteve të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme, zhdukje me forcë të personave dhe përndjekje, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit 1998 dhe shtatorit të vitit 1999. Sipas aktakuzës, krimet dyshohet se janë kryer në disa lokacione të Kosovës, por edhe në Kukës dhe Cahan në Shqipërinë Veriore.

Mbrojtja e Thaçit: Ku janë akuzat për vjedhje organesh?

Avokati i ish-presidentit Thaçi, David Hooper, e ka pyetur gjykatën në Hagë se ku janë akuzat për vjedhje të organeve dhe për të ashtuquajturën Shtëpi e Verdhë që, sipas tij, janë "njollë mbi Kosovën dhe kosovarët". "Ku janë këto pretendime për vjedhjen e organeve njerëzore dhe ku është historia e Shtëpisë së Verdhë e cila ishte e



rëndësishme për krijimin e kësaj gjykatë?”, ka thënë Hooper, duke shtuar se asnjë nga këto pretendime nuk përmenden në aktakuzën e konfirmuar ndaj Thaçit. “Këto pretendime Thaçi i dinte se ishin gjepura. Ai e ndihmoi Komisionin Evropian për krijimin e kësaj gjykatë”, ka deklaruar ai.

Gjithashtu, avokati i ka kritikuar Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar që nuk kanë simbole të Kosovës, ndonëse janë krijuar nga Prishtina zyrtare. Avokati David Hooper ka thënë se do të kërkojnë lirim të përkohshëm për ish-presidentin Hashim Thaçi. Ai ka shtuar se kërkesa për lirim të përkohshëm do të bëhet në javët e ardhshme. “Unë mund ta paraqes këtu Thaçin njëri me dinjtet dhe ndershmëri, njeri që i ka shërbyer vendit në liri dhe paqe, burrë që ka arritur shumë dhe nuk i meriton këto pretendime”, ka thënë ai, duke shtuar se Thaçi ishte zëri i arsyes gjatë luftës. “Thaçi doli mbi luftën e UÇK-së si zëri i arsyes, duke shtuar se ishte pikërisht ai personi që çoi vendin drejt pavarësisë”, ka thënë Hooper duke e cituar ish-senatorin amerikan Bob Dole për Thaçin. Më pas, ai ka përmendur edhe vlerësimin e Joe Bidenit për Thaçin. “Ish-zëvendës-presidenti Joe Biden, tash president i zgjedhur i ShBA-së, e ka quajtur z. Thaçi George Washingtoni i Kosovës”, ka thënë Hooper. Avokati Hooper ngriti edhe çështjen e vendosjes së prangave ndaj Thaçit, duke thënë se kjo është turp. “Nuk jeni organ ndëshkimi. Nuk besoj se jeni kështu. Shpresoj të jetë kështu. Mos ulni integritetin e personit deri në atë pikë”, ka deklaruar ai. Ndërkaq, gjykatësi i procedurës paraprake ka thënë se nuk ka trajtim të posaçëm për Thaçin sa iu përket prangave. “Sa iu përket prangave, nuk ka trajtim të posaçëm për klientin tuaj, është procedurë që aplikojmë për çdo person që vjen në sallën e gjyqit”, ka thënë ai.

Veseli deklarohet i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës

Më 10 nëntor 2020 ish-kreu i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka bërë paraqitjen e parë para Dhomave të Specializuara në Hagë. Ai është deklaruar i pafajshëm ndaj këtyre akuzave. “I nderuar gjykatës, i dëgjova dhe i kam lexuar të gjitha pikat e aktakuzës. Më lejoni të deklarohem me bindje të plotë, se jam i pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës”, ka deklaruar Veseli kur është pyetur nëse dëshiron të deklarohet i pafajshëm apo fajtor për aktakuzën.

Veseli, që gjatë luftës ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm i

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është arrestuar më 5 nëntor dhe është dërguar në qendrën e paraburgimit në Hagë. Ai dyshohet për vepra penale që kanë të bëjë me krime lufte, ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe krime kundër njerëzimit, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje të paligjshme, zhdukje me forcë të personave dhe përndjekje, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit të vitit 1998 dhe shtatorit 1999. Sekretarja e Gjykatës, pasi lexoi dhjetë pikat e aktakuzës, tha se ekziston dyshimi i bazuar se Veseli është penalisht përgjegjës për këto krime.

Mbrojtja: Veseli u dorëzua vullnetarisht në Hagë

Avokati i Veselit, Ben Emmerson, i cili në këtë seancë është lidhur përmes videovjeggëzës, ka reaguar ndaj procesverbaleve të gjykatës, në të cilat thuhet se ish-kreu i PDK-së është arrestuar. Ai ka treguar se Veseli është paraqitur në Hagë vullnetarisht, në bazë të një marrëveshjeje me prokurorin, duke shtuar se do ta kërkojë lirimin e tij derisa procesi të fillojë. “Z. Veseli duhet të presupozohet i pafajshëm për të gjitha akuzat. Duke vijuar nga kjo, gjykata do të marrë parashtrim ose kërkesë që Veseli të lirohet deri në pritje të fillimit të gjykimit. Desha të shënohet në proces verbal fakti se z. Veseli është arrestuar, ju si gjykatës duhet të dini se Veseli erdhi në gjykatë në bazë të një marrëveshjeje paraprake, vullnetarisht. Dorëzimi i tij vullnetar u bë me kërkesë të avokatit. Është e drejtë ta theksoj se ditën që u dorëzua ai ka dorëzuar deklaratë të cilën dua ta lexoj”, ka thënë Emmerson. Më pas, avokati Emmerson ka lexuar edhe një mesazh të Veselit për Gjykatën Speciale. “Pres që gjykatësit do të japin vendim të drejtë në fund. Kjo gjykatë është pjesë e ligjit tonë, nuk duhet të kemi mëri ndaj gjykatësve që punojnë në këtë Tribunal. Tribunali është pjesë e krijimit të Kosovës, do ta çojmë këtë kërkesë deri në fund”, ka deklaruar avokati. Gjatë kësaj paraqitjeje të parë të Veselit para gjykatës në Hagë, gjykatësi i procedurës paraprake, po ashtu, është konsultuar me Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe palën mbrojtëse lidhur me datën për mbajtjen e konferencës statutoare. Si datë për këtë konferencë është propozuar 18 nëntori. Në Rregulloren e Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës, në rregullën 96 thuhet: “Gjykatësi i procedurës paraprake thirr një konferencë mbi ecurinë e çështjes sa më shpejt që të jetë e mundur, pas paraqitjes së parë të të akuzuarit”.

Selimi: Luftën për çlirim e nisëm me Adem Jasharin, e përfunduar me Clarkun

Ndërsa ish-eprori i lartë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Rexhep Selimi, më 11 nëntor 2020 është deklaruar i pafajshëm për aktakuzën për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, që është konfirmuar ndaj tij nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Në paraqitjen e parë para Gjykatës Speciale, Selimi ka mohuar të gjitha pikat e aktakuzës. “Unë deklarohem i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës”, ka thënë Selimi, kur është pyetur që të deklarohet nëse ndihet i pafajshëm apo fajtor për akuzat që rëndojnë ndaj tij. Para se ta deklarojë pafajësinë, ai në fjalën e tij ka kundërshtuar aktakuzën duke e quajtur të padrejtë.

Ish-shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka treguar edhe arsyet se pse kishte kundërshtuar themelimin e kësaj gjykatë. “Sot këtu nuk jam si deputet që e kam kundërshtuar këtë gjykatë, por si ish-ushtar i UÇK-së, themelues i saj, përballë një aktakuze të ngritur nga Prokuroria dhe ju z. gjykatës. Rolet këtu i kemi të ndara, jemi palë të ndryshme por, ju lutem, më bëni të besoj se, po ashtu, qëllimi ynë do të jetë drejtësia, mbi të gjitha e vërteta. E pashë aktakuzën e ngritur nga Prokuroria. Ishte aktakuzë e rëndë, vuliminoze, e padrejtë, e pasaktë ndaj meje dhe luftës së popullit tim dhe shtetit nga vij unë”, ka deklaruar Selimi, duke shtuar se fundi i këtij procesi do ta dëshmojë luftën e drejtë të UÇK-së. “Ky proces do ta dëshmojë që ishim popull i shtypur që luftuam për liri. Bëmë luftë të pastër dhe të drejtë. Kjo luftë do të jetë e tillë edhe pas këtij procesi. Kush ka dyshime do të bindet se as unë e as UÇK-ja nuk kemi të bëjmë me krime e ndërmarrje të përbashkët kriminale siç akuzohemi padrejtësisht”, është shprehur Selimi.

Ai ka vlerësuar se është një çlirimtar që e ka nisur luftën me komandantin legjendar Adem Jashari dhe e ka përfunduar me ndihmën e NATO-s. “Po, unë kam luftuar kundër Serbisë, kundër Serbisë okupatore e cila veç të këqija i ka sjellë vendit tim. Prandaj, unë e kam bërë vetëm detyrën time si qytetar i vendit tim. Unë jam vetëm çlirimtar. Luftën e kemi nisur me Adem Jasharin dhe e kemi përfunduar me gjeneralin Clark, me NATO-n. Drejtësia duhet të jetë qëllimi ynë këtu, pse jo edhe i Prokurorisë”, ka deklaruar Selimi.

Para trupit gjyqësor janë paraqitur edhe drejtuesit e OVLUÇK-së, Hysni Gucati e Nasim Haradinaj, dhe ish-eprori i UÇK-së, Salih Mustafa. Që të tretë janë deklaruar të pafajshëm në lidhje me aktakuzat me të cilat janë duke u ngarkuar nga Prokuroria e Gjykatës Speciale.





Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

VITI 2020, VIT I PASIGURISË, I FRIKËS, I STRESIT, I KRIZAVE DHE I SHPRESËS SË RREJSHME. VITI 2021 NUK DO TË JETË I TILLË!

1. Vit i mbrapshtë për botën dhe Kosovën; COVID-19: Këtë vit bota u sulmua nga një armik i padukshëm që fillimisht bëri kërdi në Kinë, përkatësisht në Wuhan, ku duke e kishte bazën deleguese e pastaj në tërë botën. Sistemet shëndetësore e të cilat i merrnim si model për Kosovën, me një fjalë u shembën, duke filluar nga Italia dhe deri në ShBA. Numri i të prekurve ishte i madh dhe kapacitetet për t'i trajtuar ishin të pamjaftueshme. Kosova ishte shteti thuaja i fundit në Evropë e që u përballë me këtë armik të padukshëm që e çrregulloi jetën sikur që i uli në shkallët më të ulëta vlerat dhe solidaritetin njerëzor. U çrregulluan raportet edhe brenda familjeve sikur që edhe varrimi i të vdekurve, si respekt i fundit që e meriton çdonjëri që ndërrohet jetë, u shndërrua në ritual teknik apo zhvleftësim i çdo gjëje morale. Në kohë të pandemisë kishim dukuri sikur në të gjitha krizat; shumica u varfërua kurse një grusht politikanësh dhe biznesmenësh u pasuruan, në kurriz të shumicës. Pandemia ishte profatura dhe fatura që i mbuloi të gjitha hajnitë, të gjitha poshtërsitë, injorancën e të gjitha llojeve, me një fjalë, të gjitha punët e këqija. Kinezët e

kanë një mallkim: "jetofsh në kohëra interesante...". Ne kemi jetuar dhe po jetojmë në këto kohëra, çmendurisht interesante. Në kohë të pandemisë ndodhën zhvillime politike interesante sikur, shembja e Koalicionit të Shpresës midis LV-së dhe LDK-së. Në këtë koalicion pata besuar edhe unë dhe pata lobuar për këtë duke shpresuar në rininë e LV-së dhe përvojën e LDK-së. Sa i painformuar dhe i pa ditur që u tregova, leshko fare! Populli e ka filozofinë që asnjëherë nuk dështon se: "dy atllarë, nuk lidhen në një mullarë..." Koalicioni i Shpresës u shndërrua në një Koalicion të thyerjes së besës të dhënë votuesve. Në këtë kohë ndodhën dy dukuri të cilat i kam kundërshtuar thuaja në çdo shkrim, mocion për shkarkim të qeverisë Kurti në kohë pandemie dhe preteksti për shkarkim, për mua jashtëzakonisht i pamoralshëm që e përdorën shkarkuesit, anti-amerikanizmi i Albin Kurtit e që bashkëdyzohet me antigrenellizmin e Kurtit. Realisht, asgjë nuk ka qenë Albin Kurti kundër Grenellit, sa kam qenë unë! Mua, moti më kanë shkarkuar nga të gjitha postet për faktin se nuk kam pranuar kurrë

asnjë post. Në jetën time kam votuar vetëm një herë në fillim të viteve të '90-ta për Ibrahim Rugovën dhe Rifat Blakun ndërsa votën e përjetshme e kanë, Ideali dhe Kuptimi i Lirisë dhe të Bashkimit Kombëtar, Baca Adem Demaçi dhe Luftëtari dhe Sakrifikuesi Sublim, Komandanti Legjendar, Adem Jashari dhe të gjithë ata që luftuan, kontribuan dhe që kanë rënë për lirinë e Kosovës. Të gjithë që duan të përfitojnë nga të dy krijuesit e lirisë, të dy Ademat, janë vetëm lakra turshi, që e kanë kriposur çdo gjë! Janë zhvatësit e veprave që i kanë trashëguar! Pasi LDK-ja dhe mocionistët e kënduan, në gjuhën multietnike (esperanto) këngën: "ra Albin Faja prej fiku...", në vend të Koalicionit të Shpresës e formuan Koalicionin e Mbijetesës e që falë Gjykatës Klienteliste Kushtetuese të Kosovës, nuk e mbijetuan!

2. Gjykata Raciste Speciale e "Kosovës": Më datë 03. 08. 2015, pas një seance maratonike, në rrethana të një terrori psikik dhe shantazheve, 82 deputetë të Kuvendit të Kosovës votuan për, 5 ishin kundër dhe 1 abstenim, votuan amendamentimin e

Kushtetutës së Kosovës për themelimin e Dhomave të Specializuara si dhe Dhomave të Prokurorit të Specializuar, me prokurorë, gjykatës, hetues, oficerë dhe administratë krejtësisht të përbërë nga ndërkombëtarët kurse, si subjekt trajtimi janë vetëm shqiptarët përkatësisht ish drejtues dhe ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo individë, që në një mënyrë apo tjetër kanë ndihmuar UÇK-në dhe luftën për liri. Ndërkombëtarët kishin hallin si ta kalonin votimin në Kuvend duke deklaruar se Gjykata Speciale është pjesë integrale e sistemit të drejtësisë së Kosovës e pastaj, Kosovën dhe qytetarët e saj i trajtuan vetëm si objekt (jo subjekt) i kësaj gjykate, duke e bartur 100 për qind pronësinë e këtij procesi te ndërkombëtarët dhe në Hagë përmes marrëveshjeve që vet i bënë dhe vet i nënshkruanin. E formuan Gjykatën Kushtetuese të Gjykatës (që nuk e kishte asnjë gjykatë e ngjashme në botë), e formuan të ashtuquajturin Avokat i Popullit të kësaj Gjykate dhe mekanizma tjerë që, më shumë i përgjigjen institucioneve juridike të Serbisë se asaj të Kosovës të cilës, as që i

raportojnë për asnjë zhvillim. Në shkresat e kësaj Gjykate askund nuk ka logo të institucioneve të Kosovës, Këshillit Prokurorial apo atij Gjyqësor. Materialet për të arrestuarit, avokatët mbrojtës dhe publikun përthehen në gjuhën shqipe, me një vonesë të madhe apo vetëm pjesërisht. Për arrestimet e mundshme, së pari informohet Beogradi (ata deri më tani saktë e kanë ditur kush arrestohet dhe kur arrestohet). Politikanët e Beogradit nderojnë prokurorët e Specijallkës dhe anasjelltas. Dhe shumë të bëma të tjera që e bëjnë këtë gjykatë politike, të motivuar në baza etnike dhe raciste. Pa asnjë dyshim, sidomos nga aspekti i të drejtave të njeriut. Edhe arrestimet u bënë të planifikuara dhe të provokuara! Fillimisht u arrestua Salih Mustafa e pastaj, si në filmat e Harry Potterit nga Gjykata Speciale (thuaja e mbyllur hermetikisht) rrodhën me mijëra dhe dhjetëra mijëra dokumente shumë të ndjeshme duke përfunduar, përmes korrierit Rrufeja, aty ku më së paku pritej, para Zyrave të Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së ku Gjykata Speciale e kishte thuaja 100 për qind klientelën për arrestime!!!!



Natyrishet se u arrestuan Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati kurse askush nga Gjykata Raciste Speciale nuk e pësoi me asgjë. Duket se materiali që rrodhi nga Gjykata e që nga korrier Rrufeja, sipas modelit Alia Express përfunduan para Zyrës së OVL-së së UÇK-së u përdor si përsheptues për arrestimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit kurse, si karrem u përdorën Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. Të gjitha gjykatat e përafërta me këtë monstrum juridik, të akuzuarit kryesorë i lënin për fund kurse në Kosovë i arrestuan menjëherë. Ashtu siç raportoi i Dik Martit e pati efektin e bombës duke keqpërdorur si mbushje për shpërthim Shtëpinë e verdhë dhe trafikimin me organe njerëzore, edhe arrestimi i liderëve të luftës dhe atyre që e shpallën pavarësinë e Kosovës e kishte për qëllim të prodhonte efekte të një bombe. Ndërkombëtarët që bënë presion të madh për themelimin e kësaj Gjykate e që bënë presion edhe më të madh kur u bënë përpjekjet, sipas Kushtetutës së vendit krejtësisht të ligjshme, për shpërbërje të Gjykatës Speciale (si pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës), deklarorin se kjo Gjykatë do të trajtojë 10 raste ku do të përfshihen afërsisht 8-12 të dyshuar kurse, deri më tani janë intervistuar afërsisht 400 dëshmitarë dhe të dyshuar e që numri mund edhe të rritet edhe më shumë. Thuhej se nuk po gjykohej UÇK-së në kohën kur janë arrestuar krerët e saj kryesorë politikë dhe ushtarakë, janë marrë në pyetje si të dyshuar të gjithë ata që kanë qenë udhëheqës politikë dhe ushtarakë, në Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Shqipëri kurse dëshmitarët e mbrojtur janë shpërndarë nëpër shtetet evropiane, SHBA, Australi dhe në Serbi. Në fakt, po gjykohej lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po bëhen përpjekje të rishkruhet historia dhe, si qëllim të fundit është vënia në tavolinën e bisedimeve me Serbinë edhe vet statusi i Kosovës, përkatësisht akti i shpalljes së pavarësisë.

3. Skena e përçarë politike dhe zgjedhjet e parakohshme në Kosovë: Gjykata Raciste Speciale e ka përçarë edhe spektrin politik në Kosovë, ata që me ngazëllim e presin këtë Gjykatë dhe i gëzohen çdo arrestimi e të cilët rrënjët i kanë të kalburat e të stërkalburat dhe ata që kontribuuan për këtë liri, në çfarëdo forme që patën mundësi. Gjykata Speciale nuk do të ndajë drejtësi për 95 për qind të viktimitave për shkak se janë shqiptarë dhe nuk do të ndajë përgjegjësi për së paku 95 për qind të atyre që kanë bërë krime shkak se janë serbë. Përzgjedhja e viktimitave si dhe kriminelëve ekskluzivisht në baza etnike e

bënë këtë gjykatë, edhe raciste, edhe politike, pa asnjë dyshim. Kjo Gjykatë ka ndikuar dhe do të ndikojë në stabilitetin e skenës politike kosovare dhe, në një mënyrë është shkaktare e zgjedhjeve të parakohshme, tash dhe ato pas tyre. Kjo Gjykatë është në funksion të bisedimeve me Serbinë dhe një marrëveshjeje të imponuar ku pala kosovare nuk do të pyetet për asgjë. Nëse zgjedhjet do të mbahen pas një jave rezultatet do të ishin:

4. LV-ja do të fitonte, por nuk e besoj se do të jetë rezultati siç e parashohin Albin Kurti dhe Besnik Bislimi - Bisla me, së paku 65 deputetë. Deklarata e Albinut është politiko - psikologjike kurse e Bisles është profesionale, përkatësisht deformitet profesional. Bisla është ekspert i numrave dhe aty është në element. Në politikë është thjeshtë jashtë fushës ku luan mirë. Bisla

“vrastare” pjesën femërore si: Albulena Haxhiu, Fitore Pacolli, Arbërie Nagavci, Saranda Bogujevci, Mimoza Kusari, Vjosa Osmani, Donika Kadaj, Kimete Berisha dhe të tjera. Është ekip dhe përbërje mbresëlënëse që ngjallë frikë por meriton shumë respekt.

5. PDK-ja: Do të bëjë garë me LDK-në për vend të dytë dhe, varësisht nga lista për deputetë, nuk e besoj se mund të kenë më pak se 22-25 deputetë. Nëse i bëjnë listat si më parë, teze dhe dajë, nipa dhe mbesa, burrë dhe grua, babë dhe djallë apo vajzë, atëherë keq do t'i kenë punët. PDK-ja duhet të shkojë e vetme në zgjedhje ndërsa, për koalicionë paszgjedhore e vendosë në bazë të rezultatit. Pas zgjedhjeve, PDK-ja nuk e ka, as të nevojshme e as të domosdoshme që me çdo kusht të bëhet pjesë e qeverisë.

bjerë nën 10 deputetë, nëse nuk do të ketë tërmet në Holandë. Lehtësisht mund të bëhet lojtari kyç për formimin e qeverisë së Kosovës dhe i pashmangshëm për koalicionë paszgjedhore.

8. Nisma Socialdemokrate dhe AKR: mund të mbijetojnë vetëm nëse bëhen pjesë e listave zgjedhore të subjekteve tjera, AKR-ja e LDK-së, Nisma e PDK-së ose AAK-së.

9. Iniciativa Vjosa Osmani në LV-ja: Po të kishte mbetur në LDK-ja, Vjosa Osmani do të forcohej shumë dhe, pa asnjë dyshim, pas një kohe do ta merrte edhe kreun e kësaj partie. Gjithashtu, po të ndahej nga LDK-ja menjëherë pas çarjeve të forta dhe ta formonte një parti apo lëvizje, sot Vjosa Osmani do të kishte të garantuar, së paku 10-12 për qind të votave. Në rastin konkret kur



Armend Nimanli (AFP)

më ngjanë pakëz në Ernesto, jo Gevarën por Sabaton, shkrimtarin e njohur argjentinas, me prejardhje shqiptare, nga nëna. Sabato ishte doktor i fizikës dhe matematikës dhe shkencëtar premtues në këto lëmi. Kur vendosi ta lësh shkencën për t'ia kushtuar jetën letërsisë dhe artit, shefi i tij deklaroi se: “Sabato po e lësh shkencën, për t'u bërë sharlatan (shkrimtar)”. Edhe Bisla po e lësh shkencën, ku është shumë i mirë për t'u bërë politikan i keq. Apo, më mirë ta them për t'ia dorëzuar integritetin të pakontestueshëm profesional, një politike amatoreske, siç bëhet në Kosovë. Nëse Albin Kurti dhe Bisla (që ka deklaruar se e ka humbur krejtësisht gjumin shkak se në mënyrë marramendëse po rritet përkrahja për LV-në, tash mbi 65 për qind) ia qëllojnë rezultatit, unë botërisht do t'ua uroj fitoren dhe do t'i qeras nga një kafe. Nëse nuk ka ndonjë ndryshim dramatik, sipas meje LV-ja mund të marrë diku 35 - 37 për qind të votave. Është diçka interesante dhe për mua pozitive, se, për herë të parë, femrat në LV do ta kenë primatin dhe cilësinë përkatësisht në LV do të ketë matriarkat politik. LV-ja e ka

6. LDK-së: Po i parashohin ditë dhe net të vështira. Madje, po të dëgjohet Haxhi Avdyli, LDK-ja do ta ketë vështirësi kalimin e pragut zgjedhor. Mendoj se e kanë shumë gabim. LDK-ja ka themele të forta për t'u shembur aq shpejt dhe aq lehtë. Qeverisja e LDK-së sikur ajo e LV-së nuk mund të vlerësohet drejt për shkak të kohës së shkurtër dhe rrethanave. Jam i sigurt se, në këto rrethana, asnjë parti në Kosovë, përveç premtimeve mashtruese, nuk do të kishte mundësi të bënte diçka më shumë. LDK-ja mund të ketë deputetë sikur edhe PDK-në, në variantin më të keq nuk mund të bjerë nën 20 deputetë. Mund edhe të mos pajtoheni me mua por, sot në Kosovë politikani më i kompletuar është Isa Mustafa që asgjë nuk po përfiton personalisht por e ka shpëtuar LDK-në nga një përçarje e madhe dhe ka ndikuar në deradikalizimin e skenës politike kosovare.

7. AAK-ja: qeverisë në 6 komuna të Kosovës ku ka ndërtuar struktura partiake dhe, sikur edhe të gjitha partitë e tjera politike në Kosovë, edhe klientelizmin politik. Nuk e shoh se mund të

do të garojë, thuaja si anëtare e LV-së (pjesë e listës së LV-së), të gjithë votuesit e kanë të qartë se vota e tyre përmes Vjosa Osmanit do të jetë votë për Albin Kurtin dhe LV-në prandaj, asnjë votues tradicional i LDK-së, nuk do të votojë për Albin Kurtin dhe LV-në përmes Vjosa Osmanit. Vjosa Osmani personalisht do të përfitojë ndonjë post të dhuruar nga Albini, si lëvizje do të mbetet embrion i pazhvilluar mjaftueshëm politikisht. Vjosa Osmani është tepër e re në moshë për të pasur urrejtje ndaj atyre, që, me luftën dhe sakrificën e tyre ia mundësuan të ketë poste dhe ardhmëri në politikë. Këta që po e përkrahin Vjosa Osmanin, në me krye kamikazin Haxhi Avdyli, kur të ndahen nga trangu i LDK-së, do të shndërrohen në ashkla politike që edhe zjarri më i vogël do t'i bëjë hi. Në fund të fundit, ashklat nuk përdoren për ta mbajtur zjarrin por për ta ndezë zjarrin!

Bisedimet me Serbinë: Këto bisedime do të jenë përcaktuese për jetëgjatësinë e qeverisjes e jo mënyra e qeverisjes. Këto bisedime ndikuan që Qeveria Kurti të bëhet Qeveria ish-Kurti.

Serbia, e përkrahur nga ndërkombëtarët po luan lojë të ndyrë në Kosovë duke ndërhyrë në të gjitha punët e brendshme të një shteti. Serbia ka përparësi absolute sepse luftën nuk po e bënë në Serbi por në Kosovë. Serbia ka interes që të mbajë gjendjen e konfliktit të ngrirë të Kosovës, duke shkaktuar dhe mirëmbajtur krizat e të gjitha llojeve. Serbia nuk është e interesuar të rikthejë apo ta mbajë Kosovën nën Serbi, por është e interesuar të çnukë nga Kosova territor që i intereson dhe, vetëm pas kësaj do të pranojë të nënshkruaj marrëveshje me Kosovën. Kosova është e gozhuar nga Serbia dhe bashkësia ndërkombëtare për të pranuar çfarëdo marrëveshje dhe, pa asnjë dyshim, pa u nënshkruar një marrëveshje me Serbinë, Kosova do të vendnumërojë. Bashkësia ndërkombëtare po e kushtëzon Kosovën për çdo përkrahje me nënshkrimin e marrëveshjes me Serbinë. Edhe liberalizimi i vizave është i kushtëzuar me dëgjueshmëri politike, kushtet teknike janë plotësuar moti. Një ekip negociues, i përbërë nga të gjitha subjektet politike kosovare, mund të ndikojë që dëmi të jetë më i vogël dhe më i menaxhueshëm. Në momentin kur keni kërkuar dhe pranuar ndërmjetësim ndërkombëtar, kompromisin e keni të garantuar. Ky kompromis kushtëzohet nga ekipi negociator. Albin Kurti po e luan një shah të gabuar politik duke manipuluar me disa pionë (ushtarë të lodhur) të LDK-së. Në lojën e shahut politik, Albini veten e konsideron si mbret të pakundërshtueshëm, Vjosën do ta bëjë mbretëreshë të LDK-së kurse, disa pionë të LDK-së, thjesht do të mund të bëhen, më së shumti kuaj ose mish për topa (figurë e shahut). Oficerë nga pionë nuk mund të bëhen sepse hierarkinë e oficerëve e ka bërë LV-ja, ndërkaq që në lojën e shahut nuk ka figura të tjera përveç mbretit, mbretëreshës, topit, kuajve, oficerit dhe pionëve (ushtarëve). Edhe nëse LV-ja i fiton 65 deputetë, nuk e besoj se do ta marrë përgjegjësinë për një marrëveshje me Serbinë, pa pajtimin e subjekteve të tjera kosovare. Është kafshatë që nuk kapërdihet e lëre më të tretet, edhe nëse kapërdihet me forcë! Albini këtë e ka të qartë. Po e mbushi pushkën për derra të egër, nëse na del lepur, do ta kemi më lehtë.

Gëzuar festa e Vitit të Ri për lexuesit e gazetës “Epoka e re” dhe për të gjithë ata që më lexojnë sikur edhe për të gjitha subjektet politike që do të garojnë në zgjedhjet e ardhshme, së bashku me të gjithë votuesit e tyre! Gëzuar për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të gjithë shqiptarët, në liri, gjysmë të lirë apo të burgosur.

Flet për “Epokën e re”, Kim Mehmeti

PASOJAT E SPECIALES DO TË JENË AFATGJATA PËR KOSOVËN



Shkrimtari dhe publicisti shqiptar Kim Mehmeti e ka vlerësuar të padrejtë Gjykatën Speciale. Ai ka thënë se disa qarqe perëndimore prej kohësh e kanë filluar një proces që të gjithë popujt e këtyre hapësirave t'i barazojnë në fajësinë dhe krimet që kanë të bëjnë me luftërat e fundit ballkanike. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Mehmeti ka deklaruar se pasojat e kësaj gjykate do jenë të mëdha dhe afatgjata për Kosovën. Sipas tij, kjo gjykatë do të ndikojë në rritjen e mosbesimit ndaj sistemit juridik në Kosovë

EPOKA E RE

Muhamet KOÇI

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR
“Epoka e re”: Z. Mehmeti, si ishte viti 2020 për Kosovën dhe shqiptarët në përgjithësi?
Mehmeti: Në vitin 2020 kulmoi shpopullimi i trevave shqiptare si dhe defaktorizimi i shqiptarëve në Ballkan falë burrshtetasve të “Shqipërive” tona, kryesisht falë Tiranës zyrtare, e cila u bë më e afërt me Beogradin sesa me Prishtinën. Në 2020-n u arrit kulmi i shfytirimit të Kosovës si shtet dhe shndërrimi i saj nga

djep i atdhedashurisë, në vend që shenjë njohëse ka atë të hajnisë falë zhvatësve të saj nga radhët e ‘klanit pronto’ dhe nga radhët e ‘profesorëve e pleqve’ të LDK-së, të cilët duket se e japin shtetin, por jo edhe pushtetin. Në përgjithësi, viti që jemi duke lënë pas, e shpalosi thujtë të ‘plehun’ politik të grumbulluar dekada me radhë nëpër ‘Shqipëritë’ tona, pleh që duhet kohë e mund për ta pastruar, si parakusht për ta penguar vazhdimin e qelbëzimit dhe kalbjen e më të vlefshmes që kemi. Pra, 2020 ishte vit kur u pa

qartë se në Shqipëri, jo vetëm dikur kur nuk mungonte ndonjë mbret serb për ta ndihmuar mbretin shqiptar që ta rikthente fronin e humbur në Tiranë, apo ndonjë Mugosh, që t’ua zgjidhte shqiptarëve sekretarin e parë të Partisë Komuniste, por edhe sot nuk mungon ndonjë Vuçiq, i vëllazëruar me Pikturin e ‘Rilindjes’ e i cili, njësoj si paraardhësit e tij, e dinë se vetëm me ndihmën e Tiranës mund t’ia dalë që Beogradin ta ribëjë ‘kryeqendër’ të Ballkanit, ku do të vendoset edhe fati i shqiptarisë!



“Epoka e re”: Gjatë këtij viti në Kosovë pati shumë zhvillime politike. Në fillim të vitit kishim themelimin e qeverisë Kurti, më pas kjo qeveri u rrëzua me një mocion mosbesimi për t’u formuar qeveria Hoti. Ndërsa tani Gjykata Kushtetuese rrëzoi edhe qeverinë Hoti. Çfarë është mendimi juaj për këto zhvillime?

Mehmeti: Gjithë këto ngjarje të përfshira në pyetjen tuaj tregojnë se në Kosovën e sotme

marrin votat e shqiptarëve, por me ardhjen në pushtet bëjnë çmos që të jenë të pëlqyerit e ndërkombëtarëve dhe të ‘Listës srpska’, të cilat ua kanë fatin politik në duar. Andaj duhet shpresuar se zgjedhjet e parakohshme në Kosovë janë mundësi që LV-ja sërish të vijë në pushtet e ta rivazhdojë procesin e çlirimit të vendit nga zhvatësit e saj dhe të krijojë kushte që gjithë ‘kriminelët’ e paqes që e plaçkitën shtetin dhe

mes qeveritarëve që i shërbejnë popullit dhe atyre që kujdesen të jenë sa më të pëlqyer për të huajt dhe për fqinjët tanë.

“Epoka e re”: Në pjesën e dytë të vitit u aktivizua edhe Gjykata Speciale, e cila ka ngritur aktakuzë ndaj disa ish-krerëve të UÇK-së. Cili është qëndrimi juaj për këtë gjykatë?

Mehmeti: Qëndrimi im është po ai që ishte para se kjo Gjykatë të themelohet: se ajo në njëfarë mënyre tregon se Kosova nuk është shtet, se Kosova nuk është shtet i së drejtës, se në Kosovë mund ta dënosh të varfrin e të pambrojturin, por jo edhe kriminelin e pushtetshëm e të pasur...

As dikur, as tani, nuk kam dashur që kushdo qoftë, Kosovën ta nënvlerësojë aq shumë, sa atë ta shpallë thuajse në ‘joshtetë’. Ajo ka shumë probleme lidhur me shtetbërjen, por në këtë Ballkan nëse ka ndonjë shtet ku nuk dënohen kriminelët e luftës, ai është Serbia, e jo Kosova. Madje nuk është Kosova vendi që u paraprinë shteteve ku ligji e drejtësia kanë përkatësi etnike, sepse e keni Maqedoninë, ku vetëm sa iu përket burgjeve, dënimeve drakonike si dhe proceseve të montuara gjyqësore, shqiptarët janë më të ‘privileguarit’.

“Epoka e re”: Aktakuza ndaj z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi nga shumëkush është cilësuar si tendencë për ta kriminalizuar luftën e UÇK-së. A po tentohet ndryshimi i historisë përmes kësaj gjykate?

Mehmeti: Jo tani, por prej moti disa qarqe perëndimore e kanë filluar procesin që të gjithë neve popujve të këtyre hapësirave të na barazojnë në fajësinë dhe krimet që kanë të bëjnë me luftërat e fundit ballkanike. Pra duan që ta rishkruajnë historinë tonë duke na barazuar të gjithëve me të gjitha, duke barazuar pra viktimat me kriminelët, duke na paraqitur të gjithëve si popuj ‘barbarë’, që nuk dinë të jetojnë në paqe me njëri-tjetrin. Duhet thënë hapur: disa qarqe perëndimore duan që neve shqiptarëve të na barazojnë me kriminelët serbë, edhe pse e dinë se ata erdhën e vranë shqiptarë dhe se asnjë nga ne nuk shkoi kudo qoftë në ndonjë vendbanim të Serbisë që të vret e të plaçkitë serb. Pastaj duke dashur ta mbulojë të vërtetën se luftërat e fundit në Ballkan, me shumëçka e shpërfaqin fytyrën e pagrimuar të Evropës, Perëndimi do ta rishkruajë historinë e ballkanasve, do që ai të rrëfejë për atë që ne përjetuam. Edhe Gjykatën Speciale e shoh si pjesë të orvatjeve që të gjithë të

barazohemi në të gjitha, që në Ballkan të mos ketë kriminelë e viktima, por popuj që i barazon krimi!? Është e turpshme, e padrejtë dhe shumë e pamoralshme që të ngresh aktakuza kundër drejtuesve të UÇK-së, e ndërkohë, presidenti i Serbisë, i dalë nga kapota e Millosheviqit, është po ai që publikisht kanosej se për një serb të vranë do të vriten qindra myslimanë. Dhe kur barku i tokës serbe është përplot me viktima të pafajshme shqiptare, me kufomat e grave dhe fëmijëve që u vranë nga duart e kriminelëve serbë, kriminelë shumica e të cilëve jo vetëm se nuk u dënuan për krimet e bëra, por shëtisnin lirshëm nëpër Serbi e nëpër Evropë! Të merremi vesh: kurrë nuk do ta mohoj se kam kërkuar nga Kosova t’i dënoj ‘kriminelët e paqes’ që atë e plaçkitën. Por kurrë nuk do të pajtohem që përfaqësuesit e UÇK-së, që ata të cilët luftuan për ta çliruar vendin e vet, të gjykohen e të dënohen nga jashtë Kosovës nga gjykatës të huaj, të cilët për asgjë nuk i japin llogari Kosovës. Dua që vetë Kosova t’i dënojë të gjithë keqbërësit e saj, nëse ajo i ka, sepse e di se përderisa qytetarët e Kosovës do të dënohen nga gjykatësit e huaj, kjo do të thotë se ajo ende nuk është shtet, se ende nuk mund të përballet me të gjitha fytyrat e veta. E kam thënë dhe gjithmonë do ta them: se Kosovën e defaktorizuan si shtet dhe, se asaj ia sollën edhe Gjykatën Speciale, disa ‘komandantë’ të deridjeshëm, e politikanë të sotëm, që donin t’u takojë edhe lavdia e luftëtarit, edhe hajnia e politikanit. Njësoj siç e kam përsëritur shumë herë, se Gjykatën Speciale Kosovës ia sollën disa nga ‘komandantët’ që ndaj vendit të vet u sollën si mercenarë, të cilët nuk ndërtonin institucione shtetërore që do ta forconin shtetin e do t’u shërbenin qytetarëve, por që ata do t’i mbronin nga populli e ligji.

“Epoka e re”: Mund t’i sjellë ndonjë pasojë shtetit të Kosovës kjo gjykatë?

Mehmeti: Sipas meje, pasojat do të jenë të mëdha dhe afatgjata. Në mos më shumë, kjo gjykatë do të ndikojë në rritjen e mosbesimit ndaj sistemit juridik në Kosovë, siç do ta rritë bindjen se Kosova nuk është shtet ligjor.

“Epoka e re”: Në procesin e dialogut me Serbinë është arritur marrëveshja e Uashingtonit. Cila mendoni se është rëndësia e kësaj marrëveshje?

Mehmeti: Kjo marrëveshje është e rëndësishme vetëm për

ata që u fotografuan bashkërisht gjatë nënshkrimit të saj. Dhe ajo është e rëndësishme për Serbinë e jo për Kosovën. Vlerësoj se takimi në Shtëpinë e Bardhë ishte shumë i nevojshëm për presidentin serb, për të cilin, më në fund, edhe Uashingtoni duhej ta bënte atë që paraprakisht e kishte bërë Brukseli: ta shpërlante nga e shkuara e tij luftënxitësi dhe ta promovonte në paqendërtues të epur.

“Epoka e re”: Ndërsa procesi i dialogut në Bruksel nuk ka pasur ndonjë përparim. Si duhet të sillet Kosova me këtë proces?

Mehmeti: Kosova duhet ta kuptojë se prej moti atë nuk e rrezikojnë fqinjët, por burrështetasit e saj që kanë xhepa të thellë e tru të cekët politikë. Pastaj Kosova kurrë nuk duhet të harrojë se bashkëbisedon me një Serbi të cilën e drejton Kisha Ortodokse Serbe, e jo burrështetasit e saj, apo institucionet e shtetit. Pra, Kosova duhet ta kuptojë se disfata e saj nuk qëndron te fqinjët që askush nuk mund t’i zgjedhë, por te burrështetasit e saj që vetë ajo i zgjedh e të cilët nuk e kanë kuptuar se Kisha Ortodokse Serbe është forca e padukshme destabilizuese e Ballkanit, se ‘pronat’ e kësaj kishe në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi janë ‘mina me sahat’ që ajo i ‘shpërthen’ sa herë që do ta pengojë forcimin e këtyre shteteve. Kosova së pari duhet të definojë shumëçka që ka të bëjë me shtetësinë e saj dhe vënien nën kontroll të tërë territorit të saj, e pastaj të ulet e të dialogojë me cilindo qoftë.

“Epoka e re”: Cilat janë pritjet tuaja për zgjedhjet e reja nacionale dhe vitin 2021? Çfarë mund t’i sjellin Kosovës?

Mehmeti: Qysh gjatë bisedimeve për formimin e qeverisë LV-LDK e kam thënë se zgjedhjet janë zgjidhje për mosmarrëveshje mes këtyre dy partive, se popullit duhet t’i jepet mundësia ta korrigjojë vetveten, duke i çuar drejt zhbërjes ato parti që e “zhebënë vendin”, e të cilat i kryeson LDK-ja. Pres që populli ta dënojë LDK-në, e cila shtetin e sheh si grazhd për t’i ushqyer të fortit e partisë, e ta risjellë në pushtet Vetëvendosjen që shtetin e sheh si kopsht që duhet mirëmbajtur e pasuruar. Por mbetet ajo që e thashë më lart: është e vështirë të realizohen synimet e drejtuesve të LV-së në një Kosovë ku populli voton, por ku shumëçka varet nga vullneti i të huajve dhe i ‘Listës srpska’, e cila i shërben Beogradit.



është e vështirë të mbijetojë cilado qeveri si ajo e LV-së, pra cilado qeveri që interes parësor ka atë të popullit që përfaqëson e të shtetit që drejton, e jo të elitave partiake. Është e vështirë sepse Kosova me shumëçka i ngjan një vendi që ka tre ‘sundues’, e të cilët nuk i ndërlihd asgjë e përbashkët përpos ‘grazhdit’ shtetëror nga ata ushqehen. Pra, Kosova sot është e ‘sunduar’ nga ndërkombëtarët, që nuk i përgjigjen askujt, nga ‘Lista srpska’ që i raporton Beogradit dhe nga qeveritarët shqiptarë që

popullin e vet, të dalin përpara drejtësisë. Dhe në këto zgjedhje të parakohshme parlamentare populli shqiptar i Kosovës do të ketë mundësi t’i dënojë ‘pleqtë’ e LDK-së, ata që e rrëzuan ish-qeverinë e LV-së, me çka treguan se popullin e konsiderojnë si një turmë e pakokë, të cilën, nëse arrin ta mashtrosh e ta mbyllësh në oborrin tënd partiak, atëherë me të mund të tallesh si të ta dojë qejfi. Madje besoj se ardhja e LV-së në pushtet, mbarë shqiptarisë, e jo vetëm Kosovës, do t’i tregojë se cili është dallim

SHKRUAR ENKAS PËR "EPOKËN E RE"

KOSOVA VAZHDON TË MBETET OBJEKT I LOJËRAVE GJEOPOLITIKE

ShBA-ja dhe Rusia kanë bërë një rindarje të sferave të influencës në Ballkan, në Lindjen e Mesme dhe në Kaukaz, me ç'rast Mali i Zi i është lënë sërish influencës ruse, duke rikrijuar në Ballkan një masë potenciale tumoroze antiatlantike, bashkë me Serbinë dhe Republikën Serpska. Kjo masë tumoroze antiatlantike mund ta rritë presionin më vonë edhe mbi Bosnjën dhe mbi Kosovën



Milazim KRASNIQI

E kaluara e kombeve dhe e shteteve të Ballkanit nuk ndihmon aspak asnjë përpjekje që provohet të bëhet për bashkëpunimin ose integrimin miqësor e paqësor të tyre as në shekullin XXI, kur integrimi dhe globalizimi ka përthekuar edhe rajone shumë më problematike se sa ky rajon. Ndonëse ka një pjesë të historisë, e cila do të mund të ndihmonte atë projekt bashkëpunimi e integrimi, por pikërisht ajo pjesë e historisë injorohet dhe tentohet me çdo kusht që të harrohet. Ajo pjesë e historisë ku banorët e këtij rajoni kanë jetuar kryesisht në paqe e deri diku edhe në harmoni, përfshin një periudhë të gjatë të sundimit Osman (jo gjithë periudhën.) Shekujt XVI-XVIII mund të përfshihen në këtë vlerësim, ndërsa nga shekulli XIX, kur fillon formimi i kombeve ballkanike, fillojnë edhe konfliktet dhe kasaphanat, që kulmojnë me Luftërat ballkanike, të cilat paraqesin shembuj të lemerishëm të mizorive ndërmjet kombeve të Ballkanit. Faktikisht në këtë periudhë fillon të përdoret edhe termi Ballkan dhe ballkanizim, për ta shprehur copëtimin e territoreve dhe mizorinë, në emër të kauzave irracionale kombëtare.

Evropianët e infektuan Ballkanin me mizoritë e veta

Po nga erdhi ai pasion për mizori, pas disa shekujsh bashkëjetese në një perandori shumëkombëshe, ku të krishterët e Ballkanit e kishin

statusin e një mileti (populli) të veçantë, pa asnjë tentim që të osmanizoheshin? Kryeshkakun e këtij shpërthimi barbar të dhunës, studiuesja e famshme, Maria Todorova, e ka identifikuar te ndikimi i kombeve të mëdha evropiane, Fuqive të Mëdha, mbi projektet nacionale të ballkanasve. Kombet e mëdha evropiane i kanë nxitur drejt kombformimit, duke ua mësuar përdorimin e dhunës, spastrimit etnik dhe gjenocidit, si mjet për arritjen e qëllimeve kombëtare. Todorova konstaton se në pasionin për shkaktimin e kasaphanave, ballkanasit mbeten joevropian në krahasim më evropianët: "Me të vërtetë, ka diçka që është qartazi joevropiane në faktin që Ballkani asnjëherë nuk mundi të arrijë -përmasat e kasaphanave evropiane". Sidoqoftë, të nxitur nga sponsorët e mëdhenj evropianë, ballkanasit e filluan me mjete gjenocidale Luftën e Parë Ballkanike, me pretekst të dëbimit të Perandorisë Osmane nga Ballkani, por esencialisht me synimin që të copëtonin territoret e popujve që nuk bënin pjesë në aleancën ballkanike (malazetët, serbët, bullgarët e grekët.) Nga shikimi më i përciptë në hartë, menjëherë shihet se caku kryesor ishte copëtimi i territoreve ku jetonin shqiptarët. Zbatimi i atij komploti të katër shteteve ortodokse, rezultoi me gjenocid kundër myslimanëve në Ballkan, me objektivin kryesor kombin shqiptar. Ndërsa Lufta e Dytë Ballkanike u shndërrua në kasaphanë ndërmjet vetë aleatëve të krishterë ortodoks (serbëve, grekëve e edhe rumunëve kundër bullgarëve.) Nga arroganca e ballkanasve që u farkua në dy luftërat ballkanike, veçmas nga arroganca e serbëve, u provokua edhe Lufta e Parë Botërore (1914-1918), e cila pastaj e përfshiu në kasaphanë mbarë Evropën. Në fund të asaj lufte u zhbënë perandoritë habsburge, osmane e ruse, me ç'rast në

territoret e dy të parave u formuan një numër shtetesh sllave, të cilat në atë mënyrë e ballkanizuan edhe një pjesë të madhe të Evropës Qendrore. Ndërsa, në Rusi triumfoi bolshevizmi, një ideologji që do të bëhej vrasare për një pjesë të madhe të Evropës dhe të Ballkanit. Ndryshimet e mëdha gjeopolitike e ideologjike që ndodhën, përgatitën edhe klimën për Luftën e Dytë Botërore, e cila ishte shumë më gjakatare se sa e para. Pra, virusi i mizorisë që i kishin injektuar kombet e mëdha evropiane në kombet e vogla ballkanike, duke ua mësuar spastrimin etnik dhe gjenocidit, u përhap si epidemi shkatërrimtare edhe në vetë kombet e mëdha evropiane. Në kujtesën e kombeve të sotme ballkanike kanë mbetur përvojat e tmerrshme të luftërave ballkanike dhe të luftërave botërore, ndërsa periudhën e jetës në paqe e harmoni nën sundimin Osman, praktikisht e kanë injoruar dhe e kanë harruar. Prandaj narracionet e këtyre historive janë të pafuqishme, në ndonjë tentativë për ta jetësuar jetën në paqe dhe integrimin e kombeve dhe shteteve të sotme ballkanike.

Paaftësia dhe pafytyrësia e Bashkimit Evropian

As Bashkimi Evropian, me ofertën e vet ekonomike, kulturore e gjeopolitike, nuk po arrin ta shërojë plagën e infektuar para më shumë se një shekulli. Në fakt, Bashkimi Evropian ka bërë vetëm përpjekje parciais. Pranimi në Bashkimin Evropian i Greqisë, Bullgarisë, Rumanisë e Kroacisë, faktikisht nuk ka prekur fare në plagën e infektuar të Ballkanit. Plaga e hapur e të kaluarës është në Maqedoninë e Veriut, në Kosovë, në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Malin e Zi. Kjo është harta që mbartë pasojat e Krizës Lindore, të provokimit të Luftës së Parë Botërore, të zhbërjes së një shteti sovran - Malit të Zi dhe të spastrimit etnik e gjenocidit në vitet 1998-1999 në rastin e Kosovës. Bashkimi Evropian përkatësisht kombet e mëdha evropiane, francezët, gjermanët, italianët e anglezët nuk kanë gjetur asnjë formulë si mund të shërohet plaga të cilën ata e kanë hapur para më shumë se një shekulli në këto hapësira. Prandaj, herë bëjnë njërin sy

qorr, herë u rikthehen ideve të vjetra imperialiste, por as kanë vrasje ndërgjegjeje e as aftësi për ta mbyllur krizën. Kjo u pa më së miri në kohën e luftës në Bosnje (1991-1995) dhe në luftën në Kosovë (1998-1999.) Po të mos ishte vendosmëria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që imponuan Marrëveshjen e Dejtonit (1995) dhe atë të Kumanovës (1999), turpi do ta mbulonte Bashkimin Evropian, njësoj si në kohën e luftërave ballkanike, kur jo vetëm që nuk e ndaluan gjenocidin serb, kundër shqiptarëve, po në fakt i fshehën edhe informacionet e konsujve dhe të gazetarëve.

Paaftësia dhe pafytyrësia e Bashkimit Evropian u pa edhe kohët e fundit, kur Bullgaria e bllokoi procesin e integritit të Maqedonisë së Veriut. Brukseli rrudhi krahët dhe e la mundësinë që Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut të gjejnë zgjidhje në biseda dypalëshe. E lanë të kërkojnë zgjidhjen Bullgaria e Maqedonia e Veriut, që po të mos ishte inxhinieringu brutal i Fuqive të Mëdha Evropiane, do të ishte zgjidhur me kohë, me krijimin e një shtet-kombi bullgar, kur kombi i sotëm maqedonas nuk ekzistonte. Nëse arrihet tash një marrëveshje lidhur me të kaluarën e komplikuar dhe të mjeçulluar, pas formimit të kombit maqedonas, do të jetë meritë e vetë këtyre dy shteteve e aspak e Bashkimit Evropian. Zgjidhja është e mundshme, nëse kryeministri Bojko Borisov i përmbahet asaj që pati deklaruar para një viti lidhur me qëndrimin e Bullgarisë ndaj NATO-s: "Nuk dua të jap kurrfarë komentesh për NATO-n, duke pasur para sysh se në anën e majtë, në Detin e Zi, e kemi Krimeën, në anën e djathtë Stambollin, ndërsa prapa nesh Kosovën". Pra, Borisov po thotë se nuk lejohen aventura dhe se nuk ka siguri jashtë NATO-s. Ky është një pragmatizëm, nga i cili duhet të mësojnë edhe liderët e Maqedonisë së Veriut, po edhe të Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bosnjë e Hercegovinës. Bile Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi dhe BeH, janë në pozitë shumë më të keqe se sa Bullgaria, për ç'arsye u duhet edhe më shumë pragmatizëm. Ombrella e NATO-s këtyre shteteve u duhet veçmas që të shpëtojnë nga komplotet ruse, të cilat altonohen në vazhdimësi, me synim që rajonin ta mbajnë në gjendje jostabiliteti, me çka Rusia mund t'i bëjë më lehtë presion Bashkimit Evropian po edhe

NATO-s. Sikundër dihet, në Malin e Zi pati tentativë për grushtet dhe vrasjen e Gjukanoviqit, skundër që në Maqedoni u tentua të nxitet gjakderdhje dhe kaos në prill 2017. Edhe vizita e këtyre ditëve e ministrit rus të punëve të jashtme të Rusisë, Sergej Llavrovit, ishte provokim dhe skandal me efekte polarizuese në shtetin që sapo shënoi njëzet vjetorin e Marrëveshjes së Dejtonit. Bashkimi Evropian, prapë vazhdon ta hajë turpin me bukë.

Rindarja e fut Ballkanin në pako me Kaukazin dhe Lindjen e Mesme?

Pra, jo vetëm e kaluara, për as e tashmja e shteteve ballkanike nuk po mundëson bashkëpunim e integrim miqësor e paqësor të këtyre shteteve, ngase nxitja për konflikte e përçarje sërish vjen nga jashtë, nga Rusia në rend të parë, por pa dyshime dhe nga shtete të tjera të mëdha perëndimore. Fjala vjen, në idenë e shkëmbimit të territoreve ndërmjet Kosovës e Serbisë, ka indikacione se qenë i involvuar një segment i administratës së SHBA-ve, me Xhon Bolltonin në krye. Ndërsa po për Malin e Zi, presidenti Tramp, pas sjelljes së tij të pahijshme ndaj ish-kryeministrit malazet në një samit të NATO-s, pati deklaruar se NATO nuk do të hynte në luftë për Malin e Zi. Ajo që ndodhi më vonë është restaurimi i ndikimit rus e serb mbi Malin e Zi. Ka zëra që pohojnë se ka ardhur deri te një ndarje e re e sferave të influencës ndërmjet SHBA e Rusisë në Ballkan, në Lindjen e Mesme dhe në Kaukaz. Nëse këto parashikime janë të vërteta, ato e bëjnë edhe më të vështirë pozitën e shteteve të brishta të Ballkanit, veçmas Maqedonisë së Veriut Kosovës, Malit të Zi dhe Bosnjës. Sipas këtyre projeksioneve, SHBA dhe Rusia kanë bërë një rindarje të sferave të influencës në Ballkan, në Lindjen e Mesme dhe në Kaukaz, me ç'rast Mali i Zi, i është lënë sërish influencës ruse, duke rikrijuar në Ballkan një masë potenciale tumoroze antiantlantike, bashkë me Serbinë dhe Republikën Serpska. Kjo masë mund ta rritë presionin më vonë edhe mbi Bosnjën dhe mbi Kosovën. Ndoshta do të testohet ridizajnimi i Serbisë së Madhe, në të ardhmen si një formacion jo domosdoshmërisht



antiatlantik, por gjithësi rusofil? Me Trampin, ky projekt, bashkë me mini Shengenin ballkanik që u promovua në Marrëveshjen e Uashingtonit (shtator 2020), do të shtyhej përpara dhe do të shfrytëzohej jo vetëm si partneritet i ri me Rusinë, po edhe si presion kundër Bashkimit Evropian. Me Bajdenin pritet të rishikohet i tërë ai konstruksion.

Në të gjitha këto përvoja e zhvillime, shqiptarët mund të kenë një rol, si subjekt, nëse organizohen dhe nëse dinë çka duan, ose si objekt, nëse vazhdojnë të menaxhojnë shtete e shoqëri të dështuara. Recetat për elitat politike të shqiptarëve janë të padobishme, pasi ende përdorin në politikë receta popullore, thënë figurativisht. Thënë më butë: nuk janë kërka.

Po qe se kthjellohen, do të duhej të ndiqnin lëvizjen e rrathëve koncentrikë në hartimin e politikave shtetërore e kombëtare, duke harmonizuar interesat e shteteve ekzistuese (Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut.) Pra, jo me subordinim, siç bënë Serbia, po me koordinim dhe harmonizim. Por, për të arritur në atë pikë, pjesa pushtetore e elitave të tashme shqiptare në këto tre shtete, duhet të pensionohen. Ndërsa, kjo nuk është e mundur me këto shoqëri të traumatizuara, të frikësuar, të varfëruara e të tjetërsuara. Prandaj ka rrezik që do të mbetemi vetëm objekt i lojërave dhe eksperimentimeve edhe për një kohë.

SHKRUAR ENKAS PËR “EPOKËN E RE”

Maskat na janë bërë pjesë e gardërobës, kurse korona - traumë kolektive!



Agim VINCA

Viti 2020 do të mbahet mend si vit i pandemisë. Gjithçka në këtë vit, te ne dhe në botë, mban vulën “Covid-19”. Virusi famëkeq, që u shfaq rreth një vit më parë, së pari në Kinë e pastaj në tërë botën, shkaktoi frikë dhe pasiguri; mbyllje e izolim; dobësoi ekonominë dhe, ç’është më e keqja, mori shumë jetë njerëzish.

Në planin politik ky vit te ne do të mbahet mend si vit i rënies së “Qeverisë Kurti”, jeta e së cilës zgjati vetëm 51 ditë, sepse u rrëzua me mocionin famëkeq të mosbesimit, në mbledhjen maratonike të 25 marsit, që u quajt “ballo me maska”, ndërsa në botë do të mbahet mend për zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të

cilat i fitoi kandidati demokrat Joe Biden, mik i Kosovës dhe shqiptarëve. E kam paraparë fitoren e tij te “Ditari i pandemisë” dhe jam i lumtur që ndodhi kështu, sepse mbetja edhe më tej në Shtëpinë e Bardhë e administratës Trump do të mund të ishte fatale për Kosovën.

Në fushën e artit dhe të kulturës, viti që po lëmë pas do të mbahet mend si vit i veprimtarive të reduktuara dhe i përshtatjes së tyre masave kufizuese, që bëjnë të pamundur zhvillimin normal të aktiviteteve kulturore (tubime, promovime, konferenca shkencore etj.). Mjafton të themi se maskat janë bërë pjesë e gardërobës sonë, kurse frika nga virusi - një traumë. E, megjithatë, ky vit i vështirë e specifik, nuk mund të quhet pa rezultate sidomos në fushën e botimeve.

Gjatë vitit 2020, në shtëpitë tona botuese, si në Tiranë, ashtu edhe në Prishtinë dhe në Shkup, dolën mjaft vepra të autorëve tanë, e edhe më

shumë vepra të përkthyer nga gjuhët e tjera.

Sa më përket mua personalisht, gjatë këtij viti botova dy libra: librin “Ditari i pandemisë. Rrëfime nga karantina”, që doli në muajin korrik dhe librin me tregime “Konkubina dhe rrëfime të tjera”, që doli në nëntor. I pari edhe u shkrua në muajt mars-qershor, në kushtet e pandemisë, pa ndërprerë për 80 ditë me radhë e me një hov, kurse i dyti përbëhet nga shkrime në prozë të shkruara më parë, por të pabotuara; një prozë e llojit autofiksional.

Libri “Ditari i pandemisë” zgjoi interesim të madh: u lexua, u komentua, u fol për të në media; u botuan disa vështrime serioze në Prishtinë e në Tiranë; u shkrua për të në rrjetet sociale, edhe nga personalitete të jetës sonë publike, ndërsa unë si autor mora një varg letrash, mesazhesh, telefonatash etj. Libraria “Artini”, që është distribuesi numër një i librit shqip në Prishtinë, e ka shpallur si njërin ndër librat më të lexuar të vitit. Në

kushtet e krizës ekonomike, të luftës së ashpër politike dhe të atmosferës së rëndë sociale, të pafavorshme për vlerat shpirtërore, shpallja “Libër i vitit” në një konkurrencë të fortë, është një satisfaksion moral për çdo krijues.

Libri i dytë “Konkubina” ende nuk ka qarkulluar si duhet, por nuk ka shans ta arrijë suksesin e të parit. Për shumë arsye. Dhe në radhë të parë për shkak se nuk është “ditar i pandemisë”, i shkruar në “karantinë”.

Krijuesit janë në njëfarë dore gjithnjë në karantinë: në studiot e tyre, mes librash, dorëshkrimesh, fletorësh e shënimesh; dikur përmbi makinën e shkrimit, tani përballë ekranit të kompjuterit. Por mbyllja e detyrueshme është shumë më e rëndë nga ajo që është zgjedhje e vetë njeriut.

Uroj që ta përballojmë me sa më pak pasoja “murtajën e shekullit XXI” dhe që viti i ardhshëm të jetë vit i mposhtjes së sëmundjes dhe i normalizimit të jetës. Gëzuar Vitin e Ri 2021!



SHKRUAR ENKAS PËR "EPOKËN E RE"



SHKELZEN MALIQI

A MUND T'IA DALIM VETË?

A mund të dalim nga kriza vetë pa mbështetje nga jashtë?

Po e shtroj këtë pyetje sepse gjithnjë e më shpesh te ne po shfaqet një disponim që favorizon vetëmjaftueshmërinë, idenë se ne, para së gjithash, duhet të mbështetemi në forcat tona. Ky disponim është refleksiv vjen si pasojë e zhgënjimeve me ngadalësimin e procesit të njohjes universale të pavarësisë së Kosovës. Ngadalësimi tani është bërë edhe më shqetësues sepse ka hyrë në një fazë vendnumëro, që zbeh pandalshëm mbetjet e fundit të shpresës dhe entuziazmit të vitin 2008 që përmbledhej në thirrjen e famshme drejtuar dëshmorit legjendar Adem Jashari: "Bac, u krye!"

Sot, në mjegull, dëgjohej thirrja e ironizuar: "Bac, humbëm rrugën në oborr!"

Në mjegullën e vendnumërimit humbet besimi në aleatët. Në ata që na shpëtuan gjatë luftës, e që pastaj, në çastet kritike të paqes së mbikëqyrur, e çanë shtegun e pavarësimi i cili, zakonisht për vendet e vogla nuk hapet lehtë dhe shpejt. Ne sikur nuk e kemi kuptuar çfarë urate e jashtëzakonshme kanë qenë fjalët e presidentit Xhorxh Bush i riu: "Enough is enough, Kosovo is independent!"

Për ne "Boll më! Kosova është e pavarur!" ka qenë një konstatim i pritur dhe normal i thënë me

zemërim çfarë ka qenë edhe zemërimi i ynë me UNMIK-un dhe pushtetin paralel që kishte organizuar Serbia në Veri të Mitrovicës dhe në enklavat serbe në brendi të Kosovës.

Mirëpo, presidentin Bush nuk e kanë kuptuar si ne gjysma e botës me prirje rivalizuese dhe antiamerikane, sepse në OKB dhe në disa instanca me ndikim të madh nuk konsiderohej e zakonshme shpallja e "njëanshme" e pavarësisë të një territori që ka qenë pjesë e shtetit sovran, anëtar i OKB-së.

Fakti që Serbia ishte akuzuar si agresore dhe fajtorë për masakra dhe dëbime masive të popullsisë shqiptare si politikë e papranueshme gjenocidale ndaj pjesës së qytetarëve të vetë, meçka edhe është motivuar intervenimin humanitar të NATO-s në Kosovë, nuk ka qenë e mjaftueshme që t'i bind shumë shtete anëtare të OKB ta miratojnë shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Arsyja e tyre për refuzim ka qenë edhe fakti se këto shtete mosbindëse kanë probleme me kërkesat secesioniste të minoriteve që jetojnë në pjesët e territoreve të tyre. Ato duan të shkëputen sepse mbahen me dhunë në emër të mbrojtjes së sovranitetit. Rasti i Kosovës andaj shihet si precedent i rrezikshëm i cili, nëse do të legalizohet në praktikën ndërkombëtare, do të shkaktoje rebelime dhe copëtime zinxhirore të shumë shteteve sovraane, andaj edhe u

alarmua, dhe kjo bëhet edhe sot, se modeli i Kosovës rrezikon kriza të shumta dhe një kaos global.

Polarizimi i botës rreth çështjes së Kosovës është i madh. Nga njëra anë pjesa më e madhe e Perëndimit dhe vendeve anëtare të NATO-s, si dhe dhjetëra shtete aleate të Perëndimit, e kanë njohur Kosovën e pavarur si realitet të pakthyeshëm, ndërkaq kjo kundërshtohet nga disa blloqe të shteteve të tjera, para së gjithash nga Rusia dhe Kina, që ia mbajnë anën Serbisë.

Ky polarizim e ka ndihmuar Serbinë që ta mbajë gjallë kontestimin e pavarësisë së Kosovës dhe, falë Ruisë dhe Kinës, rolin aktiv të OKB-së dhe të Këshillit të Sigurimit, ku edhe më tej mbahen seancat e rregullta ku shqyrtohen zhvillimet në Kosovë edhe pas shpalljes së pavarësisë, që aktualizon vazhdimisht Rezolutën 1244 të vitit 1999 dhe UNMIK-un, edhe pse faktikisht është mision tejet i reduktuar në terren.

Neve UNMIK-u na duket sot si një fantom që artificialisht mbahet gjallë, por as SHBA-të, Britania e Madhe dhe Franca, që e kanë fuqinë e vetos në Këshillin e Sigurimit, nuk po mundën ta zhbëjnë këtë mision, sepse këtë nuk e lejon ende boshiti i rendit botëror, realisht i stërvjetëruar, shpesh edhe jofunksional dhe bllokues, por që nuk mund të ndryshohet lehtë.

Polarizimi i botes rreth çështjes

së Kosovës e ka kushtëzuar edhe atë pjesë të tregimit që për ne është më e dhimbshme, që edhe verdikti fatkeqësisht joobligues i GJND-së se shpallja e pavarësisë së Kosovës më 2008 nuk ka qenë shkelje e të drejtës ndërkombëtare, të mos ketë shumë peshë. Ne u detyruam që të hyjmë në dialog me Serbinë për normalizimin e raporteve mes dy vendeve, të cilin dialog aleatët tanë në krye me SHBA-të, e kanë menduar se mund të funksionojë nëse çështja do t'i delegohej si detyrë ndërmjetësuese BE-së. Logjika e vendim ka qenë kjo: me që Kosova dhe Serbia mëtojnë anëtarësimin në BE, dhe BE-ja në samitin e Selanikut (2003) u deklarua se rajonin e Ballkanit e mirëpritet të bëhet pjesë e BE-së, le ta trajton BE-ja atë si një çështje të saj praktikisht të brendshme.

Bartja e përgjegjësisë nga KS të OKB-së te Brukseli ka qenë një manovër i Perëndimit që zgjidhja e kontestit të bëhet nën ombrellën e Brukselit, pasi që konsiderohej çështje vitale e sigurisë dhe të stabilitetit të Evropës. BE-ja është superfuqi ekonomike dhe politike dhe nëse Kosovën e bën çështje të brendshme, Rusia dhe Kina, pra as OKB, nuk do të mund të kontestonin më një rezultat pozitiv të dialogut të ndërmjetësuar nga Brukseli. Kuptohet, mendësia strategjike e Perëndimit e ka ditur edhe në vitin 2010 se vendet e BE-së nuk

janë unike në qëndrimin rreth pavarësisë së Kosovës, që 5 shtete anëtare të saj, madje edhe anëtare të NATO-s, nuk e njohin pavarësinë e Kosovës që deri më sot nuk e kanë ndryshuar qëndrimin. Është ditur që ne fillim se kjo zvogëlon dukshëm mundësitë e BE-ja që të jetë eficientë në detyrën që morri. Ashtu sikur që në OKB Serbia kishte aleate Ruisë dhe Kinën që bllokuan njohjen universale të Kosovës, Serbia në BE kishte 5 shtete aleate për kauzën e saj. Për shkak të tyre BE-ja do të mbajë deri edhe sot qëndrimin neutral për statusin e Kosovës, gjë që për shumë çështje e bllokoi Kosovën dhe favorizon Serbinë. Ky fakt nuk ka qenë arsye e vetme e dështimit të planit që të evitohet OKB-ja duke e bartur çështjen dhe dialogun në pallatet e Brukselit zyrtar?

Kur analizohet dështimi i dialogut te ne nuk merret parasysh një kontekst i rëndësishëm i asaj kohe, që i jepte shpresë planifikuesve strategjik se BE-ja, megjithatë, mund të ketë sukses me detyrën e zgjidhjes së çështjes së pavarësisë së Kosovës. Duhet të kujtohem se në atë kohë BE-ja ka qenë e angazhuar në një proces të fuqizimit të kohezionit të saj si organizim kompleks, e përqendruar në rritje të kohezionit dhe te funksioneve të përbashkëta te supershteti, e fiksuar edhe në çështjen delikate të mënyrës së vendimmarrjeve, që është bazuar në konsensus të



gjitha vendeve anëtare. BE-ja kishte planifikuar aprovimin e një Kushtetute, e quajtur Kushtetute i Lisabonit, që parashihje vendimmarrjet më eficiente me shumicë të kualifikuar të votave. Nëse do të aprovohej kjo kushtetutë 5 anëtarët e BE-së që nuk e njohin Kosovën, nuk do të mund të bllokoni BE-në që me shumicën e kualifikuar ta njeh Kosovë pasi që 22 anëtarë e njohin! Kushtetuta e Lisabonit është dashur të hyjë në fuqi në vitin 2014, por dështuan referendimet në disa shtete anëtare.

Kur dështoj skenari i shfrytëzimit të vendimeve jokoncensuale, çështja e dialogut që Brukseli e kishte filluar me mandatin e OKB-së, udhëheqjen strategjike, por joformale, të dialogut e morri Gjermania, madje personalisht vetë kancelarja Angela Merkel, me një plan tjetër që aplikimi i anëtarësimit të Serbisë në BE të kushtëzohet me njohjen e ndërsjellë me Kosovën me kufijtë ekzistues të dy vendeve.

Në të vërtetë presion i drejtohej ndaj Serbisë, i thuhej se në momentin që hapej porti për anëtarësim, Serbia duhet ta njohë Kosovën pasi BE-ja nuk do më anëtarësim të vendeve që kanë konteste territoriale ose që nuk njihen mes vete.

Mirëpo, as ky ndryshim i skenarit nuk pati sukses, sepse në ndërkohë, BE-ja u ballafaqua me krizën e refugjatëve që e vrëshuan nga Lindja dhe Afrika, dhe edhe disa faktor tjerë ndikuar në humbjen e plotë të vullnetit të disa shteteve për zgjerimin e BE-së, që kryesisht godiste Ballkanin Perëndimor.

Në këto rrethana dialogu Kosovë-Serbi i cili deri në vitin 2013 arriti një marrëveshje premtuese, nuk pati më pastaj asnjë përparim substancial por vetëm ngecje, bllokada dhe dështime. Më dialogu edhe e humbi kuptimin, sidomos në Kosovë ku politikë populiste e shfrytëzonin dështimin e dialogut për manipulime të opinionin dhe si instrument për ardhje në pushtet. Marrëveshjet që i arrinte Qeveria, sidomos ajo e Asociacionit të komunave serbe por edhe demarkacioni me Malin e Zi, u shfrytëzuan për të minuar procesin e dialogut, duke paraqitur rezultatet e tij si tradhti e udhëheqësish së korruptuar dhe servile të Kosovës (para së gjithash Hashim Thaçi dhe Isa Mustafa...) e njëkohësisht, sidomos lidhur me refuzimin e pa kuptim të liberalizimit regjimit të vizave për Kosovën, edhe për uljes dhe humbje të kredibilitetit të BE-së (më pastaj edhe të ShBA-së), sidomos pasi që diplomacia e Austrisë dhe negociatorja e BE-së Mogherini provuan inaugurimin e një rruge të shkurtuar të marrëveshjes Kosovë - Serbi të bazuar në idenë e shkëmbimit të territoreve, ku pjesët e Veriut të Kosovës do të

këmbeheshin më pjesët e Luginës së Preshevës.

Kjo është shkurtimisht historia e dështimit të dialogut që krijoi platformën e diskreditimit të Perëndimit dhe fuqizimin e parullave bosh populiste se Kosova mund t'ia dalë vetë, pa miq ngatërrestar që dialogun na imponojnë me sherr për interesa të tyre meskine, të dëmshme për Kosovën. Kjo frymë e ka motivuar ish Kryeministrin Kurti që ta refuzojë takimin me delegacionin e Serbisë në Shtëpinë e Bardhë në Uashington, sepse ishte i bindur se atje do të detyrohet (siç!) ta pranojë hartën e Kosovës me thika të ngulura të copëtimit në te!

Kjo frymë është shfrytëzuar, jo vetëm nga Kurti, për nevojat e luftës së brendshme për pushtet duke diabolizuar dialogun me Serbinë si favorizim të Beogradi dhe presion joparimor ndaj Kosovës, që Hashim Thaçi, Isa Mustafa dhe të tjerët të portretizohen si tradhtar servilë e të paafte, kurse liderët botëror të involvuar në shtytjen e dialogut, si figura meskine që nuk na duan të mirën, dhe se s'duhet t'i nënshtrohem kërkesave mashtruese në konferencat e Berlinit ose Parisit. Në opinionin tonë këto procese nuk kanë mundur të mos sjellin dyshime në rolin e BE-së e më vonë edhe të administratës së Trampit dhe SHBA-ve. Në disa moment dyshimet shkonin në skajshmëri, dhe kjo reflektohej edhe në opinion. Nuk është se është tretur ndjenja falënderuese ndaj Perëndimit mbështetjen që kishim në vitet 1998-1999, ose në vitet 2008 (pavarësia) dhe 2010 (verdikti i GjND-së).

Por, nuk kuptohej fare pse detyroheshim vazhdimisht dhe me ngulm, ta mbanim gjallë dialogun me Serbinë edhe kur shihej ashiqare që Serbia atë e shndërroi në mjet për të blerë kohën pa qenë aspak e interesuar për arritjen e marrëveshjes finale. Në zgjedhjet që do të shpallen së shpejti, skena jonë politike hyn me këtë hendikep të madh të konfuzitetit me rolin që e kanë fuqitë e mëdha në dështimin e dialogut si dhe si do të duhej të sillemi në rrethanat e mosfitimit të asnjë favor të prekshëm nga dialogu. A duhet ai të ndërpritet? A duhet të flasim me ShBA-në dhe BE-në me një gjuhë tjetër duke u mbajtur atyre leksione strategjike naive, përderisa elita jonë në të vërtetë nuk tregon gatishmëri që të flasë me një zë rreth çështjeve të interesave madhore?

A mund elitat tona politike të paktën të punojnë për hartimin e një platforme të përbashkët racionale dhe analitike në të gjitha aspektet rreth planit të ri të krijimit të një zone ekonomike rajonale të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor, që pas Marrëveshjes së Uashingtonit të 4

SHKRUAR ENKAS PËR "EPOKËN E RE"

Viti i ri me sfida dhe probleme të vjetra për institucionet emergjente në Kosovë



Tahir AHMETI, drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC)

Vitet e fundit jemi dëshmitarë të fatkeqësive të ndryshme natyrore që po ndodhin në mbarë globin, si dhe përpjekjeve të atyre vendeve që sa më mirë t'i menaxhojnë këto fatkeqësi në mënyrë që të kenë sa më pak pasoja.

Por çka janë fatkeqësitë natyrore?

Me fatkeqësi natyrore kuptohen tërmetet, përmbytjet, thatësitrat atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara, sëmundjet infektive masive, pasojat e të cilave prekin popullatën, pronën, mjedisin, si dhe ngjarje të tjera

të shkaktuara nga dukuri natyrore, ndërsa me fatkeqësi të tjera kuptohen aksidentet rruqore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, shpërthimet, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore, ekologjike ose industriale dhe çdo lloj tjetër aksidenti të shkaktuar nga veprimi njerëzor, nga luftërat ose gjendjet e emergjencës, si dhe format e tjera të dhunës masive.

Kur jemi te fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, edhe Kosova potencialisht mund të goditet nga këto rreziqe të cilat mund të vijnë qoftë nga natyra, qoftë nga faktori njeri.

Vendi ynë në bazë të rasteve më të shpeshta që kemi pasur, kryesisht rrezikohet nga tërmetet, vërshimet, zjarret e pyjore dhe erërat e forta, por si rrezik mund të konsiderohen edhe ortekët e borës, rrëshqitjet e dheut, sëmundjet infektive masive etj. Gjithashtu, rreziqe mund të vijnë edhe nga faktori njeri, si: sulmet e supozuara terroriste, aksidentet ajrore, hekurudhore, rruqore dhe rrjedhjet e mundshme të materieve kimike dhe

naftës.

Institucionet emergjente në Kosovë, edhe pse me kuadër të konsoliduar ligjor, sillen në rreth vicioz. Në rast të ndonjë fatkeqësie më të madhe natyrore, Kosova nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, logjistike dhe operacionale, si dhe patjetër që duhet përsëritur për të satën herë që shteti i Kosovës nuk ka asnjë helikopter të vetëm, për ta përdorur në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore.

Përkushtimi dhe profesionalizmi i këtij institucioni nuk është në trendin e vet më të mirë.

Duhet të ketë sa më shumë trajnime, plane dhe përgatitje në vazhdimësi, ndërsa ushtrimet praktike të koordinuara të të gjitha institucioneve kompetente, janë mënyra më e mirë për të qenë sa më të gatshëm dhe më të përgatitur për t'i përballuar fatkeqësitë e mundshme natyrore.

Një rishikim i plotë i institucioneve, përgjegjësive të tyre, kapaciteteve humane dhe teknike, aftësisë së tyre vepruese, buxhetit të tyre dhe koordinimit mes tyre është më së i domosdoshëm.



shtatorit ka gjasa se do ta ketë mbështetjen edhe të administratës së re të Bidenit dhe të BE-së si një propozim më konkret, më i prekshëm për nga investimet dhe dobitë për çdo vend dhe për rajonin në tërësi. A mundën si prova të atdhetarizmit Albin Kurti, Enver Hoxhaj, Avdullah Hoti dhe liderët

e tjerë të lënë anash zënkat për pushtetin e paqenë që u zgjat vetëm disa muaj, që të ulën dhe mirën vesh për gjërat që janë më rëndësi jetike për të gjithë ne? Epilog vështirë i imagjinueshëm, por i domosdoshëm nëse kuptohet se po, ne duhet të jemi të dinjitetshëm dhe vetja jonë në bisedimet për fatin tonë, por

edhe se i gjithë procesi nuk mund të na nxjerrë fitues apo me ndonjë të mirëseardhur duke u thirrur në ato krekosje dritëshkurtra, se jemi shtet sovran që mund t'ia dalim të vetëm, duke ua bërë "vetingun" interesave të miqve të dëshmuar që i kemi!

SHKRUAR ENKAS PËR "EPOKËN E RE"

KOSOVA, SHTET I PABËRË PLOTËSISHT



Ismail SYLA

1. Kur Konferenca Ndërkombëtare e Rambouillet u finalizua në Paris më 18 mars 1999, për Kosovën ishte rrethanë fatlume refuzimi i nënshkrimit të dokumentit nga ana e Serbisë. Në marrëveshje ishte përfshirë prania e 1500 forcave ushtarake serbe në Kosovë. Bombardimi 78 ditësh i Jugosllavisë së mbetur të Millosheviqit nga NATO në fund pat epilog historik. Serbia u dorëzua me Marrëveshjen e Kumanovës me 9 qershor 1999. Refuzimi i Serbisë pos që çoi në çlirimin e Kosovës, e krijoi një moment të rëndësishëm kur sekretarja e Shtetit Madeleine Albright ia kumton lajmin me linjë satelitore liderit politik të UÇK-së Hashim Thaçi - së se nga Kosova do të tërhiqen të gjitha forcat ushtarake dhe policore serbe. Për këto 1500 forca, në bisedimet e Vjenës, nën drejtimin e të dërguarit special të OKB-së për statusin e Kosovës Martti Ahtisaari, qarkulloi një anekdotë siprituoze, kur delegacioni serb i nervozuar dhe duke parë që e kanë humbur keq Kosovën, kishte kërkuar të realizohej kthimi i tyre. Me ironi dhe cinizëm ishte përgjigjur Ahtisaari: Nëse i kthejmë me sa ushtarë të KFOR-it do t'i ruajmë ata? Duke aluduar se pas

krimeve, masakrave, spastrimit etnik dhe gjenocidit të ushtruar mbi popullatën shqiptare të Kosovës, për forcat serbe nuk kishte mbetur më vend.

2. Përfundimi i luftës në Kosovë nuk mbeti pa një plagë të thellë që është ende e gjallë sot atë ditë. Kontrollimi i pjesës së territorit prej bregut verior të lumit Ibër deri te kufiri me Serbinë nga strukturat serbe që në thelb dirigjohen nga Beogradi është problem ende i hapur. Nëntë vjet pas çlirimit, Kosova u shpall shtet i pavarur, më 17 shkurt 2008, por gjendja në veriun e saj gjeografik tregon se Kosova ende nuk është shtet i bërë një qind për qind në aspektin territorial. Bisedimet teknike dhe ato politike në Bruksel nuk kanë arritur ta rrumbullakojnë këtë aspekt të Kosovës. Natyra e krizës së veriut të Kosovës ndryshon nga gjendja e krizës së Kosovës në vitet e paraluftës dhe gjatë luftës. Kjo gjendje "paqësore" 21 vjeçare ka bërë që në Bruksel dhe Uashington të mos ketë vendosmëri të hekurt që të zgjidhet përfundimisht ky problem. Zhagmitja organike evropiane dhe mosvënja e Kosovës në listën prioritare të

agjendës amerikane ka bërë që kjo pjesë e Kosovës të jetë ilustrim i gjallë për Atdheun tonë ende plotësisht të pabërë.

3. Njohja e Kosovës si shtet i pavarur nga shumica e vendeve më të rëndësishme të botës është një e arritur e madhe diplomatike. Është e vërtetë e dukshme se Kosova ka bërë shumë koncesione, zbatim të diskriminimit pozitiv në favor të komuniteteve pakicë, e veçanërisht ndaj atij serb. Sado që të ketë bërë Kosova, Beogradi zyrtar pas mbarimit të luftës ka dëshmuar një vendosmëri të paluhatshme për ta penguar Kosovën në arenën ndërkombëtare. Së pari me mosnjohje. Logjika politike e Beogradit ka dëshmuar se kur nuk ka bombardime të NATO-s ajo nuk lëshon pe. Me krenari çdo lider shtetëror serb deklaroi se derisa të jetë në pushtet nuk do ta nënshkruajë pavarësinë e Kosovës. Ata do ta nënshkruanin ose një Kosovë të gjymtuar keq ose një Kosovë me një republikë serbe që do të bëhej funksionale në atë pjesë që me qejf do ta gjymtonin. Mosbërja e Kosovës në veri rri si shpatë Damokleu e varur në një fije të hollë peri.

4. Nëse do të shpreheshim me logjikën e shifrave, Kosova është e bërë shtet rreth 90 për qind. Tendencat për shtet - rrumbullakësi kërkon që të ecet para dhe arrijë 95 për qindëshin, pastaj me radhë deri në 99 e përfundimisht deri në 100 për qind. Tendencat kundër - shtetësi po përpiqet që përmes këtij 10 për qindëshi të pambaruar ta rrezikojë atë 90 për qind të mbaruar. Po gërryen kudo, po kërkon vrima, po përpiqet të gjejë hapësira jashtë dhe brenda Kosovës, që ta rrënojë shtetin e Kosovës, Tentativa më e sofistikuar e rrënimit të 90 për qind të pavarësisë dhe shtetësisë së Kosovës është aktakuza dhe burgosja e lidërshiptit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nëse e shikojmë elementin njerëzor që goditet nga kjo aktakuzë, shtabi i përgjithshëm, komandantët e zonave, çdo lloj eprori, "ministrat" dhe "zëvendësministrat" e "Qeverisë së Përkohshme të Kosovës" (1999), nëse këta njerëz pa gjë në dorë kanë arritur të bëjnë krime kundër njerëzimit, ngjashëm dhe njëjtë si aparati shtetëror i Jugosllavisë dhe Serbisë së Millosheviqit, atëherë vërtet arrihet një goditje e rëndë në zemër të shtetësisë së Kosovës.

5. Gërryerjet e brendshme shqiptare, dëshmitë e rrejshme, akuzat mbi baza partiake kundër njerëzve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pa dyshim janë kontributet më të ulëta që pasuruan mozaikun armiqësor dhe iu bashkuan frymën anti - Kosovë në Beograd e më gjerë. Pjesa më e ndritshme dhe më sublimë e historisë së Kosovës që kurorëzoi lirinë dhe pavarësinë e Kosovës po tentohet që të përmbysset. Nga luftë çlirimtare, lufta e UÇK-së të shndërrohet në krim kundër njerëzimit. Duke përmbysur këtë histori po shemben gur themelet e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Duke i shembur këto themele po i jepet shkas frymës anti - Kosovë që të hapet ideja e rishqyrtimit dhe kontestimit të pavarësisë së saj. E ku ka më mirë për Beogradin zyrtar që përmes këtij rishkrimi të historisë, sa herë që të akuzohet për gjenocid në Kosovë, të përmend "krimet" e Ushtrisë Çlirimtare!

E, sa për gëzimin e një pjese të konsiderueshme të spektrit politik që prapa grilave gjenden liderët themelorë të UÇK-së, duhet një shkrim tjetër.

6. A të them: Gëzuar 2021?



SHKRUAR ENKAS PËR “EPOKËN E RE”

VITI I PANDEMISË SHËNDETËSORE GLOBALE DHE I PANDEMISË SONË KRONIKE POLITIKE



Valon MURATI

1. Viti që po e lëmë pas do të jetë një vit për t'u mbajtur mend. Njerëzimin ky vit e vendosi me shpatulla në mur dhe e sfidoi në të gjitha drejtimet. Pandemia e shkaktuar nga Sars-Covid-2 ishte kryefjala e këtij viti. Virusi i panjohur jo vetëm që sfidoi mjekësinë por sfidoi krejt shoqërinë njerëzore me tërë strukturat e saj institucionale. Ndonëse sot reagimi është më i përpunuar, edhe pse pandemia vazhdon të jetë e paparashikuar, në fillimet e veta pat reagime me elemente anarkiste edhe nga shtete shumë të konsoliduara. Sigurisht shtetet më të konsoliduara, më të zhvilluara ekonomikisht e me shëndetësi më të avancuar në letër e kanë pasur më të lehtë ballafaqimin. Por në realitet disa nga këto shtete si Italia, Spanja e madje edhe Franca, Britania e Madhe e SHBA-të me shumë vështirësi u ballafaquan e janë duke u ballafaquar me pandeminë. Lufta ndaj pandemisë së panjohur u përqendrua fillimisht kryesisht në konceptin e mbylljes totale, që ndihmoi në ndaljen e përhapjes së hovit të sëmundjes por e dëmtoi rëndë dhe vazhdon ta dëmtojë ekonominë. Baraspesha në mes jetës së njeriut dhe shëndetit të ekonomisë (që prapë godit jetën e njeriut) është në fokus të politikave botërore në luftimin e pandemisë. Kohën e fundit mbylljet kanë qenë më të matura e më të kufizuara por, sidoqoftë, masa të tilla janë shtrirë së fundmi deri në Gjermani, e cila konsiderohej si kampione në betejën kundër pandemisë në fazën e parë. Sigurisht mbyllja totale u përcoll edhe me telashe të tjera, me rritjen e sëmundjeve mentale e të dhunës familjare, andaj në formën sesi u zbatua në fillim më nuk u implementua. Megjithatë festat e fundvitit në tërë Evropën do të jenë më të veçantat në dekadat e fundit prej kur ato u sekularizuan dhe u komercializuan në masën që i njohim sot. Nuk do të ketë

festime si jemi mësuar të kemi, ashtu siç nuk pat edhe mësim normal këtë vit, as ekonomi normale, as sport normal, e as jetë normale. Ndalesat për dalje janë bërë të zakonshme, sa njerëzit kanë filluar të mendojnë se cili do të jetë normaliteti i ardhshëm?

2. Një situatë e tillë e cila sfidoi shoqërinë njerëzore edhe njëherë dëshmoi se sa i lidhur është njerëzimi me njëri-tjetrin. U dëshmuua edhe njëherë se kufijtë e shteteve janë vija imagjinare njerëzore për të cilët mikroorganizma si viruset nuk brengosen fare. Vërtet këto kufij u mbyllën, për ta ndaluar njeriun që të bart virusin, por dëmi u bë. Nga Vuhani i Kinës për më pak se 3-4 muaj koronavirusi i ri u përhap në tërë botën. Goditja ndaj botës tregoi për brishtësinë e reagimit të përbashkët të njerëzimit. Institucionet e përbashkëta shëndetësore, si OBSH, apo ato ndërqeveritare si OKB apo edhe BE-ja, nuk e kanë forcën e duhur as njerëzore, as financiare e as vullnetin politik për të kryer detyrat e veta kolektive. Kështu në fazën e parë reagimet ishin shumë egoiste, duke u fshehur në kufijtë imagjinare që njerëzit e popujt i kanë vendosur ndaj njëri-tjetrit. Por në këtë egoizëm të reagimit shtetëror, reagimi i njerëzve dhe solidariteti i tyre ishte shembull. Në këso rrethanash të vështirësive nga njeriu del më e mira. Andaj edhe solidariteti njerëzor edhe njëherë ia zuri vendin egoizmit njerëzor. Në vijën e parë të frontit të betejës kundër pandemisë u vendos sektori shëndetësor së bashku me emergjencat e tjera të vendeve përkatëse. Në këtë situatë nuk mungoi solidariteti për mjekët dhe infermierët të cilët jo vetëm se ishin qenësor në këtë betejë, por duke qenë vija e parë e frontit edhe u goditën jashtëzakonisht shumë, duke lënë në vijën e parë të betejës shumë mjekë, infermierë, e motra mjekësore. Në anën tjetër shtetet e kuptuan shpejt se duhet një bashkëpunim më i madh në këtë betejë, sepse është betejë e njerëzimit për mbijetesë në të gjitha drejtimet. Koordinimi ende nuk është në nivelin e duhur por sidoqoftë ka një lëvizje përpara nga egoizmi shtetëror i ditëve të para. Në këtë drejtim edhe BE-ja krejtësisht jo efektive në fillim ka filluar të bëjë

hapat e parë serioz të bashkëpunimit qoftë në fushën shëndetësore qoftë në atë të rimëkëmbjes ekonomike.

3. Po Kosovën tonë të dashur si e gjeti pandemia. E gjeti sigurisht me shërbim shëndetësor të brishtë e me plot telashe organizative e financiare. E gjeti me ekonomi po ashtu të brishtë e me telashe. E gjeti me vështirësi në sundimi e ligjit e me probleme në sistemin gjyqësor. E gjeti me një sistem arsimor jo adekuat me kohën që po jetojmë. Por mbi të gjitha e gjeti edhe me një politikë e qeverisje vazhdimisht në pandemi politike. Prej kur pandemia u përhap në Kinë dhe në Evropë, Kosova ka pasur tre kryeministra. Shumë për një vend me gjithë këto telashe. Sidoqoftë, me krejt këto telashe e me shumë vështirësi e edhe me viktima nga pandemia, Kosova nuk mund të thuhet se ka dështuar në betejën ndaj pandemisë. Po ka pasur telashe, lëshime e vështirësi. Por njëkohësisht me një angazhim të jashtëzakonshëm të stafit shëndetësor dhe me zbatimin e masave të institucioneve, Kosova dhe sistemi i saj shëndetësor nuk kanë kollapsuar. Ekonomia është goditur rëndë, por shpirti ndërmarrës i njerëzve tanë me politika të duhura qeveritare besoj unë do të bëjë që Kosova ta tejkalojë edhe këtë sfidë. Qytetarët me gjithë pakënaqësitë e herë pas hershme kanë zbatuar masat e qeverive tona dhe kjo ka bërë që megjithatë sistemi shëndetësor

të mos mbingarkohet dhe deri më tani të arrijë të mbijetojë në betejën me pandeminë. Kosova nuk është më keq se rajoni dhe se bota në përgjithësi dhe kjo nuk është për t'u nënvlerësuar.

4. Njerëzimi i cili pos që reagoi me solidaritet e me dashuri për njëri-tjetrin në këto kohë të vështira, nga skutat e tij të errëta reagoi edhe duke ngritur teori konspiracioni, pak a shumë të zakonshme në kësi situatë. Orhan Pamuku në një shkrim në “The New York Times” e përshkruante këtë tendencë të njerëzimit për të akuzuar të tjerët për sjelljen e sëmundjeve dhe për të besuar në teori konspiracioni, si një tendencë që ka ekzistuar gjithnjë. Me padurim po pres librin e tij në të cilin po punon për pandeminë e fundit të kolerës në Stamboll e cila sigurisht do të ndikohet edhe nga pandemia aktuale. Por njerëzimi përpos këtyre situatave që dalin të natyrshme në të tilla rrethana, iu përgjigj pandemisë jo vetëm me masa politike, ekonomike, arsimore, të shëndetit publik e me teori konspiracioni por edhe me shkencë. Kështu që lajmi më i mirë i këtij fundviti është se tri vakcina u zbuluan dhe dy prej tyre janë certifikuar në shumë shtete dhe kanë filluar fushatat e dhënies së tyre tek grupe të caktuara të popullsisë. Kosova në këtë drejtim duhet të jetë shumë agile sepse mund të mbesim në fund të listës së shteteve që do të furnizohen me vaksinë. Sidoqoftë kjo është një

arritur e madhe dhe shumë e shpejt për njerëzimin. Drita më në fund po shihet në fund të tunelit.

5. Në Kosovë pandemia politike do të vazhdojë. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e rrëzoi qeverinë Hoti. Edhe ashtu kjo qeveri do ta kishte vështirë ta mbijetonte zgjedhjen e presidentit. Zgjedhjet e reja janë një mundësi për një legjitimitet të ri politik. Të kemi shpresë edhe për një qeveri stabile e që së paku pandemisë politike do t'i jepte fund. Kështu do të krijoheshin rrethanat për një betejë më të strukturuar politike, për një opozitarizëm të ri dhe për një përballje me pandeminë në fazat e fundit me institucione më të konsoliduara. Por si zakonisht sipër të gjitha qeveritë, testi kryesor edhe për qeverinë e re do të jetë përballja me Serbinë. Këtu fatkeqësisht nuk kam shumë shpresë se një qeveri e re do ta ndryshojë kursin dhe do të jetë e vendosur që njëherë e përgjithmonë ta heq Serbinë nga jeta jonë e brendshme me një marrëveshje me të cilën Kosova përfundimisht do të funksionalizohet. Sidoqoftë po futim në vitin e ri me plot shpresë se nuk do të jetë si ky që kaluam, se kemi mësuar diçka nga ky për njeriun, sjelljen njerëzore, dashurinë e solidaritetin dhe se do ta zbatojmë në jetën tonë personale dhe, po ashtu, në politikë. Urime të gjithëve Viti i Ri 2021.





Flet për “Epokën e re”, Hykmete BAJRAMI

EPILOGU I HETIMEVE TË DYMILIONËSHIT DUHET TË KRYHET SA MË SHPEJT

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka bërë me dije se gjatë periudhës kohore qershor - dhjetor 2020 aktiviteti i kryesor i Ministrisë së Financave (MF) ka qenë i fokusuar në adresimin e sfidave financiare të krijuara nga pandemia Covid-19. Në intervistën dhënë për gazetën “Epoka e re”, ajo ka theksuar se kanë zbatuar pjesën më të madhe të masave të Pakos së Rimëkëmbjes për vitin 2020, me përfutjes mbi 36 mijë biznese. “Kemi financuar shëndetësinë, arsimin, kulturën, sportin, policinë si dhe kemi mbështetur familjet në asistencë sociale të cilave ua kemi dyfishuar të hyrat për tre muajt e fundit”, ka thënë Bajrami, e cila ka folur edhe për vjedhjen e dy milionë eurove. Ajo pret që këto mjete të kthehen në thesarin e shtetit dhe rasti të zbardhet në tërësi

2020, MF në afat rekord ka rishikuar buxhetin e vitit 2020, duke konsultuar organizatat buxhetore. MF ka qenë aktorja kryesore për hartimin e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike, hartimit të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19. Menjëherë pas aprovimit të rishikimit të Ligjit të Buxhetit ne jemi angazhuar për ekzekutimin e masave të pakos së mëhershme dhe kemi mbështetur ministrinë e linjës për përgatitjen për implementim e një sërë masash të programit për rimëkëmbje ekonomike. Si pasojë e implikimeve të krijuara nga rënia e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve kosovare për shkak të pandemisë, ne është dashur ta bëjmë edhe rishikimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023 dhe

menjëherë pas këtij procesi, kemi filluar përgatitjen e buxhetit për vitin 2021, i cili, pas aprovimit në qeveri, është dorëzuar në Kuvend. Sa i përket sigurimit të financave publike të qëndrueshme, përmes reformave në menaxhimin e financave publike dhe bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare kemi shënuar arritje të rëndësishme. Në këtë drejtim kemi arritur t'i përmbyllim procedurat për nënshkrim të nëntë marrëveshjeve në vlerë financimi rreth 250 milionë euro, ku 213 milionë euro janë financim për luftën ndaj pandemisë Covid-19. Financimi përfshin rreth 26 milionë euro pajisje mjekësore dhe rreth 30 milionë intervenime në sektorin

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR

“Epoka e re”: Z. Bajrami, çfarë reformash keni bërë gjatë mandatit tuaj në krye të MF-së dhe si e keni përmbyllur

këtë vit?

Bajrami: Gjatë kësaj periudhe kohore qershor - dhjetor 2020 aktiviteti i kryesor i Ministrisë së Financave (MF) ka qenë i fokusuar në adresimin e sfidave financiare të krijuara nga pandemia. Siç jeni në dijeni,

pandemia e virusit ‘Korona’ ka shkaktuar vështirësi të konsiderueshëm në punën e bizneseve dhe kjo ka rezultuar, padyshim, me rënien e të hyrave për buxhetin e shtetit. Menjëherë pas marrjes së mandatit, në muajin qershor



shëndetësor.

Kemi zbatuar pjesën më të madhe të masave të Pakos së Rimëkëmbjes për vitin 2020, me përfutjes mbi 36 mijë biznese; kemi financuar shëndetësinë, arsimin, kulturën, sportin, policinë si dhe u kemi dalë në mbështetje familjeve në asistencë sociale të cilave ua kemi dyfishuar të hyrat për tre muajt e fundit.

Në aspektin e harmonizimit të legjislacionit në fushën e financave publike në harmoni me obligimet e dala në Marrëveshja për Stabilizim Asociim, gjatë kësaj periudhe kemi aprovuar në qeveri 16 ligje të rëndësishme. Kemi lansuar procesin e përgatitjes së Programit të Reformave në Ekonomitë 2021-2023 dhe tashmë drafti i përgatitur është publikuar në platformën për konsultime publike.

“Epoka e re”: Tani që kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka konstatuar se qeveria Hoti ishte e paligjshme, çfarë reformash kanë ngelur në gjysmë që ju i kishit objektiv të punës për vitin 2021?

Bajrami: Planprogrami i Qeverisë së Kosovës 2020-2023 parasheh një sërë reformash të rëndësishme të cilat synojnë fuqizimin e ekonomisë së Kosovës në periudhën pas pandemisë dhe natyrisht se këto reforma kërkojnë një periudhë të caktuar kohore për t’u përmbushur në tërësi.

“Epoka e re”: Në mandatin tuaj ndodhi skandali i vjedhjes së 2.1 milionë eurove, ndërkohë që paratë nuk u kthyen më në buxhetin e shtetit. Çfarë do të bëhet lidhur me këtë?

Bajrami: Menjëherë pas marrjes së njoftimit për këtë incident ne kemi ndërmarrë veprime të menjëhershme duke i njoftuar organet e ndjekjes të cilat po merren me zbardhjen e këtij rasti. Po ashtu, brenda mandatit tonë kemi ndërmarrë veprime institucionale në drejtim të fuqizimit të sistemeve të teknologjisë informativë dhe protokolleve të brendshme në Thesarin e Shtetit. Ne si Ministri e Financave jemi tejet të interesuar që epilogu i hetimeve nga organet e ndjekjes të kryhet sa më shpejt. Mirëpo, me qëllim të mos dëmtojmë proceset e hetimit, ne rezervohemi të lëshohemi në detaje.

“Epoka e re”: Në rast se këto mjete s’do të kthehen asnjëherë edhe nëse s’jeni më në krye të ndonjë dikasteri ekonomike, a do të kërkonit që të ndiqet tutje ky rast?

Bajrami: Që nga dita e parë kur ka ndodhur incidenti në fjalë, unë si ministere e Financave i kam ofruar bashkëpunim të plotë prokurorisë së shtetit në

mënyrë që ky akt i ulët, i cili dëmton interesin publik përmes vjedhjes së taksave të qytetarëve, të zbardhet me sukses. Po ashtu, konsideroj se kam qenë mjaft transparente me publikun duke e ndarë me opinionin këtë shqetësim të përbashkët për atë që lejoi legjislacionin në fuqi. Ky rast duhet të ndiqet jo për arsye se është kërkesë e imja, por sepse është obligim i institucioneve të drejtësisë ndaj qytetarëve të vendit. Unë gjithmonë do të kërkoj që mjetet të kthehen në thesarin e shtetit dhe rasti të zbardhet në tërësi.

“Epoka e re”: Sa mjete i keni planifikuar për rimëkëmbje ekonomike për vitin 2021?

Bajrami: Në Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid-19, i cili është aprovuar tashmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë përcaktuar masa të rëndësishme të cilat synojnë të fuqizojnë bizneset dhe t’i mbështesin qytetarët e Kosovës. Një nga ato është ulja e TVSh-së për hotelerinë dhe gastronominë nga 18 për qind në 8 për qind; rritja e kapitalit të Fondit Kosovor për Garantimin e Kredive, përmes të cilit do të përmirësohet ndjeshëm qasja në financa e kompanive kosovare, e fermerëve, por edhe e grave në biznes. Po ashtu, një nga masat e mbështetjes direkte financiare për bizneset përfshin shumën prej 200 milionë eurosh përmes së cilës do të ndahen mjete për bizneset e goditura nga pandemia. Masa tjetër shkon në mbështetje të punëtorëve të cilët e kanë humbur vendin e punës për një periudhë tremujore gjatë kohës së pandemisë, për të cilët do të paguhet një shumë prej 300 eurosh për tre muajt.

“Epoka e re”: A do t’i hyni garës në listën e LDK-së për deputete?

Bajrami: Në këtë periudhë jam tejet e angazhuar në ministri sa i përket përmblyljes së punëve të këtij viti fiskal. Për çështjen e garës zgjedhore ende nuk kam vendosur.

“Epoka e re”: Cilat janë pritjet tuaja nga elektorati i LDK-së, marrë parasysh se Vjosa Osmani s’do të jetë pjesë e kësaj partie?

Bajrami: LDK-ja është një parti me traditë të gjatë politike dhe me një elektorat të emancipuar. Elektorati i saj e njeh mirë filozofinë e LDK-së si një parti shtetformuese nga e cila pritet që ta vazhdojë tutje misionin e saj të fuqizimit të institucioneve, konsolidimit të shtetësisë së Kosovës në rrëfshin ndërkombëtar, zhvillimin ekonomik dhe integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike.

SHKRUAR ENKAS PËR “EPOKËN E RE”

Për vitin e paprecedent dhe mësimet e nxjerra



Arian ZEKA

Shpërthimi i pandemisë Covid-19 në muajt e parë të vitit 2020 e shndërroi vitin 2020 në një vit të paprecedentë për tërë globin në 100 vjetët e fundit. Në kontekstin lokal, planet e ndryshme për fuqizim të shtetit të Kosovës, respektivisht shtyllave të tij themelore si ekonomia, edukimi, shëndetësia, drejtësia dhe siguria, të prezantuara nga partitë politike, përfshirë edhe ato që kishin marrë besimin e qytetarëve për drejtimin e vendit në zgjedhjet parlamentare të mbajtura pak muaj para se koronavirusi të shpallej pandemi në nivel global, u zëvendësuan me masa të tjera të paplanifikuara, për mbrojtjen e kujdesit shëndetësor, të cilat në masë të madhe ndikuan në kufizimin në shkallë të gjerë të aktiviteteve ekonomike. Për shkak të kësaj, planet ambicioze për lehtësira fiskale e nxitje të investimeve të jashtme e të brendshme u zëvendësuan me masa ad-hoc për përkrahje të ndërmarrjeve e punonjësve në Kosovë, të cilët po ballafaqoheshin me turrjen më të madhe të të hyrave në dy dekadat e fundit.

Derisa pandemia shpërfaqti brishtësinë e sistemeve të kujdesit shëndetësor në shumicën e shteteve të botës, Kosova, si shtet me shpenzime më të ulëta për shëndetësinë publike, u detyrua të aplikonte masa më strikte për ta parandaluar përhapjen e pandemisë. Buxheti i kufizuar po ndikonte edhe në gjerësinë e zerrës së shtetit për t’i ndihmuar ndërmarrjet e rrezikuara dhe për t’i mbrojtur vendet e punës. Thënë shkurt e shqip, po paguanim çmimin e politikave të gabuara publike, por edhe të keqpërdorimeve të mjeteve buxhetore përgjatë viteve, të cilat po të mos kishin përfunduar paligjshëm në gjepat e disave, do të mund të investoheshin për ngritjen e kapaciteteve spitalore të vendit, të cilat do të mundësonin përbalimin më të mirë të pandemisë.

Për mësimet që duhen nxjerrë, kujdesi shëndetësor

Globalizimi dhe mobiliteti më i madh i njerëzve dhe mallrave, ka

bërë që edhe fatkeqësitë e tilla shëndetësore të përhapen në pak javë, nga njëri kënd i largët i botës në të gjitha pjesët e saj, si në rastin e koronavirusit të ri. Mutacionet e virusit aktual, apo viruset e reja që mund të shfaqen në ndërkohë, e bëjnë më se domosdoshme që shteti i Kosovës, të shohë me prioritet investimet në shëndetësinë publike. As sektori privat, e as shteti vetë nuk duhet të vuajnë pasojat e politikave populiste e të gabuara, që për fokus kanë objektivat afatshkurtra, e që për hir të së vërtetës, gjenerojnë imazhe të bukura e më shumë vota, por nuk adresojnë nevojat afatgjata të qytetarëve. Investimet duhet të përfshijnë pashmangshëm infrastrukturën fizike, por edhe atë njerëzore, që nënkupton edhe kompensimin më të duhur të të gjithë punonjësve të kujdesit shëndetësor, që me të drejtë i konsideruam heronj, për shkak se rrezikuan edhe jetën e tyre, për t’u dalë në mbrojtje qytetarëve të vendit. Të njëjtët duhen motivuar që prospektet për zhvillim profesional dhe personal, të mos i kërkojnë në shtete të tjera, por vetëm në Kosovë.

Ekonomia

Pandemia Covid-19 ka ekspozuar në masë të madhe dobësitë e sistemit ekonomik, jo vetëm në sektorin publik, por edhe në sektorin privat. Modelet dhe proceset tradicionale të biznesit, kombinuar me politikat e gabuara fiskale për shumë vite, kanë bërë që ndërmarrjet private në Kosovë, të jenë më të papërgatitura për ballafaqimin me efektet e pandemisë. Për vite me radhë është folur për rëndësinë e transformimit digjital, si dhe të orientimit drejt ekonomisë së bazuar në internet, ose ekonomisë digjitale. Derisa pandemia ka prekur gati të gjitha ndërmarrjet në mënyra dhe nivele të ndryshme, ajo që tashmë dihet është që sektori i ekonomisë digjitale ka shfrytëzuar më mirë fatkeqësinë e këtij viti. Ky do të duhej të ishte treguesi më i rëndësishëm i investimeve të ardhshme në zhvendosjen e proceseve tradicionale të biznesit me ato digjitale. Kjo do të rriste aftësinë e bizneseve për të reaguar ndaj çrregullimeve të papritura në treg dhe do të rriste gjasat e mbijetesës, në rast se bota rrezikohet nga pandemi të tjera të ngjashme, si kjo e Covid-19.

Në anën tjetër, çrregullimet në zinxhirët globalë të furnizimeve do të duheshin theksuar nevojën e rritjes së kapaciteteve prodhuese vendore, për zgjerim

në tregjet ndërkombëtare, sidomos në shtetet që janë në afërsi gjeografike me Kosovën, ose ato me të cilat Kosova gëzon aranzhime të lira ose preferenciale tregtare, siç është rasti me Bashkimin Evropian e Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Politika

Hisedarët politikë, me veprimet e tyre të qëllimshme dhe të paqëllimshme, kanë rënduar dukshëm ndikimin e pandemisë Covid-19 në ekonominë e vendit. Nëse jo për menaxhimin efikas të pandemisë, Kosova së paku ka zënë vend në titujt e lajmeve ndërkombëtare, për rrëzimin e Qeverisë dhe thellimin e krizës institucionale, pikërisht në kohën kur vëmendja e institucioneve do të duhej të ishte e përqendruar tërësisht në menaxhimin e pandemisë dhe pasojave të saj. Injoranca e demonstruar përmes qeverisjes së dobët ekonomike, së paku në 12 vitet e të ekzistuarit të Kosovës si shtet i pavarur, nuk ka mundur të ndryshojë (aq më pak për të mirë), në muajt e ballafaqimit me pandeminë. Mungesa e një strategjie nacionale zhvillimore, oferta e varfër për investitorët, si dhe sundimi i dobët i ligjit, me vite i kanë kontribuar një strukturë të paqëndrueshme zhvillimore, me shumë pak investime të jashtme, e të varur në masë të madhe nga dërgesat e Diasporës, e cila në këtë vit të rëndë, vetëm se ka vulosur peshën e kontributit të saj për mbajtjen në këmbë të ekonomisë së Kosovës.

Do të kishte qenë gati e pabesueshme të mendohej se partitë, pa përjashtim, do t’u jepnin përparësi interesave të ngushta dhe inateve partiake, në llogari të veprimit të bashkërenduar dhe të shpejtë në mbështetje të sektorit privat dhe punonjësve të Kosovës. Tanimë kur vendi do të hyjë në një cikël të ri zgjedhor, partitë politike, e veçanërisht ata që do ta marrin besimin për drejtimin e qeverisë së vendit, do të duhej të kuptonin si kurrë më parë përgjegjësinë që do të kenë për transformimin ekonomik të Kosovës. E një procesi të tillë të ndryshimit do t’i duhej paraprirë me një pakt për një ekonomi të re, të koordinuar ngushtë me akademinë, ekspertët, punonjësit dhe sektorin privat. Gjithçka tjetër do të vijonte të ishte improvizim, si dhe çmim që do të paguhej sërish në të ardhmen, për gabimet e të sotmes!

(Autori është drejtor ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë)

SHKRUAR ENKAS PËR "EPOKËN E RE"



Dr. Edita TAHIRI

Ish-zëvendëskryeministre dhe kryenegociatore

KAH PO SHKON BOTA

Pandemia globale vuri në sprovë gjithë botën. Pasoja tashmë ishin dhe mbeten shumë të rënda. Humbja e madhe e jetëve të njerëzve dhe humbjet ekonomike e varfëruan botën edhe më shumë. Sidomos vendet më pak të zhvilluara e pësuan më keq. Shqetësimi kryesor ishte shëndeti i popullsisë, i cili nxori në pah dallimet në cilësinë e sistemeve shëndetësore të shteteve. Sigurimi i oksigjenit u bë parësor për pacientët, ndërsa mjekët po bënin një betejë titanike kundrejt këtij armiku natyror. Oksigjenin e kemi pasur si të qenë nga natyra. Pandemia Covid-19 na e rizbuloi se oksigjeni natyror mund të mos jetë i mjaftueshëm ndaj krizave natyrore.

Kjo krizë globale, natyrore apo e sajuar, varësisht nga teoritë e konspiracionit, na bëri të mendojmë edhe për oksigjenin politik që i mungon botës. Ndoshta ishte e papritur, por nisën dhe u rinisën konflikte të reja nëpër botë, ranë qeveri në disa vende, ndërkohë që

hegjemionistët e sëmurë nxituan të armatosen për t'i rivendosur dominimet e humbura pas Luftës së Ftohtë. Derisa pandemia izoloi qytetarët me qëllime kujdesi shëndetësor, qeveritë e shfrytëzuan pandeminë për t'i mbuluar dëshimet e qeverisjes. Po një gjë nuk arriti të mbulohej, ishte varfërimi i qytetarëve, humbja marramendëse e vendeve të punës dhe rritja e dhunës ndaj grave. Këto humbje i ndjeu popullata, ndërsa humbnin edhe të dashurit e tyre. Një pyetje që besoj sillet në mendjen e njerëzve është se "kah po shkon bota". Kjo pyetje është edhe në mendjen time, prandaj vendosa të shkruaj. Po flitet për një "normalitet të ri", por pa ndonjë parashikim të argumentuar se çfarë do të ishte. Derisa vakcina kundër pandemisë u zbulua, tashmë doli një variant i ri i virusit Covid-19, ndaj të cilit nuk ende dihet a mjafton vakcina e zbuluar.

Sekretari gjeneral i OKB-së, Antonio Guterres, në fillim të

vitit prezantoi katër kërcënime të afërta që rrezikojnë progresin e shekullit 21 dhe mundësitë e shekullit 21. Sipas tij, kërcënimi i parë vjen në formën e tensioneve më të larta globale gjeostrategjike që kemi parë në vite, kërcënimi i dytë është kriza klimatike, kërcënimi i tretë është mosbesimi global në rritje dhe i katërti është ana e errët e botës digjitale. Pandemia u bë e pesta, por më e rrezikshme. Ndaj krizave botërore të rrezikut të lartë përgjigjen duhet ta japë politika sepse, pikë së pari, politika qeverisë botën. Njësoj politika qeverisë shtetet dhe qytetarët. Një oksigjen politik është i domosdoshëm për ta këndellur mendjen e politikanëve dhe për t'i shmangur pasojat dramatike që priten. Oksigjeni politik nuk është një metaforë e thjeshtë, është një domosdoshmëri për të shmangur një dramë botërore.

Një oksigjen politik u duhet në radhë të parë marrëdhënieve ndërkombëtare, që kërkon një rikthim në politikën e

bashkëpunimit shumëpalësh. Kjo sepse politikën e jashtme izolacioniste nuk mund t'i zgjidhin krizat botërore, as krizën shëndetësore të goditur nga pandemia, as të varfërisë, as krizën kibernetike dhe as krizën klimatike që, sipas shkencëtarëve, mund të jetë me pasoja apokaliptike.

Ndërsa sa iu takon tensioneve globale gjeostrategjike që janë në rritje, oksigjeni politik i duhet boshtit strategjik perëndimor për ta ruajtur doktrinën gjeopolitike perëndimore, e cila po kërcënohet qartë nga ambiciet gjeopolitike të aktorëve joperëndimorë. Një bosht strategjik në këtë kontekst është forcimi i marrëdhënieve euroatlantike që përjetoji rënie në periudhën e kaluar. Blloku euroatlantik është strategjik për ta mbrojtur doktrinën gjeopolitike euro-atlantike (e njohur si Doktrina e Heartlandit) në shërbim të paqes dhe demokracisë në botë. Bashkësia euroatlantike në krye me ShBA-në dhe partnerët kryesorë evropianë si Gjermania, Franca dhe Britania e Madhe duhet ta pengojnë Rusinë dhe lojën e saj gjeopolitike të bazuar në doktrinën e Euroazisë. Rusia përmes Serbisë po tenton këtë skenar gjeopolitik në Ballkan ngaqë dihet se Ballkani, përkatësisht Evropa Juglindore, është zemra e doktrinës perëndimore. Siç thotë themeluesi i doktrinës gjeopolitike të Heartlandit, Harold Mackinder, "Kush sundon Evropën Lindore komandon Heartlandin, kush sundon Heartlandin komandon ishullin botëror që sundon botën". Skenarët rus-serbë dolën përsëri në sipërfaqe vitet e fundit me lojërat e rrezikshme për ndryshim kufijsh mes Kosovës dhe Serbisë, me tentimet e dështuara të Serbisë për ta marrë veriun e Kosovës, në kuadër të iluzioneve të saj për të krijuar "Serbinë e madhe". Kosova e mposhti këtë skenar të rrezikshëm me përkrahjen perëndimore ku Gjermania pati rolin kryesor për mbylljen e saj definitive. Tani kur zgjedhjet në ShBA sollën lidhshimin e ri në krye me presidentin Joe Biden, pritjet janë optimiste për një forcim të bllokut euro-atlantik, forcimin e NATO-s dhe arritjen e një paqe përfundimtare në Ballkan, e cila fillon me njohjen reciproke mes Kosovës dhe Serbisë në kufijtë aktualë dhe përfundon me ndaljen e ndërhyrjeve të Serbisë në Kosovë, Bosnje dhe Malin e Zi dhe integrimin e shpejtë të Kosovës dhe vendeve të tjera të Ballkanit perëndimor në Bashkimin Evropian dhe NATO, hiq Serbisë që është deklaruar kundër anëtarësimit në NATO.

Në kontekstin evropian, Bashkimi Evropian duhet të bëjë një kthesë gjeostrategjike ndaj Ballkanit. Qasja e

deritashme nuk ka dhënë rezultatet e duhura. Derisa transformimet demokratike dhe evropiane janë një kusht për vendet e Ballkanit, transformimet e politikave të BE-së për ta përfshirë qasjen gjeopolitike ndaj Ballkanit është një kusht për vetë BE-në për ta realizuar projektin politik të një "Evrope të tërë dhe në paqe", ku vendet e Ballkanit duhet të integrohen shpejt. Kaluan mbi njëzetë vjet nga fundi i luftërave në Ballkan, ndërkaq vetëm dy shtete (Sllovenia dhe Kroacia) u bënë anëtare të BE-së. Sipas këtij ritmi të "breshkës", do ta quaja, a thua duhen edhe kaq vite për të integruar pesë vendet e tjera. I njëjti ritëm ka përcjell edhe dialogun e Brukselit, po bisedohet gati dhjetë vjet dhe fundi nuk po shihet. Ndërkohë që gjatë këtij viti nuk u shënuan ndonjë përparim në këtë drejtim. Nëse aleatët tanë presin një këndellje të Serbisë për të pranuar fajin për gjenocidet e bëra, apo për ta njohur Kosovën, një gjë duhet ta dinë se Serbia nuk e ka mendjen as te paqja as te pandemia. Serbia e ka mendjen si të armatoset sa më shumë nga Rusia dhe si ta ridominojë Ballkanin, si vazhdimësi e politikave hegjemoniste të Millosheviqit e klerit fetar serb, duke punuar hapur kundër interesave gjeostrategjike euroamerikane.

Në kontekstin kombëtar shqiptar duhet rritur bashkëpunimin strategjik për të përballuar së bashku tensionet gjeostrategjike botërore. Ndonëse tash jemi dy shtete, tokën shqiptare e kemi të përbashkët ashtu si edhe kombin shqiptar. Kosova dhe Shqipëria kanë obligime kombëtare për ta bashkërenditur politikën e jashtme në favor të gjeopolitikës perëndimore. Dëshiroj t'i lë në të kaluarën disa gabime historike që ndodhën pak vite më parë, ku disa liderë këndej dhe andej kufirit humbën busullën gjeopolitike duke bërë angazhime të gabueshme për ide të rrezikshme për prekje kufijsh. Besoj e kanë marrë mësimin dhe janë këndellur.

Në kontekstin e Kosovës, pavarësisht prej sfidave që kaluam këtë vit, me pandeminë shëndetësore e politike, të rënies së dy qeverive, dhe me Gjykatën Speciale, duhet ta rimarrim veten në planin strategjik dhe gjeopolitik. Jo vetëm që duhet t'i mbrojmë vlerat e luftës për liri dhe pavarësi, duhet të jemi të zotët ta zhvillojmë vendin në planin ekonomik dhe ligjor, sepse ndikimet në sferën gjeopolitike varen nga fuqia e shtetit. Bota udhëhiqet me teorinë e realizmit në marrëdhënie ndërkombëtare, prandaj fuqia e shtetit përcakton ndikimin tonë në këto rrjedha. Duhet të kemi parasysh se kah po shkon bota, për të ditur kah do të shkojmë ne.



SHKRUAR ENKAS PËR “EPOKËN E RE”

VITI I MASHTRIMIT QË DUHET TA NDËSHKOJMË ME VOTA



Faton ABDULLAHU

Gjykata Kushtetuese e Kosovës i dha fund një marrëzie politike që kishte zënë fill vitin e kaluar në zgjedhjet e fundit me një tango të pasinqertë politike ndërmjet LV-së dhe LDK-së. Të gjitha të këqijat e vitit që po e lëmë pas bartin vulën e këtij mashtrimi të madh politik ndërmjet këtyre dy subjekteve. Ato në rend të parë nuk ishin të sinqerta me njëra-tjetrën e, për rrjedhojë, nuk mund të ishin ndryshe edhe me qytetarin e Kosovës. Fituan duke premtuar se do ta luftojnë korrupsionin e nepotizmin dhe se do ta zhvillojnë vendin por, në të vërtetë, na ofruan hile ndaj njëra-tjetrës, ndërkëmbca, sulme e mashtrime. Harxhuam më shumë kohë për t’u marrë vesh për qeverinë sesa që qeverisën bashkë. Thanë se dialogun nuk e kishin me nxitim, por dialogu i përçau shpejt e keq. Nuk patën guxim, por ishin tucanë të ballafaqohen me Serbinë me dialog në Uashington (Qeveria Kurti) e kur guxuan ta bëjnë këtë (qeveria Hoti) nuk patën as unitet as mençuri që të nxjerrin sa e si duhet përfitime nga “Marrëveshja ekonomike në

Uashington”. Qeveria Kurti dhe ajo Hoti ishin dështime të ndryshme nga një brumë i njëjtë. Asgjë nuk shkoi mirë vitin që po e lëmë pas. Dhe tani të dyja këto qeveri fajësojnë njëra-tjetrën për dështimet e veta dhe tani partitë kryesore që i bënë këto dështime pretendojnë secila më zëshëm se tjetra se do të dalë e para në zgjedhjet e reja që do të mbahen së shpejti. Gjykata Speciale në anën tjetër dëshmoi me akuzat dhe burgosjet e fundit, pas pesë vjetëve mospunë, se përfaqëson vlerë anti-evropiane dhe punon me djallëzi kundër Kosovës evropiane. Gjykata Speciale bëri grushtshtet në Kosovë. Ky ishte sulm kundër shtet-ndërtimit dhe shëndetit demokratik të vendit tonë. Vendi ynë pa fajin e vet ishte viktimë e ftohjes së raporteve ndërmjet Uashingtonit, përkatësisht administratës Tramp dhe Brukselit të përçarë. Derisa nuk përfundon procesi i shtetndërtimit të Kosovës ne gjithmonë mund të jemi monedhë kusuritje ndërmjet

interesave të ndryshme globale të cilat ndryshojnë shumë dhe ndeshen shpesh edhe në këtë pjesë të Evropës. Gjykata Speciale më së shumti e ka dëmtuar Partinë Demokratike. Projekti djallëzor Dick Marti me gjykatë ka sulmuar në rend të parë Partinë Demokratike si bartëse kryesore e proceseve në vend, e cila nga gjiri i saj ka nxjerrë njerëz më të përshtatshëm dhe më të besueshëm për jetësimin e strategjisë euroatlantike në rajon, përkatësisht për interesat e ShBA-së në Kosovë. Ajo e ka lënë këtë parti pa liderin e saj, z. Veseli, i cili bashkë me z. Thaçi, për kohë të gjatë ishin bartës dhe zbatues më të besueshëm të projekteve paqësore dhe të sigurisë në këtë pjesë të Ballkanit. Ky është handikap jo vetëm për këtë parti, por edhe për shëndetin demokratik të vendit tonë. Ky është handikap sepse z. Veseli ia ndalëm punën në gjysmë i cili kishte vizion të qartë se si të vazhdojë tutje, sidomos në drejtim të ideve të reja dhe inkorporimit të njerëzve të rinj në PDK. Ditët në vijim PDK-së,

sidomos tani para zgjedhjeve, i duhet të punojë dy herë më shumë se të tjerat për ta kompensuar këtë hile që ia ka bërë “Projekti Dick Marti”. Në vitin që po hyjmë qytetari i Kosovës do të dalë para kutive të votimit. Kjo është një mundësi e re dhe e mirë për ta flakur tutje një mendësi të vjetër e të keqe që u mbëlta në vitin që po e lëmë pas e të cilës ia pamë sherrin sikur të qeveriste për shumë vite e jo vetëm disa muaj. Qytetari i Kosovës duhet ta ketë mundësinë që të votojë për ata që do ta mbrojnë shtetin e Kosovës në përballje me Serbinë, për ata që kanë guxim e nuk u ikin as përgjegjësisë, e sidomos jo dialogut, për të mbetur vetë të pastër e për ta lënë Kosovën në lloç. Kjo nuk mund të bëhet pa pasur raporte të mira, në të vërtetë shumë të mira me administratën e re Biden. Zgjedhjet e ardhshme duhet ta nxjerrin këtë mendësi politike, këtë kulturë politike, për një fitore të re e cila në variantin më të keq të humbjes dhe dështimit na u paraqit vitin që po e lëmë pas. Dhe jo vetëm

kaq. Qytetari i Kosovës para kutive të votimit duhet me votën e tij ta mbrojë UÇK-në. Nuk janë të paktë ata, dhe kurrë nuk kanë qenë më arrogantë e më të bashkuar e të cilët i sulmojnë vlerat e luftës, konkretisht UÇK-në. Këta faqezi po mendojnë se sot mund të jesh kundër UÇK-së dhe në të njëjtën kohë me administratën e re Biden. E pamundur, këto dy vlera nuk shkojnë kundër njëra-tjetrës, do të binden shumë shpejt. UÇK-ja është bebëza e shtetndërtimit të Kosovës, është themel i çimentuar me gjakun e bijve e bijave më të mira të shqiptarisë. Ne nuk mund të hyjmë në Evropë as në NATO pa vlerat e UÇK-së. UÇK-ja është margaritar i qytetërimit perëndimor. UÇK-ja ka mbrojtur vlerat evropiane, sigurinë dhe paqen euroatlantike dhe me pushkë në dorë ka lëvizur tutje kufijtë e interesave, në të mirë të ShBA-së në këtë pjesë të Evropës. Votuesi kur nis të votojë në këtë vit që po hyjmë duhet ta ketë këtë parasysh, sidomos këtë.



PANDEMIA DHE POLITIKA GODITËN EKONOMINË E KOSOVËS

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Ekonomia e Kosovës në vitin 2020, sikurse edhe ekonomia botrore, është përballur me sfidën e pandemisë Covid-19. Mirëpo, për dallim nga shtetet që kishin stabilitet politik, Kosova u përball me probleme politike, gjegjësisht rënien e qeverisë Kurti dhe formimin e qeverisë Hoti. Qeveria Kurti fillimisht miratoi pakon e rimëkëmbjes ekonomike dhe filloi shkarkimin e anëtarëve të bordeve në ndërmarrjet publike. Edhe qeveria Hoti vazhdoi masat për rimëkëmbje ekonomike dhe shkarkimin e bordeve të përkohshme të qeverisë Kurti. Ndërkohë institucionet financiare ndërkombëtare dhe ato vendore kanë paralajmëruar rënie drastike ekonomike. Sipas raportit të ri për ekonominë në rajonin Evropë dhe Azi Qendrore, të publikuar nga Banka Botërore, ekonomia e Kosovës pritet të tkurret për 8.8 për qind në vitin 2020. Ndërkaq, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, bruto produkti vendor shënoi rënie për -7.25 për qind. Ndërmarrjet publike si Telekom i Kosovës, Posta dhe "Trepça" u përballën me vështirësi financiare dhe me bllokim të xhironlogarive për shkak të borxheve të tyre. Viti

2020 do të mbahet mend edhe për vjedhjen e 2.1 milionë eurove në buxhetin e shtetit.

Shpallet tenderi për përfundimin e autostradës Pejë - Prishtinë

Ministri në detyrë i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka njoftuar për shpalljen e tenderit për përfundimin e magjistrales Pejë - Prishtinë, gjegjësisht segmentin rrugor Kijevë - Zahaq. Janë bërë disa vite që është nisur kjo autostradë, ndërkohë që punimet kishin ngelur pasi kishte mungesë të fondeve për përfundim të segmentit të fundit që lidh fshatin Kijevë të Malishevës me fshatin Zahaq të Pejës. Abrashi ka njoftuar se projekti është shpallur me përkrahjen e BERZh-it dhe BIE-së.

ASK-ja: Bruto produkti vendor shënoi rënie për -7.25 për qind

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat e Bruto Produktit Vendor për tremujorin e tretë të vitit 2020, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve me çmime aktuale dhe me çmime të vitit paraprak. Sipas ASK-së, Bruto Produkti Vendor

për tremujorin e tretë të vitit 2020 shënoi rënie për -7.25 për qind krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Aktivitetet ekonomike, që shënuan rënie në këtë tremujor, ishin: ndërtimi (-16.77 për qind); tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimet ushqimore (-16.89 për qind); aktivitetet financiare dhe të sigurimit (-3.67 për qind).

Serbia ndërpret transmetimin e energjisë, Kosova lidhet me Maqedoninë

Menjëherë pas fillimit të operimit të pavarur të sistemit energjetik të Kosovës më 15 dhjetor, Serbia ka ndërprerë transmetimin e 500 megavatëve të energjisë elektrike që Kosova kishte importuar nga ky shtet. Këta megavatë të bllokuar nga Serbia u zëvendësuan pastaj me një marrëveshje të arritur ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe atyre të Maqedonisë së Veriut për furnizim nga kapacitetet energjetike të këtij shteti.

KOSTT-i del nga blloku rregullues me Serbinë

Nga 14 dhjetori KOSTT-i operon si i pavarur dhe kontrollon kufijtë energjetikë të Kosovës. Dalja e Kosovës nga blloku

rregullues SMM (Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni e Veriut) dhe përfshirja e saj në një bllok me Shqipërinë ishte paraprak me një marrëveshje mes KOSTT-it dhe Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji (ENTSO) në muajin qershor. Ajo hyri në fuqi më 29 shtator.

Qeveria ndan 1.1 milion euro për "Trepçën"

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, së bashku me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, zëvendësministrin e Financave, Agim Krasniqi si dhe përfaqësuesit e Bordit të Përkohshëm të "Trepçës", më 13 nëntor njoftuan për ndarjen e 1.1 milion eurove për ndërmarrjen "Trepça". Kjo ndihmë erdhi pasi situata në kompaninë "Trepça" ishte shumë e vështirë për shkak të pandemisë në nivel global, pamundësisë që "Trepça" t'i shesë produktet e veta në tregje botërore dhe për shkak të rënies së çmimeve në berëz.

Minatorët në grevë

Minatorët e kombinatit metalurgjik "Trepça" gjatë këtij viti, më 19 nëntor, kishin hyrë në grevë për shkak të mosdhënies së pagave për muajin tetor. Greva e minatorëve është ndërprerë pasi që janë

informuar se pagat u kanë dalë në xhironlogari.

Bllokohen xhironlogaritë e Telekomit

Gjatë vitit dy herë janë bllokuar xhironlogaritë e Telekomit të Kosovës si pasojë e borxhit ndaj "Z-Mobile", por pastaj janë zhblokuar pas ujdisë me Ministrinë e Ekonomisë dhe qeverisë. Telekom i Kosovës është kompani publike e transformuar në shoqëri aksionare, në të cilën operon telefonia fikse dhe ajo mobile "Vala" me mbi 1.2 milion konsumatorë në nivel vendi. Telekom i Kosovës dhe kompania "Z-Mobile" në vazhdimësi kanë pasur mosmarrëveshje në lidhje me një kontratë të nënshkruar 10 vjet më parë, e cila i kishte mundësuar kompanisë "Z-Mobile" të ishte operatorja virtuale e telefonisë mobile "Vala".

Vidhen nga arka e shtetit 2.1 milionë euro

Më 21 tetor është konfirmuar se 2.1 milionë euro ishin vjedhur nga Thesari i Shtetit. Për këtë rast është arrestuar Labinot Gruda, punonjës në këtë institucion, të cilit i janë caktuar 30 ditë paraburgim nga Gjykata Themelore e Prishtinës. Qeveria



e Kosovës ka kërkuar ndihmë më 14 nëntor nga agjencia italiane "Guardia di Finanza" që ta hetojë skandalin e vjedhjes së më shumë se 2 milionë eurove në Thesarin e Shtetit. Këtë kërkesë e ka bërë Ministria e Financave.

Jep dorëheqje bordi i përkohshëm i Telekomit

Më 18 gusht bordi i përkohshëm i Telekomit të Kosovës ka dhënë dorëheqje. Ky bord ishte emëruar nga qeveria Kurti. Me këtë rast, kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se e ka pranuar me shqetësim dorëheqjen e bordit të përkohshëm të Telekomit të Kosovës, në një situatë të vështirë financiare të kësaj ndërmarrjeje publike të rëndësishme strategjike për vendin.

Formohet komisioni hetimor për hidrocentralet

Më 14 gusht Kuvendi i Kosovës në seancën plenare ka formuar komisionin hetimor mbi procesin e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për lejet e hidrocentraleve në Republikën e Kosovës. Iniciuesi i komisionit hetimor, Haxhi Avdyli, ka pohuar se me anë të kësaj do të hetohen keqpërdorimet e mundshme për lejet e hidrocentraleve.

Qeveria ndan 60 milionë euro për biznesin privat

Ministria e Financave gjatë këtij viti, për shkak i pandemisë, ka

bërë me dije se subvencionimi prej 60 milionë eurosh nga masa 1.1 sipas vendimit të qeverisë iu dedikohet bizneseve dhe se bizneset përfituese nuk kanë nevojë të aplikojnë dhe as të dërgojnë të dhëna apo njoftime në Thesarin e Kosovës.

BB-ja: Ekonomia e Kosovës pritet të tkurret për 8.8 për qind

Sipas raportit të ri për ekonominë në rajonin Evropë dhe Azi Qendrore, të publikuar më 7 tetor nga Banka Botërore, ekonomia e Kosovës pritet të tkurret për 8.8 për qind në vitin 2020. Në njoftimin e Bankës Botërore thuhet se pandemia Covid-19 ka shkaktuar rënie në eksportin e shërbimeve dhe zvogëlim të investimeve dhe konsumit.

Komisioni Evropian ndan 50 milionë euro ndihmë për Kosovën

Më 7 dhjetor Komisioni Evropian në emër të BE-së ka ekzekutuar 50 milionë euro të programit të Asistencës Makro-Financiare (AMF) për Kosovën. Asistenca Makro-Financiare (AMF) është pjesë e angazhimit më të gjerë të BE-së me vendet fqinje dhe ato të zgjerimit, dhe qëllimi i saj është të përdoret si instrument i jashtëzakonshëm i BE-së për reagimin ndaj krizave. Fondet e AMF-së vihen në dispozicion në formën e kredive afatgjata me kushte shumë të

favorshme. Fondet e AMF-së do të kontribuojnë për rritjen e stabilitetit makroekonomik dhe për krijimin e hapësirës për alokimin e burimeve për zbutjen e pasojave të rënda negative socio-ekonomike të pandemisë Covid-19.

ATK-ja ka pranuar mbi 99 mijë aplikime për kompensim të pagës

Administrata Tatimore e Kosovës (AKT) më 28 prill ka njoftuar se ka pranuar 99 236 aplikime për kompensim nga Pakon Emergjente. Drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka treguar se 87 387 kërkesa në ATK kanë ardhur nga të punësuarit, kurse janë 827 kërkesa për kompensim të punëtorëve që janë larguar nga puna dhe 6 026 kërkesa që kanë lidhur kontrata të reja.

Qeveria Kurti shkarkoi bordin e Postës, Telekomit, KRU 'Prishtina'...

Më 2 prill kryeministri në detyrë, Albin Kurti, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë, ka thirrur mbledhjen korresponduese në të cilën janë miratuar vendime nga fushat e përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore të qeverisë në detyrë, duke shkarkuar edhe bordin e Postës. Po më 2 prill Kurti ka shkarkuar edhe bordin e KRU "Prishtina" dhe bordin e KRU "Gjakovë". Qeveria e drejtuar në

atë kohë nga Kurti ka marrë vendim që të shkarkohet edhe bordi mbikëqyrës i ndërmarrjes "Trepça". Po ashtu, qeveria Kurti ka shkarkuar edhe bordin e drejtorëve të Telekomit të Kosovës.

Qeveria ndan 41 milionë euro për pagat në sektorin privat

Më 27 mars kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka bërë me dije se ministri në detyrë i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi, ka propozuar që të ndahen 41 milionë euro për pagat në sektorin privat për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19.

Formohet Komisioni Hetimor për Privatizimin

Më 10 korrik, me iniciativë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kuvendi i Kosovës ka votuar për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar i cili do të hetojë dhe do t'i zbardhë të gjitha privatizimet e bëra në Kosovë, në veçanti keqpërdorimet e mundshme dhe ato me lidhje politike. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Bedri Hamza, gjatë paraqitjes së kërkesës për komision hetimor para deputetëve, ka pohuar se qëllimi i kësaj nisme është që qytetarët e Kosovës të informohen drejt për secilin privatizim që ka ndodhur në


Kosovë dhe çdo lidhje politike që kanë personat që kanë privatizuar.

Kalon Ligji i Rimëkëmbjes Ekonomike, qytetarët tërheqin 10-përqindëshin

Më 4 dhjetor Kuvendi i Kosovës ka miratuar në lexim të dytë Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid-19. Ky projektligj ka arritur të miratohet me 72 vota për, asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim. Votat qeverisë për ta kaluar këtë projektligj ia siguruan deputetët e PDK-së, të cilët propozuan katër amendamente shtesë. Përmes këtij projektligji, mes të tjerash, parashihet tërheqja e 10-përqindëshit të kursimeve të tyre pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës - Trust.

Kuvendi miraton projektbuxhetin për vitin 2021

Më 28 dhjetor deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të hënën në lexim të parë Projektbuxhetin për vitin 2021. Pas diskutimeve që ndodhën mes deputetëve të pozitës dhe opozitës, ky projektbuxhet mori 64 vota për. Projektbuxhetin për vitin 2021 e kanë kundërshtuar deputetët nga Lëvizja Vetëvendosje. Sipas projekteve, buxheti për vitin 2021 kap vlerën 2.4 miliardë euro.



SHKRUAR ENKAS PËR “EPOKËN E RE”



DR. SC. FERAT SHALA

PSE LIQENI I UJMANIT NUK DUHET TË JETË PJESË E DIALOGUT ME SERBINË DHE CILAT JANË DILEMAT E KËTIJ PROCESI?

Sikurse dihet tashmë, Kosova dhe Serbia, me ndërmjetësimin e ShBA-së, kanë nënshkruar një marrëveshje për normalizim ekonomik të marrëdhënieve, në kuadër të së cilës “të dyja palët do të bien dakord të punojnë me Departamentin e Energjisë në ShBA dhe subjekte të tjera të Qeverisë së ShBA-së në një studim të fizibilitetit për qëllimet e shfrytëzimit të përbashkët të Liqenit të Ujmanit, si burim i besueshëm i ujit dhe energjisë”. Nga ajo që është prezantuar dhe që është thënë deri me tani, janë disa çështje që duhet të sqarohen dhe të bëhen të ditura lidhur me këtë resurs ujor të rëndësishëm të Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj çështje për Kosovën, e shoh të arsyeshme që të shpreh opinionin dhe qëndrimin tim për këtë temë duke sjellë disa argumente dhe duke ngritur disa dilema për prapavijë e këtij procesi. Fillimisht duhet sqaruar se Liqeni i Ujmanit është një ndër resurset natyrore më të rëndësishme të Kosovës. Dhe kur flasim për resurset natyrore të

Kosovës dhe obligimet institucionale për mbrojtjen e tyre atëherë domosdoshmërisht duhet ti referohemi nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili thotë: “Pasuritë natyrore si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, janë të përcaktuara me interes të veçantë për Republikën e Kosovës, dhe gëzojnë mbrojtje”. Sikur shihet, ky nen përcakton qartë autorizimin kushtetues për Kuvendin e Kosovës dhe institucionet e tjera shtetërore që ta garantojnë mbrojtjen e këtij resursi. Thelbi i marrëveshjes së Uashingtonit që ndërlidhet me Liqenin e Ujmanit është pjesa ku flitet për “shfrytëzimin e përbashkët të liqenit”. Andaj pikërisht në këtë pikë janë të fokusuar edhe debatet që nxisin dilemat për prapavijën e kësaj marrëveshje dhe qëllimin final të saj. Përmes këtij opinioni do të mundohem të sjellë disa fakte për gjendjen reale që ndërlidhet me disa nga çështjet që janë të përcaktuara në marrëveshje. Le t’i marrim me radhë disa nga to

dhe të shohim si janë faktet dhe argumentet në dispozicion.

Liqeni i Ujmanit dhe menaxhimin aktual i tij?

Përveç bukurisë së tij, liqeni konsiderohet ndër asetet me rëndësi strategjike nga e cila varet ekonomia e vendit. Penda e Ujmanit është ndërtuar midis viteve 1979-1984 dhe ka një sipërfaqe prej 11.9 kilometrash katrorë dhe 370 milionë kub ujë. Ndërmarrja publike “Ibër-Lepenci” që menaxhon me Liqenin e Ujmanit dhe me infrastrukturën përcjellësi të tij është themeluar qysh në vitin 1967. Në fillim të viti 2008, ndërmarrja është shndërruar në ndërmarrje të ekonomisë së ujërave “Ibër-Lepenci”, shoqëri aksionare 100 për qind nën pronësinë e Qeverisë së Kosovës. Ndërmarrja “Ibër-Lepenci” ka mbi 200 të punësuar dhe është ndër ndërmarrjet publike më të suksesshme të Kosovës dhe me afarizëm pozitiv dhe stabil që vazhdimisht ka ndihmuar buxhetin e Kosovës. Liqeni i Ujmanit gëzon edhe statusin e

zonës së mbrojtur ujore me rëndësi të veçantë të shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës me propozimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Si qëndron puna me pronësinë e Liqenit të Ujmanit dhe ndërtimin e tij dhe a ka hapësirë të flitet për përdorimin e përbashkët?

Sipas dokumentacionit që posedon Ndërmarrja “Ibër-Lepenci”, dhe i cili mundë të gjinden edhe në arkiva përkatëse, Liqeni i Ujmanit është në pronësi të kësaj ndërmarrje, në të gjithë territorin ku ai shtrihet. Pra ekziston dokumentacioni i elaboratit të shpronësimit, në pjesën e Kosovës dhe në pjesën e Serbisë që tregon se i tërë liqeni është pronë e ndërmarrjes “Ibër-Lepenci”, aksionar i së cilës me 100% të aksioneve është Republika e Kosovës, dhe asnjë dokument tjetër nuk mund të dëshmojë të kundërtën. Prandaj në një situatë e tillë çështja e përdorimit të përbashkët nuk

mundë të jetë temë e diskutimit dhe as e negocimit. Sipas dokumentacionit arkivor, ndërtimi i Liqenit të Ujmanit ka filluar në vitin 1972 ka përfunduar në vitin 1977. Hidrocentrali ka përfunduar së ndërtuar në vitin 1986. I gjithë projekti është realizuar pas miratimit të Ligjit për Ratifikimin e Kontratës mbi Projektin në mes të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK) së atëherëshme dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim, Nr. 777-YU (Ndërtimi i hidrosistemit “Ibër” për disa qëllime). Ligji është publikuar në Fletoren Zyrtare të KSAK Nr. 12 datë 26 Prill 1972. Financimi i ndërtimit të projektit është bërë nga kredia e marr nga Banka për Rindërtim dhe Zhvillim (45 milionë dollarë) dhe një pjesë është siguruar nga Buxheti i Kosovës. Në kohën e ndërtimit të projektit Komuna e Zubin Potokut nuk ka ekzistuar. Procedurat e eksportpruimit (shpronësimit), vlerësimit dhe kompensimit të pronarëve i ka bërë Komuna e Mitrovicës.



A ka nevojë për një studim të ri të fizibilitetit me qëllim që të shihen mundësitë e përdorimit të përbashkët të Liqenit të Ujmanit si burim i energjisë?

Liqeni i Ujmanit është pjesë e Hidrosistemit "Ibër-Lepenc", i cili përbën një sistem kompleks të pendëve, hidrocentraleve dhe kanaleve të ujitjes. Ky hidrosistem përbëhet nga dy njësi: pjesa veriore e cila bazohet në rrjedhat dhe potencialin e lumit Ibër dhe pjesa jugore e cila bazohet në resurset e lumit Lepenc. Pjesa veriore e hidrosistemit përfshinë pendën dhe hidrocentralin "Ujmani". Hidrocentrali i instaluar në pendën e Ujmanit ka fuqi të prodhimit të energjisë prej 32 megavat për orë energji elektrike. *A mund të prodhohet më shumë energji elektrike nga Liqeni i Ujmanit dhe a është i nevojshëm një studim i ri për këtë çështje?* Të dhënat e studimit të Bankës Botërore të realizuar në vitet e 70-ta tregojnë se nga Ujmani mund të prodhohen maksimalisht 36 megavat energji elektrike në orë. Aktualisht, hidrocentrali i instaluar në pendën e Ujmanit prodhon 32 megavat energji elektrike në orë, dhe që është maksimumi i shfrytëzimit për prodhim të energjisë, meqenëse sikur dihet një pjesë e ujit nga liqeni dërgohet për furnizim për nevoja ekonomike, industriale, për ujë të pijes dhe për ujitje. Tendanca për të prodhuar edhe më shumë energji nga

hidrocentrali i Ujmanit do të rrezikonte furnizimin me ujë për nevojat e ekonomisë, për ujitje dhe ujë të pijes, dhe së këndejmi nuk shihet i nevojshëm ndonjë studim i ri i fizibilitetit për çështje të prodhimit të energjisë.

A ka nevojë për një studim të ri të fizibilitetit me qëllim që të shihet mundësia e përdorimit të përbashkët të Liqenit të Ujmanit për ujitje dhe për nevoja të tjera?

Kanali apo hidrosistemi Ibër-Lepenc që furnizohet me ujë nga Liqeni i Ujmanit është 49 kilometra i gjatë dhe ka kapacitet për ujitjen e rreth 12 mijë hektarëve të tokës bujqësore në disa rajone të Kosovës. Ky hidrosistem menaxhohet nga Ndërmarrja publike "Ibër-Lepenci". Sipas të dhënave që ofron ndërmarrja Ibër Lepenci, asnjëherë nuk janë shfrytëzuar 100 për qind të kapaciteteve të sistemit për ujitje. Andaj edhe pretendimi që të bëhet një studim i ri i fizibilitetit për të shikuar mundësitë e rritjes së potencialit për ujitje është i panevojshëm. Ndërsa sa i përket shfrytëzimit për nevoja tjera, tashmë dihet se Ujmani është burimi kryesor i furnizimit të TC Kosovës A dhe B, furnizimit të fabrikës së Feronikelit, furnizimit të ndërmarrjes së Trepçës, dhe furnizim me ujë të pijes për disa komuna. Po ashtu, nuk duhet harruar fakti se në rastet e thatësisë ekstreme, uji nga Ujmani përdoret për mbushje të dy liqeneve tjera akumulues

(Liqenit të Batllavës dhe Liqenit të Badovcit) uji i të cilëve përdoret për pije për banorët e komunave të Regjionit të Prishtinës. Andaj pretendimet që të shikohen edhe mundësi tjera për shfrytëzim të përbashkët të resurseve të këtij liqeni do e rrezikonin qëndrueshmërinë e shfrytëzimit me ujë të sektorëve që u përmendën më lartë.

Disa dilema të tjera që kërkojnë sqarime dhe përgjigje?!

Në planin e veprimtari të Qeverisë së Kosovës për zbatimin e marrëveshjeve të Uashingtonit lidhur me Ujmanin thuhet se: *"Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, do të sigurojnë bashkëpunimin e nevojshëm për Departamentin e Energjisë në SHBA dhe njësitë tjera të qeverisë së ShBA-së duke krijuar grupin punues për studimin e fizibilitetit".* Deri me tani nuk kemi parë asnjë iniciativë për formimin e grupit punues dhe as ndonjë propozim për përbërjen e tij. Opinioni publik dhe Kuvendi i Kosovës, duhet të dijë se: *Deri ku ka shkuar iniciativa për formimin e këtij grupi punues. Kush e ka mandatin ta udhëheqë këtë grup? Kush janë anëtarët e tyre profesionale? Kush i ka nominuar ata? Kur pritet të filloj studimi i fizibilitetit? Cilat janë obligimet e Kosovës në kuadër të këtij procesi? Këtu duhet të ketë transparencë të plotë dhe*

debat të mirëfilltë e jo të mbesim para një akti të kryer sikur ndodhi me marrëveshjen e Uashingtonit. Kur jemi te marrëveshja e Uashingtonit dhe përfshirja e Liqenit të Ujmanit në kuadër të zotimeve të këtij dokumenti ka edhe dilema tjera që po ashtu kërkojnë sqarime dhe përgjigje. Opinioni publik dhe Kuvendi i Kosovës duhet të dijë: *A ka qenë i përgatitur sa duhet delegacioni i Kosovës për të diskutuar për këtë çështje? Me cilët ekspertë të ujërave lidhur me Ujmanin është konsultuar Qeveria e Kosovës dhe delegacioni kosovar? Pse ishte e domosdoshme që kjo çështje të përfshihej në kuadër të bisedimeve me Serbinë? Kërkesë e kujt ishte integrimi i kësaj teme në marrëveshje? A ka transkripte të bisedimeve për këtë pikë?*

Konkluzion

Nga kjo që u tha më lart mund të nxjerrim konkludimet si vijon: Liqeni i Ujmanit, është pronë e Republikës së Kosovës, që menaxhohet nga institucionet e Kosovës, dhe që shfrytëzohet për të mirën e përgjithshme të të gjithë qytetarëve të saj dhe në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit, andaj çfarëdo pretendimi për të marrë hise në shfrytëzimin e resurseve të tij nga kushdo qoftë është i paqëndrueshëm dhe i papranueshëm. Aktualisht nga Liqeni i Ujmanit shfrytëzohet

maksimumi i tij për prodhim të energjisë, për ujitje, për furnizim për ujë të pijes dhe për furnizim për prodhim për nevoja të industrisë, andaj pretendimet për studime shtesë për të shikuar mundësitë e shfrytëzimit të përbashkët me çfarë do pale tjetër janë të panevojshme dhe të papranueshme dhe do të rrezikonte qëndrueshmërinë e furnizimit për këta sektorë. Republika e Kosovës, sikurse ka vepruar deri me tani duhet të jetë e gatshme të respektojë normat ndërkombëtare dhe evropiane që rregullojnë menaxhimin e integruar ndërkufitarë të resurseve ujore në nivel të pellgjeve ujore me qëllim të monitorimit dhe mbrojtjes nga ndotja, hartimit të programeve dhe politikave ndërkufitare të menaxhimit të qëndrueshëm, apo edhe çfarëdo forme tjetër të bashkëpunimit që është në të mirë të mbrojtjes së resurseve ujore dhe që janë në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Neni 17, 18, 19); Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare (Nr. 04/L-052-Neni 12); dhe Ligjit për Ujërat e Kosovës (Nr. 04/L-147, Kreu IV).

Aneks 1 (Ekstrakt nga Ligji/Kontrata e projektit për ndërtimin e Liqenit të Ujmanit të publikuar në Fletoren Zyrtare të ish-KSA Kosova)

Aneks 2: (Harta skematike e sistemit të ujitjes Ibër-Lepenc)





FLET PËR "EPOKËN E RE", BLENDI KLOSI

PANDEMIA KRIJOI PASOJA NË GJITHË TREGUN BOTËROR TË TURIZMIT

Ministri i Turizmit dhe i Mjedisit në Shqipëri, Blendi Klosi, ka thënë se viti që po lëmë pas, për shkak të pandemisë botërore, ka krijuar pasoja në gjithë tregun e turizmit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se turizmi në Shqipëri dhe Kosovë duhet të jetë komplementar për ofrimin e produkteve turistike. Në këtë intervistë Klosi ka folur edhe për zgjedhjet që do të mbahen në Shqipëri më 25 prill 2021. Ai ka thënë se Partia Socialiste në këto zgjedhje do të fitojë sërish. "Fitorja e një mandati të tretë është historike jo aq për historinë politike shqiptare, por së pari për rëndësinë e vijimit të transformimit të Shqipërisë, ndaj nuk ka asnjë dyshim që do të fitojmë", ka deklaruar Klosi

rajoni. Edhe këtë herë vëllezërit tanë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi e kudo në trevat shqiptare zgjodhën Shqipërinë si destinacionin e tyre të parë. Këtë e kam thënë edhe publikisht shumë herë. Nuk kam veçse mirënjohje dhe përlujë ndaj gjithë vëllezërve tanë shqiptarë në rajon, që për ne nuk janë pushues, por janë pjesë integrale dhe e pandashme jona, janë në shtëpinë e tyre. Kudo ku pushojnë nga Velipoja, Shëngjini, Durrësi, Vlora, Saranda e Ksamili, e çdo destinacion i brendshëm shqiptar, shqiptarët janë këtu në vendin e tyre. Por, Shqipëria ishte edhe destinacion rajoni. Dhe nuk duhet ta harrojmë, që jemi patriotë të mirë kur punojmë për ekonominë tonë. Ndaj gjithsesi duhet të punojmë edhe për ruajtjen dhe rritjen e këtij trendi. Nga ana tjetër, edhe këtë vit ne mund të ruajmë dhe të përfitojmë flukse turistike falë fluturimeve

"charter" me qëllim frekuentimin e turizmit të diellit dhe detit nga tregje të tilla si Polonia, Ukraina dhe Bjellorusia. Bashkë me vështirësitë për ta adoptuar turizmin brenda protokolleve të reja anti-Covid, kushtet e reja zhvilluan më tej llojet turistike, turizmin e natyrës, turizmin historik, kurse agroturizmi pati një rritje të rëndësishme etj.

"Epoka e re": *Ndërkohë kishim fluks të madh të qytetarëve të Kosovës që në këtë kohë pushuan në bregdetin shqiptar. Sa ishte numri i pushuesve nga Kosova në sezonin që lamë?*

Klosi: Gjithmonë kam shmangur shifrat në daljet apo deklaratat publike, jo se nuk janë të rëndësishme, por sepse mendoj që më shumë sesa numrat, rëndësi ka fryma, bashkëpunimi, standardet, shërbimi turistik, produktet e ofertat e përbashkëta turistike, pra gjithçka që nuk lidhet me shifrat, por me kontributin për

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR-
"Epoka e re": *Z. Klosi, në vitin që po lëmë pas turizmi llogaritet ndër sektorët më të goditur nga pandemia. Ç'pasoja h i solli pandemia bregdetit shqiptar?*

Klosi: Viti që po mbylлим, për shkak të pandemisë globale, ka krijuar pasoja në gjithë tregun botëror të turizmit. Edhe

Shqipëria nuk ka bërë përjashtim, por u bë gjithçka që sektori të mbahej në punë. Dhe sot të gjithë bashkë ndihemi mirë për konstatimin e bazuar në shifra se "turizmi ndihmoi ekonominë të mbijetonte". Që në krye të kësaj pandemie matëm faktorët dhe vlerësuam situatën duke u mbështetur tek ato specifika që ka kjo industri në Shqipëri nisur nga:

Fleksibiliteti i strukturave turistike shqiptare që na dha

dorë për adoptimin e shpejtë me kushtet e reja, turizmi hyrës përmes rrugëve tokësore në masën 82.5 për qind, duke reaguar përmes hapjes së shpejtë të kufijve tokësorë me fillimin e verës, analizuar potencialin e turizmit të brendshëm dhe orientuam këtë fluks turistik drejt destinacioneve tona. Dhe, e fundit, jo për nga rëndësia, por sepse doja të ndalesha pak më gjatë në këtë pikë: turizmi nga





ta rritur këtë sektor në të dyja anët e bjeshkëve. Më vjen mirë të konstatoj sërish, se vëllezërit tanë nga Kosova janë në krye të turizmit hyrës në Shqipëri, kryesim që e mbajnë prej vitesh duke na rritur përgjegjësinë dhe ndjesinë se bashkëpunimi mes nesh duhet të konsolidohet drejt turizmit dymbëdhjetëmujor.

“Epoka e re”: Në çfarë niveli është bashkëpunimi i turizmit Kosovë - Shqipëri?

Klosi: Detyra ime e parë si ministër i Turizmit ka qenë vizita zyrtare në Kosovë me qëllimin dhe fokusin e qartë: krijimin e ofertave të përbashkëta turistike. Si homologu im në Kosovë, edhe unë konstatoj sot me kënaqësinë më të madhe se është rritur dhe forcuar bashkëpunimi mes agjencive shqiptare në të dyja anët e bjeshkëve. Në çdo shkëmbim zyrtar vizitash kemi ndihmuar lehtësimin e këtij komunikimi dhe bashkëpunimi mes sektorit privat, me një qëllim: Turizmi në të dyja anët e bjeshkëve duhet të jetë komplementar për ofrimin e produkteve turistike. Kemi bashkërenduar tashmë agjendat, prej më shumë se dy

vjetësh: Hapim sezonin turistik veror në Shqipëri në fillim të qershorit në Shëngjin me homologët nga Prishtina, me tur operatorët dhe agjencitë turistike të dy vendeve tona dhe, gjithashtu, bashkë hapim sezonin turistik dimëror në Dragash të Kosovës në fillim - vjeshte. Është jo vetëm një ushtrim praktik, por një mesazh i rëndësishëm me moton “Pusho shqip” në të dyja anët e bjeshkëve. Duhet të kemi parasysh se jemi tregje turistike të vogla, por duhet ta shfrytëzojmë diversitetin e natyrës dhe burimeve natyrore për t’i shndërruar në avantazh ekonomik. Ndaj në këtë drejtim ka shumë për të bërë e se në turizëm shumë nuk është kurrë mjaftueshëm pasi është një sektor dinamik. Ajo që nuk duhet të ndalim është fryma e bashkëpunimit dhe konsolidimi i marrëdhënieve në të gjitha nivelet: sektor publik e privat.

“Epoka e re”: Ka kritika që qytetarët nga Shqipëria nuk e vizitojnë Kosovën në nivelin e kënaqshëm. Pse ka mungesë të kampanjave?

Klosi: Kosova është tashmë destinacion për shqiptarët e

këtëj kufirit, për turizmin e fundjavës, turizmin malor, turizmin e natyrës, turizmin dimëror kryesisht, por pa harruar që edhe gjatë verës Kosova për ne është shndërruar në destinacion. A ka mundësi për përmirësim? Gjithmonë. Ndaj çdo zë publik duhet të orientohet në këtë drejtim: t’i hulumtojmë mënyrat si të rrisim këtë shkëmbim turistik?

“Epoka e re”: A keni paraparë hartimin e ndonjë strategjie në rritje të bashkëpunimit në mes të dyja shteteve dhe a do të duhej të modifikohej një pako e përbashkët financiare në ndihmë të këtij sektori?

Klosi: Me kolegët e Prishtinës e kemi diskutuar shpesh si të bëjmë më të mirën në këtë drejtim. Kemi ngritur tashmë një platformë të zhdërvjellët komunikimi, me të gjithë ministritë e linjës, pushtet vendor, sektor privat, se si duhet të operojmë në forma afatgjata për ta çuar përpara zhvillimin e kësaj industrie. Dhe mendoj se kjo është rruga. Asnjë injektim financiar nuk zëvendëson punën konkrete dhe të drejtpërdrejtë për të orientuar tregun dhe për të

nxitur sektorin privat drejt kësaj rruge. Në fund është sektori privat që duhet të punojë dhe ta nxisë drejt konsolidimit të bashkëpunimit.

“Epoka e re”: Z. Klosi, ju jeni ministër në qeverinë Rama. Opozita në vazhdimësi ka pasur kritika për këtë qeveri. Mendoni se kanë qenë reale kritikata e opozitës?

Klosi: Ajo që kemi thënë që krye të herës është bashkëqeverisja me qytetarët. Në këtë kuptim, ajo që mbetet për ne e rëndësishme është përmbushja e pritshmërive të qytetarëve tanë, rritja e standardit të jetesës, mirëqenies së tyre, ku padyshim opozita në çdo proces ka qenë e mirëpritur të kontribuojë për Shqipërinë dhe shqiptarët. Ka qenë konstatim keqardhës që s’është bërë pjesë e proceseve të rëndësishme zhvilluese. Por, ajo që mbetet detyra jonë parësore, janë investimet më shumë procese që ndihmojnë dhe zhvillojnë standarde të jetës së komuniteteve tona. Janë investimet që kanë ndikuar në këtë rritje cilësie të jetës, por sigurisht që mbetet shumë për t’u bërë. Të vetëdijshëm për

çfarë është bërë dhe për çfarë është e aftë të bëjë Partia Socialiste në qeverisje, kam bindjen e plotë se do të vlerësohet me votën e 25 prillit të 2021-shit, ku PS-ja do të mandatohet nga qytetarët për një mandat të tretë.

“Epoka e re”: Do të thotë jeni të përgatitur për të fituar edhe këto zgjedhje?

Klosi: Si partia më e madhe, më demokratike, më e organizuar dhe më pranë qytetarëve, Partia Socialiste është e përgatitur për betejën elektorale të radhës. Drejtuesit e qarqeve janë respektivisht në zonat e tyre, duke punuar në skuadër dhe në komunikim të pandërprerë me qytetarët, për të dëgjuar dhe për t’iu qasur zgjidhjes së nevojave të tyre, pa parë dhe pa ndarë votuesit në të majtë dhe në të djathtë. Është gjithë filozofia jonë fituese, të mos i ndajmë qytetarët në të majtë dhe në të djathtë, në gjithë proceset reformuese të vendit. Fitorja e një mandati të tretë, është fitore historike jo aq për historinë politike shqiptare, por së pari për rëndësinë e vijimit të transformimit të Shqipërisë, ndaj nuk ka asnjë dyshim që do të fitojmë.



KUJTIME TË GAZETARIT NUHI BYTYÇI NGA FESTIMI I VITIT TË RI 1999 NË ZONAT E LUFTËS

BESONIM SE VITI I RI 1999 DO TË JETË VIT I ÇLIRIMIT TË KOSOVËS

- Si vendosa që vitin e ri 1999 mos ta pres në Prishtinë, por në mesin e luftëtarëve të lirisë, në pozicionet e tyre dhe në mesin e familjarëve të dëshmorëve të lirisë?

- Bashkë me luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishim optimistë dhe të bindur se viti 1999 do të jetë vit i kthesës historike, vit i çlirimit dhe i largimit përfundimtar të regjimit okupues serb nga Kosova

Më 28 dhjetor të vitit 1998, i cili ishte vit i fillimit të luftës frontale midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe regjimit okupues serb në krye me Millosheviqin, isha kthyer në Prishtinë nga Zona Operative e Llapit. Në vitin e shpresës së madhe për Kosovën, vitin e lirisë dhe dhënies fund robërisë shumëshekullore të shqiptarëve të Kosovës, mendova: “Mjaft kam pritur e përcjellë ndërrime të moteve në familjen time në

Shkozë dhe në Prishtinë. Më mirë ta pres vitin e ri 1999 në mesin e trimave të lirisë. Ky ishte një rast i rrallë për mua”. Prandaj vendosa që natën e fundit të vitit 1998 dhe fillimin e vitit të kthesës 1999 ta pres në mesin e atyre djemve dhe vashave që rrokën armët dhe iu përgjigjën kushtrimit të luftës për liri dhe pavarësi. Vendosa ta pres me luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në trevën e Llapushës, ku vepronte Shtabi i

Përgjithshëm i UÇK-së dhe Shtabi i Zonës Operative të Pashtrikut, si dhe ai i Brigadës 121 të UÇK-së Ismet Jashari-“Kumanova”.

Më vinte keq prej bashkëshortes dhe djalit, Arianitit, i cili ishte maturan, që t’i lija vetë në Prishtinë e të shkoja në vargmalet e Berishës dhe të Kleçkës për ta pritur vitin e ri nën dritën e llampave të vajgurit dhe të gjeneratorëve. Kur Arianiti mori vesh se do të shkoj në zonat e luftës për ta pritur vitin e ri, më tha: “Babi, edhe unë du me ardhë me ty, sepse më ke premtu se do të më marrësh me vete për t’i parë luftëtarët dhe komandantët e UÇK-së”. Meqë ishte situatë e rëndë lufte dhe nuk kisha as vetë siguri se do të mbërrija shëndosh në vargmalet e Berishës, kisha rezervat e mia për t’ia plotësuar dëshirën që të

vinte me mua. Bashkëshortja, si nënë e djalit të vetëm, reagoi ndaj qëndrimit tim jorefuzues ndaj vullnetit të madh të Arianitit dhe insistimit të tij për të ardhur bashkë me mua në zonat e luftës. Ajo kundërshtonte që ai të më shoqëronte në zonat e luftës. Por, insistimi i Arianitit ishte i madh: “Të lutem merrem edhe mua. Tani është çasti i duhur që të më plotësohet dëshira. Nëse s’më merr ti, do ta gjej rrugën për të shkuar në zonën ku veprojnë luftëtarët e lirisë!” Isha midis dy zjarreve: në njërin anë konsideroja se kërkesa e Arianitit, si i ri, që mbështeste në mënyrë të hapur luftëtarët e lirisë dhe kërkonte të vinte me mua për t’i takuar drejtpërdrejtëata, ishte e madhe, ndërsa në anën tjetër kisha po atë frikë që kishte nëna e tij, bashkëshortja ime, për

rrezikimin e jetës së djalit. Zgjodha ta respektoj vullnetin e Arianitit. E mora me vete. Ndërkohë, i tregova Abaz Zekës se kam vendosur të shkoj në vargmalet e Berishës që ta pres ndërrimin e moteve mes luftëtarëve. I thashë “nëse mundesh me ardhë, do të ishte mirë”. Ai më tha se “edhe unë kisha me ardhë me ty, por më duhet të bisedoj me fëmijët e mi të vegjël, Albanin dhe Arbërin, dhe bashkëshorten, Fëllanzën, që ta marr miratimin e tyre për të munguar në pritjen e vitit të ri së bashku me ta”.

Abazi sapo kishte biseduar me familjarët e vet, më tha: “Nuhi, djemtë dhe bashkëshortja u pajtuan që këtë vit të mungoj. Do të vij me ty që të shkojmë bashkë në vargmalet e Berishës për ta pritur vitin ri 1999”. Më erdhi mirë që s’më la vetëm. E mori edhe kamerën që, për çdo rast, të xhirojmë materiale ekskluzive për të përgatitur një emision për TVSh-në.

Me makinën time shkuam deri në Stacionin Autobusëve. E lashë në parking të stacionit. Nuk dinim kah t’ia mbanin. Nuk dinim kah është më i sigurt udhëtimi deri në ShP të UÇK-së. Hipim në autobusin që qarkullonte për Prizren. As nuk dinim ku është më mirë të zbresim, në Suharekë apo në Lypjan. Kur më pyeti konduktori për ku udhëtoni, i thashë për Lypjan. Zbritëm në Lypjan dhe pritëm autobusin për Magurë dhe Shalë. Ishte rrëmujë para autobusit, shumë udhëtarë që kishin arritur të blinin ndonjë gjë për natën e Vitit të Ri dhe për t’u kthyer në shtëpi. Hipëm disi dhe qëndruam këmbë në autobus me plot udhëtarë.

Kur mbërritëm tek udhëkryqi Lipjan-Shtime-Magurë, jo fort larg Burgut të Lipjanit, policia serbe e ndali autobusin dhe hyri brenda për t’i kontrolluar lejet e njoftimit të udhëtarëve. Të them të drejtën, fillova të frikësohem pak për shkak të Arianitit, sepse ishte i ri, trupgjatë dhe kishte me vete disa ekzemplarë të “Gjimnazistit”, ku në ballinë ishte fotografia e Fatmir Limajt dhe në brendi ishin shkrimet për UÇK-më ku Arianiti kishte vendosur emrin dhe mbiemrin e





vet. Fatmirësisht, s'na kontrolluan dhe kështu arritëm të vazhdojmë rrugën drejt Magurës dhe Shalës (ish-Sedllarit).

Takimi me dr. Fitim Selimin dhe me gjeneral Sali Veselin

Në Shalë takojmë Fatmir Shurdhën, komandant i Batalionit të UÇK-së në këtë fshat. Me të shkojmë në ambulancën ushtarake. Takojmë dr. Fitim Selimin, humanist i vërtetë, i cili, me buzëqeshje të natyrshme, na dëshiron mirëseardhje. Dr. Fitimi ishte në shërbim të përkujdesjes shëndetësore të luftëtarëve të lirisë dhe të popullatës civile. Befasia ime ishte takimi me Sali Veselin, epror i lartë i ShP të UÇK-së, të cilin e përshëndeta, por s'e njoha, edhe pse me të isha takuar në vitin 1991 te Tahir Geci në Zug të Zvicrës, ku ata ishin vendosur si refugjatë politik. Me Saliun shtrënguam duart edhe një herë, sepse qysh atëherë, më 1991, interesohej në mënyrë të veçantë se si eprorët ushtarakë të angazhohen për organizimin e rezistencës së armatosur për çlirimin e Kosovës. Dhe ja dëshira e tij prej ushtaraku tashmë po jetësohej praktikisht, duke qenë pjesë aktive e organizimit të luftës së armatosur për çlirimin e Kosovës.

Aty kemi bërë planin si të

shkojmë në Fshat të Ri, në Lladrovc, ku ishte një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm. Arianiti me komandantin e brigadës 121 të UÇK-së, Haxhi Shalën, me kolegun Abaz Zekën dhe me anëtarin e drejtorisë operative të UÇK-së, Sali Veselin udhëtuan me një xhip, kurse unë me një traktor me komandantin Shaban Dragajn. Kishim shumë probleme të ngjiteshim shtatëve deri në Divjakë, sepse ishte akull dhe acar i madh, por Shabani u dëshmuar vozitës i shkathët.

Takimi me anëtarët e ShP të UÇK-së, Fatmir Limaj dhe Rexhep Selimi në Fshat të Ri

Të gjithë jemi bashkuar përsëri në Fshat të Ri në shtëpinë e Sabit Zogajt dheaty jemi takuar me anëtarët e SHP të UÇK-së, Fatmir Limajn, Rexhep Selimin dhe me bashkëluftëtarët e tyre. Kur na kanë parë janë çuditur. Vërtet u befasuan për të mirë dhe na thanë: *"Në vend se me e pritë Vitin e Ri në Prishtinë, ju vini këtu!"*. U thashë: *"Vendosëm të vijmë që ta presim bashkë me ju Vitin e Ri në territorët e çliruara të Kosovës, ngase në Prishtinë mungon liria"*. U erdhi shumë mirë. Ata e çmuan këtë sakrificë tonën. Kur e panë Arianitin u gëzuan edhe më shumë dhe e mirëpritën jashtëzakonisht mirë. Djali, Ari, siç e quajmë unë, bashkëshortja dhe e gjithë

familja jonë, kishte marrë me vete disa ekzemplarë të numrit më të ri të revistës "Gjimnazisti". Në faqe të parë Arianiti dhe shoku i tij Fiton Peja kishin vendosur fotografinë e Fatmir Limajt me "Gjimnazistin" në duar, duke e shfletuar atë. Ishte kjo fotografi e nxjerrë nga xhirimi i mesazhit që Fatmir Limaj me 28 nëntor 1998 nga Fshati i Ri i kishte dërguar nxënësve të Gjimnazit "Xhevdet Doda" të Prishtinës në shenjë falënderimi për mbështetjen që këta nxënës përmes revistës "Gjimnazisti", e cila udhëhiqej nga Fiton Peja dhe Arianit Bytyçi, i kishin dhënë luftës çlirimtare të UÇK-së. Në numrin më të ri të revistës "Gjimnazisti" përveç botimit të mesazhit të Fatmir Limajt-komandant Çelikut, Arianiti dhe Fitoni, Bujar Sadiku nxënës të tjerë kishin vazhduar të botonin edhe shumë shkrime të tjera që i kushtoheshin Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Arianiti me vete kishte marrë edhe disa ekzemplarë të gazetës studentore "Bota e re", disa shkrime që unë dhe Muhamet Mavraj i botonim për UÇK-në, për pritjen e 28 nëntorit në Divjakë, si dhe një shkrim i Arianitit në mbështetje të UÇK-së që e kishte botuar po në "Botën e re". Arianiti asokohe edhepse ende ishte maturan, pra nuk ishte ende student, botonte shkrime mbështetëse për UÇK-në në gazetën e studentëve "Bota e re". Nga Fshati i Ri kemi shkruar në

Lladroctë Malishevës, në shtëpinë e Ibrahim Zogajt, i cili punonte në Gjermani, kurse shtëpinë e kishte lënë në shërbim të UÇK-së.

Vizitë në familjet e dëshmorëve dhe në pozicionet e luftëtarëve

Bashkë me Fatmir Limajn, anëtar i ShP të UÇK-së, Rexhep Selimin, inspektor gjeneral i UÇK-së, Haxhi Shalën, komandant i Brigadës 121 të UÇK-së dhe bashkëluftëtarët e tyre, Çerkin Dukollin, Shefqet Buçajn, Avdi Racin, Shefqet Zogajn, Xhevat Krasniqin e të tjerë bëmë një plan xhirimi. Propozova të vizitojmë disa njësi në detyrë, ushtarët që janë në mbrojtje të sulmeve të forcave serbe natën në ndërrimin e moteve. Po ashtu, bëmë planin t'i vizitojmë edhe disa familje të dëshmorëve në Lladroc, në familjen e dëshmorit Habib Zogaj dhe të Ali Zogajt, kurse në Guriq në familjen e Nuhi Mazrekut. Babai i Ali Zogajt, Bajrami dhe vëllezërit, Ramadani, Iliri, familjarët e dëshmorit Ali Zogaj, i falënderuan bashkëluftëtarët e Aliut për vizitën. Ilir Zogaj ka qenë i angazhuar në UÇK prej fillimit të luftës në Llapushë. Babai i Aliut, xha Bajrami, para bashkëluftëtarëve të djalit e tha edhe këtë dëshirë të madhe: *"Kisha dashur që sa jam gjallë ta përjetoj lirinë, së paku një orë, tani me vdekë s'kam dert!"* Kjo na emocionoi të gjithëve dhe

shokët e Aliut i premtuan axhës Bajram se *"gjaku i djalit tuaj dhe i dëshmorëve të tjerë, si dhe lufta jonë gjatë vitit 1999 do të largojë përfundimisht Serbinë nga Kosova dhe do ta gëzojmë të gjithë lirinë!"* Axha Bajram i përqafoi Fatmirin, Rexhën dhe u dëshiroi sukses në betejat e ardhshme të UÇK-së. Ndërsa babai i Habib Zogajt-komandant "Arbërit", Bahtiu, mërgimtar shumëvjeçar në Gjermani, fliste me një zë të qetë, me mburrje për kontributin e djalit dhe të shokëve të tij në luftën për liri. Në odën e familjes së Habib Zogajt- "Arbërit" na pritën edhe xhaxhai i tij, Hakiu, vëllai Agroni dhe familjarë të tjerë. Në Lladrovc vizituam edhe Avni Buçajn, luftëtar i plagosur, i cili më vonë gjatë vitit 1999 kishte rënë dëshmor. Po ashtu vizituam dhe familjen e dëshmorit Afrim Buçaj. Me këtë rast, Fatmir Limaj rrëfeu se si mësuesi i tij, Afrimi, i kishte edukuar në frymën atdhetare atë dhe nxënësit e tjerë në Banjë. Ai e ngushëlloi nënën e Afrimit, Hajrijen, djalin Valmirin, dy vajzat e tij dhe motrën e Afrimit, atëherë studente e Aktrimit, Sheqerie Buçajn dhe premtoi mbështetjen e përhershme. Kur shkruam në Guriq në familjen e dëshmorit të luftës së UÇK-së, Nuhi Mazrekut, babai i tij, axha Zejnullah, një burrë i mençur, ishte shumë krenar për birin e tij dhe me të gjithë luftëtarët dhe dëshmorët e lirisë. Njeri fjalëpakë, i vendosur, na priti



shumë mirë në odën e tij në Guriq, mua, Abazin, Fatmirin, Rexhepin, Haxhi Shalën, Kadri Krasniqin, Çerkin Dukollin, Avdi Rracin, Naser Hoxhën – “Gjermanin”, si dhe djalin tim, Arianitin. Pasi bashkëluftëtarët e dëshmorit Nuhi Mazrreku edhe në këtë fundvit e ngushëlluan babain e tij xha Zejnullahun për rënien e birit të tij në fushën e nderit, plaku i falënderoi ata dhe me shumë krenari tha: *“Si prind jam krenar që kisha asi djali, që i doli zot vendit tone, por mendoj se si popull hala nuk kemi dhanë sa duhet për luftën, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Duhet me dhanë edhe ma shumë të gjithë dhe një here e përgjithmonë me e ëargu armikun nga këto troje. Dëshiroj që viti 1999 të na sjellë lirinë e plotë!”*

Ishin këto fjalë nga një prind, i cili normal që kishte dhembje për rënien e djalit, por vëretë ndihej krenar me të dhe shokët e tij dësgmorë dhe të gjallë, që vazhdonin luftën për liri.

Gatishmëria luftarake e UÇK-së, në nivel të lartë

Bashkë me drejtuesit e UÇK-së vizituam luftëtarët e Batalionit “Sadik Shala” në Javur. Në një odë në këtë fshat, u takuam me eprorët dhe ushtarët e këtij batalioni shumë të vyeshtë të Brigadës 121 të UÇK-së. Komandanti Ajet Kastrati-

“Eprori” dhe eprorë të tjerë i informuan anëtarët e ShP të UÇK-së lidhur me gjendjen e gatishmërisë luftarake të këtij batalioni gjatë festës së vitit të ri. Ajet Kastrati përmendi disa prej ushtarëve më të dalluar të këtij batalioni: Sejdi Gashin, Milazim Elshanin, Shefqet Shalën, Mustafë Shalën, Besim Hoxhën, të cilët ishin shpërblyer për përkushtimin e treguar gjatë luftës në këtë trevë.

Pastaj vizituam ushtarët e këtij batalioni të cilët ishin në pozicione në malet e Javurit. Ishte acar i madh. Abazi nxitoi ta xhironte luftëtarin Sejdi Gashi, i cili vështronte terrenin natën, lëvizjet eventuale të forcave serbe, dhe i thotë atij: *“Mos rri shumë në borë se po ftofesh”*. Pas pyetjes sime drejtuar Sejdi Gashit se a ju pengon acari i madh që të qëndroni në pozicione? Ai pa u hamendur u përgjigj: *“Në asnjë mënyrë nuk na pengon fare acari, sepse jemi të përgatitur dhe kemi vullnet të jashhtëzakonshëm për të qëndruar në pozicionet tona dhe për tui kundërvënë çdo provokimi të forcave ushtarake e policore serbe”*.

Zhvillova edhe një bisedë me Rexhep Selimin, inspektor i përgjithshëm i SHP të UÇK-së lidhur me gatishmërinë ushtarake të luftëtarëve të UÇK-së. Ai me këtë rast tha:

“Gatishmëria luftarake e të gjitha njësiteve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është në nivelin më të lartë. Për të mbrojtur popullatën civile dhe njësitet tona nga sulmet eventuale të forcave serbe, luftëtarët e lirisë janë në pozicionet e tyre dhe të gatshëm që tu kundërvihen atyre.”

Vitin e ardhshëm do ta festojmë në Kosovën e lirë

Xhirimet e asaj nate ishin të veçanta, sidomos kur komandant Ajet Kastrati ia dha me një zë të kumbueshëm raportin ushtarak anëtarit të SHP të UÇK-së, Fatmir Limajt para ushtarëve të tubuar natën e Vitit të Ri në Javur, kur xhiruam me drita të makinës, sepse nuk kishim drita të posaçme për xhirim natën. Këtu me një minutë heshtje iu bënë nderime dëshmorëve të rënë për liri në betejat e zhvilluara nga UÇK-ja gjatë vitit 1998. U emocionuam shumë kur dëgjuam Fatmirin t’u thoshte luftëtarëve: *“Ju uroj Vitin e Ri 1999 dhe ju përgëzoj për luftën që keni bërë! Shpresojmë se vitin e ardhshëm do ta festojmë në Kosovën e lirë”*. Këto fjalë ishin shumë inkurajuese për luftëtarët e lirisë.

Xhirimet që i bëmë me Abazin

në rrethana luftarake ishin tipike dokumentareske. Ne nuk mund të bënim film artistik, por bënim përpjekje që në rrethana të luftës ta prezantojmë UÇK-në për mbrojtjen e popullatës civile. Edhe në natën e Vitit të Ri të gjithë ishin në pozicionet e veta. Edhe pse ishte ftohtë i madh, të gjithë ishin të gatshëm të qëndrojnë dhe t’u bëjnë ballë provokimeve të forcave serbe. Te të gjithë luftëtarët e lirisë vërehej entuziazëm i veçantë për sfida të reja.

Atë natë në fshatin Tërpezë të Malishevës, Fatmir Limaj dhe Rexhep Selimi në një odë patën një bisedë të drejtpërdrejtë me ushtarët e Batalionit “Afrim Krasniqi” të UÇK-së, udhëhequr nga Skënder Hoti. Meqë ishte atmosferë festive, për t’i argëtuar luftëtarët e lirisë, kënduan disa këngë folklorike Ali dhe Hajdin Limaj. Në pushim të këngëtarëve, Fatmir Limaj para ushtarëve i përkujtoi zhvillimet gjatë vitit 1998 dhe komentoj disa kronika të cilat u transmetuan atë natë në lajmet nga Kosova në TVSh. Aty u transmetua edhe një kronikë e imja telefonike nga Lladrovci i Malishevës për pritjen e Vitit të Ri në këtë zonë të luftës, në mesin e eprorëve dhe ushtarëve të UÇK-së. Nga luftëtarët e lirisë u vlerësua lart puna e ekipit tonë, e imja, e Abazit, e Migjenit, e Ekran dhe Ergyn Dobërçanit

dhe e njerëzve të tjerë që na mbështesnin. Ata thoshin se *“njerëzit që e duan vendin e vet, e duan UÇK-në, e çmojnë luftën dhe prezantojnë luftën drejt dhe nga vendi i ngjarjes”*. Në mënyrë të veçantë, Fatmir Limaj na falënderoi dhe na inkurajoi mua dhe Abazin për punën që e bënim për pasqyrimin e sakrificës së popullit, të sakrificës së luftëtarëve të lirisë në përballje të drejtpërdrejtë me provokimet e vazhdueshme të armikut në këtë zonë, Zonën Operative të Pashtrikut, ku vepronte edhe Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, ku kishte shumë zhvillime dramatike dhe ku ishte organizimi i mirëfilltë i rezistencës së armatosur kundër forcave pushtuese serbe. Ndërsa u dëgjuan edhe kritika për disa gazetarë, të cilët raportonin nga Prishtina, kuptohet nga zyrat, për të gjitha ngjarjet politike në Kosovë të vitit ’98, që ishte realisht vit i UÇK-së, por nuk e përmendnin në mënyrë meritore ashtu si ishte zhvillimi i UÇK-së. Fatmiri para ushtarëve i analizoi disa paraqitje për edicionin e lajmeve të Kosovës në TVSh të cilat ishin përgatitur nga kolegët e mi të ekipit që raportonte me telefon nga Prishtina, duke thënë se në ato paraqitje të zhvillimeve të vitit 1998 mungonte pjesa kryesore, ajo e zhvillimeve në zonat e



luftës. Ishin të fokusuar kryesisht në prononcimet e udhëheqjes në Prishtinë, sidomos në konferencat për shtyp që mbaheshin në selinë e Lidhjes Demokratike. Sipas tyre, thua se asgjë tjetër nuk kishte ndodhur në Kosovë. Kjo irritoi sidomos Fatmir Limajn, i cili shprehu pakënaqësinë e vet, duke thënë se mjerisht disa gazetarë nuk janë duke e kryer detyrën e vet në mënyrë profesionale.

Gjatë vizitës në Banjë të Malishevës, në batalionin e fshatit të Limajt, raportin për gatishmërinë luftarake të UÇK-së ia dha eprori Çerkin Dukolli. Fatmir Limaj nuk kishte pasur kohë të vizitonte një kohë as familjen e vet, prandaj, e shfrytëzoi këtë rast dhe kërkoi mirëkuptim, që bashkë me ne të shkojmë në shtëpinë e vet dhe ta vizitojmë një pjesë të familjes së tij. Një pjesë e saj ishte në Prishtinë, kurse një pjesë në Banjë. Kur kemi shkuar aty ishte bashkëshortja, Zaria dhe fëmijët e tyre, djali Durimi, nipi, djali i motrës - Arianiti, axha i Fatmirit - Ganiu, bashkëshortja e axhës,

Hajrija, njëherësh teze e Fatmirit. I them Abazit, xhiroje takimin e Fatmirit me familje në mënyrë të natyrshme.

Me të vërtetë ishin xhirime të veçanta dokumentare sepse Fatmiri në njëfarë mënyre nuk kishte kohë të përkujdesej për familjen e vet dhe përqendrohej në organizimin e rezistencës në Zonën e Pashtrikut dhe më gjerë. Ato xhirime pasqyrojnë një realitet të atyre çasteve, të pritjes së Vitit të Ri 1999, dhe me të vërtetë te të gjithë, edhe te fëmijët, të rriturit dhe ushtarët vërehej optimizëm për ditë më të mira për Kosovën, për pritjen e Vitit të Ri në Kosovën e çliruar. Gjatë qëndrimit në çerdhet e UÇK-së në Llapushë, duke udhëtuar nga një fshat në tjetrin, isha në një makinë me Rexhep Selimin, i cili na voziste. Përpara ishte ulur Fatmir Limaj, kurse prapa unë dhe i biti im, Arianiti. Ishte po ashtu një automjet tjetër, ku ishin Haxhi Shala, Avdi Rraci, kolegu Abaz Zeka dhe disa ushtarë të tjerë të UÇK-së. Ata e çmuan ardhjen tonë nga Prishtina, sidomos xhirimet që i

bënim me këtë rast. Për një çast Rexhepi dhe Fatmiri thanë: *"Baci Nuhi, kur vendos diçka, pa e realizua nuk e lë!"* Unë thashë: *"Unë kam shprehur vullnetin të vij ta pres Vitin e Ri në mesin tuaj. Jo vetëm me pritë, por me regjistru një pjesë të historisë së popullit tonë në vitin 1998, i cili ishte viti vendimtar për popullin shqiptar të Kosovës".*

Me të vërtetë ndihesha shumë më mirë që isha në mesin e luftëtarëve të lirisë për ta pritur Vitin e Ri 1999 sesa të kisha qëndruar dhe pritur në Prishtinë, në gjirin familjar. Kisha pritur më parë mjaft ndërrime të moteve në mesin familjar. Por, ky ishte viti i rëndësishëm për mua, më i rëndësishmi prej gjithë të tjerëve në jetën time. Të them të drejtën, nëse nuk kisha shkuar në mesin e luftëtarëve të lirisë, me të vërtetë do të më kishte mbetur merak, do të ishte në njëfarë mënyre dështimi im për t'ia sjell opinionit ato xhirime dhe realitetin se si UÇK-ja e priste ndërrimin e moteve në gjendje të gatishmërisë së lartë

edhe gjatë kësaj feste. Pra, qëllimi kryesor ishte që opinionit t'i tregonim për ndërrimin e moteve, se si luftëtarët e lirisë janë në detyrën e tyre, në mbrojtje të Kosovës, në vazhdimin e luftës për liri. Nuk ishte qëllimi im vetëm të shkoja të rrija, të pija ndonjë gotë verë.

Gjatë qëndrimit në zonat e luftës, me rastin e Vitit të Ri, në Fshat të Ri erdhën edhe zëvendëskomandanti i përgjithshëm i ShP të UÇK-së, Jakup Krasniqi dhe Adem Grabovci, anëtar i ShP i UÇK-së. Bashkë me ta bisedonim dhe komentonim zhvillimet në zonat e luftës dhe zhvillimet politike në Kosovë dhe rajon. Te të gjithë vërehej optimizëm i veçantë, se liria e Kosovës po shihet në horizont. Nga të gjitha këto vizita në mesin e luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përgatitëm një emision të veçantë në TV shqiptar me titull *"Viti i Ri në linjën e parë"*. Ishte ndjenjë e veçantë për mua, por edhe për opinionin e gjerë për ato imazhe historike.

Mund të them se kalimin e vitit 1998 dhe hyrjen e vitit të ri 1999 do t'i mbaj mend përgjithmonë. Viti 1999 vërtet ishte vit i kthesës historike për popullin shqiptar të Kosovës sepse pas shumë betejave frontale midis luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave ushtarake e policore serbe, pas shumë masakrave të regjimit të Millosheviqit mbi popullatën civile shqiptare në shenjë hakmarrjeje për humbjet në fushëbeteja me UÇK-në, si dhe pas ndërhyrjes së forcave ajrore të NATO-s ndaj caqeve militare serbe, më 9 qershor 1999 ushtria e Millosheviqit u detyrua ta nënshkruajë kapitullimin dhe më 12 qershor të atij viti filloi të tërhiqet përfundimisht nga Kosova. Kështu, për popullin e Kosovës filloi një etapë e re, e lirisë dhe më 17 shkurt 2008 Kosova u shpall shtet i pavarur dhe sovran, duke u realizuar ëndrra shumëshkulllore.

(Fragment nga "Libri i luftës" i autorit Nuhi Bytyçi, botuar nga "Armagedoni", mars 2019)





FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIR MATOSHI

AKR-ja PREFERON KOALICION MË PARTITË OPOZITARE

Kryetari i Kuvendit Aleanca Kosova e Re (AKR), Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se kjo parti synon të shkojë në koalicion parazgjedhor në zgjedhjet e parakohshme. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se AKR-ja preferon koalicion me partitë opozitare, Lëvizjen Vetëvendosje ose Partinë Demokratike të Kosovës. Megjithatë, ai ka treguar se mundësia ekziston që të ketë bashkëpunim edhe me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Sipas Matoshit, kushti i vetëm i AKR-së për koalicion do të jetë pajtimi për program dhe për të bërë punë të mira për vendin

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR-
"Epoka e re": Si ka qenë viti 2020 për Kosovën sipas AKR-së?

Matoshi: Padyshim se është një nga vitet më të vështira që nga paslufta. Nuk ishte një vit i mirë e i mbarë për Kosovën sikundër që ishte vit shumë i rëndë për gjithë botën për shkak të përhapjes së virusit Covid-19, i cili, pos dëmeve të mëdha e humbjes së jetëve të njerëzve, solli edhe pasoja të rënda edhe në ekonomi e zhvillim. Ishte një vit me një pasiguri institucionale, me institucione të brishta. Filluam vitin me një qeveri në detyrë, pastaj vendi u qeverisë edhe rreth dy muaj të pranverës po ashtu nga një qeveri në detyrë dhe vitin

po e përmbyllim sërish me një qeveri në detyrë, pa president, pa drejtor të AKI-së, pa drejtor të policisë, pa drejtor të ShSKUK-së në kohë pandemie etj. E gjithë kjo jo për koncepte politike e zhvillimore për vendin, por nga etja dhe dëshira për pushtet më të madh të disa liderëve politikë. Kosova u përballë edhe me Gjykatën Speciale e cila, po ashtu, ishte ngjarje e keqe që na ndodhi. Presidenti i vendit, dy ish-kryeparlamentarë dhe shefi i deputetëve të partisë më të madhe në vend u privuan nga liria dhe detyrat e tyre institucionale që kishin, për t'u përballuar me akuzat e fabrikuara që rëndojnë mbi ta e që

ndërlidhen me kohën e luftës çlirimtare.

"Epoka e re": Në këtë vit Kosova ka pasur dy qeveri. Cili është vlerësimi juaj për këto dy qeveri jetëshkurtra?

Matoshi: Ashtu si kanë ardhur, njësoj kanë ikur që të dyja, pa lënë ndonjë gjurmë ose punë të mirë të kryer. E keqja e gjithë kësaj është se partitë që drejtuan këto dy qeveri patën ngjalluar shumë shpresë te qytetarët, pastaj për çështje krejt dytësore nuk arritën ta jetësojnë programin e tyre qeverisës. Kjo padyshim se ka pasoja të mëdha për vendin. Duke qenë se e kam drejtuar për një vit e pak muaj Ministrinë e

Mjedisit, mund të flas me më shumë kompetencë në këtë fushë. Është një degradim total i njërës prej sferave më të rëndësishme të jetës së qytetarit. Në emër të zvogëlimit të qeverisë është fuzionuar mjedisi dhe planifikimi hapësinor një herë në Ministrinë e Infrastrukturës e pastaj në atë të zhvillimit ekonomik. Kemi kryer punë jashtëzakonisht të mëdha sa ishim në atë ministri, kemi filluar edhe shumë të tjera që ishin në një fazë mjaft të mirë të zhvillimit të tyre. Me keqardhje them se të gjitha kanë ngecur aty ku i kemi lënë. Patëm filluar një program mjaft të rëndësishëm për krijimin e rezervave të reja ujore në Kosovë, ndërtimin e digave, programet për trajtim të ujërave të zeza, eliminimin e qeseve të plastikës, sistemin e kthimit të depozitave në shishe të plastikës, qelqit dhe aluminit, mbështetje të madhe komunave për grumbullim dhe menaxhim të mbeturinave, që të gjitha kanë ngecur dhe është për keqardhje, po ashtu edhe procesi i trajtimit të

ndërtimeve pa leje është plotësisht i harruar. Buxheti për 2020-n dhe ai për 2021-n në këto fusha kanë pësuar rënie drastike, ndërsa është harruar se në rrugën tonë për integrim në BE, mjedisi do të jetë sfida më e madhe për vendin.

"Epoka e re": Me aktgjykimin e fundit, Kushtetuesja po e çon vendin në zgjedhje. Si e keni parë këtë veprim të Kushtetueses?

Matoshi: AKR-ja asnjëherë nuk i ka komentuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Si subjekt vetë jemi atakuar nga vendime të mëhershme të gjykatës, e që është rasti i presidentit Pacolli, ku ai ishte një viktimitë e mosmenaxhimit të mirë të punës në Kuvend dhe zbatimit të Rregullores së Punës së Kuvendit, atëkohë z. Pacolli pa asnjë hamendje është larguar nga Presidenca duke dhënë shembullin e një politikani e qytetari të përgjegjshëm të këtij vendi.

"Epoka e re": Si do të shkojë AKR-



SELIMI: ËSHTË SHËNUAR PROGRES NË FUSHËN E DREJTËSISË

Prishtinë, dhjetor/janar-
Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka mbajtur konferencën vjetore për media, ku ka paraqitur raportin e punës për periudhën qershor - dhjetor 2020, me ç'rast u vlerësua se pavarësisht rrethanave të vështira të krijuara si pasojë e pandemisë, Ministria e Drejtësisë gjatë kësaj periudhës ka realizuar progres të dukshëm në shumë fusha brenda fushëveprimit të saj.

Në shpalosjen e raportit të punës, ministri Selimi ka pohuar se Ministria e Drejtësisë është angazhuar në zbatimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës për fushën e drejtësisë dhe në realizimin e objektivave, programeve dhe projekteve sektoriale si pjesë e dokumenteve strategjike të saj. "Duke qenë njëri nga prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë, adresimi i llogaridhënies në sistemin e drejtësisë, është dërguar në Qeverinë e Republikës së Kosovës, propozim/vendimi për themelimin e Grupit Punues për hartimin e modaliteteve dhe skenarëve

për çështje të reformës në sistemin e Drejtësisë, me qëllim të adresimit të Llogaridhënies duke përfshirë edhe Vettingun, i cili është aprovuar nga Qeveria me datë 15.07.2020. Po ashtu gjatë kësaj periudhe është shënuar nisja e fazës së tretë të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, gjegjësisht fazës së hartimit të Strategjisë Sektoriale për Sundimin e Ligjit. Tanimë e kemi draftin e Strategjisë Sektoriale për Sundimin e Ligjit, ky draft pritet të vihet në konsultime publike", ka theksuar ministri Selimi.

Ministri Selimi ka thënë se Ministria e Drejtësisë ka filluar punën për ri-themelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë, ndërsa një vëmendje të veçantë i është kushtuar kompensimit të viktimave të krimit. "Janë shqyrtuar gjithsej 55 raste të paraqitura, nga të cilat 22 janë aprovuar, dhe shumica e kompensuar është mbi 91 mijë euro", është shprehur ministri Selimi.

Në gjashtëmuorin e punës, ministri Selimi ka theksuar se

është punuar në ndryshime substanciale të legjislacionit në sektorin e drejtësisë, duke rishikuar dhe hartuar Projekt-Kode, Projektligje, Koncept-Dokumente dhe akte tjera nënligjore si dhe angazhimi në përmbytjen e kërkesave që dalin nga Agjenda Evropiane. Ministria e Drejtësisë sipas ministrit Selimi ka punuar edhe në hartimin e disa koncept dokumenteve, si: Koncept Dokumentin për Sanksionet e Sh njestruara për Shkelësit e te Drejtave t Njeriut; Koncept Dokumentin për Fondin e Konfiskimit; Koncept Dokumentin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, si dhe Koncept Dokumentin për Ekspertizat Gjyqësore si dhe ka finalizuar 10 akte nënligjore

Gjatë konferencës, ministri Selimi ka përmendur edhe të arriturat e Agjencive të Pavarura në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. "Avokatura Shtetërore, ka përfunduar institucionet shtetërore në procedura gjyqësore në rreth 950 raste, ndërsa Shërbimi Korrektues ka dalë të

jetë njëri nga institucionet me të besueshëm në nivel vendi, e ranguar si e dyta, pas FSK-së. Shërbimi Sprovues ka kryer detyrat në drejtim të mbikëqyrja e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative, mbikëqyrja e të liruave me kusht nga burgju; Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, ka ekzekutuar gjithsej 92 vendime të dërguara nga gjykatat për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar", ka pohuar ministri Selimi.

Sipas tij, gjatë këtij viti Instituti i Mjekësisë Ligjore ka zbatuar urdhëresat për zhvarrime, duke marrë pjesë në 15 lokacione në Kosovë dhe Serbi, ku si rezultat i këtyre zhvarrimeve janë gjetur gjithsej 11 trupametje mortore.

Ndër tjerash, ministri Selimi foli edhe për fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar ku theksoi se tanimë janë proceduar 2254 kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike ndërsa janë realizuar gjithsej 28 ekstradime.

ja në këto zgjedhje, e vetme apo me ndonjë koalicion parazgjedhor?

Matoshi: Shpejt do të vendosim, por unë preferoj dhe, duke parë rrethanat politike, besoj se do të jemi pjesë e ndonjë koalicioni.

"Epoka e re": Me cilat parti preferon AKR-ja të shkojë në koalicion parazgjedhor?

Matoshi: Kemi bashkëpunuar pothuajse me të gjitha deri më sot, qoftë në nivel qendror ose lokal. Sistemi zgjedhor që ne kemi në një formë i kushtëzon bashkëpunimet mes subjekteve politike. Tani me qenë se jemi në opozitë do të ishte më e udhës që të jemi me ndonjë nga partitë opozitare, LV-në ose PDK-në, por mundësia ekziston që të kemi bashkëpunim dhe koalicion edhe me LDK-në.

"Epoka e re": Ka ndonjë kusht kjo parti për koalicion?

Matoshi: Këto zgjedhje shpresoj që të ofrojnë zgjidhje për disa sfida që na presin. Kërkohen 80 vota për zgjedhjen e presidentit qysh në fillim të punës së legjislaturës së re. Normalisht që në situata sikurse kjo kërkohet unitet i subjekteve politike. Kushti ynë i vetëm do të jetë dakordimi për program dhe për të bërë punë të mira për vendin. Tashmë kemi mbetur shumë mbrapa dhe nëse do të dështojmë edhe pas këtyre zgjedhjeve, atëherë zhgënjimi do të jetë vërtet i madh te qytetarët.



NGJARJET MË TË RËNDËSISHME NË BOTË GJATË VITIT 2020

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Pandemia globale Covid-19, humbja e Donald Trumpit dhe fitorja e Joe Biden kanë qenë lajmet kryesore që kanë karakterizuar botën gjatë vitit 2020. Po gjatë vitit që po lëmë pas kanë ndodhur edhe disa ngjarje siç është ajo e vrasjes së gjeneralit iranian Qasem Soleimani nga ShBA-ja, zbulimi i vaksinës kundër Covidit, luftimet në mes të Armenisë dhe Azerbajxhanit etj.

ShBA-ja vret gjeneralin e forcave elite të Iranit

3 janar - Gjenerali Qasem Soleimani, kreu i forcave elite të Gardës Revolucionare të Iranit, është vrarë nga forcat amerikane në Irak. Pentagoni ka konfirmuar se ai është vrarë me "vendim të presidentit". Gjenerali Soleimani ka qenë në makinë teksa ishte nisur në aeroportin e Bagdadit, bashkë me milicinë e përkrahura nga Irani, kur është qëlluar përmes një sulmi ajror të Shteteve të Bashkuara. Lideri suprem i Iranit, Ayatollah Ali Khamenei, ka thënë se "hakmarrje e ashpër i pret kriminelët" mbrapa këtij sulmi. Ai ka shpallur tri ditë zie.

Bie borë në shkretëtirën e Arabisë Saudite

11 janar - Reshjet e mëdha të borës mbuluan rajonet veriperëndimore të Arabisë Saudite, veçanërisht në malet Dahr. Pamjet janë bërë virale në rrjetet sociale, pasi janë publikuar nga mediat vendore.



Shkak i motit jo të zakonshëm janë bërë temperaturat që në disa zona kanë rënë nën zero gradë.

Britania largohet zyrtarisht nga BE-ja

1 shkurt - Britania nuk është më pjesë e Bashkimit Evropian. Ky vend i ka dhënë fund anëtarësisë 47-vjeçare në bllokun evropian, duke e lënë atë me 27 anëtarë. Britania tani e tutje do të konsiderohet nga BE-ja shteti i tretë dhe përfaqësimi i saj i përhershëm në këtë bllok do të shndërrohet në mision të jashtëm. Pas largimit, Mbretëria e Bashkuar do të hyjë në një periudhë transitore 11-mujore, në të cilën do t'i zbatohet rregullat e bllokut evropian, mirëpo nuk do të përfaqësohet në institucionet e tij. Kjo periudhë pritet të zgjasë deri më 31 dhjetor të këtij viti. Vendimi për largim të Britanisë nga blloku evropian ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundruall 48 për qind që kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.

Senati e shfajëson presidentin Trump

5 shkurt - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, është liruar nga akuzat për abuzim të pushtetit dhe pengim të punës së Kongresit, të cilat përbëjnë bazë për shkarkim nga detyra. Senati i Shteteve të Bashkuara, i udhëhequr nga Partia Republikane e presidentit, votoi të mërkurën për shfajësimin e



tij. Votimi u zhvillua veç e veç për të dyja akuzat. Për akuzën e parë, abuzim të pushtetit, 52 senatorë votuan për shfajësimin e presidentit, ndërsa 48 për fajësimin e tij. Ndërkaq, për akuzën e dytë, pengim të punës së Kongresit, 53 vota ishin për shfajësim, 47 për fajësim.

Gjashtëmbëdhjetë të vrarë në një sulm në Kanada

20 prill - Një person i armatosur dhe i veshur si oficer i policisë ka kryer një sulm duke vrarë 16 veta në provincën kanadeze Nova Scotia. Ky është sulmi më vdekjeprurës në historinë e Kanadasë. Autoritetet thanë se edhe sulmuesi është vrarë. Në mesin e të vrarëve është edhe një oficer e policisë. Disa trupa u gjetën brenda dhe jashtë një shtëpie në qytezën e vogël

Portapique, rreth 100 kilometra në veri të Halifaxit, në atë që policia e quajti skena e parë e krimit.

Vrasja e George Floyd shkakton zemërim në ShBA

25 maj - George Floyd, një burrë me ngjyrë 46 vjeç, është vrarë në Minesota nga një oficer i policisë, pasi ia kishte vënë këmbën në qafë për gati nëntë minuta. Policia fillimisht pretendoi se Floyd i kishte rezistuar arrestimit, por pasi pamjet e kamerave të sigurisë dhe videot e bëra nga dëshmitarët qarkulluan gjerësisht, të katër oficerët u pushuan nga puna. Vdekja e Floydit ka shkaktuar demonstrata dhe protesta në të gjithë botën kundër përdorimit të forcës së tepërt nga policia, mungesës së përgjegjësisë së policisë dhe racizmit të policisë. Protestat në zonën metropolitane Minneapolis-Saint Paul janë bërë të dhunshme pasi një zonë policie dhe dy dyqane janë djegur dhe plaçkitur. Disa demonstrues ishin përplasur me policinë, të cilët qëlluan me gaz lotsjellës dhe plumba gome.

Anulohet Haxhi, shkak pandemia

22 qershor - Arabia Saudite do të lejojë vetëm "një numër shumë të kufizuar" të njerëzve, të cilët jetojnë në këtë Arabi, të mund ta bëjnë haxhillëkun tradicional, që fillon nga fundi i korrikut. "Për shkak të situatës me pandeminë Covid-19 në nivel botëror, haxhillëku këtë vit do të mbahet me numër shumë të kufizuar të personave nga të gjitha kombësitë që jetojnë në Arabinë Saudite", është thënë në

njoftimin e Ministrisë për Haxhillëk dhe Umre. Më shumë se dy milionë persona për çdo vit shkojnë në haxhillëkun tradicional në qytetin e shenjtë Mekë.

Shpërthim i fuqishëm në Bejrut

4 gusht - Kryeqyteti i Libanit, Bejruti, është shkatërruar nga një prej shpërthimeve më të mëdha jobërthamore në histori. Një zjarr ka përfshirë rezerva prej gati 3 000 tonëve të nitrarit të amonit, që janë lënë në pakujdesi afër portit të qytetit. Si pasojë e shpërthimit, shumë shtëpi janë hedhur në ajër. Më shumë se 200 persona kanë vdekur dhe mijëra janë plagosur, situatë që ka nxitur protesta masive dhe dëme ekonomike. Si pasojë e këtij shpërthimi ka dhënë dorëheqje edhe kryeministri i këtij shteti.

Nënshkruhet marrëveshja në mes të Izraelit dhe Emirateve të Bashkuara Arabe

13 gusht - Izraeli dhe Emiratet e Bashkuara Arabe kanë nënshkruar një marrëveshje që synon t'i normalizojë marrëdhëniet në mes të këtyre vendeve. Izraeli dhe fqinjët arabë kanë zhvilluar tetë luftëra dhe kanë nënshkruar pak marrëveshje për paqe. Kjo është vetëm marrëveshja e tretë në mes të një vendi të Gjirit Arab dhe Izraelit për krijim të lidhjeve diplomatike. Egjipti ka nënshkruar një marrëveshje të ngjashme më 1979 dhe Jordani më 1994. Izraeli është krijuar më 14 maj të vitit 1948. Ky shtet menjëherë është përballur me sulme nga vendet fqinje si, Egjipti, Jordan, Libani dhe Siria, mirëpo ka arritur t'i zmbarsë të gjithë.



Për pak sa nuk nis lufta në mes të Turqisë dhe Greqisë

10 gusht - Turqia dërgoi një anije për të kryer një studim sizmik në një zonë të debatueshme në Mesdheun Lindor, një veprim që Greqia e konsideron të paligjshëm dhe që ka të ngjarë t'i rrisë tensionet mes dy aleatëve të NATO-s. Në paralajmërimin e lëshuar nga marina turke është thënë se anija "Oruc Reis" do të veprojë në zonë gjatë dy javëve të ardhshme. Ky veprim i Turqisë ka ngjallur reagime të shumta, duke përfshirë edhe reagimin e Greqisë. Dy vendet kanë mosmarrëveshje për shkak të pretendimeve territoriale mbi burimet e hidrokarbureve në rajon.

Helmohet kundërshtari më i ashpër i Putinit

20 gusht - Politikani i opozitës ruse, Alexei Navalny, është helmuar pasi kishte pirë një filxhan çaj. Ai ka qëndruar për disa ditë në komë në një spital në Gjermani. Alexei Navalny ka akuzuar në vazhdimësi presidentin rus Vladimir Putin për helmimin, por një gjë të tillë është mohuar nga ky i fundit.

Lufta Armeni - Azerbajxhan

27 shtator - Armenia dhe Azerbajxhani kanë zhvilluar luftime të ashpra në rajonin e Nagorno Karabakut. Luftimet kanë lënë të vrarë të paktën 1 000 ushtarë dhe civilë. Pas këtyre luftimeve më 10 nëntor është arritur një marrëveshje në mes të këtyre dy shteteve. Kjo marrëveshje ka ngjallur reagime dhe protesta. Kujtojmë se këto luftime po konsiderohen si më të ashprat që prej armëpushimit të vitit 1994 që i kishte dhënë fund luftës ndërmjet Armenisë dhe Azerbajxhanit për statusin e rajonit të Nagorno Karabakut. Nagorno Karabaku ndërkombëtarisht njihet si pjesë e Azerbajxhanit, por ky rajon kontrollohet nga

armenët etnikë që kanë mbështetjen e Jerevanit që prej vitit 1994.

Franca dhe myslimanët

17 tetor - Prerja e kokës së një mësuesi nga një çeqen 18-vjeçar jashtë Parisit është pasur nga vrasja e tre personave në Nicë nga një emigrant tunizian. Për pasojë, Franca ka rritur alarmin e sigurisë në nivelin më të lartë. Sulmet kanë ardhur teksa po zhvillohej një gjykim për masakrën e vitit 2015 në revistën satirike "Charlie Hebdo", e cila ka publikuar karikatura të Profetit Muhamed. Mësuesit i është prerë koka për shfaqje të karikaturave në klasë, derisa është diskutuar për liri të shprehjes, qasje e mbrojtur nga presidenti francez Emmanuel Macron. Karikaturat dhe qëndrimi i Macronit kanë nxitur kombet myslimane që t'i bojkotojnë produktet franceze.

Presidenti Trump infektet me koronavirus

2 tetor - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dhe Zonja e Parë, Melania, kanë dalë pozitivë në testin për koronavirus. Lajmin e kishte bërë me dije vetë presidenti Trump. "Unë dhe Zonja e Parë kemi dalë pozitivë me Covid-19. Do ta nisim karantinën dhe procesin e shërimit menjëherë. Do t'ia dalim bashkë", kishte shkruar Trumpi në "Twitter". Ndërsa më 13 tetor, Trumpi kishte njoftuar se ishte shëruar nga Covidi.

Papa Françesku mbështet martesat civile të homoseksualëve

21 tetor - Papa Françesku ka mbështetur martesat civile të homoseksualëve. "Homoseksualët kanë të drejtën të jenë pjesë e një familjeje. Ata janë fëmijë të Perëndisë dhe kanë të drejtën të kenë familje", ka thënë Ati i



Shenjtë në një dokumentar me titull "Françesku", sipas Agjencisë Katolike të Lajmeve.

Opozita bjelloruse fiton Çmimin Sakharov

22 tetor - Opozita demokratike bjelloruse është nderuar me Çmimin Sakharov për liri të mendimit, që ndahet nga Parlamenti Evropian. Protestat e opozitës kundër Alyksandr Lukashenkës në Bjellorusi kanë vazhduar që prej zgjedhjeve presidenciale të 9 gushtit. Në këto protesta, mbi 10 mijë persona janë raportuar se janë arrestuar, disa të vdekur dhe qindra të lënduar. Lukashenka është në krye të Bjellorusisë që nga viti 1994. Ai pretendon se ka fituar në zgjedhjet e 9 gushtit, por opozita thotë rezultatet zgjedhore janë manipuluar dhe fituese e zgjedhjeve është kandidatja opozitare Svyatlana Tsikhanouskaya. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë refuzuar ta pranojnë fitoren e Lukashenkës.

Joe Biden, presidenti i 46 i ShBA-së

3 nëntor - Joe Biden është fitues i zgjedhjeve presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Anëtarët e Kolegjit Zgjedhor të ShBA-së në 50 shtete dhe Distriktin e Kolumbisë, më 14

dhjetor kanë zyrtarizuar Bidenin president të ardhshëm të ShBA-së. Bideni ka fituar zgjedhjet e nëntorit me 306 vota të Kolegjit Zgjedhor, duke e mundur presidentin aktual Donald Trump, i cili ka fituar 232. Për t'u zgjedhur president i ShBA-së duhen së paku 270 vota të Kolegjit Zgjedhor. Inaugurimi i presidentit të ri pritet të bëhet më 20 janar të vitit 2021.

ShBA-ja tërhiqet zyrtarisht nga Marrëveshja e Parisit për Klimën

4 nëntor - Pas një vonese trevjeçare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) janë bërë vendi i parë në botë që janë tërhequr zyrtarisht nga Marrëveshja e Parisit për Klimën. Presidenti Donald Trump ka shpallur planet për tërheqje qysh në qershor të vitit 2017, por rregullat e Kombeve të Bashkuara kanë kërkuar që vendimi të hyjë në fuqi vetëm sot, një ditë pas zgjedhjeve në ShBA. Marrëveshja e Parisit për Klimën është hartuar në vitin 2015, për ta forcuar përgjigjen globale ndaj ndryshimeve klimatike. Ajo është nënshkruar gati nga të gjitha vendet. Marrëveshja synon ta mbajë rritjen globale të temperaturës në këtë shekull nën 2 gradë celsius. Trump e ka kundërshtuar marrëveshjen, duke thënë se ajo e pengon biznesin dhe u jep përparësi vendeve të tjera. Ai e ka vënë vazhdimisht në dyshim shkencën e ndryshimit të klimës. ShBA-ja është përgjegjëse për rreth 15 për qind të emetimeve globale të gazrave serë, që thuhet se ndikojnë në ndryshimet klimatike.

Zbulohet vaksina anti-Covid

9 nëntor - Më në fund është zbuluar vaksina që e ndalon infektimin me Covid-19. Kjo vaksinë është zbuluar nga kompania "Pfizer" dhe "BioNTech". Sipas kësaj kompanie, zbulimi i kësaj vaksine është "zhvillim i madh

për shkencën dhe njerëzimin". Kjo vaksinë tashmë ka nisur të përdoret. Edhe kompania "Moderna" ka zbuluar një vaksinë të tillë.

Ish-kryeministri kroat dënohet për korrupsion

13 nëntor - Ish-kryeministri i Kroacisë, Ivo Sanader, është dënuar me tetë vjet burgim, pasi është gjetur fajtor për krijimin e fondeve për partinë e tij konservatore HDZ, duke marrë para nga kompanitë publike përmes një agjencie të marketingut. Sanaderi ka hedhur poshtë të gjitha akuzat për korrupsion dhe pritet që ta apelojë këtë vendim të gjykatës. Ky ishte një rigjykim i një rasti të mëhershëm, ku Sanadeir ishte dënuar me nëntë vjet burgim më 2013, por vendimi ishte anuluar nga Gjykata Supreme për shkak se ishin gjetur shkelje procedurale. Partia e tij, HDZ, që aktualisht është në pushtet, është gjobitur 550 000 dollarë dhe është urdhëruar nga gjykata që të kthejë 2.1 milionë dollarë fonde, të përfituara në mënyrë të paligjshme.

Arrihet marrëveshja tregtare pas Brexit-it ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së

24 dhjetor - Britania e Madhe ka arritur marrëveshje tregtare pas Brexit-it me Bashkimin Evropian. Marrëveshja është shumë e rëndësishme për raportet e Britanisë së Madhe dhe BE-së pasi një dështim i saj do ta detyronte vendosjen e tarifave të ndërsjella. Qeveria britanike ka thënë se "marrëveshja është një lajm fantastik për familjet dhe bizneset në çdo pjesë të Britanisë së Madhe". Vendimi për largim të Britanisë nga BE-ja ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundruall 48 për qind që kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.





Muzeu i Kristaleve të Kosovës “Trepça”, thesar i Kosovës

Kosova ka pasuri të shumta. Ka tokë flori. Ka vende të bukura për turizëm dhe vende historike, arkeologjike dhe me përplot gojëdhëna dhe mite. Një prej bukurive të saj të shumta e të veçanta është Muzeu i Kristaleve të Kosovës “Trepça”, i cili shtrihet në mes të maleve të Pretenit dhe atyre të Kutllocit, përkaj rrugës që shpie për në malet e bukura të Shalës së Bajgorës. Në këtë galeri të mijëra kristaleve të Kosovës më mirë dhe më shumë se askund tjetër vlerësohet pasuria e madhe nëntokësore që ka Kosova.

Në këtë muze, të cilin e vizituar në kuadër të projektit “Observimi i traditës” ditë më parë, janë të ekspozuara mbi 1 900 eksponate, me 65 lloj kristalesh, nga të cilat mbi 90 % janë kristale të minierës së Trepçës në Stantërg, ndërsa të tjerat janë nga minierat e tjera të Kosovës, por edhe nga minierat e vendeve të ndryshme të botës të cilat hëm ia kanë dhuruar muzeut, hëm i njëjti i ka blerë sa për ekspozitë, veçanërisht me Gjermaninë, Italinë, Francën, Spanjën, Brazilin, ka bërë këmbim me disa prej kristaleve të nxjerra nga miniera e “Trepçës”. Përveç kristaleve të Trepçës, në muze janë ekspozuar edhe mjete të vjetra pune me të cilat kanë punuar xehetarët në fillimet e punëve në minierë e që kanë mbi njëqind vjet jetë.

Muzeu është hapur në vitin 1960 në një objekt tjetër, pak metra më tutje nga objekti i ri i cili, për shkak të vjetërsisë dhe



mosplotësimi të kushteve për ekspozim dhe për ruajtje të kristaleve, është mbyllur dhe është ndërtuar objekti i ri në vitin 2012 i cili vizitohet nga vizitorë të huaj dhe vendorë, në stinë të ndryshme të vitit.

Muzeu “Trepça” konsiderohet një nga vendet më atraktive turistike që vlen për t’u vizituar, pasi llogaritet perlë jo vetëm e qytetit të Mitrovicës, por e gjithë Kosovës. Për të hyrë në minierën e “Trepçës”, në njërën nga minierat më mëdha në botë të metaleve të plumbit, zinkut, arit dhe argjendit, për ta parë punën e minatorëve, duhet leje e posaçme dhe paraprake.

Sipas ciceronit të muzeut, Ibrahim Musa, muzeu ka kristale kryesisht nga galaniti, sfaleriti, piriti, pirotina, kuarci, kalciti etj. Në mesin e tyre ka edhe kristalminerale shumë të çmuara e të

rralla, siç janë vivianiti dhe lludllomiti. Është i veçantë edhe kristali galeniti në formë të pjatës, të cilin e quajnë “kristali i Nju-Jorkut”, pasi ka formën e këtij qyteti amerikan. Po sipas Musës,

iniciativa për themelimin e muzeut ka rrjedhur nga një grup minatorësh entuziastë, të cilët në vitin 1960 grumbulluan një numër kristalesh që kishin nxjerr nga miniera.

Historiku i “Trepçës” dhe i minierës

Miniera “Trepça” në Stantërg i përket qytetit të Mitrovicës. Për herë të parë në literaturë emri “Trepça” përmendet më 1303 në dokumentet që ruhen në Arkivin e Dubrovnikut (Republika e Kroacisë), si dhe në arkivat osmane. Hulumtimet e para gjeologjike në të filluan në vitin 1924, kur gjeologët anglezë filluan kërkimet për mineralizimet polimetalore sulfure të Pb – Zn, në suaza të fushës xeherore të “Trepçës” në Stantërg. Më vonë,

saktësisht në vitin 1926, në Londër formohet një shoqëri aksionare e njohur me emrin “Trepça Mines Limited”, e cila merr me koncesion shfrytëzimin e këtij vendburimi për 50 vjet.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore gjermanët e mbajnë minierën e “Trepçës” në Stantërg në gjendje punë, por me një nivel të zvogëluar të prodhimit. Ndërsa nga viti 1945 e tutje, deri më 1990, miniera ka punuar pa ndërprerë, me një kapacitet mesatar të prodhimit rreth 600 000 tonë në vit. Disa nga vendburimet sulfure (“Trepça” në Stantërg, Belo Brdo, Černac, Përroi i Ngjyrosur, Artanë), edhe sot, pas luftës së fundit në Kosovë (1998/99), janë në shfrytëzim. Ndërkaq vendburimet si: Hajvalia, Badovci dhe Kishnica janë të zhytura në ujë dhe kanë mbetur pa kurrfarë mbikëqyrje edhe pse para luftës (më 1988/99) ishin prodhuese të rëndësishme të xehes Pb, Zn dhe Ag etj. Ndërkaq, pas luftës, gjatë periudhës së viteve 2000-2004, miniera nuk ka prodhuar, por ka qenë në permanizim, hulumtim dhe përgatitje të punishteve për prodhim. Vetëm në vitin 2005 miniera ka filluar prodhimin e xehes Pb dhe Zn me kapacitet minimal.

(Ky artikull është përgatitur në kuadër të projektit kulturor “Observimi i traditës”, realizuar nga Qendra për Kulturë dhe Edukim “Sheshi”, Prishtinë. Fusnotat i hoqi redaksia)





NË KOMPLEKSIN E ISË ADEM BOLETINIT NË BOLETIN

Trashëgimia kulturore është një temë shumë e rëndësishme në të gjitha vendet e botës. Për ruajtjen e saj përkujdesjen institucione, shoqata, biznese, dashamirë e kush jo tjetër që ka një pikëtakim shpirtëror ose një fije kujdesi për objektet e vjetra. Edhe trashëgimia kulturore e Kosovës është një temë mjaft me interes për t'u trajtuar në cilado medime dhe, po ashtu, mjaft me interes për t'u përkrahur nga institucione qendrore dhe lokale vendore dhe të huaja.

Që nga paslufta përkujdesje për trashëgiminë materiale dhe atë jomateriale po sa Kosova kanë treguar edhe organizatat e huaja ndërkombëtare që veprimtarojnë në Kosovë. Një prej objekteve të trashëgimisë materiale të Kosovës, për të cilin është treguar kujdes i veçantë, është "Mulliri i Nikës" i cili gjendet në fshatin



një nga objektet më të vjetra në Ferizaj. Pra, ka më shumë se 500 vjet. Sipas Shaban Kashtanjevës, babai i tij nuk e ka njohur Nikën, emrin e të cilit e mban mulliri. Sipas tij, nga ajo çfarë ka dëgjuar nga të tjerët, Nika ishte një njeri i

mbrojtjen e përkohshme të trashëgimisë kulturore si peizazh natyror. Mulliri është restauruar në vitin 2002/2003, me ç'rast



është bërë rindërtimi i shumë pjesëve të tij për ta ruajtur traditën e trevës së Ferizajt.

"Mulliri i Nikës", sipas rrëfimeve të disa prej banorëve të vjetër të Ferizajt, për nga fuqia e punës ishte mulliri i dytë në këtë vend pasi para tij ishte Mulliri i Madh i cili kishte gjashtë gurë për bluarje e që gjendet rreth 500 metra larg nga "Mulliri i Nikës".

Përpos këtyre dy mullinjve të mëdhenj, Ferizaj vite më parë

kishte edhe 52 mullinj të cilët ishin të ndërtuar që të gjithë pranë rrjedhës së Lumit Nerodime. Pjesa më e madhe tyre sot nuk ekziston. Më të vegjlit janë shkatërruar me kalimin e viteve, disa të tjerë nuk janë në gjendje të keqe, por s'është interesuar askush më për funksionimin e tyre pasi që mullinjtë elektrikë i kanë nxjerrë nga përdorimi mullinjtë me gurë të cilët sjellin të ardhura të vogla materiale.

As "Mulliri i Nikës" që gjashtë vjet më nuk është funksional pasi që i është ndalur rrjedha e lumit Nerodime që buron në bjeshkët e Jezercit. Megjithatë, ai është i hapur për vizitorë edhe në ditë të fundjavës.

Aziz Guri, një qytetar nga Ferizaj, tregon se sot nuk vihet në këtë mulliri për të bluar misër dhe grurë, por vihet për qejf, për të parë një monument që ka funksionuar moti dhe kohë të gjatë, si dhe për ta shijuar ushqimin tradicional të restorantit përbri mullirit.

"Mulliri i Nikës" është i ndërtuar nga materiali prej guri, realizim i mjeshtërve popullorë me përvojë, që ta përkujton teknikën e ndërtimit të kullave.

Mulliri para luftës ka punuar pa

ndërprerë me katër gurë me kapacitet të plotë. Vinin të bluanin në këtë mulliri banorë të qindra fshatrave të Ferizajt, Vitisë, Shtimes, Kaçanikut, nga e gjithë Kosova, thuajse. Sipas Gurit, mulliri ka pasur shumë punë dhe ka punuar natën dhe ditën. Me kalimin e kohës, ndër vite, është dëmtuar. Pastaj është rinovuar dhe tash, pas ndaljes së rrjedhës së ujit për funksionim, ka mbetur monument i rëndësishëm kulturor për vizitorët.

Guri tregon se, siç keni ardhur ju sot për ta vizituar dhe shkruar për të, ka pasur dhe ka mjaft interesim për ta vizituar objektin nga shumë qytetarë, të cilët vijnë bëjnë edhe fotografi me rastin e fejesës ose të martesës. Po ashtu, ai ka parë edhe shumë vizitorë shqiptarë që kanë



ardhur nga Perëndimi, edhe vizitorë të kombësive të të huaja. Brenda "Mullirit të Nikës" ka edhe gjësende të tjera të vjetra, si: magje, sofër, sitë, lugë, enë, bakej të drurit etj.

(Ky artikull është përgatitur në kuadër të projektit kulturor "Observimi i traditës", realizuar nga Qendra për Kulturë dhe Edukim "Sheshi", Prishtinë. Fusnotat i hoqi redaksia)



Nerodime, përkaj fenomenit të bifurkacionit, në vendin ku bëhet ndarja fizike e bifurkacionit në dy degë, njëra që shkon për lumin Sitnicë, duke vijuar rrjedhën në Ibër deri në Detin e Zi, tjetra që vazhdon në Lumin Lepenc, më tutje Vardar dhe përfundon në Detin Egje.

Sipas rrëfimeve të qytetarëve të Ferizajt dhe familjes Kashtanjeva e cila është pronare e mullirit, "Mulliri i Nikës" është ndërtuar në shekullin XVI, në kohën e Perandorisë Osmane dhe është

pasur, i cili, për shkak të një zënke me një tjetër, kishte shkuar në Turqi. Në këtë mulliri, që nga moshja 15 vjeçe e derisa ka ndërruar jetë, punonte babai i Shabanit, i cili pastaj është përkujdesur për mullirin. Ndër të tjera, Shabani ka njoftuar se mulliri ka punuar njëzet e katër orë, pa ndërprerë kurrë, sepse kishte kërkesa të mëdha për bluarje të misrit dhe të gruarit nga shumë qytetarë, të cilët pritnin dy javë kohë për ta kryer bluarjen. Për shkak të rëndësisë dhe të vjetërsisë së tij, mulliri është nën



'MULLIRI I NIKËS' TASH GJASHTË VJET VETËM MONUMENT KULTUROR



Trashëgimia kulturore është një temë shumë e rëndësishme në të gjitha vendet e botës. Për ruajtjen e saj përkujdesjen institucione, shoqata, biznese, dashamirë e kush jo tjetër që ka një pikëtakim shpirtëror ose një fije kujdesi për objektet e vjetra. Edhe trashëgimia kulturore e Kosovës është një temë mjaft me interes për t'u trajtuar në cilado medime dhe, po ashtu, mjaft me interes për t'u përkrahur nga institucione qendrore dhe lokale vendore dhe të huaja.

Që nga paslufta përkujdesje për trashëgiminë materiale dhe atë jomateriale po sa Kosova kanë treguar edhe organizatat e huaja ndërkombëtare që veprimtarojnë në Kosovë. Një prej objekteve të trashëgimisë materiale të Kosovës, për të cilin është treguar kujdes i veçantë, është "Mulliri i Nikës" i cili gjendet në fshatin Nerodime, përkaj fenomenit të bifurkacionit, në vendin ku bëhet ndarja fizike e bifurkacionit në dy degë, njëra që shkon për lumin Sitnicë, duke vijuar rrjedhën në Ibër deri në Detin e Zi, tjetra që vazhdon në Lumin Lepenc, më tutje Vardar dhe përfundon në Detin Egje. Sipas rrëfimeve të qytetarëve të Ferizajt dhe familjes Kashtanjeva e cila është pronare e mullirit, "Mulliri i Nikës" është ndërtuar në shekullin XVI, në kohën e Perandorisë Osmane dhe është një nga objektet më të vjetra në Ferizaj. Pra, ka më shumë se 500 vjet. Sipas Shaban Kashtanjevës,

babai i tij nuk e ka njohur Nikën, emrin e të cilit e mban mulliri. Sipas tij, nga ajo çfarë ka dëgjuar nga të tjerët, Nika ishte një njeri i pasur, i cili, për shkak të një zënke me një tjetër, kishte shkuar në Turqi. Në këtë mulli, që nga moshja 15 vjeçe e derisa ka ndërruar jetë, punonte babai i Shabanit, i cili pastaj është përkujdesur për mullirin. Ndër të tjera, Shabani ka njoftuar se mulliri ka punuar njëzet e katër orë, pa ndërprerë kurrë, sepse kishte kërkesa të mëdha për bluarje të misrit dhe të gruarit nga shumë qytetarë, të cilët pritinin dy javë kohë për ta kryer bluarjen.

Për shkak të rëndësisë dhe të vjetërsisë së tij, mulliri është nën mbrojtjen e përkohshme të trashëgimisë kulturore si peizazh natyror. Mulliri është restauruar në vitin 2002/2003, me ç'rast është bërë rindërtimi i shumë pjesëve të tij për ta ruajtur traditën e trevës së Ferizajt.

"Mulliri i Nikës", sipas rrëfimeve të disa prej banorëve të vjetër të Ferizajt, për nga fuqia e punës ishte mulliri i dytë në këtë vend pasi para tij ishte Mulliri i Madh i cili kishte gjashtë gurë për bluarje e që gjendet rreth 500 metra larg nga "Mulliri i Nikës". Përpos këtyre dy mullinjve të mëdhenj, Ferizaj vite më parë kishte edhe 52 mullinj të cilët ishin të ndërtuar që të gjithë pranë rrjedhës së Lumit Nerodime. Pjesa më e madhe tyre sot nuk ekziston. Më të vegjlit janë shkatërruar me

materiale.

As "Mulliri i Nikës" që gjashtë vjet më nuk është funksional pasi që i është ndaluar rrjedha e lumit Nerodime që buron në bjeshkët e Jezercit. Megjithatë, ai është i hapur për vizitorë edhe në ditë të fundjavës.

Aziz Guri, një qytetar nga Ferizaj, tregon se sot nuk vihet në këtë mulli për të bluar misër dhe grurë, por vihet për qejf, për të parë një monument që ka funksionuar moti dhe kohë të gjatë, si dhe për ta shijuar ushqimin tradicional të restorantit përbri mullirit.

"Mulliri i Nikës" është i ndërtuar nga materiali prej guri, realizim i mjeshtërive popullore me përvojë, që ta përkujton teknikën e ndërtimit të kullave.

Mulliri para luftës ka punuar pa ndërprerë me katër gurë me kapacitet të plotë. Vinin të bluanin në këtë mulli banorë të qindra fshatrave të Ferizajt, Vitisë, Shtimes, Kaçanikut, nga e

kalimin e viteve, disa të tjerë nuk janë në gjendje të keqe, por s'është interesuar askush më për funksionimin e tyre pasi që mullinj të elektrikë i kanë nxjerrë nga përdorimi mullinj të me gurë të cilët sjellin të ardhura të vogla



gjithë Kosova, thuajse. Sipas Gurit, mulliri ka pasur shumë punë dhe ka punuar natën dhe ditën. Me kalimin e kohës, ndër vite, është dëmtuar. Pastaj është rinovuar dhe tash, pas ndaljes së rrjedhës së ujit për funksionim, ka mbetur monument i rëndësishëm kulturor për vizitorët.

Guri tregon se, siç keni ardhur ju sot për ta vizituar dhe shkruar për të, ka pasur dhe ka mjaft interesim për ta vizituar objektin nga shumë qytetarë, të cilët vijnë bëjnë edhe fotografi me rastin e fejesës ose të martesës. Po ashtu, ai ka parë edhe shumë vizitorë shqiptarë që kanë ardhur nga Perëndimi, edhe vizitorë të kombësive të të huaja.

Brenda "Mullirit të Nikës" ka edhe gjësende të tjera të vjetra, si: magje, sofër, sitë, lugë, enë, bakej të drurit etj.

(Ky artikull është përgatitur në kuadër të projektit kulturor "Observimi i traditës", realizuar nga Qendra për Kulturë dhe Edukim "Sheshi", Prishtinë. Fusnotat i hoqi redaksia)





NË TYRBEN E ROGANËS, SKAJ 'LISIT TË KËSMETIT'



Para se të shkruajmë për tyrbe, siç është ajo e Roganës në këtë rast, është e udhës që të japim një shpjegim rreth konceptit të tyrbeve dhe rëndësisë së tyre për trashëgiminë tonë kulturore. Një shpjegim i tillë do t'i ndihmonte lexuesit për kuptimin e konceptit dhe të rëndësisë së tyre.

Trybja është një mauzole karakteristike në të cilën ndodhet një varr apo disa varre të personaliteteve të rëndësishme religjioze, shehlerëve e dervishëve apo njerëzve të shquar, të cilët në kujtesën dhe besimin e besimtarëve kanë bërë jetë të veçantë e të shenjtë. Varrat i është bërë tyrbe vetëm ndonjë shehu apo dervishi që shquhet për veprime të pazakonta e mrekullibërëse, që besimtarët i kanë cilësuar si "muxhize" (arab., mrekulli). Ka tyrbe ku është varrosur vetëm një i shenjtë, por ka edhe kur janë varrosur më shumë veta, zakonisht i shenjtëruari me ndonjë pjesëtar të

familjes së tij, në të shumtën e rasteve me gruan. Thuaje të gjitha tyrbet janë ndërtime të ulëta, formë e shtëpizave përdhës, në mes të secilës është varri i të veçantit, siç ngjet në tyrben e Roganës (Rogoçicës), që ndodhet në komunën e Kamenicës. Në një kthinë të tyrbeve lihet një hapësirë për ndezjen e qiririt nga ana e besimtarëve. Në të shumtën e rasteve është një dollap i zbrazët, në të cilën nevojtarit e ndez qiririn për shpirtin e të shenjtit (sipas tij) dhe lutet që t'i plotësohen dëshirat apo t'i hiqen shqetësimet që e mendojnë. Me t'u ndezur qiriri, nevojtarit bën një rrethrotullim rreth tyrbes, konkretisht rreth varrit të të shenjtit, duke u lutur për zgjedhjen e halleve dhe telasheve të tij.

Pra, tyrbet kanë rëndësi së pari religjioze e shpirtërore, pastaj kulturore dhe trashëgimore. Ato janë pjesë e pasur e trashëgimisë kulturore të Kosovës meqë me to evidentohet një prani e

trashëgimisë religjioze islame, me të cilën ka jetuar dhe jeton vendi ynë, gjë që i jep kolorit kulturor dhe fetar.

Tyrbja që ndodhet në fshatin Roganë të Komunës së Kamenicës është e veçantë dhe e rëndësishme për shumë njerëz e besimtarë për shkak se në të kryhen një sërë lutjesh dhe aktiviteteve. Me datën pesë të majit të çdo viti mbledhen me qindra e mijëra njerëz nga Kosova dhe shtetet përreth saj për të festuar Shën Gjergjin pagan dhe për t'u lutur për të tashmen dhe të ardhmen e tyre. Djemtë dhe vajzat e reja këtë ditë e marrin si ditë të natyrshme feste, pa ndonjë konotacion religjioz a pagan por, thjesht, si një mundësi takimesh e njohjesh rinore, ndërsa të moshuarit kanë më shumë interesime që të luten në tyrbe për begatinë e tyre familjare, përmirësimin shëndetësor, por edhe për gjetjen e fateve jetësore e martesore për djemtë, vajzat, nipat dhe mbesat e tyre.

Brenda kësaj tyrbeje është edhe një lis i madh shumëvjeçar i cili në popull njihet si "lisi i kësmetit" apo lisi i fatit, prekje e të cilit, marrja e një dege të shkurtër apo flete, besohet mund të të sjellë fat në dashuri. Kështu mendojnë dhe supozojnë ata që kanë besim dhe kanë predispozita pozitive në raport jo vetëm me ritet e lutjet që mund të kryhen në tyrbe, por ndaj çdo gjëje spirituale, jokonkrete dhe jomateriale. Besimi se tyrbja mund të sjellë shërim, begati e fat jetësor është shpirtëror dhe assesi nuk mund të interpretohet me predispozita të njohjes sonë materiale, shkencore dhe konkrete.

Tyrbja e Roganës (Rogoçicës) është pa pullaz, e pambuluar dhe nuk mund të mbulohet pikërisht për shkak të lisit të fatit, "lisi të kësmetit" që ndodhet brenda saj. Ajo menaxhohet nga familja Kallaba, e cila kujdeset për të, për pastërtinë e saj dhe për gjërat që kanë të bëjnë me objektin e tyrbes.

Nuk dihet saktë se kur është ndërtuar tyrbja e Roganës, edhe pse ka mendime se ajo është e shekullit XVIII, kur edhe është dëgjuar për herë të parë legjenda për shehun e vrarë në luftë. Legjenda thotë se një sheh ishte vrarë në një luftë dhe ai, me kokën bartur nën sqetull, kishte fluturuar dhe kishte rënë mu në vendin ku është tyrbja, që ishte edhe vendlindja e tij, vendi i tij i origjinës. Kjo është një legjendë mistike lidhur me ndërtimin e kësaj tyrbeje, por që ka kuptimin e kërkimit të vendlindjes, origjinës nga qenia njerëzore. Njeriu edhe i vdekur e kërkon vendin e origjinës, sepse dëshiron të varroset në të dhe nuk do të shkëputet nga rrënja e tij.

(Ky artikull është përgatitur në kuadër të projektit kulturor "Observimi i traditës", realizuar nga Qendra për Kulturë dhe Edukim "Sheshi", Prishtinë. Fusnotat i hoqi redaksia)



NË SHTËPINË E PREFEKTIT TË MITROVICËS, XHAFER DEVA

Shtëpia e veprimtarit të rëndësishëm politik dhe atdhetarit shqiptar të shekullit të kaluar, Xhafer Devës, gjendet në qendër të qytetit të Mitrovicës, në pjesën jugore të këtij qyteti, ku ka qenë edhe pjesa e vjetër e këtij qyteti.

Është një shtëpi që edhe sot duket e bukur pavarësisht prej shndërrimeve të njëpasnjëshme që ia kanë bërë valët e kohës, që e tjetërsuan objektin për nevoja të ndryshme të pushteteve dhe administratave të vendosura në Kosovë dhe qytetin e Mitrovicës. Kjo shtëpi u ndërtua në vitin 1930 si një shtëpi banimi për familjen e madhe të Xhafer Devës. Ai ishte një nga personalitetet më të rëndësishme të kohës, një atdhetar dhe një antikomunist i paepur. Ai ka mbajtur pozita të rëndësishme shoqërore para Luftës së Dytë Botërore, kur edhe ishte për një kohë prefekt i Mitrovicës, ndërsa në vitet 1943 dhe 1944 ishte ministër i Brendshëm në qeverinë shqiptare të kohës. Ishte një nga një eksponentët kryesorë të forcave djathtiste e nacionale shqiptare gjatë gjysmës së parë të shekullit XX. Pas përfundimit të luftës së sipërcekur, Xhafer Deva ishte në shënjestër të komunistëve jugosllavë, andaj emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku edhe vdiq në vitin 1978. Xhafer Deva vlerësohet për konsistencë të politikave të djathta nacionale, si dhe për korrektësi në raport me hebrenjtë, të cilëve u doli në mbrojtje, përkundër që qeveria shqiptare e kohës, ku ai ishte ministër, kishte një bashkëpunim të mirë me nazistët.

Shtëpia e Xhafer Devës është një nga pikat më të veçanta e më të rëndësishme të qytetit të Mitrovicës, gjë që na jep shenjë se para Luftës së Dytë Botërore në këtë qytet ishin të përqendruara

elitave më të rëndësishme politike dhe kulturore të vendit. Kjo shtëpi ka një arkitekturë moderne dhe ndërtimi i saj shënjon kalimin nga arkitektura me karakteristika orientale në arkitekturën me karakteristika oksidentale, perëndimore. Stili i saj ngjan në ndërtimet sipas modelit të arkitekturës që cilësohet austro-hungareze. Një objekt i tillë në qytetin e Mitrovicës ishte edhe ish-hotel "Adriatiku", që është goxha i ngjashëm për nga modeli i ndërtimit me ish-hotel "Unionin" në Prishtinë. Të dyja objektet të lartpërmendura të trashëgimisë arkitektonike austro-hungareze u është ndërruar veprimtaria dhe sot funksionojnë për diçka tjetër. Ndërkaq, shtëpia e Xhafer Devës ende ka mbetur si shtëpi monumentale, si monument kulturor, përkundër shumë përpjekjeve që edhe asaj t'i ndërrohet veprimtaria. Ndoshta edhe kjo do të ketë qenë arsyeja e mundshme e djegies së saj në vitin 2015, në mënyrë që veprimtaria dhe pasmja e saj të jetë më lehtë e pranueshme. Por, fatmirësisht, dëmet e djegies së saj janë sanuar dhe falë dashamirësisë së njerëzve që kanë vullnet të mirë dhe kujtesë historike dhe kulturore, shtëpia e personalitetit tij ka mbetur ende monument kulturor.

Prania e një shtëpie të tillë, të madhe e me përkatësi arkitekturore evropiane, tregon për një orientim perëndimor të elitave tona kulturore dhe politike pas viteve '30 të shekullit të kaluar. Po ashtu, tregon edhe për një aristokraci të spikatur në kuptimin e vërtetë të fjalës, e cila ishte krijuar në gjysmën e parë të këtij shekulli, që me ardhjen e komunizmit jugosllav, një aristokraci e formësuar tashmë u shthur dhe kulturalisht në këtë plan vendi zbriti në pikën zero.



Në pikën ku nuk i kishte më shtyllat, familjet e mëdha dhe personalitetet e rëndësishme që e mbanin mbi supe trajektoren e zhvillimit të vendit tonë.

Shtëpia e Xhafer Devës në Mitrovicë është simbol i një të kaluarë kulturore e historike të Kosovës që nuk bën të harrohet. Simbol i një kohe që është mirë të kujtohet për t'iu rrëfyer brezave të tashëm dhe të ardhshëm që politikën që synojnë fillimin e historisë nga pika zero vetëm dëme mund t'i bëjnë atdheut. Shtëpia e Xhafer Devës është një ndërtim masiv, e ndërtuar me

tulla argjile dhe materiale druri e guri, ndërsa mbulesa e saj është me qeremide. Gjatë nëntorit të këtij viti (2020), kur e vizituam këtë shtëpi, ajo shtëpi ishte duke u restauruar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe shpresojmë që një gjë të përfundojë sa më shpejt, në mënyrë që ajo të hapet për vizitorët e shumtë dhe kureshtarë për të kaluarën tonë historike, politike dhe kulturore. MKRS-ja dhe Komuna e Mitrovicës së Jugut duhet të kenë një interesim të shtuar për këtë shtëpi, duke e vendosur në të një

udhëzues të dijshtëm që do të dijë t'ua shpjegojë atyre rëndësinë e madhe të kësaj shtëpie për të kaluarën e Kosovës. Po ashtu, duhet të sensibilizohet në media dhe opinion rëndësia e saj, në mënyrë që të nxiten vizitorë që përmes një vizite të mundshme, të mësojnë më shumë për të kaluarën e vendit tonë.

(Ky artikull është përgatitur në kuadër të projektit kulturor "Observimi i traditës", realizuar nga Qendra për Kulturë dhe Edukim "Sheshi", Prishtinë. Fusnotat i hoqi redaksia)





XHAMIA E MAZHIQIT NË MITROVICË, SOT GËRMADHË



Në kilometrin e trembëdhjetë në dalje të qytetit të Mitrovicës, në fshatin Mazhiq, përkaj rrugës, në krahun e djathtë, mund t'i shohim rrënojat e një xhamie të vjetër, e cila quhet xhamia e Mazhiqit. Është objekt i vjetër kulti, i ndërtuar në shekullin XVI (gjashtëmbëdhjetë), konkretisht në vitin 1549, pra në fund të gjysmës së parë të këtij shekulli.

Objekti i mbetur i kësaj xhamie është zyrtarisht nën mbrojtje në

së Bajgorës dhe ka një rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore islame në vendin tonë. Vlera e saj është tek arkitektura e veçantë orientale dhe te varrezat e vjetra dhe mbishkrimet e vjetra në gurët e varreve në oborrin e xhamisë. Nëse nuk do të ketë përkujdesje më të madhe nga institucionet komunale dhe shtetërore në të ardhmen, do të jetë shumë i vështirë deshifrimi i mbishkrimeve në gurë, meqë me

mund ta njohin terrenin e Mitrovicës dhe të Shalës së Bajgorës. Kjo përkujdesje është e udhës të bëhet për shkak të krijimit të mundësive më të përshtatshme për t'u vizituar kjo xhami e vjetër nga vizitorët e ndryshëm, veçmas nga ata vizitorë që mund të cilësohen si turistë me interesime religjioze, të cilët mund të jenë



përhapur në një masë të madhe te popullsia vendëse. Ndërtimi i një xhamie të tillë, që është cilësuar edhe si xhamia e Trepçës, ka shërbyer për banorët vendës, tashmë të islamizuar, për kryerjen e riteve fetare islame. Në bazë të arkitekturës së saj, shihet se ajo do të ketë qenë një xhami e rëndësishme për zonën e Mitrovicës dhe të Shalës së Bajgorës. Kjo xhami do të ketë qenë një qendër e rëndësishme

në rrënim e sipër. Andaj, konservimi i saj është i nevojshëm. Sipas të dhënave, xhamia e Mazhiqit është ndërtuar nga arkitekti turk Muslihuddin Abdu'l-Gani në vitin 1549 sipas kalendarit që e njohim sot, ndërsa sipas kalendarit islam, kalendarit të hixhrit, është ndërtuar në vitin 956. I njëjti arkitekt thuhet se ka ndërtuar Kurshumli Hanin, Shëngyl Hamamin dhe Mesxhitin, si dhe një han që supozohet se do



listën e monumenteve të mbrojtura por, realisht, është pa përkujdesje institucionale. Njeriu, në anën e epërme të rrugës, e ka të vështirë të hyjë në të. Në anën e poshtme të saj, hyn kushdo. Por, nëse dëshironi ta vizitoni duhet të gjendeni disa, të rrëshqisni paksa, ose t'i kapërceni gardhet e saj me thera dhe me gurë rreth këtij monumenti, i cili që nga viti 2012 është përcaktuar si monument i kulturës në Kosovë.

Xhamia e Mazhiqit llogaritet një ndër xhamitë më të vjetra në rajonin e Mitrovicës dhe të Shalës

kalimin e kohës po zbehet pamja e tyre.

Ky objekt ka nevojë për një konservim dhe kujdes të shtuar institucional. Përpos hapjes së një dere, një shtegu, ka nevojë edhe për vendosje të mbishkrimeve rreth një historiku të shkurtër të xhamisë që mungon në muret apo në hyrje të objektit. Po ashtu, ka nevojë për sinjalizues, për të treguar se ku ndodhet saktësisht kjo xhami, për shkak se është tejet e vështirë të gjendet, po qe se nuk e njeh mirë terrenin. Dhe jo të gjithë të interesuarit dhe kureshtarët

kureshtarë për objekte të vjetra kulti dhe religjioni. Vendi ynë do të ishte mirë që t'i promovonte të gjitha mënyrat dhe format e turizmit kulturor, andaj edhe turizmi religjioz gjithsesi se bën pjesë në këtë dimension.

Xhamia e Mazhiqit, që ndodhet në fshatin me të njëjtin emër, në afërsi të Mitrovicës, i takon shekullit XVI, pra kohës kur Kosova ishte pjesë e Perandorisë Otomane dhe feja islame ishte

religjioze islame. Ajo është e ndërtuar me gurë dhe tulla dhe me një bazë gurore. I takon arkitekturës otomane të ndërtimit të xhamive, ku spikasin kupolat dhe shkallët për t'u ngjitur në minare për ta thirrur ezanin. Shkallët kanë mbetur ende në këmbë, ndërsa kupolat jo. Më shumë ngjan në një rrënojë sesa në një objekt i mirëmbajtur i trashëgimisë kulturore islame në Kosovë. Ka mbetur në këmbë vetëm pjesa ballore dhe muret anësore, ndërsa pjesa tjetër është

të ketë qenë i ndërtuar në afërsi të xhamisë së Mazhiqit.

Respekti dhe kujdesi ndaj vlerave trashëgimore religjioze, pavarësisht se cilit religjion i takojnë, e ndihmon diversitetin kulturor të qytetarëve të Kosovës.

(Ky artikull është përgatitur në kuadër të projektit kulturor "Observimi i traditës", realizuar nga Qendra për Kulturë dhe Edukim "Sheshi", Prishtinë. Fusnotat në artikull i hoqi redaksia).





KULLA E MULLA ADEMIT NË KEQEKOLLË, NË PRAG TË SHKATËRRIMIT TË TËRËSISHËM

Keqekolla është fshat në Komunën e Prishtinës dhe në rajonin malor të Gollakut, i cili shquhet për bukuri të rrallë e të virgjër. Fshatrat e këtij rajoni, edhe Keqekolla, janë duke u braktisur nga banorët për shkak të kushteve të rënda ekonomike dhe infrastrukturës së duhur për një jetë më të mirë në këtë fshat.

Të interesuarit për trashëgiminë tonë kulturore dhe kombëtare, për historinë dhe për personalitetet e rëndësishme të popullit shqiptar ndër shekuj, në këtë fshat mund ta gjejnë, ende në këmbë, vetëm se të dëmtuar shumë, shtëpinë apo kullën e Adem Keqekollës, i njohur edhe si mulla Ademi i Keqekollës, një figure mjaft të rëndësishme të fillimshkullit XX, por pak të njohur nga publiku e shumë pak të studiuar nga historianët e popullit shqiptar.

Adem Keqekolla është figurë mjaft e veçantë dhe mjaft interesante për t'u njohur dhe për të hartuar monografi për të. Ishte prijës i rëndësishëm fetar dhe politik në dy dekadat e para të shekullit njëzetë. Mulla Ademi i Keqekollës ishte edhe luftëtar i denjë, ishte edhe pjesë e elitës shoqërore të kohës. Ishte kundërshtar i xhonturqve në



fund të shekullit XIX si dhe kundërshtar i rreptë i pushtimit të mbretërisë serbo-kroate-slovene në fillim të shekullit XX. Për shkak të aktivitetit të tij atdhetar, Adem Keqekolla ishte vazhdimisht i përndjekur nga të dy pushtuesit, ai otoman e ai i sllavëve të jugut, veçanërisht nga ky i fundit, ku u përndoq gjerë në vdekje. Në vitin 1921 ai u vra në oborrin e shtëpisë, së bashku me trembëdhjetë anëtarë të familjes, gjatë një aksioni të

xhandarmërisë së mbretërisë së sllavëve të jugut. Thuhet se mbi të dhe familjarët u ushtrua terror i paparë, që kulmoi me një masakër të të afërmeve të pafajshëm të Adem Keqekollës. Kulla e Adem Keqekollës në fshatin Keqekollë të Gollakut ka një ndërtim atipik krahasuar me shtëpitë dhe kasollet e kohës. Një gjë vihet re te mënyra e ndërtimit dhe afishimi i simbolikave në hyrje të shtëpisë së tij. Një mënyrë e ndërtimit, një

arkitekturë që tregon se në të ka jetuar një familje e kamur, një familje aristokratike, marrë parasysh që ajo figuron të jetë e ndërtuar në vitin 1804, pra qysh në fillim të shekullit XIX. Nisur nga kjo datë e ndërtimit të kullës, mund të theksojmë se familja e Adem Keqekollës ka qenë e rëndësishme e me reputacion për kohën edhe gjatë shekullit XVIII, veçmas gjatë gjysmës së dytë së këtij shekulli.

Në hyrje të kullës dhe në pjesët e saj anësore shohim simbolika të ndryshme që mund të interpretohen si shenja me kuptime religjioze dhe nacionale. Shohim simbolin e gjysmëhënës, ylli të Davidit dhe gjarprit (gjarprit të shtëpisë) etj. Ballkonet dhe frëngjitë e kësaj kulle janë atipike në krahasim me shtëpitë e kasollet e ndërtuara gjatë kohës kur zuri fill ndërtimi i kullës së këtij njeriu të veçantë, por pak të njohur prej nesh. Kulla është e ndërtuar me material të gurit, llaçit dhe drurit.

Në ditët e sotme kjo kullë është dëmtuar pothuajse tërësisht. Muret e brendshme janë të rrëzuara, shumica e trarëve thuajse kanë rënë dhe atë e mbajnë në këmbë vetëm themelet e forta dhe muret e

jashtme, veçmas ato ballore. Një gjendje e tillë e saj mund ta rrezikojë për vdekje secilin vizitor e të interesuar për historinë dhe rëndësinë e figurës së Adem Keqekollës, meqë po të hyjë brenda dhe të shkelë në katin e epërm, mund të bie poshtë dhe së bashku me trarët e kalbur. Andaj, sa më shpejt duhet intervenim nga ana e institucioneve tona publike që kanë për obligim ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore materiale dhe shpirtërore. Kulla e Adem Keqekollës në Keqekollë, që të mbetet në këmbë edhe më tutje, ka nevojë të domosdoshme për konservim dhe restaurim. Po qe se në të nuk shtrijnë shpejt dorën e ndërhyrjes institucionet, në bashkëpunim me ekspertët e trashëgimisë kulturore, kulla e Adem Keqekollës brenda tri-katër vjetëve mund të shembët krejtësisht, pasi që reshjet atmosferike, shiu dhe bora, edhe faktori njeri, mund ta dëmtojnë edhe më tutje.

(Ky artikull është përgatitur në kuadër të projektit kulturor "Observimi i traditës", realizuar nga Qendra për Kulturë dhe Edukim "Sheshi", Prishtinë. Fusnotat i hoqi redaksia)





PËRSKAJ VARRIT MË TË THELLË NË BOTË, SHPELLËS SË AZEM GALICËS

Në magjistralen Prishtinë – Pejë, po qe se nisesh nga Prishtina, në kilometrin e 50 në drejtim të Pejës, në anën e majtë të rrugës para syve të shfaqen pllakate të mëdha të metalit, të veshura me mbishkrime të dëmtuara nga rrezet e diellit, nga shiu dhe nga bora. Zënë vend në secilën prej tyre ngjyra e kuqe me të zezën. Njëra pllakate ka të shkruar “Olympi i Kosovës”, një tjetër “Azem Galica (Shpella)”, kurse një tjetër përkaj saj “Azem Galica Shpella Granit i shekujve”. Asnjë tabelë për orientim për të “varri” më i thellë në botë nuk gjen aty. Prandaj, po nuk qëlloni atypari ndonjë banor i Gllarevës ose i Përçevës duke nxjerrë gurë, nuk di kah të shkojë njeriu për të shpellëvarri i Azem Galicës. Kështu që, po nuk qe askush aty, duhet të presësh aty derisa të vijë ndonjë banor që di për vendndodhjen e shpellës në të cilin më 1924 qe hedhur trupi i veprimtarit Azem Galica. Për ta vizituar këtë shpellë ne pritëm aty rreth njëzet minuta derisa erdhi një gumxjerrës dhe gurgdhendës, i cili e kishte mbushur rimorkionin e traktorit përplot gurë dhe na tha: “Shkoni drejt, kah kjo rrugë e pashtruar, rreth dy kilometra. Sapo ta shihni një lis të madh, ndaluni aty, se aty është shpella e Azemit”. U nisëm, si e quajti ai, drejt “shpellës së Azemit”, me shpresë se do ta gjejmë lirin, pastaj shpellën. Bëmë rreth dy kilometra rrugë pa parë askund shenjë orientuese për të shpella e tij. Ec e ec, më në fund na shohin sytë një lis jo aq të madh dhe jo aq shumë të dallueshëm nga të tjerët. Megjithatë, dallon pak prej atyre që ka përreth. Rruga për të lisi, nën rrënjët e të cilit është shpella, s’është e shënjuar me asnjë gjë. Duhet të shkelësh drurë me këmbë e të shtysh rema me duar për të shkuar deri te shpella e tij, e cila, kur të shfaqet, të shfaqet e befasishme, si kur të takohesh me ndonjë ari ose ujë në pyll. Pra, është shpellë e rrezikshme sepse është e pavërejtur, e parrethuar me asgjë, përpos me rrënjë dhe dushk. Po bëtë me të voglin gabim, mund të rrëshqisni dhe të fundoseni në brendinë e saj të thellë 73 metra. Prandaj, kini kujdes ku shkelni dhe nga ç’rrem dhe ç’rrënjë kapeni aty. Sa je pranë saj të shtohet interesimi për historinë e saj, për ndodhinë e hedhjes së trupit të Azem Bejtës në të. Por, për historinë e kësaj shpelle dinë pak banorët e fshatit. Dinë, po kaq pak, se kush i ka hedhur eshtrat e Azem Galicës në të dhe kush i ka nxjerrë. Secili prej tyre flet me “më duket se...” Prandaj, ngjarjet rreth saj dhe për të duhet t’i kërkosh në libra historikë dhe në gazeta, të cilët dhe të cilat, po ashtu, kanë shumë pak të dhëna për shpellën e Azemit. Megjithatë, duke shfletuar libra dhe gazeta, duke lexuar studime dhe intervista të dëshmitarëve, gjen të dhënën se ky vend i shpellës quhet “Çuku që kërcet”, se gjendet në malet e fshatit Përçevë të Klinës. Sipas hulumtimeve vendore dhe botërore, për shkak se në të ishte hedhur një kufomë, ai u bë varri më i thellë në botë, i cili për 47 vjet mbajti brenda vetes, nën betimin e bashkëlufëtareve të Azem Bejtës

dhe të banorëve të Përçevës, eshtrat e tij. Një ish-kryetar i Komunës së Klinës, Osman Krasniqi, kishte dijeni për ruajtjen e fshehtësisë së varrimit të trupit të Azemit dhe kishte qëllim të rivarrimit të eshtrave të tij në Galicë. Për këtë arsye, pra për nxjerrjen dhe varrimin e eshtrave të Azemit nga shpella, Osman Krasniqi kishte biseduar disa herë edhe me dajë Kadri Imerin, bashkëlufëtar i Azem Bejtës. Dhe, sa Osman Krasniqi ishte kryetar i Komunës së Klinës, njerëzit e aksionit për nxjerrjen e eshtrave të Azemit kishin besim tek Osmani për shkak të rrethanave të krijuara nga puna e mirë e tij në Klinë dhe rrethinë. Prandaj, me insistimin e tij, nga Drejtoria e Mbrojtjes Popullore dhe kryeshefi Hysen Krasniqi u morën masat për hyrje në shpellë. Më 22 deri më 28 maj 1971 ishte ngritur kampi për t’u lëshuar me konop me çikrik në këtë shpellë. Cenë Gashi nga fshati Përçevë, tash i ndjerë, në fejttonin e publikuar në vitin 2003 kujton: “Aty më kanë ardhur në ndihmë disa të rinj, bashkëfshatarë të mi. Filluan të më lëshojnë në shpellë. Me ndihmën e tyre mbërrita te vendi i eshtrave të Azemit. Aty pashë mbeturina dhe zall të imët. U kërkova të më tërhiqnin me litar. Kur dola u thashë burrave se në shpellë duhet të hyjnë dy veta. Po ashtu, u tregova se kam arritur te vendi ku janë eshtrat e Azemit, por duhet të hiqet një pjesë e mbeturinave që të nxirren eshtrat e tij. U thashë se nëse nuk do të më ndihmonte askush prej tyre, do ta merrja vajzën time që sapo i kishte mbushur katër vjet, e cila do të ma mbante llambën e karbitit, kurse gropimin deri te eshtrat e Azemit do ta bëja vetë. Por, vendosëm që unë dhe Avdyl Krasniqi të lëshoheshim në shpellë. Avdyl ma mbante llambën e karbitit. Pasi i hoqa zallin dhe mbeturinat, i gjeta eshtrat e Azem Galicës dhe i mbështolla në çarçaf të bardhë. Kur e gjeta kafkën e Azemit e mbështolla me plisin tim të bardhë me qëllim që të mos shkapërderdhej dhe, bashkë me Avdyl Krasniqin, i nxorëm mbi sipërfaqe të shpellës, me ndihmën e djemve jashtë, të cilët me çikrik e ngrehnin litarin me të cilin ishim lidhur unë dhe Avdyl. Në sipërfaqe të shpellës ishin tubuar rreth 30 bashkëfshatarë edhe të fshatrave përreth. Me çikrik na kanë nxjerrë nga shpella Zymer Hyseni, Islam Shabani, Sefer Zeqiri etj. Pasi dolëm prej saj eshtrat e Azemit i vendosëm në një sënduk të ushtrisë, pastaj në një dollap të odës sime i kam ruajtur edhe me pushkë në dorë, sepse kështu e kishte lënë amanet Azemi”. Këta eshtra Cenë Gashi i ka ruajtur në kullën e vet çdo ditë dhe natë. Për këtë akt ishte informuar edhe kryetari i atëhershëm i Komunës së Klinës, Osman Krasniqi, i cili qe angazhuar të kontaktohte me drejtuesit e atëhershëm politikë të Kosovës dhe me insistimin e tij, duke marrë përgjegjësinë për rivarrimin e eshtrave, ishte arritur pëlqimi që eshtrat e Azemit të varroseshin pa u bërë zhurmë politike. Osman Krasniqi dha kontribut të madh për rivarrimin e eshtrave të



Azem Bejtës në maj të vitit 1971. Ai e dinte mirë kush ishte heroi ynë kombëtar, andaj tri ditë dhe net nuk pushoi së punuari që eshtrat e Azem Galicës të mos hidheshin përsëri në shpellë, siç kishte urdhëruar Veli Deva. Osmani mori tërë përgjegjësinë dhe ia doli që rivarrimi i eshtrave të heroit kombëtar të bëhej në fshatin e tij të lindjes, në Galicë. Pas tri ditësh e netësh punë me drejtuesit e komunave Skenderaj, Vushtrri dhe me vajzën e Azemit, Azeminën, u pajtuan për rivarrimin e eshtrave të Azemit më 28 maj të vitit 1971, me nderime, siç e meritonte. Edhe pse ky veprim ishte në kundërshtim me politikën e atëhershme, Osmani ishte i vendosur të organizohej një rivarrim solemn i eshtrave të Azem Galicës. Me mençurinë dhe largpamësinë e tij e me qëllim që të ngadhënjente mbi kundërshtarët politikë dhe mbi nacionalët serbë, ai propozoi që rivarrimi i tij të bëhej nën përkujdesjen e Lidhjes Socialiste të Komunës së Klinës, kryetar i së cilës ishte shovinisti serb Bozho Gariqi. Në krye të këshillit për rivarrim, pavarësisht prej dëshirës së tij, u zgjodh Bozho Gariqi ngaqë, sipas pozitës që kishte, duhej të zgjidhej ai. Madje ai u angazhua të fliste në fshatin Galicë për historinë e heroit Azem Galica. Ky organizim i rivarrimit i befasoi shumë edhe pjesëmarrësit e rivarrimit në fshatin Galicë, që ishin të shumtë nga Komuna e Klinës, e Skenderajt, e Vushtrisë e më gjerë. Pasi u nxorën eshtrat dhe u vendosën në vend të sigurt, në arkën e odës së Cenë Gashit, u nisën lajmëtarët për në Galicë. Vendlindja e këtij trimi këtë sihariq e priti me gëzim. I madh dhe i vogël u çuan në këmbë për ta pritur të birin e tyre, i cili, pas 47-vjetësh po kthehej në vendlindje për t’u prehur, aty ku kishte lindur. Galicasit e thërrasin kuvendin dhe vendosin që rivarrimi i eshtrave të bëhet në vendin ku ishte zhvilluar beteja e fundit, aty ku trimi e kishte kullën. Po atë natë në Komunën e Vushtrisë, Klinës dhe Skenderajt ishte formuar komisioni për bartjen e eshtrave. Në Prishtinë ishte dhënë paralajmërimi se sa më shpejt duhet bërë rivarrimi sepse ka lajme që eshtrat e tij të dërgohen në Beograd për ekspertizë mjekësore. Të nesërmen, në orën 7.00, me automobilin e Komunës së Vushtrisë janë nisur për në Përçevë, pos kryetar Osman Krasniqi, aktorëve të nxjerrjes së eshtrave, komisionit komunal për rivarrim dhe shumë qytetarëve nga Klina. Këta qytetarë i ka shoqëruar edhe makina e policisë (vetë komandanti me dy policë) nga

Klina, për në Përçevë dhe në kortezhin e rivarrimit në Galicë. Në malin e Përçevës, te shpella “Çuku që kërcet”, ishte rregulluar vendi si për dasmë. Ishte pastruar terreni përreth shpellës, ishin prerë shkurret dhe ishin shtruar qilima dhe sixhade. Rreth 50 burra kishin dalë në pritje. Pas një ceremonie të shkurtër të gjithë janë nisur për në shtëpinë e Cenë Gashit në Përçevë. Këtë borxh kishin klinasit sepse këndeji pari luftoi Azemi, vdiq dhe u varros. Kjo anë e ruajti me fshehtësi të madhe varrin shpellë të tij. Te dera e kullës, ku ruheshin eshtrat, bënë rojë dy burra të armatosur. Eshtrat i kishin futur në një arkë prej druri, kurse arkën e kishin futur në dollap, mbyllur me dyer. Edhe në shtëpinë e Cenës është bërë një ceremoni e shkurtër pastaj, pasi janë marrë prej aty, i kanë nisur për Galicë. Rrugës për në Galicë kalvarit vazhdimisht i bashkëngjiteshin njerëz. Erdhën njerëz nga Klina, Prishtina, Glogoci, Vushtrria, Mitrovica e nga Skenderaj. Në Galicë, edhe pse nuk ishte lajmëruar si duhet, po grumbulloheshin njerëz. Varri ishte hapur. Njerëzit po prisnin në heshtje. Ishte një varrim i pazakonshëm. Po rivarroset biri më i madh i tyre, heroi i Drenicës, i Kosovës dhe i mbarë Shqiptarisë, kryekomandanti i çetave kryengritëse të viteve 1915-1924. Po rivarroset Azem Bejtë Galica. Herën e parë ishte varrosur nga 4-5 veta në varrin shpellë të thellë 73 metra. Për gjetjen e shpellës e për varrimin e Azemit ndihmuan Halim e Hamit Ngucati nga Përçeva të cilët siguruan edhe jorganë për mbështjelljen e kufomës. Halimi ishte në mesin e katër shokëve që, bashkë me Shotën, kishin lëshuar kufomën e Azemit në shpellë. Pas hedhjes së kufomës, në shpellë qe hedhur një dru për çështje sigurie. Pas vdekjes së Azemit, me Shotën në Shqipëri shkoi edhe Halim Ngucati, të cilin e vranë partizanët në fund të vitit 1944. Ky kishte ikur 20 vjet nga Jugosllavia e vjetër, por e vrau Jugosllavia “e re”! Hamiti, edhe pse mori rafalë plumbash, po vdiste duke qeshur. Por, për t’ia ndalë buzëqeshjen, shtënë për së dyti dhe për së afërmi në të, thonë dëshmitarët që panë këtë krim. Shumica e njerëzve, qindra mijëra veta, kishin dalë të sheherorja e magnezitit, pranë zyrës së vendit dhe po e prisnin delegacionin me eshtrat e Azemit. Dikur pasdite delegacioni arriti. Brenda në zyrë u bënë përgatitjet e nevojshme. Aty ishin edhe mjekët Fevzi Dërvari dhe mjeku nga Prespa, Sako Sakoja, drejtor i atëhershëm i Shtëpisë së

Shëndetit në Vushtrri. Pasi u nxorën eshtrat nga arka, u radhitën nga mjekët e lartpërmendur në arkivolin e ndërtuar nga punëtorët e NP “Kosova” dhe i njëjti u mbulua me flamurin kombëtar. Prej aty arkivoli u bart në duar të njerëzve, sipas zakonisht, deri në Galicë. Pas tij shkonte kortezhi i gjatë i njerëzve, i mësuesve dhe i nxënësve. Te varri prisnin të tjerët. Aty kishin ardhur edhe bashkëlufëtaret të Azem Galicës. Ata derdhën edhe disa pika loti. Pasi u kryen ceremonitë dhe ritet e zakonshme, u bë rivarrimi i eshtrave. Pra, më 28 maj 1971, në orën 18.30, u rivarrosën eshtrat e Azem Bejtë Galicës, aty ku e kishte zhvilluar betejën e fundit, epopenë e lavdishme, më 15 korrik 1924. Propozim për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtorinë e Kulturës të Komunës së Klinës: Shpella, e quajtur “Azem Galica”, duhet të shndërrohet në atraksion turistik për vizitorë vendorë dhe të huaj e të mos mbetet vetëm objekt për hulumtim nga historianë, antropologë, etnologë, filologë etj. Prandaj, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, duhet të bëjë investime atje, duke bërë shtrimin e rrugës me zhavorr dhe me rërë deri te shpella, e gjatë rreth dy kilometra, ta shënjorë rrugën deri te shpella, ta rrethojë shpellën me gardh metalik dhe të vendosë përkaj saj shenja të kujdesit për qytetarë pasi që, meqë është e fshehtë, përbën rrezik për vizitorët.

PËR TË DHËNA TË TJERA:

Asllan Krasniqi, Klina me rrethinë në valët e historisë,
<http://www.zemrashqiptare.net/news/5129/adem-berisha-klina-me-rrethine-ne-valet-e-historise-i.html?keyword=a> (shikuar më datë 09.10.2020)
Asllan Krasniqi, Qëndresa shqiptare dhe terrori serb, Azem Bejta në Përçevë, “Bashkimi”, Prishtinë, 1991
Asllan Krasniqi, Kujtime, dorëshkrim
Asllan Krasniqi, Reshit Gashi, Met H. Durmishi: (monografi në 79-vjetorin e lindjes), “Koliqi”, Prishtinë, 2019
Bedri Tahiri, Azem Bejtë Galica, pjesa e tretë, në 85-vjetorin e betejës së fundit të Azem Bejtë Galicës, publikuar më 6 korrik 2009;
<http://www.albaniapress.com/lajme/9345/AZEM-BEJTE-GALICA-PJESA-III-.html> (shikuar më datë 09.10.2020)
Cen Gashi, pas 32 vjetëve, trëfen se si i ka zbuluar eshtrat e trimit legjendar Azem Bejtë Galicës: Që në moshën 11-vjeçare më ishte ngulitur në kokë se unë do t’i nxjerrja nga shpella eshtrat e Azemit, “Bota sot”, 2 mars 2003, fejttoni 3
Deklaratë e Osman Krasniqit, Klinë, dhjetor 2000
Gani Morina, Kur dhe si e kam njohur Osman Krasniqin, dorëshkrim, Klinë, 2012
Kujtime nga Islam dhe Osman Krasniqi dhënë Asllan Krasniqit dhe Reshit Gashit, dhjetor 2000
Kujtime të Beqir Qupevës dhënë Asllan Krasniqit dhe Reshit Gashit më 05. 07. 2017
Cen Gashi, Vendosa që eshtrat e Azemit t’i mbroja edhe me pushkë që të mos binin në duar të shkive, “Bota sot”, 3 mars 2003, fejttoni 4

(Ky artikull është përgatitur në kuadër të projektit kulturor “Observimi i traditës”, realizuar nga Qendra për Kulturë dhe Edukim “Sheshi”, Prishtinë).



KISHA E SAKSONËVE NË MITROVICË, PARA SHKATËRRIMIT

Ndodhja e një kishe katolike mesjetare sase (saksonë) në Kosovë, për shumë qytetarë të Kosovës, është pak e imagjinueshme. T'i thuash dikujt se në shekullin XIII, para më shumë se shtatëqind vjetëve, në Kosovë kishte gjermanë (saksonë) që ishin minatorë të zotë dhe kishin ardhur të punonin dhe të jetonin këtu, veçmas në pjesët përkrah minierave, është si t'u lexosh ndonjë tregim fantastik. Por, kisha saksonë është aty, për historinë e së cilës historianët kanë të dhëna të mjaftueshme dhe të argumentueshme. Duke dëgjuar historianët dhe lexuar studimet e tyre, gjejmë të dhëna se ata (sasët/saksonët) ishin njohës të mirëfilltë të xeheve dhe dinin si t'i nxirrin ato si pak popuj gjatë mesjetës së vonë. Ata ishin të vendosur në fshatra, qytete dhe kështjella fare pranë minierave. Gjurmët e tyre në Kosovë i gjejmë në masë më të madhe në lokalitetet e Mitrovicës dhe të Novobërdës, në të cilat qenë zbuluar minierat që nga periudha mesjetare.

Kisha e këtyre minatorëve gjermanë saksonë është bazilika "Shën Pjetri" në Stantërg të Mitrovicës, e cila njihet ndryshe edhe si kisha e sasëve/saksonëve. Arkitektura e saj e ndërtimit ka stil gotik. Atë e vërejmë në muret e saj, në gurët dhe shenjat e tjera që i kanë mbetur pa u shkatërruar dhe humbur. Kishës shtatëqindvjeçare "Shën Pjetri" i ka mbetur në këmbë vetëm muri ballor dhe disa gurë dhe themelet anash, ndërsa pjesa tjetër e bazilikës nuk ka

shpëtuar. Prandaj, që të ruhet kështu si është, që të mos e tretë koha edhe këtë pak trashëgimi që ka mbetur nga kjo kishë, ka nevojë për konservim të saj. Aty duhet të intervenojë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), konkretisht Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, që bashkërisht me punonjësit përgjegjës të saj t'i marrin hapat për konservimin e saj. Së këndejmi, për gjendjen e saj duhet të përkujdesjen edhe institucionet lokale të Komunës së Mitrovicës, edhe ndonjë organizatë e huaj me veprimtari në Kosovë.

Gjatë hulumtimit që i kemi bërë kësaj kishe kemi parë gurë që lehtësisht shpëputen nga objekti. Kështu që, për të mos ndodhur shkatërrimi i saj edhe më tutje, duhet të intervenohet që të ruhet së paku forma e mbetur. Po ashtu, duhet të bëhen hulumtime të thelluara e të specializuara në bazamentet e saj për ta shikuar mundësinë se çfarë gjejmë në oborrin e saj, ndonjë dëshmi tjetër shtesë. Një rekomandim tjetër që do t'ua jepnim MKRS-së dhe institucioneve të tjera përgjegjëse

për këtë objekt është sinjalizimi i rrugës deri te kisha. Nuk ka shenja në rrugë që e orientojnë një turist të mundshëm kulturor për ta gjetur atë sa më lehtë e sa më shpejt.

Kisha e saksonëve në Stantërg të Mitrovicës është përmendur për herë të parë në fillim të shekullit XIV, konkretisht në vitin 1303, kur Papa Benedikti XI i dërgon një letër famullisë katolike në Trepçë. Në të, përpos kjo kishë, përmendet për herë të parë edhe emri i Trepçës. Nga kjo e dhënë, nga kjo letër e Papa Benediktit XI, mund të themi se kjo kishë do të jetë ndërtuar qysh në shekullin XIII. Pra, si monument e si objekt kulture, ka një jetëgjatësi gati shtatëqindvjeçare dhe një gjë e tillë përbën një vlerë të qenësishme për kulturën dhe trashëgiminë tonë.

Prania e një kishe katolike në një periudhë të mesjetës së vonë thotë shumë jo vetëm për trashëgiminë kulturore të Kosovës, por edhe për historinë e saj, veçmas për historinë e zhvillimit të religjionit dhe religjioneve në vendin tonë. Ka të dhëna se kisha "Shën Pjetri"

në Stantërg ishte funksionale deri në shekullin XVI dhe gjerë në këtë kohë kryheshin rite dhe ishte në shërbim të besimtarëve katolikë, veçmas saksonëve që punonin për nxjerrjen e xeheve në minierën e Trepçës. Por, në shekujt XVI dhe XVII shënohet edhe fundi i pranisë së saksonëve (sasëve) në Kosovë. Saksonia dhe saksonët për herë të parë përmenden nga historiani Ptolemeu rreth vitit 150 para erës sonë. Ata janë një degëzim i fiseve gjermane që jetonin rreth lumit të Elbës në Gjermani. Një pjesë e madhe e tyre qëndroi në Gjermani, një pjesë emigroi në ujdhesën britanike (anglo-saksonët) dhe në Evropën Lindore dhe juglindore. Sipas historianëve, saksonët ishin të zotë në mjeshtëri, punë, zbulime të kohës, por ishin edhe njerëz me shpirt luftarak, pasi që vetë emri i tyre "sakson" do të thotë njerëz të shpatës, bijë të shpatës.

Bazilika "Shën Pjetri" apo kisha e saksonëve (sasëve) në Stantërg të Mitrovicës ka një pamje piktoreske për shkak të rrethimit me male të cilat i shtojnë vlerën turistike. Nëse investohet dhe shënjohet si zonë

me rëndësi turistike, do të jetë një vend i këndshëm dhe ekzotik për t'u vizituar nga turistët, veçmas nga turistët që kanë interesim për historinë dhe për religjionin. Në këtë kontekst, për këtë objekt të vjetër fetar duhet të informohen shtetasit gjermanë, veçmas ata me shkollim të lartë dhe punonjësit e institucioneve universitare dhe kërkimore, edhe gjermanët me prirje të larta religjioze, të cilët mund të jenë vizitorë potencialë dhe promovues të kësaj kishe mjaft të veçantë që, mbase, edhe do të mund të ndihmonin materialisht për t'i mbajtur ata gurë të ngrehur edhe më tutje.

Kisha e saksonëve në Stantërg ka statusin e monumentit të kulturës dhe është në listën e trashëgimisë kulturore. Pra, ligjërisht është e mbrojtur që nga viti 2011, por duhet të bëhet më shumë për të e më shumë punë përreth saj. Në bazë të madhësisë së saj, perimetrit të saj të mbetur, duket se ka qenë një kishë e madhe, që do të ketë qenë shtëpi e lutjeve për shumë besimtarë katolikë, një pjesë e të cilëve mund të kenë qenë edhe shqiptarë. Andaj, kujdesi ynë për të duhet të jetë më i madh dhe më dinjitoz për një objekt kulturi që e nderon trashëgiminë dhe të kaluarën tonë.

(Ky artikull është përgatitur në kuadër të projektit kulturor "Observimi i traditës", realizuar nga Qendra për Kulturë dhe Edukim "Sheshi", Prishtinë. Fusnotat në artikull i ka hequr redaksia).





Intervistë

Poezia është më e veçanta e letërsisë

Pse shkruan?

Sepse arti është reflektim i secilës ndjenjë dhe mendim njerëzor për më tepër duket sikur njerëzit përmes poezisë e gjejnë edhe kuptimin e vërtetë të jetës.

Cka është poezia për ty?

Është zhanri më i veçantë i artit, burim i veqantisë së shpirtit. është fjala e zemrës.

Cka je ti pa poezinë?

Oh, nuk e di çfarë të them, për shkak se ndërmjet poezisë unë e shpreh vetvetën. Pa poezinë do të isha sikur nata pa hënë, sikur njeriu kur mbetet pa fjale dhe nuk arrinë të shprehet dot.

Kur shkruan?

Sa herë që inspirimi troket në derën time.

Pse vetëm poezinë e jo zhanre tjera?

Sepse poezia është pjesa më e bukur dhe më e veçantë e letërsisë. Përmes poezisë poeti shkruan një roman me kaq pak fjalë por me përmbatje shumë të madhe.

Cilët poetë të tërheqin për lexim?

Pablo Neruda
Fatos Arapi
Dritëro Agolli
Ismail Kadare
Francesko Petrarca

Ku qëndron poezia shqipe sot?

Besoj se do të duhej të i jepnin me shumë hapsirë poezisë dhe poetëve mediat e tona se ashtu do të promovohesh me shumë arti shqiptar modern duke i inkurajuar edhe më shumë gjeneratat e reja që të lexojnë dhe inspirohen.

Cfarë rëndësie ka për ty një shpërblim?

Njëherë kam lexuar se puna e shkrimtarit përfundon aty ku përfundon vepra artistike në këtë kuptim kritikant nuk janë janë aq të rëndësishme për mua për shkak se jam person që gjithçka shikoj nga një aspekt pozitiv megjithatë shpërblimet mbesin si një mirënjohje e rëndësishme e punës time nga vet lexuesit të cilët me anë të shprehjes së pëlqimit të tyre duke e bërë veprën artistike të sukseshme më inspirojnë të vazhdoj më tutje duke mos u ndalur asnjëherë së shkruari për t'i dhuruar botës të paktën disa mesazhe të bukura.



Valbona R. Hadri



Nga: Ganimet KLAIQI
(1965-2017)

Titujt në gazetatat e Kosovës

Titujt nga gjuhëtarët vlerësohen si pjesët më të vështira të teksteve në zejen e gazetarisë. Në njërin anë përmbajnë pjesën thelbësore të artikullit, kurse në aspektin global duhet ta shpërfaqin informacionin më të rëndësishëm. Së këndejmi, ata e fitojnë ose e humbin lexuesin, konkretisht marrësin e informacionit. Në rast se janë të paqartë, lexuesit nuk i zgjohet kureshtja për të hyrë në tekst. Hyrja në tekst bëhet nga qartësimi i shprehjeve gjuhësore. Nga kjo bazë titujt i plotësojnë detyrat formale dhe funksionale të artikujve.

Titulli, nëntitulli, koka e lajmit, si njësi konvencionale që janë, njihen nga shfrytëzuesit e tyre në çdo kulturë dhe grup të caktuar etnik.[1] Nga kjo pikëpamje, titujt përfaqësojnë formë të posaçme të prezentit të gazetarisë. Në një përkufizim stilistik të studiuesit Lucke, që e kishte bërë në vitin 1963, titujt duhet të jenë të shndritshëm, të formuluar, të shkurtër, të hetueshëm, të kërkueshëm, rastësorë, të gdhendur dhe përmbajtjesorë.[2] Në kuptimin e formulimit të tyre, sipas studiuesve të gjuhës së gazetave, titujt nxjerrin dallime midis gjuhës praktike dhe asaj pragmatike. Dallimi bëhet në kriteret e sistemit gjuhësor, para së gjithash, sintaksor. Një përkufizim përmbajtjesor për

këtë e ka dhënë studiuesja Barbara Sandig, sipas së cilës, titujt janë mbishkrime që dëshmojnë vlerën e fjalisë.[3] Nga ky këndvështrim titujt në disa gazeta të përditshme të Kosovës, si *Përkujdesje që obligon (Rilindja)*, *Tjera ndryshime (Epoka e re)*, *Takime lobuese (Lajm)*, *Presidenti i partive (Infopress)* nuk paraqesin karakter të plotë komunikimi ose, thënë ndryshe, krijojnë asociim. Nga pikëpamja e kësaj studiueseje, titujt e këtyllë janë shembuj të këqij dhe pa shkallë të mjaftueshme të njoftueshmërisë. Të tillët paraqesin indiferencë për aktualitetin.

Titulli është një mbishkrim, i cili përsërit ose parafrazon shprehje nga konteksti.[4] Sipas studiuesve, vendosja e titujve në gazeta duhet të përcaktohet me karakteristika gramatikore, sintaksore dhe stilistike. Pa këto elemente komplikimi i titujve në raport me thjeshtësinë mund të ndikojë në procesin e interpretimit. Nga ana tjetër, titujt me shprehje të fuqishme gjuhësore, të përzegjedhura mirë, zgjojnë interesimin e marrësit. Titujt e kësaj natyre bëhen më të kërkueshëm nga lexuesit, të cilët, kur i shfletojnë gazetatat, duan t'i gjejnë të tillët. Nëse titujt zgjojnë interesim te lexuesi, kjo është bërë për shkak të dinamikës së shprehjeve gjuhësore, por që s'është

demaskuar gjithçka nga përmbajtja e artikullit. Një titull i mirë mbulon informacionet thelbësore dhe konkretizon temën e artikullit. Megjithatë, pritjet e këtyllë nuk mund të harmonizohen gjithmonë për t'u kapur aspektet: titulli dhe teksti në artikullin e gazetës.

Karakteristikë tjetër, sipas studiuesve të titujve, në aspektin gjuhësor është se nuk është e thjeshtë të vendoset se cilët tituj janë më të vlefshëm, cilët janë më informativë dhe më të dukshëm për të zgjuar interesim. Nga pikëpamja pragmatike e gjuhës, titujt kanë për detyrë të transmetojnë informacion të përmbledhur me fakte të besueshme për ta nxitur dhe motivuar lexuesin. Studiuesi i gjuhës së gazetave në Kosovë, Bardh Rugova, në studimin për këtë çështje thekson se në gazetatat e Kosovës rëndom, krahas titullit dhe nëntitullit, shënohet edhe mbititulli... koncepti mbititull zakonisht shënon rrethanat e caktuara, titulli shënon temën dhe nëntitulli përmbledhjen, duke lënë mundësi që kjo përmbledhje të zgjerohet edhe në kreun e shkrimit.[5] Nga kjo që u theksua, titujt rezultojnë të jenë pjesa më e rëndësishme objektive e artikullit si në kriterin formal, po ashtu edhe në atë përmbajtjesor. Studiuesi Rugova, pasi thekson se titulli i shkrimit ka një formë të caktuar

gjithnjë, sepse vendoset në fillim, ende pa nisur shkrimin, konstaton se titulli ka një funksion të rëndësishëm tematik, ngaqë i shpreh temën dhe përmbledhjen e ngjarjes kryesore të shkrimit, asaj që ka prioritet gjatë të kumtuarit.[6]

Nga pikëpamja e studiuesit Herald Burger, titujt paraqesin pozitën dhe formulimin e pavarësisë relative të një gazete. Funksionimi i tyre në radhë të parë u adresohet lexuesve.[7] Ndërtekstualitetin e parë të titujve e lidh me mbititullin, nëntitullin dhe hyrjen. Fillimi i tekstit në kuptimin e funksionit paraqet rëndësi sa edhe vetë titulli sepse me pak fjalë paraqet përmbajtjen e artikullit me rrjedhshmëri. Me fjalë të tjera, sipas tij, titulli në gazetarinë moderne formohet në bazë të tekstit.[8] Nga sa u theksua, përshtypja e parë për lexuesit zakonisht krijohet nëpërmjet titujve, të cilët, në fakt, janë karrem për ta tërhequr lexuesin për ta vazhduar leximin e një artikulli gazetaresk deri në fund. Titulli ka rëndësi esenciale, duke u nisur nga fakti se njeriu si qenie është i prirë që përshtypjen e parë ta krijojë pikërisht nga ajo që e sheh së pari. Në parim, lexuesi së pari e përqendron vëmendjen në titull, ndaj edhe gjithçka nis aty. Ideja e gazetarit, apo e redaktorit është të vendosë një titull të bazuar në tekst dhe i cili,

përveç kësaj, është formuluar në atë mënyrë sa ta tërheqë lexuesin.

Janë tri arsye të cilat e determinojnë rëndësinë e titujve në kuadër të një gazete. Titujt kanë, së pari, karakter informativ për një temë, çështje apo përmbajtje. Nuk duhet të kenë qëndrim, pra të mos shfaqet mendimi i gazetarit apo redaktorit, por të jetë si një emërues i përbashkët i një situatë për të cilën është ndërtuar artikulli. Titulli si njësi sinjalizon një pjesë të informacioneve të tekstit.[9] P. sh., nëse trajtohet çështja e imunitetit të deputetëve të Kuvendit të Kosovës si dhe të zyrtarëve të lartë të këtij shteti të ri dhe Gjykata Kushtetuese jep vlerësimin gëzojnë apo jo imunitet, atëherë titulli mund të nxirret nga konteksti, nëpërmjet të cilit do të përshkruhet një situatë e tërë, por gjithnjë duke mbajtur distancë ndërmjet autorit dhe çështjes. P. sh., në ballinë të së përditshmes *Koha ditore* titulli *Kushtetuesja përmend arrestimin për deputetët, jo për qeveritarët* vërehet se është ndërtuar distancë e dukshme ndërmjet autorit të tekstit dhe situatës. Kjo distancë pikësepari është rezultat i përdorimit të foljes në kohën e tashme të dëftores dhe të kryefjalës në vetën e tretë të njëjësit. Në këtë titull, me pak fjalë të ngjeshura, thuhet



shumëçka, ndërsa lexuesit i mbetet për të "hulumtuar" më tepër brenda tekstit. Edhe titulli tjetër në të njëjtën gazetë, në të njëjtën ditë, si: *AAK: Politikat e ministrit Agani për shëndetësinë, të dështuara*, ka distancën e mjaftueshme midis dërguesit dhe marrësit. Edhe në këtë titull, gazetari, nëpërmjet shprehjeve gjuhësore dhe ngjeshjes sintaksore të fjalëve, ka arritur ta krijojë distancën me ngjarjen a fenomenin, sepse nuk është qëndrim i gazetarit apo redaktorit t'i përcaktojë nëse janë apo jo të dështuara politikat e ministrit Agani. Ata i referohen një subjekti, një ministri, duke e vendosur edhe titullin mbi atë bazë. Në aspektin e gazetarisë titulli i gazetës ka për qëllim ta informojë opinionin e gjerë se çfarë po ndodh, kurse në aspektin gjuhësor ai ka rëndësi për ta bërë sa më të qartë raportin dërgues – marrës. Ndryshe janë shprehjet gjuhësore të vendosura në një titull, si: *I prishi paraja*, në gazetën e përditshme *Epoka e re*. Këtu gazetari merr qëndrim dhe ka vlerësim për fenomenin. Këta tituj që shpesh përdoren për stil paraqesin subjektivizëm dhe, pos të tjerash, dalin të jenë të mangët edhe në gjymtyrë, pasi nuk jepet të nënkuptohet se kush janë ata që në të vërtetë i ka prishur paraja, që do të thotë se vetvetiu mungon pyetja, për të marrë një përgjigje të këtyllë. I njëjti titull dhe në të njëjtën ditë, për shembull në *Koha ditore*, është: *Paratë ndajnë Lëvizjen për Bashkim me 'Vetëvendosjen'*, në të përditshmen *Zëri: Parja ndan dy lëvizjet*, në *Lajm: LB dhe VV shkurorezohen shërr i parave*. Titujt përdoren edhe për çështje estetike. Preferohet vendosja e titujve të shkurtër, përmbledhës sepse humbet ritmi dhe esenca për të cilën

vendosen. Struktura e titujve, sipas Heraldit, duhet të jetë e qartë, të ketë kompaktësi, duke i përdorur drejt mjetet gjuhësore, siç janë foljet dhe mjetet e tjera sintaksore e stilistike. Ata formulojnë hyrjen tematike në tekst, derisa nëntitujt specifikojnë faktet për ngjarjet. Këto elemente bashkërisht formulojnë logjikën ndërtekstuale, me mjete gjuhësore që japin kompleksivitetin e titullit, duke e lidhur atë me hyrjen dhe rrjedhën e tekstit.^[10] Zakonisht parapëlqehen titujt që s'e kalojnë një rresht në proporcion me shkrimin. Por, në disa media të Kosovës ka edhe tituj të karakterit sensacional, por edhe me nga dy rreshta. Në fakt, *Koha ditore* ka aplikuar modelin e ndërmjetëm, i cili konsiston në vendosjen e titujve që përkojnë me tekstin, që kanë dalë rrjedhimisht nga teksti dhe që kanë bazë në të. Titujt nuk janë njëtrajtësisht rezyme e përmbajtjes, por pjesë e saj, në të cilën më i rëndësishëm është prezantimi i fakteve përpara rrëfimit. Në parim, te titujt gazetareskë nuk ka dilemë se synim kryesor është që ata të jenë përmbajtjesorë, tërheqës dhe të shkurtër, gjithnjë duke i pasur parasysht mjetet gjuhësore dhe lidhjen e ngjeshur sintaksore. Pra, titulli është një përmbledhje e tekstit, i cili përmban në vete faktet kryesore. Shpesh titujt i ngjasojnë një lajmi flash si, p. sh.: *Shkarkohet presidenti*. Për të njëjtën çështje gazetat e Kosovës të datës 21 shtator 2011 japin versione të ndryshme të titujve: *Koha ditore: Kushtetuesja përmend arrestimin për deputet, jo për qeveritarët*; *Zëri: Kushtetuesja foli: S'ka imunitet*; *Lajm: Pa imunitet*; *Epoka e re: Deputetët,*

presidenti dhe anëtarët e qeverisë nuk gëzojnë imunitet; *Kosova sot: Mund të arrestohen*; *Infopress: Vendim antikushtetues*. Nga tetë gazeta të përditshme që botohen në Kosovë, për të njëjtën çështje titujt dalin me shprehje të ndryshme, në kuptimin e përdorimit të shenjave gjuhësore. Nëse njoftueshmëria është një nga shtatë kriteret e tekstualitetit, qëllimi i të cilit e jep të priturën dhe të papriturën, disa nga këta tituj janë me mangësi. Një përzgjedhje e mirë e fjalëve e bën informacionin më të dëshirueshëm, kurse dhënësin e informacionit shumë më të qëndrueshëm e më të besuar. Nëpërmjet titujve lexuesi i pranon edhe artikujt, pasi që ata e sforcojnë edhe njoftueshmërinë e tij. Kjo ka kuptim për faktin se është nxjerrë pika kryesore e artikullit. Kjo, sipas studiuesit Rugova, do të thotë se përzgjedhja e një titulli të mirë e popullarizon gazetën. Ai thekson se në këtë pikë ka rëndësi të madhe kombinimi i fjalëve në një strukturë të shkurtër të fjalisë, ku rolin kryesor e merr subjekti, veprimi i të cilit mund të përmblihet në pak fjalë, kurse të shtjellohet në tekst. Me një fjalë, titulli i gazetës paraqet hapin më të mirë që të nxitet lexuesi për të hyrë në tekst dhe për të bashkëjetuar me të. Rugova i vlerëson të gabueshëm titujt në gazetat e Kosovës, kur ata i nxjerrin si tituj asociativë. Kjo e dëmton në shkallë mjaft të madhe informacionin dhe kalon në suaza të tekstit letrar. Por, në gazetatat e përditshme, në të shumtën e herëve, titujt e gazetave dalin të njëtrajtshëm, sepse gazetarët apo redaktorët formulimin e titujve e pronësojnë, duke mos dashur

të dalin nga shabllonet. Që njoftueshmëria e tekstit të ketë edhe qytetari, gazetarët dhe redaktorët e vëmendshëm rëndom i përzgjedhin titujt që të mos jenë emocionalë, të mos kenë egërsi dhe të jenë plotësisht informativë. Kjo praktikë duket të jetë shumë e pranishme në të përditshmen e pavarur informative *Koha ditore*, derisa në disa të tjera mungon. Dëshmi për këtë është rasti i burgosjes së gjashtë zyrtarëve komunalë të Prishtinës. Për dallim nga *Koha ditore* (4 maj 2011), kur ka dhënë informacionin se *Policia kundër krimeve ekonomike ka arrestuar 6 zyrtarë komunalë*, në disa gazeta të tjera informacioni është dhënë: *Gjashtë në kajmak (Express, 4 maj 2011)*. Sado që titulli i fundit duket si bombë, ai është tendencioz dhe i njëanshëm. Një titull i tillë e mbytyt informacion dhe tekstin gazetaresk e kthen në një tekst krejt letrar, duke i sjell vështirësi lexuesit që ta pranojë në hapin e parë lajmin. Pra, është titull subjektiv. Një titull për lexuesin është potencial atëherë kur ai e pranon atë në shikim të parë. Kurse nëse vetë gazetari dyshon se titulli i tij nuk ka arritur të përmblihet me shprehjet më të pranueshme gjuhësore, atëherë edhe lexuesi do ta ketë po atë dilemë. Një titull i mirë dhe informativ në asnjë rast nuk bën të jetë si një pjesë e një deklarate të ashpër, aq më tepër kur brenda tij mund të shtrohen shumë pyetje për të marrë një përgjigje. Prova më e pranueshme e një titulli është akceptimi i tij informativ. Dëshira superlative e autorit për të bërë sa më shumë bujë titulli i tij e bën atë që të ngatërrohet në përmbajtje të tekstit dhe kalon në paqëndrueshmëri.

I doli duqi (Infopres) ishte një titull në një gazetë të Kosovës, një ditë pas arrestimit të gjashtë zyrtarëve të Komunës së Prishtinës. Gazetari, apo redaktori, kanë synuar të jenë superlativë, por në aspektin pragmatik e informativ të gazetës i ka kaluar të gjitha caqet. Në këtë aspekt një gazetar i mirë dhe që synon njoftueshmërinë për ngjarjet që na rrethojnë për çdo ditë do të duhej ta peshonte vënien e fjalëve së pari në titull e pastaj edhe në tekst. Sa më e madhe që të jetë pasuria e leksikut, aq më e madhe është edhe mundësia e përzgjedhjes së një titulli më të shkurtër dhe më domethënës, në kuptimin e përmbledhjes së informacionit. Janë pikërisht këto elemente të trajtuara me shkallë të njoftueshmërisë nga studiuesit Beaugrande dhe Dressler dhe të pasuar edhe nga studiues të tjerë. Ata pasi e kanë cilësuar njoftueshmërinë si kriterin e pestë të tekstualitetit, kanë caktuar tri shkallë të cilat kategorizojnë marrëdhëniet dërgues – marrës.

[1] Van Dijk, i cituar nga Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave*, f. 116
 [2] Hartmut Luck, *Zeitungsdeutsch und Umgangssprache. Untersuchungen zur des Spigels*. In: *Muttersprache, Munchen, 1963, f. 335*
 [3] Barbara Sandig, *Syntaktische Typologie der Schlegelzeile. Möglichkeiten und Grenzen der Sprachökonomie im Zeitungdeutsch*. Munchen: Institut für Germanistik, (Linguistische Reihe 6), 1971, f. 38
 [4] Hellwig Valentin, *Zeitgeschichte 1818-2004. Klagenfurt, 2005, f. 170*
 [5] Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave, Koha, Prishtinë, 2009, f. 118*
 [6] Po aty f. 110
 [7] Herald Burger, *Mediesprache: Eine Einführung in Sprache und Kommunikationsformen der Massmedien*, Verlag 3, Berlin, 2005, f. 114
 [8] Po aty f. 115
 [9] Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave, Koha, Prishtinë, 2009, f. 118*
 [10] Herald Burger, *Mediesprache: eine Einführung in Sprache und Kommunikationsformen der Massmedien*, Verlag 3, Berlin, 2005, f. 116





NJË INTERVISTË GATI E PAMUNDUR ME PROFESOR EQREM ÇABEJN

Përgatiti Bashkim KUÇUKU

Puna e redaktorit në gazetën Drita më detyroi t'i marr intervistë atij që nuk do të më shkonte mendja kurrë, pa le të guxoja, Profesor Eqrem Çabejit, për të cilën janë shkruar këto radhë, si dhe për fisnikërinë e pazëshme të Profesor Mahir Domit.

Ka qenë gusht. Më kujtohen lëvizjet nëpër vapë për të gjetur lëndën e numrit vijues.

E vetnja mundësi nga mund ta kapnim profesorin ishte vepra e tij Studime etimologjike në fushë të shqipes, që kishte filluar ta botonte Akademia e Shencave.

Fillova të vrisja mendjen, duke qenë i bindur, se ishte e pamundur. Brezi ynë nuk pati fatin të dëgjonte ligjëratat e tij. Dy-tre vjet para nesh nuk dha më mësim në universitet. Duke qenë student, kam ndjekur një ligjëratë të tij tepër mbreselënëse për etimologjinë e shqipes para profesorëve të fushave të ndryshme, në sallën e Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës.

Në redaksi nuk e kisha parë ndonjëherë të vinte. Edhe në ndërtesën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, ku ishte edhe redaksia, e shihje me raste të veçanta, kur ishte i detyruar të vinte për respekt të problemit, ose, të jubilarit. Një shkrim, që

kishte botuar te Drita me titullin Një njëqindvjetor, kushtuar në mos gabofsha, albanologut Norbert Joklit, e kishte sjellë sekretarja e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Me që më ishte ngarkuar mua ta lexoja dhe ta përcillja te kryeredaktori, -lënda në daktiloshkrim pa asnjë gabim teknik, fletët të lidhura, mbështjellë në zarf, me adresën e gazetës Drita, duke m'u kujtuar më trembnin edhe më, sepse kishin krijuar tek unë përfytyrimin e një përkore të madhe.

-Sidoqoftë, - thashë, - të bëj timen! E para, të marr vesh, se ç'natyrë ka profesori. Nga larg e me të dëgjuar e dinim, se ishte tërësisht i përqëndruar te puna e vet shkencore, në Tiranë, e gjetiu lëvizte pak, miqtë e shokët i kishte të përzgjedhur, edhe për arsye të moshës, por edhe sipas kodit etik të dikurshëm. Për të ditur konkretisht dhe nga burime të sigurta për natyrën e tij, bisedova me studiuesin Jorgo Bulo, shef i sektorit të studimeve letrare në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, që punonte në të njëjtën ndërtesë me profesorin.

- Pak e çuditshme, kjo kërkesë, - më tha Jorgoja. - Eqrem Çabej, gazeta dhe intervista janë të kundërta me njëra tjetrën. Megjithatë, ti provoje. Po t'u përgjigj, do jetë një gjë e rrallë. Bisedoje me Seit Mansakun, atë ka

ndihmësin kryesor. Po e mori ai përsipër, edhe mundet.

Seiti nuk e mori përsipër. - Profesori është natyrë e vështirë për një punë të tillë. Nuk i them dot.

Më mbeti të përballesha vetë. Duke e ditur se e kishte drojën e zyrave qeveritare, më erdhi një ide. Do t'i them e kemi porosi nga lart, që nënkuptonte Komitetin Qëndror të Partisë, përkatësisht Drejtorinë e Shtypit e të Propagandës. Me këtë pranonte të përgjigjej kushdo, sado "i vështirë" të ishte.

Me të vetmin çelës, dhe frikë se mos më nxirrte edhe jashtë, trokita në derën e zyrës ku punonte. Zyra ishte shumë e vogël, ngjitur me zyrën e drejtorit,

Androkli Kostallari. Ulur si i ngucur, në një tryezë edhe ajo shumë e vogël, dhe vet profesori i imët, më pa habitshëm, se si hyri një i panjohur, që nuk ishte punonjës i institutit. Pas përshëndetjes dhe të falurit të tepruar, që po i kërkoja për shqetësimin, ndiqte me shpërfillje fjalët e mia: gazeta, kërkesat e lexuesit, dëshira e redaksisë, porosia e kryeredaktorit, etj. Kur i zura në gojë intervistën, nuk di, ndoshta, i jam dukur "i lajthitur."

- Ç'lidhje kanë këto me mua? - ma preu.

M'u desh t'ia përsërisja ato shkurtimisht, të cilat mezi filloi t'i dëgjonte.

- Unë s'jam për intervista. S'kam dhënë ndonjëherë. Shkonite ndonjë koleg. Mos më shqetësoni, që, e kthyer në shqip, do të thoshte, tani shko, në mos, mbathja.

Në pikën më kritike u tregova këmbëngulës.

- Ju kërkoj, vërtet, ndjesë, por më kuptoni përse po ngul këmbë. Vij me porosi të kryeredaktorit. Kryesia e Lidhjes së Shkrimtarëve ka kritikuar redaksinë "Pse nuk ju ka marrë juve intervistë, sidomos tani që ka dalë vepra madhore "Studime etimologjike në fushë të shqipes?" " Ky është quajtur faj i redaksisë.

- Kryesia e Lidhjes ka punët e veta, - ma ktheu.

- Më vjen keq që jam i detyruar t'ua shpjegoj, pasi nuk jam i autorizuar. Kritika ka ardhur nga lart, "Pse e mënjanoni profesorin?" Prandaj, ju shqetësoj. Ndryshe nuk do të guxoja të trokisja në derë.

- Mendon, se është kaq e ngatërruar, një gjë e thjeshtë?

- Nuk di më tej. Pa këtë barrë nuk do të vija.

- Kam punët e mia. Nuk shkëputem dot. ...Më duhet ta mendoj.

Dhe, pas pak.

- Si bëhet kjo punë?

Nga « thyerja » e tij, mora kurajë. Fjalët më vinin me vrull, por i pengoja. Fola sa më shkurt, se mos mërziqej dhe ndërtonte mendim. - Është fare e thjeshtë, profesor. Me

mundësitë e mia modeste, Me që kam mbaruar për gjuhë shqipe dhe letërsi, do të përpiqem të formuloj disa pyetje.

- Të shikoj pyetjet, pa ju jap përgjigje.

Me mirësjellje të përunjur, nuk dija si ta falenderoja.

Përsëri te Seiti, i cili u habit nga përgjigja e tij.

- Kam frikë se do ta kthejë fjalën. Mos e ka bërë për të më hequr qafe?

- Jo. Po të ka thënë kështu, do të përgjigjet. Fjalën nuk e shkel kurrë.

- Tani është radha jote, do të më ndihmosh për pyetjet.

- A, jo, është e pamundur. Sikur ta marrë vesh që unë të bëj pyetjet, unë nuk punoj dot më me të. Ai është i prerë. Këtë e quan pabesi dhe nuk ia fal askujt.

- Si të veproj?

- Për këtë vetëm profesor Mahiri mund të të ndihmojë, nëse pranon. Atë e ka mikun më të ngushtë. I a një natyrën. Po pati guxim...?!

Me profesor Mahirin ishte më e lehtë. Më dëgjoi me vëmendje. Edhe atij i pëlqente që gjuhëtari më i njohur, i mbyllur në punën e vet, të komunikonte, qoftë edhe një herë, drejtpërdrejt me lexuesin.

- Po më vë në vështirësi! Mirë është të japë një intervistë, edhe për gjuhësinë, edhe për atë vetë, edhe për lexuesin. Këtu nuk bisedojmë dot, sepse, po e mori vesh, nuk di si



t'i përgjigjem. Mik e kam, po ai ka rregullat e tij, të cilat unë ia respektoj gjithmonë. Do të lëmë një takim. Këtu, në zyrë, ju lutem, mos të vini më, sepse mund t'ju shikojë ose ta marrë vesh.

I mirësjellshëm me të gjithë, i gatshëm për të ndihmuar dhe i përpiktë, me profesor Mahirin u takuam te Kafja e Pallatit të Kulturës në katin e tretë.

– E para e punës, – më tha, – do të më jepni fjalën, se nuk do ta marrë vesh njeri, që pyetjet po i bëjmë bashkë. Po më dhatë besën, do t'ju ndihmoj.

Pasi e sigurova për këtë, më këshilloi të formuloja idetë e mia, se çfarë kërkoja, për t'i mbushur me lëndën përkatëse dhe t'i përpunonte shkencërisht. Megjithë ngurrimin tim, të cilin i a shprehja, se mos shkruaja vulgaritete, i formulova. Në takimin tjetër, po në të njëjtin vend, profesori i solli pyetjet në daktiloshkrim. Më rikujtoi besën, që duhet të mbaja dhe mos të shkelja në zyrën e tij.

Afër mesdite, në po atë zyrë të ngucur, i dhashë pyetjet. Ai i ulur, unë në këmbë, sepse nuk kishte karrige tjetër. Me që isha në këmbë, e vëreja në mimikë pa më kuptuar. Nga leximi shpërfillës, sikur kaloi në një lloj habie dhe dyshimi të pavetëdijshëm, në se i kisha formuluar unë. Leximi mbaroi vëmendshëm. Më vërejt me mosbesim në thellësi, të pangritur në sipërfaqe.

– Mirë, do të mendohem.

– Ju lutem, kur mund t'ju shqetësoj në telefon?

– Këtu, mos më shqetësoni më. Më keni humbur shumë kohë. Më keni prishur punë.

– Mund t'ju marr në shtëpi? Mjafton të më thoni, në cilën orë nuk ju shqetësoj.

Më caktoi rreth orës 17.00, pasi binte zhegu, ose, ndoshta, çohet nga pushimi i drekës.

Pritja në telefon, edhe pse i thashë me tërë mirësjellje se kush isha, qe befasuese:

– Ju lutem, kush jeni ju që më shqetësoni? Kush ju jep të drejtë të telefononi dhe të kërkonin llogari.....?!

Mendova, se do të kishte harruar edhe bisedën, edhe atë që kishte

marrë përsipër. U tërhoqa qetësisht, duke i sqaruar:

– Më keni dhënë leje t'ju telefonoj në ditën dhe në orën, që ju mora. Vazhdoi në të tijën, që nuk kisha të drejtë ta shqetësoja.

Mbeta në pritje. Një ditë qëlluam ballë për ballë tek

Pallati i Kulturës, tek hyrja e sotme për në Bibliotekën Kombëtare.

Edhe ai u drejtua nga unë. Më i përmbajtur, ndonëse, me një lloj mllefi ndaj “padrejtësisë” që i kisha bërë, më shpjegoi se kishte të drejtë. U zura ngushtë. Nuk dija si t'ja ktheja. Nuk doja as ta lëndoja, as ta kundërshtoja.

– Ju kërkoj ndjesë që ju kam shqetësuar! Ndoshta, nuk ishte ora e përshtatëshme. Mund të më lini një orë tjetër.

– Si guxonin ju, të telefononi në shtëpi?

– Më falni, profesor, por më keni dhënë ju leje, t'ju telefonoj. Ndyshe, si mund t'ju merrja?

– Është e vërtetë që ju kam dhënë leje?

– Po, më keni dhënë edhe numrin e telefonit.

Mbeti.

– Në është kështu, ju kërkoj ndjesë.

– S'ka gjë. Unë ju kërkoj ndjesë!

U takuam dy herë tek një kafe e vogël, e pastër, ngjitur dhe para se të hyje tek restorant “Peshku”, në krye të rrugës “Abdi Toptani”, aty ku takohet me rrugën që vjen nga Sahati dhe vazhdon për në Rrugën e Elbasanit, më tej kullës së sotme e ngjashme me një piramidë kokëposhtë. Në atë kafe, ku kthehej me ndonjë mik, sepse, sikurse më sqaroi, “bënin kafe të mirë, ishte qetë, dhe nuk humbje kohë, se ishte në këmbë.” Në të dy takimet patëm biseda të lira për punët studimore letrare, universitetin, gazetën letrare, për të cilat ishte i interesuar të dinte diçka.

Në bisedën e zakonshme, nga je, përse ke kryer studimet etj., vendlindja Konispol dhe mbiemri im i tërhoqën vëmendjen:

– Familja, fisi juaj ka lidhje me Muhamet Çamin?

Kur dëgjoji se isha nga ai fis, pyeti:

– Më vjen mirë. Po ç'studime ke bërë për veprën e Muhamet Çamit?

– Nuk kam bërë, – iu përgjigja, duke ngritur supet.

Në ato vite Muhamet Çami dhe vepra e tij, pas luftës së madhe kundër fesë dhe institucioneve fetare, ishte hequr nga Antologjitë dhe tekstet shkollore. Diku, me disa rreshta kritikohet se ishte përfaqësuesi tipik i përhapjes së besimit islam. Për mua nuk ishte vetëm kjo arsyeja përse nuk kisha punuar me të. Më tërhoqte fort letërsia bashkëkohore, njohjet, debatet me shkrimtarë dhe kritikë, ndonëse debate nuk kishte. Ato i kishte mbuluar miqësia e “mirëkuptimit” me të gjithë, bisedat e kafeneve dhe shkrimet e censuruara.

– Po punimin e diplomës, nuk e keni bërë për veprën e tij?

– Jo.

– Kjo është keq për ti! Si ka mundësi mos të interesohesh për veprën e tij, që është në çamërisht, një nga vlerat e mëdha të gjuhës shqipe?! Ti, do të ishe i pari që do të interesohesh.

Qortimi këmbëngulës më vuri në pozitë për të arsyetuar në ndonjë mënyrë, që deri atëherë nuk më kishte shkuar ndër mend.

– Është e vështirë, profesor. Të them të drejtën, është jashtë mundësive të mia.

– Pse?

– Më duhet medoemos të njoh, apo, të kem të dhëna për letërsinë arabe.

– Të lexosh.

– Që të lexoj, më duhet të di arabisht.

– Do ta mësosh. Do t'i hysh dhe do ta mësosh.

Foli sikur mësimi i arabishtes të ishte fare i thjeshtë dhe të kryhej për një kohë të shkurtër.

– Arabishtja, larg shqipes, është e vështirë.

– Nuk ka gjuhë të vështirë. Edhe arabishtja është një gjuhë si të tjerat. Sa studiues e mësojnë në botë!

– Më duket, se nuk shkon. Unë një pasardhës të shkruaj për paraardhësin tim. Ngjan se dua të ngre veten.

– Kjo, nuk shkon. Unë të them studioje, jo lavdëroje. Ti je studiues.

– Të paktën, kështu, kam menduar.

– Të të shpjegoj, pse e ke gabim.

Çdo njeri punën e fillon nga prejardhja e tij. E njeh prejardhjen e tij, njeh dhe të tjerët me të. Pastaj vazhdon me shkrimtarë të tjerë. Po ta them si mik, sepse e kam bindjen të tillë. Çdo njeri, që nuk niset nga e tija, nga ajo që njeh dhe e ka për detyrë, nuk mund t'i shkojnë punët mirë. Edhe ti nuk kanë për të shkuar punët mirë, derisa ta kryesh këtë detyrim. Mos të të vijë keq dhe mbaje mend!

Më vonë kam menduar, edhe sot, them: “Mos ka dashur me këmbënguljen e tij të më bindte të studioja një traditë, që, nënvleftësohej e hidhej poshtë, dhe, që brezi i ri po largohej prej saj?”

Këtë refren nuk harronte të ma kujtonte, madje dhe me një lloj ironie, në të tria herët që u takuam në kafe, dhe kur shiheshim diku rastësisht.

– Gëzohem, profesor, që ju shikoj. Punët, besoj, ju shkojnë mirë.

– Mua mirë më shkojnë. Po ti nuk i ke mirë. Kur të më thuash që ke filluar studimin për Muhamet Çamin, atëherë do të shkojnë mirë. Intervistën e mora në zyrën e vogël të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Pata përshtypjen se shpëtoi nga një barrë e madhe. Megjithatë, duhej dhe fotografia.

– Më falni, profesor, edhe një bezdi të fundit.

Më pa me vëmendje.

– Është e domosdoshme një fotografi!

– Fotografi nuk kam.

– S'ka gjë. Vjen fotografi i gazetës në zyrën tuaj.

– E kam të vështirë fotografinë. E lëmë me kaq, – tha si me lutje.

– S'kam ç'bëj, është rregull.

Intervista shoqërohet me fotografinë e të intervistuarit. Vetëm thoni ditën dhe orën, që e keni për mbarë.

Fotografi i gazetës, Fatos Maliqi, i bëri disa foto. Njëherë, më të njohurën, e kam parë të botuar në faqet e shtypit të asaj kohe. Vite më vonë, kur m'u desh një foto e tij për revistën Universi Shqiptar i Librit (1997/3), për të shoqëruar shkrimin e Prof. Seit Mansakut për Studime etimologjike në fushë të shqipes IV, kërkova në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, tek punonjësi i Arkivit. Ai më dha një prej atyre fotove, e cila nuk ishte dhe aq e qëlluar, prandaj, i thashë të më jepte një tjetër. Më tregoi katër-pesë. Ishin të atij momenti.

– Të tjera s'kemi, – më sqaroi.

Më erdhi keq. Një institut shtetëror, të mos kishte një dosje sosh për gjuhëtarin më të madh, ishte edhe e pabesueshme, edhe revoltuese. Meqenëse nuk kishte të tjera, në shenjë ndëshkimi, nuk e ktheva as atë.

Takimin për t'i dhënë disa kopje të gazetës me intervistën e botuar, e la te kafja e Hotel Dajtit, e paracaktuar për të huajt, shoqëruesit shqiptarë, sigurimsat dhe disa personalitete të rralla të letërsisë e shkencave, prej të cilëve nuk mund të përjashtohet Eqrem Çabej. Mbaj mend se kisha hyrë nja dy herë për të takuar shkrimtarin Shefqet Musaraj, i cili aty pinte kafen dhe shkruante. Nën hijen e tij nuk ngjalle dyshim.

Erdhi me përpikmëri minutash, me xhakëtën verore që e mbante gjithmonë, veshur ose hedhur krahëve si burrat e qëmoçëm. Nga sjelljet dukej se ishte i familjarizuar me mjedisin, banakierin dhe kamarierin. Edhe ata sillëshim si me të shtëpisë. Kafen tek banaku e porositi vetë. U ulëm diku nga mezi i sallës së madhe anash, në sfondin e së cilës ishin nja dy dyshe të huajsh në bisedat e tyre. Sjellja e përzemërt shprehte një lloj kënaqësie. Për intervistën nuk tha tjetër, veç falenderimit. Gazetën nuk e hapi. Mund ta kishte marrë më parë. Kënaqësinë e tij e ndieja edhe në bisedën e zgjatur, gjysmë, apo, tre çerek ore, një kohë e tepruar për të. Më vjen keq që nuk mbaj mend se çfarë biseduam. Afërsisht u vërtitëm tek temat e mëparshme. Kafen e pagoi ai. Këmbënguljen time e shpërfilli pa



kundërshtime gojore, duke iu drejtuar me ton autoritar kamarierit, që mua nuk më linte shteg.

Me rastin e botimit të këtyre intervistave, prej të cilave nuk mund të lija jashtë atë të Profesor Eqrem Çabejit, mbase, e vetmja e tij, dhe ndihmesën e profesor Mahir Domit, tanimë, pas afro tridhjetë e pesë vjetëve, që fjala e dhënë nuk prish punë, po e them të vërtetën e historisë së paharrueshme për mua, në shenjë nderimi për të dy gjuhëtarët e mëdhenj, që shquheshin edhe për mirësjellje e fisnikëri, secili sipas etikës së vet.

Tiranë, korrik 2013

NJËSIA GJUHËSORE PASQYRON NJË NJËSI KULTURE

Tri pyetje Prof. Eqrem Çabejit rreth Studimeve etimologjike në fushë të shqipes

Drita, 9 shtator 1979

Studiuesit dhe publiku ynë para ca kohësh patën në dorë veprën tuaj Studime etimologjike në fushë të shqipes, vëllimi i dytë. Ne mësuam se së shpejti Ju do të dërgoni në shtyp vëllimet 1 dhe 3 të kësaj vepre madhore me aq rëndësi për historinë e gjuhës dhe të kulturës sonë në përgjithësi. A mund të na thoni dy fjalë lidhur me përmasat e kësaj vepre dhe strukturën e saj?

Sikundër e thoni edhe Ju vetë, nga vepra Studime etimologjike në fushë të shqipes, që po botohet nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë sonë të Shkencave, në vitin 1976 ka dalë vëllimi i dytë, që përmban fjalët e shkronjave A e B dhe që është pajisur edhe me një përmbledhje fjalësh frëngjisht e me indekse fjalësh. Kam dorëzuar para disa kohëve vëllimin e parë edhe të tretin. I pari, Hyrja e gjithë veprës, përmban, shqip e me përktim tërësor frëngjisht, parimet dhe metodën e ndjekur në gjurmimin etimologjik të elementëve që përbëjnë pasurinë leksikore të gjuhës.

Aty jam nisur nga vetë lënda e shqipes, duke i vështruar çështjet, që dalin në atë mes, nga rrethanat e brendshme të gjuhës: me bindjen që objekti, e me të



bashkë dhe materiali, përcakton shpeshherë edhe metodën e punës. Ky vëllim, i cili përmban dhe shkurtimet bibliografike të caktuara prej meje gjatë punës, si edhe indeksat e fjalëve, ka marrë formën përfundimtare dhe është gati për shtyp.

Parimet dhe metoda e punës, të parashtruara në Hyrje, shfaqen në mënyrë konkrete në vëllimet e gjithë serisë, si në atë që është botuar si në vëllimet që do të ndjekin në të ardhmen. Nga ato, vëllimi i tretë, që, si u tha, edhe ky është dorëzuar prej meje, përmban fjalët e shkronjave C, Ç, D, DH, përveç përmbledhjeve frëngjisht dheindekseve të fjalëve. Struktura e veprës është e tillë, që mbarë vepra mendohet të përfshijë disa vëllime, pas parashikimeve rreth tetë e mbase edhe ndonjë më shumë. Mënyra e paraqitjes së lëndës do të jetë e njëjta në të gjitha vëllimet.

Lexuesit e vëllimit 2 Studime etimologjike në fushë të shqipeskanë vënë re se duke u mbështetur në një konceptim të gjerë, të ri tëstudimeve etimologjike, janë arritur rezultate me rëndësi në fushëne studimeve të gjuhës e të kulturës sonë. A mund të na thoni diçkaj për këto koncepte dhe parime shkencore që janë vënë në bazë të studimeve etimologjike dhe për mundësitë që kanë krijuar ato për të arritur në sqarime dhe zgjidhje të reja të burimit dhe të historisë së fjalëve të gjuhës sonë?

U përmendën më sipër objekti, materiali, parimet e metoda e punës që ndiqet në këtë fushë studimesh. Këto, si u tha, janë të lidhura dhe kushtëzohen në mes të tyre. Dihet lashtërisht që etimologjia është dija që studion burimin e fjalëve. Në konceptin modern të zbatuar në këtë lëmë kërkimesh etimologjia ndërkaq përfshin një fushë më të hapët. Ajo duhet të rrokë historinë e elementeve përbërëse të leksikut të gjuhës në vështrimin më të gjerë të asaj fjale. Shtrohet detyra të ndiqet filli i jetës së fjalëve, fatet dhe zhvillimi i tyre në hapësirë e në kohë. Aty ndërkaq do pasur përherë parasysh që fjalët e një gjuhe nuk kanë ekzistuar e nuk ekzistojnë kurrë në vetvete.

Në të vërtetë janë njerëzit që e kanë folur e që e flasin gjuhën e që kanë përdorur e përdorin fjalët e sistemit të saj. Kështu elementet leksikore, fjalët, nuk mund të merren të shkëputura nga shoqëria dhe nga kushtet e saj ekonomike e kulturore. Duke i shikuar këto të gjitha – ashtu si edhe duhet – nga këndi i vështrimit të rrethanave vetjake të gjuhës shqipe, kërkimet etimologjike dhe rezultatet e tyre marrin një rëndësi të veçantë përbrenda gjuhësisë dhe përgjithësisht brenda lëmit të shkencave shoqërore. Dihet se shqipja ndër gjuhët motra të Evropës është e dokumentuar me shkrim relativisht vonë, në gjendjen e sotme të njohurive tona me këta pesë shekujt e fundit e këtej. Dihet më anë tjetër që ajo paraqet një ndër gjuhët e lashta të

kontinentit. Këtë realitet të dyfishtë duhet ta kenë parasysh historia gjuhësore përgjithësisht dhe përbrenda saj etimologjia në veçanti dhe t'i përgjigjen në mënyrë shkencore objektive. Kjo vlen si në konceptimin, në rrokjen e kësaj problematike në përgjithësi si në punë të zbatimit të saj në gjurmimet etimologjike të gjuhës. Aty e ka burimin dhe metoda e punës, e cila, si u tha, kushtëzohet dhe nga objekti e nga materiali. Aty, për t'u ngjitur në disa shkallë më të moçme të gjuhës, ndihmojnë kryesisht dy lloj burimesh gjuhësore.

Më një anë janë përmendoret e vjetra të shkrimit, duke nisur nga ato të epokës kastroitiane e duke zbritur në kohë. Më anë tjetër është lënda e gjallë e gjuhës sot dhe e dialekteve të saj, brenda trojeve ku flitet shqipja dhe nëpër ngulimet e përhapura brenda e jashtë

Gadishullit Ballkanik. Kjo lëndë gjuhësore, ndonëse nuk është mbledhur ende tërësisht, paraqitet në ditë tona shumë më e pasur nga sa dihej sot e një shekull më parë. Ky rezultat është arritur kryesisht me punën e palodhur të shqiptarëve vetë në Shqipëri dhe nëpër viset e ndryshme ku flitet shqipja. Letrarë, arsimtarë e dashamirë të tjerë të gjuhës amtare kanë punuar, në kohët e kaluara, me vetëmohim, e shpeshherë në kushte të vështira, në mbledhjen e dokumentimit me shkrim të lëndës gjuhësore. Një punë më e thelluar, më sistematike, e me kritere shkencore më të shëndosha, është kryer e vazhdon të kryhet tek ne në epokën e Pasqirimit nën kujdesin e pareshtur të Partisë. Krahas me këtë punë ka shkuar e po shkon dhe mbledhja e emrave të vendeve, e toponimisë, ku ruhet një pjesë e moçme dhe e

paregjistruar e pasurisë leksikore të gjuhës.

Duke u mbështetur sidomos në këto të dhëna, për një pjesë të mirë të paditura më parë e për dijen, prandaj shumë herë të reja, ka qenë e mundur të arrihet në një fazë gjuhësore më të vjetër, ku dialektet kanë qenë më afër ndaj njëri-tjetrit, si dhe ndaj tipit të përbashkët të gjuhës. Në atë fazë mjaft fjalë dëshmohen me një trajtë ose me një kuptim të ndryshëm nga trajtat a kuptimet e sotme. Me këtë rrugë edhe historia e tyre paraqitet shpeshherë në një dritë të re. Ashtu mundësohet hetimi i trajtës a domethënies së kryehershme të fjalëve, dhe me këtë rast lehtësohet dhe diktimi, gjetja e burimit të tyre. Një ndihmë të mirë na japin në këtë mes të dhënat e dialekteve të diasporës shqiptare, të ligjërimeve sidomos të Greqisë e të Italisë; të shkultura para disa shekujve prej trungut të përbashkët të gjuhës, ato ruajnë shpeshherë tipare gjuhësore më të moçme.

– Më e vështirë paraqitet puna e gjurmimit etimologjik kur dëshmitë e vjetra, shkrimore a gojore, mungojnë. Aty kërkimtari detyrohet të dalë jashtë caqeve të shqipes. Ndërsa gjer aty mjaftonte krahasimi i brendshëm, krahasim midis dialekteve ose ndërmyet dialekteve dhe burimeve shkrimore, tashti ndërmerren krahasime të jashtme, midis shqipes dhe gjuhëve të afra (farefis) me të, krahasimeve të fushës indoevropiane. Në atë mes dalin në shesh tipare që dëshmojnë karakterin vetjak edhe të lashtë të shqipes në rreth të idiomave të kësaj familjeje gjuhësore. Shihet këndej rëndësia që merr etimologjia shqiptare edhe për gjuhësinë e përgjithshme indoevropiane.

Gjithashtu në mënyrë të veçantë dhe për hetimin e gjuhëve ballkanike të lashta të zhdukura gjatë kohëve, e për gjuhësinë ballkanike në përgjithësi. Metoda e gjurmimit aty, përveç krahasimit, është edhe rindërtimi, diktimi i disa tipareve të padëshmuara në mënyrë konkrete. Aty puna e gjuhëtarit i përngjan asaj të arkeologut. Edhe ky nga disa mbeturina rrënojash, nga ndonjë hark, nga disa shtylla mbetur më këmbë, rindërton një tempull a një pallat të kohëve të lashtësisë.


Gjurmimet etimologjike përveç se për historinë e gjuhës janë me peshë edhe për historinë e popullit dhe historinë e tij kulturore. Populli shqiptar është trashëgimtar i një kulture ballkanike të lashtë.

Elementët e leksikut të shqipes të hetuara në historinë e tyre hapin shtigje për të gjurmuar elementët e kulturës popullore e të zhvillimit të saj në rrymë të kohëve. Me gjithë afrimet që ka me kulturat fqinje, kjo kulturë përmban tipare vetjake. Dhe ajo jo vetëm ka marrë prej sosh, po edhe u ka dhënë atyre nga elementët e veta, gjë që gjer më sot nuk ka qenë vënë në dukje sa duhet. Gjurmimet etimologjike janë një mjet në këtë mes për të nxjerrë në dritë këto rrethana.

Studimet etimologjike të shqipes kanë një traditë mjaft të pasur. Përveç dijetarëve të huaj, që gjuhësia shqiptare i vlerëson si duhet, do të theksohet se edhe mjaft gjuhëtarë vendës kanë lëvruar këtë fushë studimesh. Pa mundur të përmendim të tjerët, do të themi se një vend të veçantë zënë aty Kostandin Kristoforidhi dhe Aleksandër Xhuvani. E nga vargu i gjatë i arbëreshëve të Italisë sidomos Dhimitër Kamarda edhe Marko La Piana.

Nga studimet në këtë fushë, a dalin të dhëna me interes që dëshmojnë për njësinë e gjuhës e të kulturës sonë kombëtare në periudhat e ndryshme të historisë? Gjurmimi i historisë së fjalëve ç'na tregon për traditat e gjuhës sonë të shkruar dhe për punën e frytshme të zhvilluar nga autorët tanë për përpunimin dhe pasurimin e vijueshëm të saj?

Burimet kryesore për studimin e fjalëve të gjuhës në zhvillimin e tyre historik janë, sikundër u tha, shkrimet letrare, sidomos ato më të vjetrat, edhe gjuha e gjallë me dialektet e saj. Të dyja këto burime japin dëshmi për karakterin e njësisë të gjuhës dhe bashkë me të edhe të kulturës popullore. Ka forma fjalësh që janë të barabarta në ligjërimet e Kosovës dhe në Çamëri, kjo për arsyen e ditur në gjuhësi që në një truall gjuhësor të caktuar anët, skanjet, ruajnë tipare më të lashta. Gjithashtu ka forma dhe kuptime fjalësh të dialekteve veriore e të autorëve të vjetër të Veriut që janë të ngjashme me ato që ndeshen në ligjërimet arbëreshe të Greqisë a të Italisë dhe te shkrimtarët e tyre. Këto të gjitha dëshmojnë për një



njësi brenda ndryshimeve.

Njësia gjuhësore ndërkaq pasqyron një njësi kulturore. Me gjithë ndryshimet krahinore që shfaqen, si kudo, edhe përbrenda trevave shqiptare në këtë fushë, një dije në vështrimin e mirëfilltë të fjalës, një etnografi e një sociologji objektive nuk mund të mos vënë re karakterin në analizë të fundit të njësisë të kulturës popullore.

Si në kulturën materiale, si në kulturën mendore të popullit tonë, ka elemente të përbashkëta të pamohueshme. Ata integrohen në një bashkësi më të madhe ashtu si integrohen dialektet në bashkësinë gjuhësore. Studimi historik i gjuhës, gjurmimet etimologjike të kryera në formë objektive, u japin në këtë mes studimtarëve të fushave të ndryshme një mjet në dorë për të rrokur disa nga tiparet qenësore, esenciale të kësaj kulture. Kuptohet vetvetiu që kjo është me peshë edhe për kërkimet në lëmin e historisë.

Në lidhje me këto, më së fundi, do vënë në pah se tradita letrare dhe pasuria dialektore që u zunë n'gojë më sipër, nuk janë dy fusha qenësish të ndara njëra nga tjetra. Shkrimtarët shqiptarë, duke nisur që me autorët e vjetër, e mbase dhe me të tjerë që mund të kenë vepruar përpara tyre, kanë marrë vazhdimisht fjalë nga gjuha popullore. Ata shpeshherë i kanë përpunuar ato, i kanë shtënë në përdorim në veprat e tyre dhe i kanë ngritur ndonjëherë në një sferë kuptimore më të lartë. Kjo veprimtari ka vijuar pa ndërprerje dhe më vonë, ndonëse me përmasa më të vogla, edhe në shekujt para shkrimtarëve të Rilindjes. Këta ndërkaq, si në Shqipëri – edhe më parë – në Itali, duke u mbështetur dhe në traditën e mëparme, e kanë vazhduar këtë rrugë me frymë të vetëdijshme e në mënyrë të thelluar. Këtë rrugë po ndjekin edhe shkrimtarët e sotëm, me veprat e tyre në poezi e në prozë. Ata përveçse frymëzohen nga gurra e pashtershme e poezisë dhe gjuhës popullore, me drejtimet e dhëna nga Partia, synojnë edhe në pastrimin e kësaj gjuhe prej ndikimit të huaj dhe në pasurimin e saj të vazhdueshëm.

Eqrem Çabej
(Marrë nga libri me intervista: Bashkim Kuçuku Uni krijues dhe vepra, Toena, Tiranë, 2019)





Tito e ka helmuar Stalinin!?

Historiani slloven, Joze Pirjevec, pohon se Stalini ishte i helmuar nga vrasësi që është paguar nga Tito.



Josif Stalini, në vitin 1923 ia ka dërguar një letër Byrosë Politike, përmes së cilës informon se lideri tashmë i sëmurë, Vladimir Lenini, e ka kërkuar nga ai një dozë të cianidit vdekjeprurës, për t'i dhënë fund agonisë dhe vdekjes së ngadaltë.

“Nuk kam forcë për ta përmbushur kërkesën e Leninit, ndaj më duhet ta refuzojë këtë mision, pa marrë parasysh se sa human dhe i nevojshëm është”, ka shkruar Stalini.

Lenini vdiq vitin tjetër, si pasojë e sulmit në tru. Konkluzioni tek i cili kanë arritur mjekët është se Lenini me të vërtetë ka mundur të ketë sulm, si pasojë e helmimit me

cianid. Dyshohet se Stalini nuk ka ngurruar ndaj kërkesës së Leninit sidomos pasi ai, në rast të vdekjes së tij, do ta merrte kontrollin e Bashkimit Sovjetik.

Këtë fakt, si pikënisje për tezën e tij, e përdori historiani slloven Joze Pirjevec, i cili kohët e fundit botoi biografinë e Titos, “Tito in tovarisi” (Tito dhe shokët), që ndjek 27 vjetët e tij në pushtet. Biografia është bazuar në dokumentacion të gjerë, nga arkiva të shumta, shumë prej të cilave janë neglizhuar dhe injoruar më parë.

Në mesin e shumë zbulimeve të tij, Pirjevec thotë se Tito, sipas të gjitha gjasave, ka urdhëruar

vrastjen e Stalinit me helm, i cili helm ka shkaktuar më vonë sulmin e tij në tru. Ai thotë se Tito e urdhëroi vrasësin për ta helmuar Stalinin, në të njëjtën mënyrë siç ka kërkuar Lenini. Ndërsa, shumica thonë se nëse Stalini e ka vrrarë Leninin e Tito Stalinin, në këtë mënyrë ka vepruar drejtësisht: Kur Stalini vdiq më 5 mars 1953, në zyrën e tij është gjetur letra paralajmëruese e Titos.

Dihet paraprakisht se Stalini nja 22 herë u përpoq ta vriste Titon, sepse ata nuk pajtoheshin, që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Por, të gjitha përpjekjet e këtyre atentateve kanë dështuar, përfshirë rastin kur Stalini ia ka

dërguar një kuti për bizhuteri e cila kur hapej lëshonte gaz nervor. Në letrën e tij Tito ka paralajmëruar Stalinin se ai (Stalini) mund të dërgojë sa të dojë vrasës, por se atij (Titos) i mjafton vetëm një...

Historia fillon më 28 shkurt 1953, atëherë kur Stalini i lodhur e lëshon kabinetin dhe tërhiqet në shtëpinë që ndodhej në periferi të Moskës. E zhvilloi një takim me bashkëpunëtorët e tij më të afërt, përfshirë kreun e policisë sekrete, si dhe Nikita Khrushchevin – shefin e atëhershëm të partisë për Moskën.

Sipas të dhënave historike, takimi zgjati deri në orën katër të mëngjesit dhe asnjë prej të pranishmëve nuk vërejti se Stalini ndjehej keq. Stalini sigurimit pastaj ia dha “lirinë”, duke i urdhëruar që të mos e zgjojnë nga gjumi.

Zakonisht, Stalini është zgjuar në ora 06:30 të mëngjesit. Atëherë e ka ftuar sigurimin që t'ia sjellin një çaj. Por, kjo nuk ndodhi kështu. Derisa truporjat ishin të shqetësuar, nuk kanë harruar se janë urdhëruar që të mos e zgjojnë. Në atë kohë, shpërfillja e urdhrave ndëshkohej madje edhe me ekzekutime.


Ata gjetën Stalinin të shtrirë në dysheme, të palëvizshëm, pa fuqi për të folur. Ishte ende gjallë. Ora e tij e thyer ishte ndalur në 6:30, gjë që tregon se në atë kohë e kishte pësuar sulmin.

Sigurimi edhe atëherë nuk guxonte që ta ftonte mjekun, nga frika se i tejkalojnë kompetencat që i kanë. Pas reflektimit të gjatë, e telefonuan ministrin e Sigurimit të Shtetit, i cili e ftoi shefin e policisë sekrete. Tek atëherë ka arritur mjeku (shumë historianë sot besojnë se ata qëllimisht e vonuan ardhjen e tij).

Kur mjeku erdhi, Stalini ishte i paralizuar, pjesërisht, ndërsa vllite gjak. Çdo gjë tregonte se ai ka përjetuar një sulm të rënd në tru. Stalini jetoi në agoni për disa ditë, për të vdekur më 5 mars, si rezultat i problemeve me frymëmarrje.

Pirjevec thekson se Stalini ishte i shqetësuar seriozisht në lidhje me kërcënimin e Titos, ndonëse mendimi i pranuar, botërisht, e që mbizotëron edhe sot, është se Stalini kishte edhe më herët sulme të tilla në tru dhe se sulmi i fundit nuk ishte befasues për askënd. Por, kur në vitin 1955 Khrushchevi e viziton Beogradit, ai i ka kërkuar falje Titos për të gjitha atentatet, ndërsa i jep mirënjohje që ka mbijetuar.

“Vërtet jeni ruajtur mirë. Keni njerëz të mirë rreth vetes, spiunë të mirë të cilët e dinin çdo qëllim të Stalinit”, ka thënë Khrushchev. “Stalini e dinte gjithmonë se sa mirë më ruajnë. Pas paralajmërimeve se ka dërguar shumë vrasës, është e qartë se edhe ai ka pas pak frikë”, ia kthen Tito.



Kënga që bashkon dhe 'ndan' amerikanët

Gjithëpërfshirëse dhe patriotike, me rrënjët në të majtën radikale, kënga më e njohur popullore nga Woody Guthrie na jep një vizion të gjerë për amerikanët, shkruan Dorian Lynskey



Në serinë televizive të vitit 2020, "Znj. Amerika", Sarah Paulson luan rolin e një amvise (të trilluar) anti-feministe të viteve 1970, Alice Macray, që bën fushatë për të penguar ratifikimin e Ndryshimit të Drejtave të Barabarta. Në episodin e parafundit, Alice merr pjesë në Konferencën Kombëtare të Grave, më 1977 në Hjuston, me synimin për të sabotuar platformën e Konferencës, por një pilulë misterioze e bardhë e dërgon në një udhëtim përrallor. Në një moment, ajo e lumtur këndon këngën e Woody Guthrie, "This Land Is Your Land" (Kjo tokë është toka jote). E ngazëllyer, i thotë një aktivisteje feministe se e këndon në shtëpi, bashkë me fëmijët e saj. Aktivistja i përgjigjet se një socialist e ka shkruar. Alice qesh. "Ej, mos u bëjë qesharake!" Kur aktivistja këmbëngul se është "këngë marksiste", Alice reagon: "Oh jo, jo, jo. Është patriotike". Aktivistja buzëqesh. "Pikërisht."

Është kjo një skenë e vogël që tregon se si dy kundërshtarë politikë mund të lidhen me vizionin e Guthrie për Amerikën, por gjithashtu ngrë dilemë në lidhje me domethënien e një kënge kaq të famshme që është përshkruar edhe si "himn alternativ kombëtar".

Woody Guthrie e kaloi një jetë klasike amerikane, të mbushur me aventura, idealizëm dhe tragjedi. Lindi në Okemah të Oklahomës më 1912. Babai i tij Charley ishte pronar tokash që kishte aspirata politike, por fati nuk shkoi në favor të Guthrie. Një zjarr në shtëpi, më 1919, vrau motrën e madhe të tij, Clara. Një tjetër ngjarje e vitit 1927 e dërgoi nënën e tij Nora në një institucion mendor. Për ta marrë veten, Charley u zhvendos në Pampa të Teksasit ku i kërkoi djalit që t'i bashkohej dy vjet më vonë.

Woody i ri ishte autodidakt, një shoumen i lindur dhe një shpirt rebel. Edhe pse kishte grua dhe fëmijë në Pampa, u tërhoq nga jeta endacake, duke bredhur e udhëtuar nëpër Perëndimin amerikan e duke shkruar këngë për jetët e shkatërruara që kishte hasur. Në Kaliforni u zemërua nga trajtimi i pashpirt i migrantëve ekonomikë, të

njohur si 'Okies'. Vajza e tij Nora më vonë do të thotë se ai "e mësoi socializmin në autostradat e Amerikës". Në vitin 1937 u transferua në Los Anxhelos, ku merr famë lokale si këngëtar protestues dhe si moderator radioje. Pasi një shfaqje e tij u anulua, vendosi të provonte fatin në Nju-Jork, ku shkoi në shkurt të vitit 1940.

Ishte ky viti më i rëndësishëm i jetës muzikore të Guthrie. Atë pranverë gjithçka ndryshoi. U shfaq në skenën e Nju-Jorkut, ndërsa takoi koleksionistin e këngëve popullore, Alan Lomax, si dhe një këngëtar të ri me emrin Pete Seeger. Aty nisi të shkruajë atë që më 1943 do të jetë autobiografia e tij, "Bound for Glory" (Të bashkuar për lavdinë). Punoi me Lomaxin dhe Seegerin në një libër me këngë popullore protestuese, "Hard-Hitting Songs for Hard-Hit People" (Këngë goditëse për njerëzit e goditur). Dhe, e incizoi albumin debutues me Lomaxin si producent, "Dust Bowl Ballads" (Baladat e stuhisë së rërës).

Guthrie ishte me fat që shkoi në Nju-Jork, një javë pas premierës së versionit filmik të bestsellerit të John Steinbeckut të vitit më 1939, "The Grapes of Wrath" (Frytet e zemërimit). Ai u pa si një Tom Joad real (kryepersonazh i veprës - v.j.), një "Okie" nga "stuhia e rërës", me këngë njerëzore të farkëtuara në kazanin e Krizës së Madhe Ekonomike. Koncerti i tij u quajt "Mbrëmja e fryteve të zemërimit", ndërsa Steinbeck e lavdëroi Guthrien me parathënien për albumin e tij: "I këndon këngët e njerëzve dhe unë dyshoj se ai është, në një farë mënyre, ata njerëz".

Para gjithë kësaj, më 23 shkurt, Guthrie u ul në hotelin e lirë "Hanover House" në Nju-Jork, ku shkroi gjashtë strofat e një kënge që e quajti "Zoti e ka bekuar Amerikën". Siç e bën të qartë titulli, ishte një kundërsulm ndaj një kënge që e shqetësonte: "God Bless America" (Zoti e bekoftë Amerikën) nga Irving Berlini. Një emigrant hebre rus ishte mirënjohës për sigurinë e atdheut të ri që e pranoi, për krahasim nga makthi që përfshiu Evropën. Berlini e bëri këngën si një 'lutje' për ShBA-në dhe për paqen. Kur këngëtarja Kate

Smith e dha në emisionin e saj në radio, më 11 nëntor 1938 (20 vjetori i Ditës së Armëpushimit), menjëherë u pëlqye, por jo nga Guthrie. I lodhur nga dëgjimi i incizimit i Smithit që jepej në çdo radio dhe çdo xhuboks në Nju-Jork, u nxit të shkruante një lloj tjetër himni patriotik.

Kënga e Guthrie nuk ishte tamam parodi, por e sfidoi Berlinin. Derisa "Zoti e bekoftë Amerikën" e vendos vendin mbi popullin, përgjigjja e Guthrie i vë njerëzit në radhë të parë: "Kjo tokë u krijua për ty dhe për mua". Derisa lirika e shkurtër e Berlinit skicon peizazhin e ShBA-ve në dy rreshta ("Nga malet te preritë / në oqeanë e bardha nga shkuma"), vargjet e Guthrie përfshijnë pyje, lugina, shkretëtira, fusha gruri, autostrada dhe qytete të vogla. Ai e përfundoi çdo rresht me "Zoti e bekoftë Amerikën për mua", por duket se kishte mendime tjera duke e ndryshuar titullin me "Kjo tokë". Në fund të faqes ka shkruar: "Gjithçka që mund të shkruash është ajo që shikon".

Çuditërisht, Guthrie nuk e dinte se çfarë kishte në duar. Ky nuk ishte draft i egër që kërkonte rishikime të mëdha, por nuk ishte në mesin e dhjetëra këngëve që incizoi me Lomaxin në vitet '40. Në fakt, për katër vitet e ardhshme e injoroi. Tek në prill 1944, Guthrie e kujtoi tekstin "Kjo tokë është toka jote" gjatë një incizimi me inxhinierin e zërit Moe Asch. Atë dhjetor e bëri melodinë, për emisionin e tij javor në radion WNEW. "Do ta këndoj një këngë që do t'ju dëshmojë se kjo është bota juaj", u tha dëgjuesve.

"Kjo tokë është toka jote" u lansua në një kompilacion të vitit 1951. Ashtu si "Hallelujah" e Leonard Cohenit, nuk ka një version të vetëm përfundimtar. Dy nga strofat e vitit 1940 ranë

nga kënga. Dikush sugjeron që ShBA-ja i përket të gjithëve, pavarësisht nga pronësia e tokës: *Atje ishte një mur i madh i lartë që tentonte të më ndalonte. Një tabelë ishte ngjyrosur me: Pronë private. Por, në anën e pasme, nuk tha asgjë* -

[Kjo tokë është krijuar për ty dhe mua.] Strofa tjetër paraqet dyshim në vizionin optimist të këngës, duke përshkruar një skenë nga Kriza e Madhe Ekonomike *Në një mëngjes me diell të ndritshëm në hijen e pjerrësisë. Nga zyrat për ndihma pashë njerëzit e mi - Teksa rrinin atje të uritur, Qëndrova atje duke menduar në s e [Kjo tokë është krijuar për ty dhe mua.]*

Kur Guthrie publikoi tekstin në broshurën e tij të vitit 1945, "Ten of Woody Guthrie's Songs" (Dhjetë nga këngët e Woody Guthrie), ai shtoi strofën e fundit që afirmon mesazhin e këngës:

Askush që jeton nuk mundet kurrë të më ndalojë, Teksa vazhdoj të eci në autostradën time të lirisë. Askush që jeton nuk mund të më shtyjë të kthehem prapa. Kjo tokë është bërë për ty dhe për mua.

Teksa kënga flet për barazinë, incizimi i vitit 1944 përjashtoi strofën nga zyrat e ndihmave dhe versioni i vitit 1951 humb të dy strofat radikale, ashtu si pamfleti i vitit 1945. Në vitin 1950, botuesi i Guthrie, Howie Richmond, licençoi këngën për përdorim në librat shkollorë, për vetëm një dollar, gjë që e bëri një këngë virale. Por, e përdori versionin korrekt politik - kuptohet, duke pasur parasysh rritjen e Mekartizmit (kampanja kinse kundër komunistëve e nxitur nga senatori Joseph

McCarthy - v.j.). Pra, versioni që Alice Macray e këndonte me fëmijët e saj e errëson politikën e Guthrie.

Por, cila ishte ajo politikë? Një nga kërkimet kryesore në Google për "Kjo tokë është toka jote" është kjo pyetje: "A është këngë komuniste?" Woody kishte një shaka për këtë: "Nuk jam domosdo komunist, por kam qenë i kuq gjatë gjithë jetës time". Teksa është e vërtetë se kurrë nuk iu bashkua Partisë Komuniste Amerikane (CPUSA), gjatë viteve 1938 dhe 1939 interpretoi për mbledhje fondesh dhe shkroi një kolumne për gazetën "People's World". Për partinë, ky zë autentik karizmatik nga zemrat e klasës punëtore, ishte dhuratë nga perëndia, sepse komunistët amerikanë ishin në një fazë të rimarrjes së patriotizmit, në vend të refuzimit. CPUSA dha mbështetje për Marrëveshjes e Re të presidentit Roosevelt, duke thënë: "Komunizmi është amerikanizmi i shekullit XX". Guthrie, një kuazi-komunist që vazhdoi të shkruante këngë patriotike, mishëronte këtë në një mënyrë, ndaj "Kjo tokë" përfaqëson diçka që e majta shpesh e lufton për të arritur: patriotizmin radikal për masat. E popullarizuar tashmë nga librat shkollorë, "Kjo tokë është toka jote" merr rëndësinë politike në vitet 1960 përmes ringjalljes së muzikës popullore dhe lëvizjes për të drejtat civile. U këndua nga shumë dhe kudo. Sepse, ashtu si heroi i tij Walt Whitman, Guthrie synonte të mishëronte të gjithë amerikanët. "Gjaku im rreh spanjisht dhe fryma më digjet në mënyrën indiane e shpirti më zien zi", shkroi ai në një poezi të pabotuar të vitit 1950. Prandaj, "Kjo tokë është toka jote" është këngë e gjallë: një tekst i rrjedhshëm që mund të pranojë vizione të shumta të Amerikës dhe të amerikanëve.



Në vendin e parë prej disa vitesh: Ky është vendi më i mirë në botë për cilësinë e jetës!

Sipas Indeksit të Zhvillimit Njerëzor të Kombeve të Bashkuara (HDI), Norvegjia është votuar si vendi më i mirë në botë për cilësinë e jetës.

As Britania e Madhe apo SHBA-ja, nuk janë në dhjetëshen e parë, ndërsa Norvegjia ka qëndruar në vendin e parë për disa vite.

HDI rendit një vend në varësi të jetëgjatësisë së tij, viteve të pritshme të shkollimit, viteve mesatare të shkollimit si dhe të ardhurave bruto ndërkombëtare (GNI).

Për Norvegjinë, jetëgjatësia e saj është më e larta nga 189 vendet në indeks, me një mesatare prej 82.4 vjet. Ndërkohë, Britania e Madhe ishte 81.3 vjet, dhe SHBA ishte 78.9.

Në vendin e dytë ishte Republika e Irlandës me një jetëgjatësi mesatare prej 82.3.

Në vendin e tretë është Zvicra, ndjekur nga Hong Kong, Islanda, Gjermania, Suedia, Australia, Holanda dhe Danimarka.

Mbretëria e Bashkuar erdhi në vendin e 13, ndërsa Shtetet e Bashkuara në të 17-in.

Rank	Country	HDI value (2019)	Life expectancy at birth (years) SDG3	Expected years of schooling (years) SDG 4.3	Mean years of schooling (years) SDG 4.6	Gross national income (GNI) per capita (PPP \$) SDG 8.5
1	Norway	0.957	82.4	18.1	12.9	66,494
2	Ireland	0.955	82.3	18.7	12.7	68,371
2	Switzerland	0.955	83.8	16.3	13.4	69,394
4	Hong Kong, China (SAR)	0.949	84.9	16.9	12.3	62,985
4	Iceland	0.949	83.0	19.1	12.8	54,682
6	Germany	0.947	81.3	17.0	14.2	55,314
7	Sweden	0.945	82.8	19.5	12.5	54,508
8	Australia	0.944	83.4	22.0	12.7	48,085
8	Netherlands	0.944	82.3	18.5	12.4	57,707
10	Denmark	0.940	80.9	18.9	12.6	58,662





Thëniet e Faik Konicës, aktuale edhe sot

Klasës politike aktuale shqiptare dhe të gjithë shqiptarëve kudo, Faik Konica u thotë:

“Duke parë dhe duke dëgjuar, bota mësojnë mend dhe ndërtohen. Ne shqiptarët, s’marrim dot mësim; malet të tunden dhe të rrëkëllehen, ne nuk këmbejmë mënyrën tonë. Mbani mirë (mend) këtë që po ju them: në njëqind vjet, në vafshim si po vemi, do të jemi aq poshtë sa edhe sot”.

“Sa e sa marrëzi, sa e sa poshtërsi e krime janë bërë në emër të së gjorës Shqipëri”.

“Armiqtë e Shqipërisë janë shqiptarët, jo të tjerë. Shqiptarët kanë shkruar me gjakun e tyre më tepër se një faqe në histori të Evropës.”

Gjithë shqiptarët kudo dhe pa dallim, Faik Konica do i këshillonte:

“Të përpiqemi me të gjitha forcat tona të shërojmë shqiptarët nga dashuria për individët. Ata duhet të mësojnë të duan Shqipërinë – jo për t’i bërë qejfin këtij apo atij shqiptari”. (Albania’ 16, 15-30 korrik 1898).

Për ata që thonë se 30-vjet post-komunizëm nuk mjaftojnë për të vendosur një demokraci të vërtetë

perëndimore, Faik Konica u thotë:

“Tek prisnim të piqeshin kushtet, na u kalbën dëshirat.”

“Politika e vërtetë qëndron në kapjen e drejtimit të një evolucioni të caktuar dhe në përpjekjen për të ndihmuar në përshejtimin e fundit të tij”. (Albania’ 11, 1898).

Për ata që rininë e quajnë “huliganë”, Faik Konica u thotë:

“Rinia është në sytë e injorantëve kërcënim për të ardhmen; por është edhe rrezik për të tashmen, sepse rinia është e çiltër, ndërkohë që dhe çiltërsia është armiku i natyrshëm i sharlatanëve”. (Albania’ 5, 1905).

“Populli është i duruar, po gjer në një pikë: e kur kupton dhe e zë zenga, tërbimi i tij bën çudira të shëmtuara”.

Për ata që nuk kuptojnë ose nuk duan të pranojnë zemërimin e njerëzve, në kohë të vështira, Faik Konica u thotë:

“Si mos të dëshpërohesh në këtë vend, ku të pasurit nuk ndihmojnë dhe të varfërit nuk punojnë?”

Për opinionistët dhe analistët e TV-studiove të sotme shqiptare,

Konica do të thoshte:

“Shumica e atyre që kanë marrë mbi vete misionin modest ‘të ndriçojnë opinionin publik’ as që kanë ndjesinë më elementare ta nisin fillimisht nga vetvetja për t’u mirinformuar. Venë e vënë në përdorim mënyra huluntimi të cilat, sikur të zbatoheshin në çdo shkencë, do bënin për të qeshur edhe një nxënës shkollë”. (Albania’ 6, 1905).

“Frikacaku i ka tërë karakteristikat, dhe kryesisht këtë: hakmerret ndaj përbuzjes së tjetrit nëpërmjet sharjes. I pafuqishëm, veç flet keq e shan poshtërsisht të tjerët”. (Albania’ 5, 1905).

“Ka njerëz që shitën në guverna për të pështyr gjënjehtra. Ka të tjerë që marrin ndihmë nga një guvernë për të thënë të vërteta që ndryshe nuk mund t’i thonë”. (Albania’ 2, 1899).

“Ka pasur në çdo kohë, dhe përherë do ketë individë të gatshëm për të folur e shkruar lidhur me çështje për të cilat nuk ia kanë haberin të shprehin as fjalën e parë. Por për mendjet e matura, të etura për të studiuar seriozisht një vend e një popull, nuk ka dhe nuk do të ketë veçse dy metoda në përdorim, jashtë së cilave

gjithçka tjetër nuk është veçse mashtrim: metoda e parë ka të bëjë me ndërmarrjen e udhëtimeve për të bërë anketime të hollësishme e sistematike drejtpërdrejt në vend; e dyta, me leximin sa më shumë që të jetë e mundur të broshurave e librave të lidhura me çështjen konkrete, me qëllim që të arrihet nëpërmjet induksionit – përmes një morie dokumentesh, faktesh dhe pohimesh kontradiktore – të veçohet e vërteta dhe të koordinohet një tërësi pikëpamjesh të qarta e objektive”. (Albania’ 6, 1905).

Akademikëve dhe studiuesve, Faik Konica u thotë:

“E vërteta nuk ka nevojë për stil gjarpërues e të yndyrshëm të shkrimeve akademike”. (Albania’ 2, 1897).

Atyre që bëjnë sehir ndaj të këqijave të shoqërisë, urrejtjeve dhe armiqësive, Faik Konica u thotë:

“Urrejtja nuk çarmatoset nëpërmjet heshtjes e asnjansisë”. (Albania’ 12, 1909).

“Një i mbushur me mllëf e mëri, në mendjen e tij anemike, rrokullis mendime të tmerrshme”. (Albania’ 9, 1898).

Apologjetëve të komunizmit të Enver Hoxhës, 30-vjet post-komunizëm, Faik Konica u thotë:

“Dallimi në kulturë shpjegon dallimin në mendime” – “Nuk mund të pretendosh të përfitosh nga tërë dobitë e lirisë, duke ruajtur njëkohësisht tërë privilegjet e tiranisë. Për të pasur institucione të lira, duhen luftuar mendimet nëpërmjet mendimeve”. (Albania’ 5, 1907).

“Të verbrit do të mbeten të verbër in saecula saeculorum (gjer në fund të botës); edhe sikur t’u shtini perona në sy, ata prapë nuk do shohin kurrjë”. (Albania 1, 1897).

Përfaqësuesve të partive politike shqiptare, Faik Konica do u thoshte të mënjanojnë urrejtjet:

“Urrejtja partiake shpesh merr përparësi ndaj instinktit kombëtar”. (Albania’ 2, 1904).

Atyre që po shkatërrojnë bukuritë e natyrës së Shqipërisë (Valbona, Vjosa) për përfitime ekonomike, Faik Konica u thotë mos urreni bukuritë që Perëndia u ka falur shqiptarëve:

“Shqipëria është një vend i bekuar me njëmijë bukurira, shkelur nga turmë e cila ushqen njëfarë urrejtje ndaj bukurisë”.

/Nga: Frank Shkreli/



“M'u duk vërtet prekëse”

Ato po mbanin homazhe për gjyqtaren Ruth Bader Ginsburg në 26 shtator të këtij viti. Ishin mbështetëset konservatore të gjyqtares Amy Coney Barret duke u lutur në dyert e gjykatës.

"Ishte interesante sepse njerëzit po shëtisnin rreth saj dhe u kërkonin miqve të tyre të bënin fotografi sikur të mos e kishin vënë re atë grua që qante atje në Gjykatën e Lartë", thotë Schaff. "Unë u ula atje për një kohë, duke parë, dhe pastaj këto katër gra u ngritën dhe ngritën duart lart. Unë pashë dorën e saj në fytyrë, përbërjen e saj dhe dualitetin e emocioneve që të gjitha ndjenin. Dukej vërtet prekëse për mua".



“Ajo ditë formësoi gjithë vitin tim”

Kur George Floyd u vra nga policia në Minneapolis ishte e hënë. Deri të premten, Amerika ishte ndryshe. Malike Sidibe, 23 vjeç, u zhvendos për të marrë pjesë dhe fotografuar një protestë për herë të parë në jetën e tij. Në Brooklyn, më 29 maj, ai pa protestuesit që luftonin me policinë. Sidibe thotë sot: "Ajo protestë ndryshoi mënyrën se si unë e shikoj botën."



“Është e vështirë të zbulosh se çfarë dinte ai”

Fotografi Peter van Agtmael ka ndjekur Donald Trump dhe tubimet e tij që nga viti 2016. "Fillova të mësohesha disi me mënyrat e tij dhe shprehjet e tij, të cilat kishin një lloj qëndrueshmërie. Edhe brenda spontanitetit dhe lëvizjes së tij të lirë, kishte qëllim dhe kontroll", thotë fotografi.

Më 4 nëntor, menjëherë pas mesnatës dhe me pritjen që vota që mbetej për t'u numëruar (fletëvotimet postare dhe votat e hershme) do të ndryshonin rezultatin, van Agtmael hyri në një dhomë të Shtëpisë së Bardhë shumë, shumë të heshtur. Trump u drejtohej votuesve amerikanë, por mes gamës standarde të shprehjeve të tij kishte tension. "Kishte gjithashtu një tension të qartë, stres dhe zemërim dhe për një moment, kur zv.presidenti Mike Pence po fliste, ai lloj kontrolli rigoroz i disa prej emocioneve të tij ra për vetëm disa sekonda".

“Me të vërtetë dukej si një shfaqje e forcës”

Më 13 mars, disa javë pasi Shtetet e Bashkuara dhe Talibanët nënshkruan një marrëveshje paqeje, fotografi me qendër në Kabul, Jim Huylebroek dhe kolegët e tij shfrytëzuan qetësinë e luftimeve për të vizituar kryengritësit në provincën lindore Laghman. Gjatë rrugës, automjeti i tyre u ndalua nga një Njësi Talibanë. "Ata na trajtuan në një mënyrë miqësore, por gjithsesi tensioni ndihej," thotë Jim. Ndërsa gazetarët përgatiteshin të vazhdonin rrugën, dy fëmijë ecën rrugës dhe kaluan mes luftëtarëve. "Për mua," thotë Huylebroek, "kjo tregon realitetin e ashpër në të cilin rriten fëmijët."



“Askush nuk mund ta prekte atë”

Hector Retamal, një fotograf i AFP me seli në Shanghai, arriti në Wuhan me tren më 23 janar, ndërkohë që qyteti po bllokohej. "Wuhani ishte bërë me të vërtetë një qytet fantazmë", kujtoi ai në fillim të këtij viti. "Njerëzit në rrugë ishin të paktë: për të blerë ushqim, për të shkuar në një farmaci ose për në spital."

Më 30 janar, Retamal dhe një koleg i tij po ecnin pranë një spitali kur panë një burrë në tokë, një bllok larg spitalit. "Ishin dy gra që shikonin burrin pa bërë asgjë. Kur na panë, na bërtitën. Më duket na thanë që të mos afroheshim më pranë se mund të infektoheshim", kujton Retamal. Pas pak, mbërritën të tjerët me kostume mbrojtëse; ata iu afruan burrit, por nuk e prekën.



10 fotot e vitit 2020, sipas Time

Teksa viti ikën është e vështirë të kujtohet gjithçka që kemi jetuar përgjatë tij, por janë pikërisht fotot ato që i thërrasin kujtesës. Ndaj "Time" ka publikuar 10 fotot e 2020-ës, me një titull dhe një shpjegim përkrah.



"Një dritë në mes të errësirës"

Kjo foto është shkrepur gjatë pranverës në Brooklyn. Qëllimi ishte sensibilizimi i njerëzve dhe tregimi i së vërtetës, që virusi Covid-19 vret. Më 22 prill, Meridith Kohut fotografoi Kyle Edwards duke kontrolluar me fener nga brenda një prej frigoriferëve rimorkio që mbante kufomat e virusit. "Secila qese me një trup të pajetë përfaqësonte caq shumë dhimbje dhe vuajtje, jetë të humbura dhe familje të shkatërruara", thotë Kohut.



"Ajo nuk donte ta lëshonte"

Më 24 maj, motra e fotografit Al Bello e telefonoi për t'i thënë se familjarët e saj do ta vizitonin në Wantagh, N.Y., dhe donin ta përqafonin të gjithë; një qese plastmase e varur nga një litar rrobash do të shërbente si një barrierë mbrojtëse mes tyre. Kurioz, ai shkoi atje. Pasi Mary Grace takoi nipin e saj në "stacionin e përqafimit", ajo filloi të qante. Takimet e tyre zgjatën për 45 minuta.



"Trishtimi dhe zemërimi i tyre ishte i vërtetë"

Në një xhami në Teheran, më 5 janar, gratë iraniane vajtojnë Kasem Soleimani pas vrasjes së tij në Bagdad. "Ato ndiheshin të lënduara dhe donin të hakmerreshin", kujton fotografja Newsha Tavakolian. Brenda, atmosfera ishte e fortë. "Kam kërkuar gjatë se si mund ta kapja këtë moment dhe gjeta këtë skenë, një moment të qetë mes një vorbulle njerëzish. Gruaja duke ngritur grushtin ndërsa mban posterin, të tjerat në mendimet e tyre. Ato po endeshin përreth, vetëm me ndjenjat e tyre".



"Mbeti pas zjarrit"

Pas zjarrit në Australi kjo koala ishte tharë nga zjarri. Një vullnetar i hodhi ujë sipër për ta hidratuar. Në atë zjarr u dogjën mbi 3 miliardë kafshë. Foton e shkrepri Adam Ferguson.

"S'mund ta harroj fytyrën e saj"

Hoda Kinno, 11 vjeçe, po mbahej në krah nga xhaxhai i saj Mustafa pas një shpërthimi masiv në portin e Beirutit, më 4 gusht. "Kur arrita në vendndodhje, nuk mund të besoja atë që po shihja", shkruan fotografi Hassan Ammar. "Po bëja fotografi të gjithçkaje kur pashë burra që mbanin dy vajza të plagosura në autostradën përballë portit. Unë ndoqa njërin derisa arritën në një automjet ushtarak që ishte duke u ngarkuar me njerëz të plagosur për t'u evakuuar në një spital.

Në ditët më pas, Ammar mbeti kureshtar se si kishte shkuar më tej gjendja e saj. U deshën rreth dy javë, por Ammar e gjeti familjen në jug të kryeqytetit. Shpërthimi i kishte shkatërruar ata. Associated Press raportoi se Hoda pësoi një thyerje të qafës dhe dëmtime të tjera, kurse motra e saj 15-vjeçare, Sedra, u vra. "Ajo ditë në Bejrut është një ditë që ndryshoi jetën tonë", shton Ammar, "më ndryshoi mua si njeri dhe fotograf".





Çfarë mësuam nga viti 2020?

Pandemia dhe izolimi e ka bërë jetën të vështirë për të gjithë ne, ku shumë njerëz kanë ndjerë efektet e të mos qenit në gjendje të shohin të dashurit e tyre, ose kanë humbur punën. Por gjithashtu kjo situatë, na ka mësuar shumë për atë që është me të vërtetë e rëndësishme për ne. Nëse shikojmë prapa, kuptojmë atë që kemi fituar nga ky vit befasues, që ka ndryshuar jetën në shumë mënyra.

Kënaqësi nga e zakonshmja

"Me më pak shpërqendrim dhe duke ngadalësuar ritmin e jetës, na është dashur të shohim zakonet tona dhe të zbulojmë se sa e rëndësishme është të qëndrojmë të shëndetshëm dhe të motivuar", thotë Ali McDowall, bashkëthemelues i The Positivity Planners. "Kemi gjetur vlera duke u përqëndruar në ritualet e thjeshta që na sjellin gëzim, ato momente që shpesh kalojnë pa u vënë re. Ne gjithashtu kemi kuptuar që vetë-kujdesi është me të vërtetë vetë-ruajtje."

Mirënjohja

"2020-a ishte kaq 'zbuluese', jo vetëm në një shkallë globale, por në një shkallë personale," vëren psikologu Dr Tony Ortega. "Çfarë keni mësuar për veten tuaj që mund ta përdorni edhe në 2021-shin? Cilat gjëra ju ka marrë malli për t'i bërë gjatë 2020-ës dhe si pasojë e

kësaj, keni një ndjenjë të rritur mirënjohjeje?" Ecni në vitin e ri me atë mirënjohje dhe motivim të shtuar për të bërë këto gjëra (kur mundeni) dhe me vetëdije të plotë se sa të fortë jeni në të vërtetë. Shumë prej nesh nuk e dinin se sa të fortë ishim para vitit 2020, tani e dimë më mirë.

Një vlerësim për të tashmen

"Shumë mësim të paçmueshme për ndryshimin e jetës mund të nxirren nga fatkeqësia dhe 2020-a na ka mësuar rëndësinë e të jetuarit tani, pasi është praktikisht e pamundur të planifikosh për një të ardhme të pasigurt," thotë psikoterapistja Keeley Taverner nga Key for Change. Ne mësuam vlerën e të jetuarit më thjeshtë dhe të vendosim përparësi të asaj që ka rëndësi dhe të lëmë atë që nuk na shërben. Në fund të fundit, fatkeqësia zbulon se siguria është e paparashikueshme dhe ndryshimi është i pashmangshëm.

Prioritetet tona

"2020 na ka dhënë më shumë kohë për të vlerësuar dhe rivlerësuar jetën tonë. Ndërsa punonim nga shtëpia, njerëzit kanë pasur pak më shumë kohë për t'u përqëndruar në gjendjen e tyre personale dhe shëndetin mendor"-vëren Jemma Thomas, themeluesi i Jemma's Health Hub. "Shpresoj që njerëzit të



shpenzojnë më shumë energji duke bërë gjërat që duan në vitin 2021. Nuk ka të bëjë me punën; ka të bëjë edhe me veten të ndihesh mirë."

Kontrolli që kemi

"Ky ishte një vit kur të gjithë ndjenim se nuk kishim kontroll, por ky nuk ishte rasti i duhur për të dalë në këtë konkluzion"- thotë Emma Jefferys. 'Ne gjithmonë do të kemi kontroll mbi atë se kush jemi, si shfaqemi për veten dhe të tjerët, çfarë lexojmë, me kë rrimë, çfarë ndajmë, si reagojmë. Ne kemi ende në

kontroll të gjithçka, përveç rrethanave dhe kjo mund të jetë një gjë e fuqishme për t'u mbajtur mend."

'Keqardhja' mund të jetë e dobishme

Do të ishte e pamundur të mos pendoresh ose të ndjesh një element pikëllimi për përvojat që kemi humbur. "Aftësia për të patur keqardhje është një shenjë e pjekurisë emocionale dhe aftësia për të pranuar para të tjerëve se jemi penduar është një dëshmi e mëtejshme për një mendje të shëndetshme."

Një perspektivë e re

"Çdo situatë na mëson nëse jemi të gatshëm të ndryshojmë perspektivën tonë" thotë Taz Thornton. "Shumë shpesh, situata sjellin krisje të gjërave për të cilat kemi punuar shumë gjatë - marrëdhëniet, karriera, mënyra e të menduarit. Ne mund të vazhdojmë të ankohemi për situatën që na detyroi të hapim sytë, ose mund ta njohim këtë si goditja që na duhej për të krijuar ndryshime. Ndryshimi është rrallë i rehatshëm, por rezultati përfundimtar mund të jetë një jetë shumë më i mirë."

Viti i Ri gjatë fëmijërisë: Gjëra që s'do të na kthehen më kurrë!

18 ditë na ndajnë 31 dhjetori i 2020-ës dhe kjo do të thotë vetëm një gjë: shpresë për ditë më të mira dhe shumë, shumë nostalgji për Vitin e Ri 2000.

Ishte viti kur bota hyri në një shekull të ri, që do të sillte me vete një zhvillim të paparë teknologjie në të gjitha drejtimet, por kujt ja merrte mendja që dy dekada më vonë bota do ta festonte në mes të një pandemie globale?

Gjithsesi, e rëndësishme është që vazhdojmë ende të dëgjojmë "All I Want for Christmas is You", dhe shohin "Home Alone" por tashmë në Youtube, Spotify ose Netflix. Dhe meqënëse vetë jemi rritur në epokën e magnetofonit, në këtë periudhë të vitit ka ca gjëra që na rikthehen çdo herë, veçse vetëm në mendje.

Vizitat e datës 1 janar

Sa e largët dhe e pamundur na duket ajo kohë sot? Mëngjesi i datës 1 na gjente të veshur e të zbukuruar, gati për të shkuar tek nëna, te zja, halla, etj, etj. Praktikisht gjatë një dite mund

të hanim 4 copa bakllavaje gjatë ditës dhe ndalonim vetëm kur dëgjonim mamin që thoshte: "Jo jo, mos i jep se nuk i ka qejf të ëmblat".

Maratona e këngëve më të bukura të vitit në TV

Ju kujtohet se dikur në fundvit, televizionet transmetonin hit parade-n e këngëve më të bukura? "MTV" vazhdon ta bëjë, por televizionet shqiptare e braktisën këtë formulë që kur panë se njerëzit mund të krijonin një hit parade personale në Youtube.

Një pjesë të mirë të atmosferës festive e krijonte muzika me të cilën zgjohesh në mëngjesin e 31 dhjetorit, kur televizori buçiste ndërsa gjyshja ishte zgjuar që në 5 për të bërë gati gatimet e darkës së ndërrimit të viteve.

Dy kuti filmash për aparatin

Aparatet me film janë diçka e shkuar e harruar dhe me thënë

të drejtën, s'ka asgjë më letësuese se fakti që mund të bësh sa foto të duash, mund t'i rishikosh dhe të fshish ato që të pëlqejnë, dhe të mos të të duhet të presësh sa të lahen.

Megjithatë, duhet pranuar se rruga për tek fotostudio për t'i marrë më në fund, ishte një super emocion.

Dhe pozat, ah pozat!

Dhe fakti që dikush flijohej për të bërë foton dhe nuk ishte asnjëherë në fotot familjare të fundvitit. Zakonisht babi, sepse një djallush i vogël i kishte mbushur mendjen që s'di të pozojë, kështu që më mirë të merret me shkrepjen.

Koncerti i fundvitit

Një event i mirëorganizuar me skaletë, skenar dhe numra koreografikë. Fëmijët e atëhershëm kanë qenë producentë të lindur, tjetër punë se rrethanat na çuan në call center.

Më shumë afrimet dhe më shumë frymë familje: i mbani

mend kushërijtë tuaj artistë, secili me një talent të veçantë? Dhe meqë ra fjala: cili prej jush ishte Shakira?

E ngre na sa për gjithë vitin

Kur mendoj lumturinë, mendoj një tavolinë të madhe të shtruar mbarë me ushqime plot vaj, djathë, kripë, sheqer. Epo, diçka e tillë ishte darka e fundvitit atëherë kur s'e dinim ç'janë kaloritë. E mbani mend kur zgjoheshim në mëngjes dhe mami na porosiste të mos hanim shumë gjatë ditës meqë kishim darkën e madhe më vonë?

Tani që jemi rritur e kulturuar dhe e dimë ç'janë karbohidratet dhe proteinat, kërkojmë falje 100 herë përpara se ta gllabërojmë copën e bakllavasë. Java e parë pas vitit të ri është një vetëndëshkim që ne na pëlqen ta quajmë "detoks".

Mrekullia e dhuratave

Atëherë kur nuk e kuptonim se lumturia nuk është të marrësh,

por të japësh, gëzimi i hapjes së një dhurate ishte kaq i brendshëm, i sinqertë, kaq shpirtëror.

Sot që e dimë se të japësh është më bukur se të marrësh, u dhurojmë vetëm atyre që e kemi të domosdoshme, fjala vjen shefit apo mikut që të ka bërë ndonjë nder, e kështu me radhë.

Ndoshta duhet të na kishin mësuar të marrim, që tani të donim vërtet të japim.

Lumturia e pamatë kur dëgjoheshin fishekzjarret e pare

Ky ishte momenti që kishe prituri gjithë vitit. Kë e zinte gjumi, i lutej të gjithëve ta zgjonin pak përpara 12-ës për të dalë në dritare e për të shprehur një dëshirë. A thua shashka e madhe që blinte çdo vit Çimi, bos i lagjes, kishte fuqi të mbinatyrshme.

Kurse tani, një Zot e di sa shumë do të donim ndonjëherë të mund të kishte një buton "mute" për ato fishekzjarre, që të mund të flemë rehat.





Si festohet Viti i Ri në vende të ndryshme të botës

Viti i ri është festa më supersticioze që ekziston, lihet pas krahëve viti i vjetër, dhe shihet me pozitivitet drejt të ardhmes, duke shpresuar për më të mirën. Kjo ndjenjë përkthehet në veprime që kërkojnë tërheqjen e një fati të mirë.



BRAZIL

Të rinjtë vishen me të verdhë, në homazh të diellit, jetës dhe arit, simbol i bollëkut. Kryefamiljari hedh pas shpatullave një gotë verë për të larguar fatin e keq, ndërsa të rinjtë nuk heqin dorë nga notimi i mesnatës.

GJERMANI

Gjatë Vitit të ri gjermanët përdorin maska, pijnë verë të kuqe dhe hanë shumë lajthi, arra etj. Ata më tradicionalët pijnë Feuerzangenbowle, pija e vëllazërisë me bazë verë, kanellë dhe rum. Në fund të mbrëmjes lihet mbi tavolinë një pjatë plot me ushqim, për të pasur një vit të ri me prosperitet dhe bollëk.



KINË

Në Kinë viti i ri nuk festohet më 31 dhjetor, si në kalendarin grigorian, por në një ditë që ndjek kalendarin hënor, dhe që varion nga 21 janari deri në 19 shkurt. Sipas traditës gjatë festimeve vishesh me të kuqe, dhe kjo do të trembte Nian, monstrën mitologjike që në legjendë dilte nga vrima e saj çdo 12 muaj për të ngrënë njerëz, që përfaqësohen nga maskat e luanëve për të sfiluar në qytet.

JAPONI

Viti i ri është periudha që shfrytëzohet për të bërë punët e shtëpisë që zgjasin tre ditë, deri më 3 janar. Në këto ditë festohet duke falenderuar zotat për të ardhurat dhe për të mirëpritur shpirtat e të parëve shtëpia dekorohet me rrënjë pisha, bambu dhe kashtë. Për ndërrimin e viteve këmbanat e tempujve budiste bien 108 herë, për të rrëfyer mëkatet e të gjithë njerëzve.



TAJLANDE

Viti i ri tajlandez festohet mes 13-15 prillit, që përkon me vitin e ri budist. Është një nga festat më të pritura të vitit dhe më e ndjekura nga turistët. Tradita e do që të bëhen larjet e tempullit dhe fotove të Budës me ujë dhe duke pastruar me themel shtëpitë. Kjo përkthehet në një luftë uji që hidhet ndaj kalimtarëve, që sipas traditës largon fatin e keq. Për ta bërë këtë përdoret çdo gjë, që nga kallamshitet e madje deri tek elefantët.

RUSI

Në Rusi viti i ri festohet dy herë, më 31 dhjetor sipas kalendarit gregorian dhe më 13 janar sipas atij julian, dhe që quhet dhe si Viti i ri, i vjetër. Më 31 dhjetor pritet mesnata për të kërcyer e për të ngrënë ëmbëlsirën tipike, të mbushur me arra dhe salcë kosi. Në goditjen e 12-të të këmbanës hapen dyert për të pritur me gëzim vitin e ri.

Fotot më unike të GODLIS-it

Veterani i fotografisë së rrugëve, GODLIS (David Godlis), ka kap anarkinë dhe humorin e jetës së përditshme të Nju-Jurkut, që në vitet '70 të shekullit të kaluar. Libri "Godlis Streets", i publikuar nga shtëpia botuese "Reel Art Press", i dedikohet punës së tij. Më poshtë janë fotot më unike të tij



"Wall Street, 1987": Lustrimi i këpucëve jashtë varrezave të Kishës së Trinitetit. Pavarësisht nga pamja e këtyre personave, askush nuk më tha gjë. Të gjithë janë të zënë në këtë qytet. Kush e dinte nëse ishte i vërtetë ndonjë nga titujt e mëdhenj të tabloidëve njujorkezë të viteve '80, por për t'ia shtuar shijen fotove të mia i kërkoja "lajmet" më të mira.




"New York City, 1979": Vitet '70 paraqesin ditët më të çuditshme për reklama. Por, si mund të mos e bësh këtë foto? Nuk është e lehtë të jesh shenjtor në qytet.



"Veselka, the East Village, 1982": E bërë nga dritarja e asaj që dikur ishte lokal ushqimi – i quajtur "Veselka". Paramendo habinë time kur katër vjet më vonë e mora një letër me postë, nga Britania e Madhe, të vajzës në këtë foto. Ajo më gjeti pasi e ka parë njoftimin në një galeri lokale. Kjo ishte jeta para internetit. U befasona shumë kur zbulova se ajo dhe shoku i saj kishin pasë një debat të ashpër. Mendova se po argëtoheshin. Dhe, po, ia dërgova asaj një kopje. Në fakt, kohët e fundit e kontaktova atë – në internet – për t'i thënë se fotoja do të jetë në këtë libër.



"Times Square, 1980": Kjo temë vazhdon të rritet me kalimin e viteve, ndoshta duke arritur kulmin në vitin 2020 me gjendjen aktuale në Amerikë. Ai e pa një ëndërr vs kllounit Ringo!



GODLIS (David Godlis)



"New York City, 1980": Më pëlqen të përfshij fjalët në fotografitë e mia. Në këtë janë pothuajse biblike. Duke ndjekur këta të dy poshtë shkallëve të metrosë, i imagjinoja tek thoshin: 'Pra është koha e pastaj është jeta'.




“New York City, 1983”: Zakonisht fotoqrafij shpejt, kështu që askush nuk më vëren. Kjo grua, syzet e diellit të së cilës përputhen në mënyrë të përsosur me syzet 3D pas saj, po shikon paradën e Ditës së Shën Patrikut në Nju-Jork. Kështu që pjesa më e madhe e veprimit është prapa. Ajo që dua ta dini është se xhaketa e saj është e gjelbër, sepse unë fotoqrafij në bardhezi. Ishte i madhi Robert Frank që tha: “E zeza dhe e bardha janë ngjyrat e fotografisë”.



“Metropolitan Museum, 1976”: Për të bërë këtë fotografi duhet të jeni pak me fat dhe ta keni si tatu në tru shenjën “Mos pengoni”. Fotografi Lee Friedlander një herë tha: “Nuk keni pse të shkoni të kërkonte fotografi. Dilni dhe fotografitë po ju shikojnë”.



“Times Square, 1979”: Siç thashë, fotot i bëj shpejtë, me kamerë të pararendosur teksa eci në mënyrë që të mos humbas asgjë. Nuk di çfarë ndodhte këtu, apo nëse situata ishte vërtet kaq dramatike sa duket në fotografi. Nju-Jorku është qytet shumë i zënë. Por, jam i sigurt se dikush u kujdes për këtë fëmijë.



“Times Square, 1976”: Uniforma e vjetër e policisë. E bën një shkrepje, thua diçka dhe largohesh. Ditë të mbarë polic.



“St Marks Place, 1980”: Në zemër të pankut të viteve 1970-'80. Në sfond me grafitin SAMO nga Jean-Michel Basquiat, këto vajza janë ulur në shkallët e një ndërtese që dikur i përkiste Alexander Hamilton-it. Anarkia në ShBA.



“Statue of Liberty, 1974”: E bërë në pranverën e vitit 1974, në kabinën e informacionit poshtë Statujës së Lirisë, pikërisht në mes të skandalit “Watergate”. E bëra në dritë të dobët që mos vërehem. Gjashtë muaj më vonë, në gusht, presidenti Richard Nixon do të jepte dorëheqjen. Ky është suvenir i im.

5 mite të njohura për vaksinën e Covid-19, që shkencëtarët i mohojnë



Covid-19. Disa njerëz mendojnë se ARN-ja ndryshon ADN-në e njerëzve ose redakton qelizat.

"Kjo është padyshim 100% një mit," thotë Sullivan. "Ne kemi ADN në qelizat tona. Ajo që ndodh është se ADN-ja transkriptohet në ARN dhe pastaj ARNi përkthehet në një proteinë. Është e pamundur që ADN-ja të kthehet në ARN."

3.Vaksina shkakton infertilitet tek gratë, sterilitet tek burrat

"Kjo është vetëm një deklaratë arbitrare", tha Amesh Adalja. "Nuk ka asnjë provë që e ka demonstruar ndonjëherë këtë," tha ai. "Kjo është vetëm një deklaratë për të ardhur keq."

Dhe Pitzer tha se nuk ka asnjë arsye për të besuar se vaksina do

të ndikonte në aftësinë e dikujt për të pasur fëmijë.

"Nuk ka asgjë që bën biologjikisht vaksina, që mund të lidhet me sterilitetin ose infertilitetin," tha ajo.

4.Vaksina shkakton COVID-19

Njerëzit shpesh gabimisht besojnë se një vaksinë do të bëjë që një person të zhvillojë sëmundjen. Thjesht nuk është e mundur.

"Vetë virusi nuk është pjesë e vaksinës. E vetmja gjë që përfshihet në vaksinë është proteina spike - si trupi juaj e njeh virusin", tha Pitzer. "Nuk përfshin aspekte të tjera të virusit që do të shkaktonin COVID-19".

Ndërsa njerëzit shpesh mendojnë se "imuniteti natyror", ajo që zhvillohet pas marrjes së një sëmundjeje, është më e mirë, ekspertët thonë se kjo nuk është e vërtetë.

5. Duhet aplikuar vetëm një here

Vaksina Pfizer-BioNTech dhe vaksina Moderna, kërkojnë dy injeksione. Nëse miratohet, vaksina Johnson & Johnson mund të kërkojë vetëm një injeksion. Ndërsa vaksina Pfizer-BioNTech tregon mbrojtje të fortë pas një doze, ekspertët thonë se njerëzit që marrin vaksinën Pfizer-BioNTech ose Moderna duhet të marrin dy siç rekomandohet.



Keqinformimi rreth vaksinave të koronavirusit filloi të qarkullonte edhe para se të miratohej një vaksinë. Ndërsa ekspertët thonë se disa efekte anësore nga vaksinat mund të ndodhin, këto mite nuk janë të vërteta.


1.Vaksina është e nxituar

Vetëm në nëntë muaj, një vaksinë për Covid-19, vaksina Pfizer-BioNTech, tashmë është aprovuar. Deri në fillim të vitit 2021, të paktën tre vaksina të tjera për t'u miratuar. Ndërsa këto vaksina u zhvilluan shpejt, studiuesit ndoqën të njëjtat procedura që bëjnë kur testojnë ndonjë trajtim mjekësor.

"Sigurisht që ishte një vendosje shumë më e shpejtë sesa më parë, por kjo nuk do të thotë që hapat u anashkaluan ose ndonjë nga aspektet e rëndësishme të vlerësimit u neglizhua", shpjegoi Virginia Pitzer, epidemiolog në SHBA. "Arsyeja pse ishte e mundur të zhvillohej një vaksinë kaq shpejt është se ajo po kalonte në shumë kërkime që kanë vazhduar për vite me rradhë."

2. Vaksina redakton ose ndryshon ADN-në

Vaksina Pfizer-BioNTech përdor ARN për të dhënë proteina 'spike' në qeliza, për të inkurajuar trupin të prodhojë një imunitet ndaj





FLET PËR "EPOKËN E RE", MUSA SELIMI, DEKAN I FAKULTETIT TË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT

Sporti është goditur nga Covidi, duhet ndihmë më e madhe nga shteti



Dekani Musa Selimi është shprehur i lumtur që studentët e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, sportistët dhe klubet sportive me sukses janë duke i bërë ballë virusit "Korona". Ai ka apeluar që shteti ta ndihmojë edhe më shumë sportin derisa të rikthehet normaliteti

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, DHJETOR-JANAR - Dekani i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, Musa Selimi, në këtë intervistë dhënë për numrin festiv të gazetës "Epoka e re", ka thënë se viti 2020 ka qenë mjaft i vështirë si për studentët, po ashtu edhe për klubet sportive dhe sportistët për shkak të pandemisë Covid-19. Më tutje, profesor Selimi ka kërkuar që dora e shtetit të jetë e zgjatur për sportin, në mënyrë që të mos shuhet klubet dhe aktivitetet sportive t'i japin dinamikë jetës në vend. "Janë munduar t'u dalin në ndihmë sportistëve MKRS-ja dhe qeveria, por ka mundësi edhe më shumë të rriten ndihmat dhe të mos kemi shuarje të klubeve. Aktivitetet sportive që i japin dinamikë jetës duhet të vazhdojnë, por me kujdes maksimal derisa të zhduket virusi që e ka trazuar mbarë botën", ka thënë Selimi.

"Epoka e re": Dekan, viti 2020 është karakterizuar me përballje të virusit "Korona". Sa keni arritur ta përmbushni realizimin e planprogramit të paraparë dhe sa ka lënë pasojë ky virus në Fakultetin që drejtoni?

Selimi: Si në të gjitha sferat e tjera të jetës, pasojat janë evidente edhe në fakultetin tonë, por ne jemi munduar të jemi afër studentëve. Fati i mirë është që s'kemi asnjë problem me shëndet nga studentët e as nga stafi. Mësimi online në teori dhe fizikisht në praktikë ka dalë të jetë formë e mirë. Në përgjithësi kemi arritur të përballemi me virusin e padukshëm dhe shpresojmë që në vitin 2021 të rikthehet normaliteti.

"Epoka e re": Cila ka qenë arritja më e madhe e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit dhe cilat janë planet e juaja si drejtues të fakultetit për vitin 2021?

Selimi: Sukseset nuk kanë

munguar, por nuk kemi pasur suksese të theksuara për shkak të izolimit. Konsideroj se do të kthehemi në gjendje normale dhe t'i vazhdojmë aktivitetet.

"Epoka e re": Edhe sporti është goditur fuqishëm nga virusi "Korona". Shumë klube po përballen me kriza financiare dhe disa të tjera po shuhet. Si i shihni këto zhvillime?

Selimi: Virusit 'Korona' e ka goditur fuqishëm mbarë globin. Këtu bën pjesë edhe sporti. Jemi dëshmitarë të një krize të madhe që e ka përfshirë sportin, ku klubet gjigante kanë aplikuar uljen e pagave, prandaj është normale që një krizë e ka përfshirë edhe sportin e Kosovës, i cili edhe para pandemisë nuk ka qenë në gjendjen më të mirë financiare. Uroj të përfundoj sa më shpejt dhe sportistët t'i ndjekin ëndrrat e tyre.

"Epoka e re": Ministria e Sportit dhe Qeveria e Kosovës janë munduar t'i ndalin në ndihmë

sportit. Sipas jush, a është e mjaftueshme kjo ndihmë dhe si duhet të veprohet për t'i shpëtuar klubet nga shuarja?

Selimi: Janë munduar t'u dalin në ndihmë sportistëve MKRS-ja dhe qeveria, por ka mundësi edhe me shumë të rriten ndihmat dhe të mos kemi shuarje të klubeve. Aktivitetet sportive që i japin dinamikë jetës duhet të vazhdojnë, por me kujdes maksimal derisa të zhduket virusi që e ka trazuar mbarë botën.

"Epoka e re": Pavarësisht prej problemeve, xhudistët vazhdojnë të shkëlqejnë në arenën ndërkombëtare, pa përjashtuar edhe disa sporte të tjera. A mund të kemi në një të ardhme të afërt ndonjë sport kolektiv që, krahas xhudos, të arrijë suksese në skenën ndërkombëtare?

Selimi: Mendoj se dëshira është më e madhe se realiteti, por shpresojmë që në një të ardhme edhe në futboll të shkëlqejmë dhe të arrijmë suksese historike. Na duhet të punojmë më shumë me gjeneratat e reja si në sportet individuale, po ashtu edhe në ato kolektive.

"Epoka e re": Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ishte shumë afër një suksesi historik, por u eliminua nga Maqedonia. Më pas rezultatet munguan thujse përgjatë gjithë vitit. Sipas jush, cili ishte faktori kryesor i rënies së formës së përfaqësueses?

Selimi: Ka shumë faktorë, njëri nga ta është mungesa e disa prej futbollistëve kryesor. Ne si një përfaqësuese e re nuk e kemi të lehtë zëvendësimin e menjëhershëm të lojtarëve kryesorë, por jam optimist se kemi një të ardhme të ndritur me përfaqësuesen ku shumë futbollistë janë pjesë e klubeve të mëdha në futbollin evropian dhe pritjet shumë nga ta, pra të sigurohet pjesëmarrja në një eveniment të madh sportiv.

"Epoka e re": Në futboll po vlerësohet se ka ngritje të cilësisë, sidomos pas pjesëmarrjes së klubeve në garat ndërkombëtare, derisa në sportet e tjera kjo po vërehet më pak. Cili është komenti juaj?

Selimi: Kemi ngritje të cilësisë

në futboll, por edhe në disa sporte të tjera. Mirëpo ende jemi larg organizimeve të mirëfillta dhe afatgjata. Nuk mund të punohet me një planifikim gjashtëmuor apo njëvjeçar, por një projekt serioz kërkon kohë më të gjatë që të implementohet.

"Epoka e re": Klubet e futbollit kanë marrë pjesë në garat evropiane, sikurse edhe ato të hendbollit. Si i vlerësoni paraqitjet e tyre?

Selimi: Deri tash nuk kanë treguar rezultatet e pritura, por duhet më shumë punë për organizim që kemi rezultate shumë më të mira. Si vend kemi potencial dhe sportistë të talentuar, vetëm duhet të punojmë më shumë për organizim të klubeve sportive dhe t'i kushtojmë kujdes punës me talentët e rinj.

"Epoka e re": Kur jemi te talentët e rinj në Kosovë, çfarë u rekomandoni atyre?

Selimi: Ne kemi shumë sportistë që po bëjnë karrierë të suksesshme në Evropë. Të rinjtë tanë, nëse duhan të kenë karrierë të suksesshme ndërkombëtare, duhet ta marrin si model Xherdan Shaqirin, Granit Xhakën, Haxhi Krasniqin, por edhe Vedat Muriqin dhe Amir Rrahmanin të cilët nga sporti vendor kanë arritur që me hapa të sigurt dhe punë e disiplinë të madhe të arrijnë deri te një prej kampionateve më të forta evropiane, Seria A. Vendi ynë shquhet si vatër e talentëve vetëm që duhet punë për të arritur majat në sport.

"Epoka e re": Në të kaluarën keni drejtuar me sukses disa klube të futbollit, por që një kohë të gjatë jeni duke qëndruar i heshtur. A do ta merrni drejtimin e ndonjë skuadre në fillim të vitit 2021?

Selimi: Them të drejtën, oferta kam pasur në vazhdimësi, por jam shumë i zënë me punët në fakultet dhe Kampionatin Botëror të Hendbollit që do të mbahet në vitin 2022 në Prishtinë. Futboli po më mungon shumë dhe normalisht se do të rikthehem një ditë, por tash për tash nuk mund të jap ndonjë datë të caktuar.

Sporti i bën ballë Covidit

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, DHJETOR - JANAR - Viti 2020 do të mbahet mend gjatë për shkak të përballjes me pandeminë Covid-19. Ky virus i panjohur goditi botën dhe shumë veprimtari sportive. Prej tij nuk shpëtoi as sporti. Pavarësisht mbylljes tremujore thuajse në të gjithë botën, shumë sporte kolektive dhe individuale u rikthyen dhe përfunduan kalendarin e garave për këtë vit, ani pse me disa ndryshime e me disa shkurtime të numrit të garave. Disa sporte të tjera, si Lojërat Olimpikë të Kampionatit Evropian 2020, janë shtyrë për vitin 2021. Në rrafshin vendor spikatin sukseset e xhudistëve që tashmë janë bërë të zakonshme, kurse për Përfaqësuesen e Kosovës ky vit mund të cilësohet dështim për faktin se pësoi humbje në ndeshjen kryesore të plejofit ndaj Maqedonisë në Shkup dhe e humbi mundësinë e kualifikimit në evropian. Në rrafshin ndërkombëtar veçohen sukseset e Bayern Munchenit që arriti t'i fitojë të gjithë titujt e mundshëm në futboll, kurse piloti i Formulës 1, Lewis Hamilton, e ka fituar titullin e shtatë dhe e ka barazuar rekordin e legjendës Michael Schumacher. Bota e sportit humbi edhe legjendat Komby Bryant dhe Diego Armando Maradona.

Pandemia nuk i ndal sukseset e xhudistëve

23 JANAR - Xhudo vazhdon të jetë sporti kryesor në Kosovë për suksese. Në vitin 2020, edhe përkundër pandemisë, xhudistët e udhëhequr nga Driton Kuka nuk u ndalen dhe arritën t'i sjellin Kosovës medalje ndërkombëtare. Nora Gjakova e ka nisur vitin 2020 me medaljen e bronzë, të fituar në Grand Prixin e xhudos në Tel Aviv të Izraelit. Kampionia e Evropës 2018 dhe nënkampione e 2019-s fitoi të bronzën në kategorinë -57 kilogramë përmes repesazhit. Ajo mposhti në luftën për të bronzën portugezen Telma Monteiro. Në muajin shkurt medalje ari dhe bronz rrëmbeu ekipi i xhudos në kryeqytetin e Francës, Paris.

Distria Krasniqi, e cila pas gati dy vjetësh garoi në kategorinë -52 kilogramë, fitoi medaljen e artë. Ajo në finalen e zhvilluar para rreth 20 mijë shikuesve mposhti medalisten e argjendtë të Lojërave Olimpikë Rio 2016, italianen Odette Giuffrida. Medalje, por të bronzë fitoi edhe Nora Gjakova në kategorinë -57 kilogramë. Nora fitoi medaljen e bronzë, pas fitores ndaj francezes, Leonie Cysique. Në muajin tetor xhudistët iu



Pandemia nuk i ndal sukseset e xhudistëve

rikthyen garave me sukses të plotë. Një e artë dhe një e bronzë ishte bilanci i ekipit olimpik të xhudos, nga pjesëmarrja në Grand Slamin e xhudos, që për tri ditë u mbajt në Budapest të Hungarisë. Distria Krasniqi fitoi të artën, duke dominuar kategorinë deri në 48 kilogramë. Ajo në finale mposhti kampionen olimpikë "Rio 2016", Paula Pareto. Medalja e bronzë, por në kategorinë -78 kilogramë, ishte rezervuar për Loriana Kukën, e cila fitoi medaljen e parë në një Grand Slam. Kuka në finale mposhti rusen Antonina Shmeleva. Distria Krasniqi, po ashtu, ka fituar medaljen e bronzë në Kampionatin Evropian të xhudos, në Pragë të Republikës së Çekisë. Distria mposhti me ippon francezen Melanie Clement, kategoria deri në 48 kilogramë. Loriana Kuka është medaliste e bronzë e Evropës në kategorinë -78 kilogramë të xhudos. Ajo fitoi të bronzën në Kampionatin Evropian Pragë 2020. Në luftën për të bronzën Lori mposhti italianen Giorgia Stangherlin me shënim të artë.

Bryanti dhe vajza e tij humbin jetën pas rrëzimit të helikopterit

26 JANAR - Viti 2020 nisi jo mirë për adhuruesit e sportit dhe me gjerë, pasi në fund të muajit janar ndërroi jetë ish-basketbollisti i njohur i Shteteve të Bashkuara, Kobe Bryant, pas përplasjes së helikopterit të tij privat me të cilin po udhëtonte në Kaliforni. Bryant, 41 vjeç, dhe vajza e tij, Gianna, 13 vjeçe, ishin në mesin e nëntë njerëzve të vdekur nga kjo përplasje. Bryant, pesë herë kampion i NBA-së (Asociacionit Kombëtar të Basketbollit), ka luajtur për LA Lakers gjatë gjithë karrierës së tij 20-vjeçare dhe konsiderohet një nga lojtarët më të mëdhenj në historinë e basketbollit botëror.

Muhamet Ramadani, kampion i Ballkanit në hedhjen e gjyles

9 SHKURT - Muhamet Ramadani ka treguar forcën e tij edhe në kampionatin ballkanik U-20 të atletikës në sallë, që u mbajt në Stamboll të Turqisë. Ramadani fitoi medaljen e artë në hedhjen e gjyles 6 kg. Ai e hodhi gjylen në largësi 19.20 metra, duke lënë pas garuesit nga Turqia e Greqia. Në këtë disiplinë garoi edhe Alaudin Suma, i cili doli i shtati me distancë 15.89 m.

Karateistët e Kosovës rrëmbejnë tri medalje të bronzta në Kampionatin Evropian

9 SHKURT - Tre karateistët e Kosovës arritën të stolisen me medalje të bronzë në Kampionatin Evropian "Budapest 2020", që u mbajt për grupmoshat kadetë, juniorë dhe U-21. Albulena Gërvalla, Vesa Ibrahimimi dhe Benjamin Shabani fituan medaljet e bronzta në grupmoshën U-21. Sukses arriti edhe Djellza Sejdiqaj që shënoi dy

fitore, ndërsa garuesit e tjerë u ndalën kryesisht në luftën e parë dhe të dytë. Një ditë më parë Betim Maliqi kishte fituar, po ashtu, të bronzën për juniorë (kategoria -68 kg). Karateja u përfaqësua në evropian me 29 garues.

Përurohet shtatorja e kampionës olimpikë, Majlinda Kelmendi

28 SHKURT - Në muajin shkurt është përuar shtatorja e kampionës olimpikë Majlinda Kelmendi. Ceremonia e inaugurimit të shtatores u mbajt në Parkun e Qytetit të lindjes së Majlindës në Pejë. I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos, Marius Vizer. Shtatorja ishte dhuratë nga Federata Ndërkombëtare e Xhudos për Kosovën.

Peja, fituese e Kupës. Covidi ndërpret Superligën

15 SHKURT - KB Peja ka fituar Kupën e Kosovës në basketboll, pasi e ka mposhtur në finale KB Yllin, me rezultat 79:64 (9:26, 22:21, 20:10, 13:22). Kjo ishte kupa e pestë në histori të Klubit Peja, ndërsa e para që nga viti 2015. Ndërsa Superliga në të dyja konkurrencat është ndërprerë me një vendim të Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), i cili e mori një vendim të tillë për shkak të përhapjes së madhe të pandemisë Covid-19. Në këtë mënyrë nuk është shpallur kampioni për edicionin 2019/20 në asnjë konkurrencë.

Covidit shtyn Lojërat Olimpikë për vitin 2021

24 MARS - Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" janë shtyrë deri në verën e vitit 2021. Ky vendim është marrë

pas një bisede telefonike mes presidentit të KON-it, Thomas Bach dhe kryeministrit të Japonisë, Shinzo Abe. Të dy udhëheqësit Bach dhe Abe ranë dakord që Lojërat Olimpikë të XXXII-ta të mbahen në një datë tjetër pas vitit 2020, por jo më vonë se vera e vitit 2021, në mënyrë që të ruhet shëndeti i sportistëve dhe të gjithë atyre që janë të përfshirë në Lojërat Olimpikë.

Boksierët rikthehen në Kosovë me avion privat të Behgjet Pacollit

28 MARS - Pas shfaqjes së rasteve të para të personave me Covid në Kosovë, delegacioni i boksit mbeti i bllokuar në Londër, kurse me ndihmën e ish-zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Jashtëm, Behgjet Pacolli, është bërë i mundur rikthimi i tyre në Prishtinë, pra me avionin privat të Pacollit. Ekipi i boksit ndodhej në Londër, ku po merrte pjesë në turneun kualifikues evropian për Lojërat Olimpikë "Tokio 2020", turne i cili u pezullua për shkak të koronavirusit. Ekipi i boksit më pas qëndroi 15 ditë në karantinë në Qendrën e Studentëve në Prishtinë.

Qeveria ndryshon, Dumoshi mbetet në krye të Ministrisë së Sportit

3 QERSHOR - Vlora Dumoshi ka vazhduar punën në krye të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit edhe në qeverinë Hoti, e cila është votuar më 3 qershor nga 61 deputetë, 24 vota ishin kundër dhe 1 deputet kishte abstenuar. Dumoshi ishte ministre e MKRS-së edhe gjatë katër muajve të vitin 2020 kur Qeveria e Kosovës drejtohej nga Albin Kurti. Ministrija Dumoshi ka qenë mjaft aktive duke përkrahur shumë projekte sportive të cilat ishin në proces nga vitet e mëparshme ku një ndër to ishte edhe përfundimi dhe përurimi i Palestrës së Sporteve në Istog, në të cilin kishin zgatur punimet plot 16 vjet.

Liverpooli shijon titull pas 30 vjetësh, Reali rrëzon Barçën

16 QERSHOR - Paris Saint Germaini është shpallur kampion i Ligës 1, pasi Liga e Francës (LFP) mori vendim për përfundimisht e parakohshëm të kampionatit për shkak të krizës së Covid-19. LFP-ja, po ashtu, ka shpallur Lorientin kampion të Ligës 2. Në ligat e tjera të mëdha evropiane u



Qeveria ndryshon, Dumoshi mbetet në krye të Ministrisë së Sportit



vazhdua futbollit dhe kampion në La Liga doli Real Madridi. Kjo skuadër, pas rikthimit të futbollit nga pandemia, ishte superiore dhe arriti ta tejkalojë Barcelonën. Reali shpallet kampion për herë të 34-t në histori të klubit, një xhiro para përfundimit të sezonit në La Liga me 86 pikë. Ndërsa në Angli, Liverpools është shpallur kampion pas 30 vjetësh. "Redsi" e siguroi titullin e 19, shtatë xhiro para përfundimit të sezonit, ndërsa në Gjermani titullin e ka mbrojtur Bayerni, sikurse që e mbrojti Juventus në Itali.

KH Besa fitoi titullin dhe Kupën. KHF Ferizaj e fiton titullin, KHF Vushtrria e fiton Kupën

28 QERSHOR - KH Besa Famgas ka kompletuar një edicion perfekt duke ia shtuar Kupën e Kosovës trofeut të kampionit që e kishte fituar më herët (të shtatën radhazi). Besa Famgas në finale të Kupës e mposhti Prishtinën me rezultat të ngushtë, 23:21. Ndërsa në konkurrencën e femrave, Ferizaj e fitoi titullin ku në finale e mposhti Istogu. Ndeshja e parë në Ferizaj u fitua nga skuadra vendase me rezultat 34:29, ndërsa Istogu më pas fitoi me rezultat 27:26, por festa u takoi lojtarëve të Ferizajt. Vushtrria u shpall fituese e Kupës në hendboll në konkurrencë të femrave, ku në finale e mposhti Istogun me rezultat 22:17. Finalja ishte interesante e cilësore, ndërsa të dyja skuadrat kanë luftuar deri në fund pa kursyer asgjë, por ishin vushtrriaset që shfaqën më shumë dhe fituan finalen e madhe.

Drita arrin sukses historik në Ligën e Evropës

8 GUSHT - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, në gjysmëfinalen e fazës parakualifikuese të Ligës së Kampionëve e ka mposhtur ekipin nga Andorra, Inter Club D'escaldes (2-1) dhe është kualifikuar në finale. Golat e fitores për Dritën i shënuan Xhevdet Shabani dhe Hamdi Namani. Në finale Drita duhej të përballlej me kampionin e Irlandës së Veriut, Linfield, por ndeshja u anulua dhe UEFA mori vendim që ndeshja të regjistrohet me rezultat 0-3 për skuadrën e Linfieldit. Gjilanasit garat i vazhduan në Ligën e Evropës, duke e shënuar një sukses historik për futbollin e Kosovës. Drita bëhet skuadra e parë vendore që do të marrë pjesë në rrethin e tretë të Ligës së Evropës. Drita në Shkup ka triumfuar kundër ekipit nga Maqedonia e Veriut, Sileksit (0-2). Golat u shënuan nga Fidan Gërbeshi dhe Ardian Limani. Në raundin e tretë Drita pësoi humbje në Varshavë të Polonisë nga Legia (2-0). Pavarësisht prej humbjes dhe eliminimit, Drita pati paraqitje dinjitoze ndaj skuadrës polake.

Pjesëmarrëse në Ligën e Evropës si nënkampione e Kosovës ishte edhe Gjilani. Kjo skuadër u eliminua pas humbjes që pësoi në stadiumin "Fadil Vokrri", pas vazhdimeve nga skuadra e njohur qipriote, APOEL Nicosia (0-2). Në këtë garë pjesëmarrëse ishte edhe Prishtina si fituese e Kupës së Kosovës, por kryeqytetasit janë eliminuar me rezultat zyrtar 0-3 në favor të Lincolnit. UEFA e mori një vendim të tillë pasi Prishtinës i rezultuan tetë lojtarë me Covid.

Hendbollistët e Kosovës pësuan humbje nga Mali i Zi dhe Suedia

8 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll ka zhvilluar dy ndeshje kualifikuese për "Euro 2022". "Dardanët" në të dyja



Krasniqi shpallet kampion bote në kategorinë IBO dhe WBA



Themelohet Liga Unike e Basketbollit Shqipëri - Kosovë

ndeshjet kanë pësuar humbje edhe përkundër angazhimit të madh. Kosova fillimisht pësoi humbje në Podgoricë nga Mali i Zi, kurse më pas u mposhtën në Prishtinë nga Suedia me rezultat 30:16. Suksesin hendbollistët "dardanët" do ta kërkojnë në ndeshjet e vitit 2021.

Drita fitoi titullin dhe Superkupën, Prishtina Kupën

22 KORRIK - Skuadra e Dritës së Gjilanit e ka festuar titullin e tretë në historinë e saj. Skuadra nga Gjilani një javë para se të

mbyllet kampionati e siguroi titullin e kampiones për stinorin 2019/20, pasi në ndeshjen e parafundit Gjilani luajti baras me Ballkanin (2-2). Ndërsa FC Prishtina është shpallur fituese e Kupës në futboll për sezonin 2019/2020, duke e mposhtur 1-0 Ballkanin në finalen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri". Golin e vetëm të ndeshjes e shënoi Otto John. Skuadra e Dritës e fitoi edhe Superkupën e Kosovës, ku në finale e mposhti skuadrën e Prishtinës me rezultat 2-1.

Themelohet Liga Unike e Basketbollit Shqipëri - Kosovë

10 SHTATOR - Ditë historike për basketbollin dhe sportin e Kosovës dhe Shqipërisë u



Lakersat e rikthyen titullin pas 10 vjetësh në NBA

Verë e bereqetshme për futbollistët shqiptarë

13 SHTATOR - Pavarësisht prej virusit "Korona", afati kalimtar për futbollistët shqiptarë ka qenë i bereqetshëm. Transferimi më i madh mund të vlerësohet ai i sulmuesit Vedat Muriqi nga Fenerbahçe në Lazio për 20 milionë euro, mirëpo nuk duhet harruar edhe kalimin e Amir Rahmanit nga Verona te Napoli. Ndërsa në Serinë A u transferua edhe një futbollist "dardan", Mërgim Vojvoda, i cili iu bashkua Torinos nga Standardi. Ndërsa mesfushori Valon Berisha iu bashkua Arbër Zenelit në skuadrën e Reimist në Francë. Nga futbollistët e Kombëtares së Shqipërisë spikat transferimi i Marash Kumbullës nga Hellas Verona te Roma.

Krasniqi shpallet kampion bote në kategorinë IBO dhe WBA

11 TETOR - Boksieri shqiptar Haxhi Robin Krasniqi arriti suksesin më të madh në karrierën e tij, duke u shpallur kampion bote për peshat gjysmë të rënda në federatat IBO dhe WBA. 33-vjeçari i lindur në Junik, por që garon me flamurin gjerman, mposhti pas tre raundesh me nokaut Dominic Boesel. Krasniqi i cili e nisi duelin si sfidant e

meritoi fitoren, që është e para për një boksier me prejardhje shqiptar. E djathta e tij shembi dy herë në tapet rivalin në ringun e GETEC Arena në Magdeburg. Në fund Robin Krasniqi festoi me flamurin shqiptar. Kjo ishte sfida e 51-të që Krasniqi fiton në ringun profesionist në 57 duele të karrierës 15-vjeçare.

Lakersat e rikthyen titullin pas 10 vjetësh në NBA

12 TETOR - Edhe përkundër pandemisë Covid-19, NBA vendosi të rikthehet edhe pse me disa rregulla të reja. Los Angeles Lakers është shpallur kampion, duke u rikthyer pas dhjetë vjetësh te titulli kampion në basketbollin amerikan. Në ndeshjet finale Lakersat e mposhtën Miami Heatin që u detyrua të dorëzohet në duelin e gjashtë të cilat i luajti të gjitha në maksimumin e mundësisë së saj.

Bayerni mbledh gjithë trofetë

7 KORRIK - Bayern Munchen ka shkëlqyer gjatë vitit 2020, duke i mbledhur të gjithë titujt e mundshëm. Klubi gjerman fillimisht bëri ndryshim në krye të shtabit teknik, ku në vend të Niko Kovaqit e angazhoi Hansi Flickin, i cili e shndërroi Bayernin në një klub të



Verë e bereqetshme për futbollistët shqiptarë

papërbalueshëm. Bayerni e fitoi Ligën e Kampionëve, pasi në finale e mposhti PSG-në me rezultat 1-0, derisa "bavarezët" e fituan edhe Bundesligën si dhe Kupën e Gjermanisë. Në finalen e zhvilluar në "Olimpiastadion" të Berlinit, Bayerni iu imponua Bayer Leverkusenit teksa e theu me rezultatin 4-2 për ta fituar Kupën e Gjermanisë për të 20 herë në historinë e tij. Më pas Bayerni e rrëmbeu edhe trofeun e Superkupës, pasi në finale e mposhti Borussia Dortmundin (2-3). Ndërsa në finale të Superkupës së Evropës, Bayerni e mposhti Sevillan me rezultat 2-1. Koha e rregullt përfundoi me rezultat 1-1, kurse në vazhdimë "bavarezët" shënuan golin e fitores.

Covidi anulon çmimin për 'Topin e Artë'

20 KORRIK - Çmimi "Topi i Artë"



Bayerni mbledh gjithë trofetë

fitores me anë të Velkovskit (2-1). Përfaqësuesja e Kosovës në futboll nuk pati rezultate të mira në vitin 2020, pasi përfundoi e treta në grupin 3 të Ligës C, me vetëm pesë pikë të grumbulluara.

Shqipëria fiton Ligën C

18 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë e ka fituar grupin e 4-t

Hamiltoni fiton titullin e shtatë, barazohet me legjendën Schumacher

15 NËNTOR - Lewis Hamiltoni fitoi Çmimin e Madh të Turqisë. Kështu piloti britanik i Mercedesit e barazoi gjermanin Michael Schumacher, i cili ishte shtatë herë kampion bote në



Kosova humbi shansin të kualifikohet në Evropian

(Ballon d'Or) që ndahet për futbollistin më të mirë të vitit nuk është ndarë në vitin 2020 për shkak të pandemisë Covid-19. Organizuar nga revista "France Football", ngjarja nuk do të mbahet për herë të parë që nga viti 1956 për shkak pandemisë. Revista njoftoi se për shkak të Covidit nuk ka kushte të mjaftueshme sikurse vitet e kaluar dhe se kjo pamundëson që lojtarët të mund të vlerësohen në kushte të barabarta dhe të drejta.

Kosova humbi shansin të kualifikohet në Evropian

8 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll, edhe përkundër paraqitjeve të mira në Ligën e Kombeve, nuk arriti të kualifikohet në Kampionatin Evropian, pasi pësoi humbje në Shkup nga Maqedonia e Veriut (2-1), në gjysmëfinale të kësaj lige. Vendasit kaluan në epërsi me autogolin e Kolollit, kurse Hadërgjonaj barazoi rezultatin në 1-1. Në pjesën e parë, Maqedonia shënoi golin e

në Ligën C, pasi në ndeshjen e fundit e ka mposhtur Bjellorusinë me rezultat 3-2. Kuqezinjtë në këtë mënyrë e mbyllën me sukses edicionin në Ligën e Kombeve dhe në edicionin e ri do të bëjnë gara në Ligën B. Sokol Cikalleshi shënoi dy gola për kuqezinjtë, kurse një tjetër gol e shënoi Rey Manaj. Për bjellorusët golat i shënuan Maksim Skavysh dhe Max Ebong.

Formula 1. Para këtij titulli, Hamiltoni ka fituar titullin e botëror në 2008, 2014, 2015, 2017, 2018 dhe 2019.

Joan Miri për herë të parë shijon titullin në MotoGP

15 NËNTOR - Joan Mir e ka fituar titullin e tij të parë në karrierë në MotoGP. Vendi i 7-të në Çmimin e Madh të Komunitetit Valencian i mjaftoi 23-vjeçarit spanjoll për ta



Hamiltoni fiton titullin e shtatë, barazohet me legjendën Schumacher

festuar fitimin e titullit kampion në klasën mbretërore, një titull në kohë pandemie me pilotin e Suzukit që u favorizua gjatë këtij sezoni edhe nga lëndimi i Marc Marquezit që në garën e parë dhe tërheqja e tij nga të gjitha ndalesat e tjera të këtij edicioni. Mir për të festuar matematikisht titullin u ndihmua edhe nga vendi i 4-t i shokut të tij të skuadrës Alex Rins dhe nga rrëzimi që në fillim i francezitet Fabio Quartararo. Një garë para fundit të sezonit spanjollit i Suzukit u shpall matematikisht kampion i MotoGP.

Basketboll / Kosova fiton dy ndeshje dhe humb dy të tjera

26 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll e ka nisur mirë kampanjën parakualifikuese për Kupën e Botës 2023. E prirë nga Dardan

pak kohë para se të vdiste e kishte kryer një operacion të ndërlikuar, pas një goditje të rëndë në tru dhe gjendja e tij ishte e stabilizuar, aq sa mjekët kishin dhënë lejen për ta vazhduar kurën në një shtëpi pranë dy vajzave të tij. Por jo gjithçka shkoi mirë sepse, sipas raportimit të Clarin në Argjentinë, legjenda e futbollit botëror pësoi një arrest kardiak në shtëpinë e tij, në San Andres, në qytetin e Tigre. Sipas raportimeve, ambulanca dhe ekipi i specializuar i mjekëve bënë maksimumin për ta mbajtur në jetë, por në fund nuk ia arritën qëllimit të tyre. Maradona më 30 tetor festoi 60-vjetorin e lindjes. Stadiumi i Napolit e mori emrin e tij.

Joshua gjunjëzoi Pulevin

13 DHJETOR - Anthony Joshua e ka nokautuar dy herë në raundin e tretë Pulevin, por bullgari u kthye në lojë dhe arriti të rezistojë deri



Fikret Shatri realizoi rrugëtimin sfidues nga Prishtina në Tiranë

Berisha e Drilon Hajrizi, Kosova e ka mposhtur Islandën 80:78, në ndeshjen e parë parakualifikuese për Kupën e Botës 2023. "Dardanët" kanë vazhduar me fitore, duke mposhtur edhe Luksemburgun në udhëtim, 84:80. Më të dalluarit ishin Drilon Hajrizi me 25 pikë dhe Erjon Kastrati me 19 sosh. Kosova ka pësuar dy humbje në muajin nëntor. Fillimisht Kosova pësoi humbje nga Sllovakia me rezultat 91:67 (21:9, 21:20, 20:13, 29:25), kurse më pas u mposhtë edhe nga Islanda me rezultat 86:62 (21:17, 24:12, 22:14, 19:19). Kosova ndeshjet e fundit në grup do t'i ketë në muajin shkurt të vitit të ardhshëm, ku do të përballet me Sllovinë dhe Luksemburgun.

Shuhet ylli argjentinasi Diego Maradona, stadiumi i Napolit merr emrin e tij

25 NËNTOR - Legjenda e futbollit botëror dhe një nga më popullore në të gjithë globin, Diego Armando Maradona, më 25 nëntor është ndarë nga jeta. Ish-ylli i Napolit dhe Barcelonës

në raundin e nëntë ku pësoi edhe dy nokdaunë të tjera. Me këtë fitore Joshua ka mbrojtur titujt e tij në pesha të rënda si WBA, IOBF dhe WBO. Pas kësaj fitore, Joshua pati një mesazh edhe për Furyn: "Kushdo që i ka brezat dua të luftoj kundër tij. Nëse ai është Tyson Fury, le të jetë Tyson Fury".

Fetahu i besohet udhëheqja e FBK-së edhe për katër vjet

18 DHJETOR - Arben Fetahu është rizgjedhur kryetar i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Në Kuvendin e Rregullt Zgjedhor të FBK-së ishin të pranishëm 29 delegatë dhe të gjithë ishin pro kandidaturës së Fetahut. Po ashtu, janë zgjedhur edhe dy nënkryetarët e FBK-së: Linda Shala dhe Artan Kurti. Ndërsa janë zgjedhur edhe shtatë anëtarë të Bordit: Teuta Abdullahu, Arben Bislimi, Rrahman Përteshi, Artan Qerkini, Alban Ramën, Valton Bilalli, Egzon Fetiu. Ndërkohë në Këshillin Mbikëqyrës janë zgjedhur: Fidan Hamiti, Shaqir Totaj dhe Artan Spahija.



Fikret Shatri realizoi rrugëtimin sfidues nga Prishtina në Tiranë

Fikret Shatri realizoi rrugëtimin sfidues nga Prishtina në Tiranë

4 KORRIK - I stërlodhur dhe me lot gëzimi dhe tejet krenar në shpirt, atleti Fikret Shatri ka realizuar rrugëtimin sfidues nga Prishtina për në Tiranë. 45-vjeçari nga Istogu vrapoi 257 km, derisa shkaku i një lëndimi të vogël, kilometrat e fundit i përfundoi duke ecur. Shatri arriti rreth orës 15:30 te sheshi "Skënderbeu" në Tiranë, pas 45 orësh rrugëtim. Ai ishte nisur më 2 korrik në orën 18:00 nga sheshi "Skënderbeu" në Prishtinë. Motoja e tij ishte:

"Vrapi i shqipes nga Skënderbeu n'Skënderbe".

Donjeta Sadiku, e argjendte në turneun ndërkombëtar "Balkan"

25 TETOR - Donjeta Sadiku ka fituar medaljen e argjendte në turneun ndërkombëtar të boksit "Balkan", të mbajtur në Sofje të Bullgarisë. Donjeta në finale u përballë me kampionen botërore, brazilianen Ferreira Beatriz, e cila ndodhet e para në renditjen botërore të AIBA-s, kategoria -60 kg. Donjeta edhe në finale shfaqti luftë të barabartë, duke treguar se është

në formë të mirë para garave që vlejné për pikë olimpikë. Në finale drejtësinë e ndau gjyqtari ndërkombëtar Latif Demolli.

Boksieri Mustafiq fitoi medaljen e bronzte

21 NËNTOR - Boksieri i Kosovës, Remzo Mustafiqe, ka fituar medaljen e bronzte në Kampionatin Evropian për të Rinj (17-18 vjeçar), në Budva të Malit të Zi. Remzo u mposht në gjysmëfinale nga ukrainasi Mykyta Gorbatenko, kategoria deri në 91 kilogramë. Mustafiq kishte mposhtur në çerekfinale izraelitin Manuchar Kriheli.

Drejtësinë në Budva 2020 e ndau edhe gjyqtari ndërkombëtar Latif Demolli.

Dy medalje evropiane për taekwondistët

14 DHJETOR - Dy medalje të bronzta ishte bilanci i medaljeve të fituara nga taekwondistët e rinj në kampionatin evropian për kadetë që u mbajt në Sarajevë të Bosnjë e Hercegovinës. Jon Gashi dhe Elion Agushi u ngjitën në podium, në kategoritë 61 kilogramë, përkatësisht 57 kg. Agushi mposhti rumunin Stefan Agrisan, ndërsa u mposhtë në gjysmëfinale nga Fahrudin Adilović i Bosnjë e Hercegovinës. Gashi triumfoi ndaj polakut Mikolaj Sokolowski, për t'u ndalur më pas në gjysmëfinale.

Kosova mbeti pa shumë sportistë

15 DHJETOR - Shumë personalitete që gjithë jetën ia kushtuan sportit kanë ndërruar jetë gjatë vitit 2020 në Kosovë. Ish-gazetari i sportit në Radio Kosovë, Avni Shabani, ishte në mesin e atyre që shkuan në amshim. Personalitetet që ndërruan jetë gjatë këtij viti ishin: Shaban Demiri (gjyqtar i hendbollit), Daver Haskuka (ish-kryetar i KH Prizreni), Shefqet Sinani (ish-futbollist), Gëzim Kaçaniku (trajner i futbollit), Rexhep Shehu (gazetar), Emin Dushullovc (ish-sekretar i FSK-së),

Shaqir Shaqiri (ish-kryetar i KOK-ut), Afrim Qorrolli (ish-hendbollist).

Klubet e hendbollit, të suksesshme në garat evropiane

19 DHJETOR - Dy skuadra nga Kosova, Besa Famgas dhe Prishtina, ishin të suksesshme në garën e Kupës Evropiane. Kampionia në fuqi, Besa, nuk ia arriti të kualifikohet në një të tetën e finales së Kupës Evropiane edhe përkundër që e fitoi ndeshjen e parë 24:22, por e humbi ndeshjen e dytë me tri gola dallim (23:20) nga Boraci. Ndërsa Prishtina u eliminua në rrethin e tretë, pasi pësoi dy humbje nga AEK-u (37:19, 41:8). Hendbollistëve të Istogut u ka munguar fati për të kaluar në raundin e katërt të Kupës Evropiane. Istogu në raundin e tretë u eliminua nga skuadra bjelloruse Victoria - Berestie. Ndeshjen e parë, të shtunën, Istogu e fitoi 33:30, por të dielën istogaset pësuan me katër gola dallim, 32:28 dhe kështu skuadra bjelloruse avancon në raundin tjetër. Në këtë garë pjesëmarrëse ishte edhe Vushtrria, por kjo skuadër është eliminuar pikërisht nga një tjetër skuadër e Kosovës, Istogu. KHF Ferizaj është eliminuar nga Kupa Evropiane në kuadër të rrethit të tretë nga skuadra turke Muratpasha Belediyesi. Ferizaj ndeshjen e parë e humbi me rezultat 40:15, kurse ndeshjen e dytë e humbi me rezultat 32:16.



Shuhet ylli argjentinasi Diego Maradona, stadiumi i Napolit merr emrin e tij



Portieri i Bayernit ndërron gruan, por jo shijen

Beqaria e Manuel Neuerit nuk ka shkuar më tepër se katër muaj. Pas ndarjes nga bashkëshortja e tij, me të cilën ishte i martuar prej dy vjetësh, portieri i Bayern Munchenit ka gjetur partnere të re. Por këtë herë femra në krahët e tij është vetëm 19 vjeçe, plot 15

vjet më e re se Neueri. E, megjithatë, përpos moshës, ajo që habit më shumë është ngjashmëria me ish-gruan, Nina. Të dyja bionde dhe me tipare të përafërta, ndërsa ndajnë edhe pasione të njëjta si ai për kuajt. Sipas asaj që raporton "Bild",

Anika studion për modë dhe ka një pasion të madh për sportin, teksa luan në Bundesligën 2 të hendbollit. Ndërkohë mësohet se të dy kanë nisur të jetojnë në vilën luksoze të Neuerit, i cili e ka prezantuar partneren e re edhe me nënën e tij.

E dashura e Neymarit me foto provokuese 'çmend' rrjetet sociale

E dashura e Neymar JR, Natalia Barulich, provokoi sërish në rrjetet sociale. Bukuroshja amerikane ka publikuar një foto në rrjetin zyrtar në "Instagram". Format

e saj pranë pemës së Krishtlindjes janë të përkryera. "Jeni sjellë mirë apo keq? Tregohuni të sinqertë", shkruan e dashura e Neymarit.



Sharapova: Ja pse vendosa të tërhiqem nga sporti

Në shkurt të këtij viti tenistja ruse Maria Sharapova vendosi të tërhiqet nga sporti në moshën 33-vjeçare. Një lamtumirë disi e papritur kjo e tenistes bukuroshe që, në fakt, prej disa vitesh nuk po arrinte të jepte atë që të gjithë prisnin në fushë. Duke folur për mediat, në lidhje me tërheqjen e saj nga sporti, Sharapova ka deklaruar: "Edhe pse isha e përqendruar, kuptova se po lodhesha kot duke luajtur, pasi si



teniste e kisha humbur kontaktin me kompeticionin. Kjo e bëri të vështirë të gjithë procesin. Bashkë me stafin tim kuptova se nuk do të merrja më asgjë nga fusha e tenisit dhe se duhej të përqendrohesha në aktivitete të tjera. Nuk doja që të më njihnin vetëm si ish-fituese. Nëse do të merresh me sport duhet të jesh 100 % në çdo drejtim. Unë kisha humbur shumë kontakt me këtë sport".

Wanda e Icardit nuk njuh limite

Wanda Nara nuk njuh limite me pozat e nxehta që publikon në rrjetet sociale. Nëna e pesë fëmijëve "tërboi" ndjekësit në "Instagram" me foto nudo. 33-vjeçarja pozoi e shtrirë mbi një kalë, tërësisht e zhveshur, duke shfaqur format bombastike trupore. Bashkëshortja e



Mauro Icardit nuk la vend për imagjinatën me foton seksi.

Portieri i Shqipërisë ua prezanton të dashurën prindërve

Thomas Strakosha kaloi një periudhë të vështirë teksa para një muaji rezultoi pozitiv me koronavirus dhe për këtë arsye ishte i detyruar të qëndronte jashtë fushave të lojës. Përveç Lazios, Strakosha i është kthyer edhe familjes së tij që jeton në Athinë dhe përbëhet nga nëna, babai, Foto Strakosha dhe vël-lai Dimitris. Portieri i kombëtares ka udhëtuar drejt Greqisë, por nuk ishte i vetëm. Ai ka marrë me vete edhe të dashurën e tij Ester Adjoa Asiedu për ta çuar në shtëpi për t'ua prezantuar prindërve. Gjatë udhëtimit për në Greqi Strakosha nuk ngurroi të pos-



tonte edhe fotografi përkrah partneres së tij, teksa e shoqëroi me shkrimin: "Zemra ime u kyç".

Basketbollistja seksi italiane, relaksohet në vaskë



Basketbollistja seksi italiane Valentina Vignali vijon t'i magjepsë fansat përmes postimeve "hot" në rrjetet sociale. Ajo ka postuar së fundi një tjetër foto provokuese, e veshur me bikini, duke u larë në një vaskë të mbushur me shkumë. "Relaks", komenton basketbollistja italiane, e njohur edhe në fushën e modës si modele. Ajo ka treguar edhe një herë format seksi për fansat.



D P A
 Departamenti për punë administrative
 Department for administrative works
 Prishtinë me 30.12.2020 | Nr. 2027

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, KRU „Prishtina“ sh.a. – Prishtinë, publikon:

KONKURS PUBLIK
 Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Kompani

1. Dy (2) Inxhinier të Hidroteknikës,
2. Dy (2) Arkatar në pikat e inkasimit për zonën e veprimit të Kompanisë,
3. Dy (2) Teknik të elektros – elektrikista,
4. Pesë (5) Operator të Pompave për zonën e veprimit të Kompanisë,
5. Tre (3) Kimist Laborant për zonën e veprimit të Kompanisë,
6. Shtatë (7) Ujëinstalues për zonën e veprimit të Kompanisë,
7. Nëntë (9) Punëtor fizik për zonën e veprimit të Kompanisë,
8. Tre (3) Pastrues për zonën e veprimit të Kompanisë.
9. Një (1) Nëpunës në Qëndren e thirrjeve.

Kushtet :

Për kryerjen e këtyre punëve, përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të kenë:

Për pikën 1: Kandidatët duhet të kenë: - Fakultetin e Ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknik, sistemi pesë vjeçar apo Master Shkencor (MSc), së paku 2 (dy) vite përvojë pune, ne menaxhim te projekteve (ndërtim të sistemeve të furnizimi me ujë dhe kanalizim), njohje të softuerëve profesionale, njohja e gjuhës angleze është me përparësi.

Për pikën 2: Kandidatët duhet të kenë: Përgaditjen e mesme shkollore; së paku 1 (një) vit përvojë pune; aftësi të mira për komunikim me konsumator.

Për pikën 3: Kandidatët duhet të kenë: - Përgaditje te mesme teknike - Elektroteknikë, së paku 1 (një) vite përvojë pune, patentin për shofer kategoria “B”

Për pikën 4: Kandidatët duhet të kenë: - Përgaditje te mesme teknike, Elektro ose makineri, së paku 1 (një) vite përvojë pune, patentin për shofer kategoria “B”

Për pikën 5: Kandidatët duhet të kenë: - Përgaditje te mesme teknike, drejtimi kimi - teknologji, - së paku 1 (një) vit përvojë pune, - njohuri në teknologjinë e trajtimit të ujit të pijes.

Për pikën 6: Kandidatët duhet të kenë: - Përgaditjen e mesme teknike, drejtimi instalues i ujit apo trajnime profesionale dhe certifikime shtese ne fushen e Hidro Instalimeve, - së paku 1 (një) vite përvojë pune, - njohuri në sisteme te instalimeve te ujit, - patentin për shofer kategoria “B”, përparësi do të kenë kandidatët e certifikuar në sisteme të ujësjellësit, saldime apo fusha tjera relevante

Për pikën 7: Kandidatët duhet të kenë: - Përgaditjen fillore apo të mesme shkollore; aftësi të mira fizike dhe shëndetsore; - vullnet të mirë për këto punë.

Për pikën 8: Kandidatët duhet të kenë: - Përgaditjen fillore apo të mesme shkollore; aftësi të mira fizike dhe shëndetsore; - vullnet të mirë për këto punë.

Për pikën 9: Kandidati duhet të ketë: Përgaditjen e mesme shkollore; së paku 1 (një) vit përvojë pune; aftësi të mira për komunikim me konsumator.

Punët dhe detyrat e punës: Sipas Rregullorës për Përshkrimin të punëve dhe detyrave.

Orari i punës: Puna me orar të plotë.

Paga mujore: Sipas Rregullores.

Kohëzgjatja e kontratës: Kohë të pacaktuar, me një periudhë të punës provuese prej 6 muajsh.

Inkurajojmë pjesëtarët e komunitetit joshumicë që të aplikojnë në Konkursin e publikuar.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- diploma e përgaditjës shkollore;
- kopja e letërnjoftimit;
- çertifikata e lindjes;
- vërtetimi i përvojës së punës (ku është kërkuar);
- Certifikata që nuk është nën hetime më e re se 6 muaj;

Procedura për aplikim: Aplikacioni merret në Kompani ose në web-faqën e Kompanisë, të njëjtit i bashkëngjiten fotokopjet e dokumenteve personale dhe dokumentacioni tjetër të kërkuar sipas Konkursit dhe dërgohen në adresën KRU „Prishtina“ sh.a. në Prishtinë, Rr. „Hazir Shala“ nr.4, në zyrën nr. 44, më së voni deri me datën **18.01.2021** në ora **16.00**.

Vërejtje: Kërkesat e kandidatëve me dokumente të pakompletuara, do të refuzohen ndersa ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Dokumentacioni i dorëzuar përmes postës pranohet brenda afatit prej 72 orësh pas mbylljes së konkursit. Dokumentacioni pranohet në kopje dhe nuk u kthehet kandidatëve.

Rruga “Hazir Shala” nr.4, Prishtinë
 Tel + 381 38 54 12 11, +381 38 55 10 10
 Fax + 381 38 54 14 37

www.kur-prishtina.com
 E-mail: info@kur-prishtina.com



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -VI ada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr.503/1

Dt. 29.12.2020

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN ENXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021 KLASËT E 10-ta PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË PROFESIONAL – MESIMI PER TE RRITUR

Për plotësimin e vendeve të lira regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë(10) në Shkollën e Mesme të Lartë Teknike “11 Marsi” në Prizren, shpallim këto drejtime:

I. Makineri			
1	Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit	1 Paralele	24 nxënës
2	Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit	1 Paralele	24 nxënës
3	Automekanik	1 Paralele	24 nxënës
4	Dizajn i Metaleve	1 Paralele	24 nxënës
II. Ndërtimtari			
1	Arkitekturë	1 Paralele	24 nxënës
2	Ndërtimtari	1 Paralele	24 nxënës
III. Artet e aplikuara			
1	Dizajn Veshje	1 Paralele	24 nxënës
IV. TRANSPORT			
1	Trafik Rrugor	1 Paralele	24 nxënës
V. Elektroteknikë			
1	TIT	1 Paralele	24 nxënës
2	Informatikë	1 Paralele	24 nxënës
3	Instalues Elektrik	1 Paralele	24 nxënës

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimin për të rritur në shkolla profesionale, për vitin shkollor 2020/2021, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe që janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftësive në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (ecila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesë origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve, bëhet 15 ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës SHMLT “11 Marsi” në Prizren, nga ora 9:00-16:00.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Gëzuar Vitin e Ri 2021!

- ### Quality & Sales Award Recipients
- (Listed in alphabetical order)
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

